



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**

**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

**“BASHKIA SARANDË”**

**Tiranë 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit .....	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	11
<b>II. HYRJA.....</b>	<b>14</b>
1. Objektivat e auditimit.....	14
2. Qëllimi i auditimit .....	14
3. Identifikimi i çështjes .....	14
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	15
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	15
6. Kriteret e vlerësimit .....	15
7. Standardet e auditimit .....	16
8. Metodologjia e auditimit.....	16
9. Dokumentimi i auditimit .....	17
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>17</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	17
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	18
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	18
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, viti 2022. ....	22
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.....	53
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve. ....	74
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	114
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimin të territorit.....	120
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. ....	125
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. ....	126
2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	146
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>148</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i OE
OE	OE
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Sarandë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Buxheti për vitin 2022 është realizuar në masën 76%, ku zëri investime paraqitet i realizuar në masën 59%;
- Drejtoria e të Ardhurave nuk ka në strukturën e saj sektor të menaxhimit dhe mbledhjes së borxhit;
- Në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton një gjendje e konsiderueshme prej 511,887,154 lekë, nga e cila, debitorët për taksat dhe tarifat vendore në masën 68 % të totalit. Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se dhe kjo vlerë nuk është e saktë, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet debitorë nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje në shumën 74,782,000 lekë dhe detyrimet nga abonentët familjarë në shumën 259,314,461 lekë;
- Në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*”, janë kontabilizuar gabim **16 artikuj** aktive materiale në vlerën 78,696,463 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël;
- Në llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*”, janë kontabilizuar gabim **25 artikuj** aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël;
- Lejet e ndërtimit të audituara janë miratuar në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, duke evidentuar mangësi që lidhen me treguesit e distancave ndërmjet ndërtimeve dhe pronave etj;
- Nuk janë aplikuar masa administrative për kundërvajtjet e kryera në fushën e mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje;
- Të ardhura të munguara nga parkimet e rezervuara janë në vlerën **380,000 lekë**;
- Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 2567 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën **321,676 mijë lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë;
- Vlera e detyrimeve që lindin nga kontratat e qirave për asetet, është **3,195,540 lekë**;
- Vlera e detyrimeve nga taksat e ndikimit në infrastrukturë është **85,315 mijë lekë**;
- Vlera debitore në fund të vitit 2022 për taksën e tokës bujqësore është **25,675 mijë lekë**;
- 9 procedura me vlerë të fondit limit **137,262 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ofertat ekonomike të OE të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT;
- Ka diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **320,000 lekë pa Tvsh**.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr .	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i asetëve në pronësi/përdorim të Bashkisë Sarandë, kaluar me VKM respektive, rezulton se për miradministrimi e tyre nuk janë ndjekur si duhet identifikimin i gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë nga Bashkia në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre, pasi shumica e asetëve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël. (faqe 58-79 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për evidentimin në terren të të gjitha pronave (asetëve) të kaluara në pronësi/ përdorim bashkisë me VKM.</p> <p>Të hartojë regjistrin e pronave, duke evidentuar pronat të pashfrytëzueshme, prona të zaptuara nga të tretë, pronë të shfrytëzueshme për interes të bashkisë, si dhe të përgatisë dhe regjistrojë në ASHK Dega të gjitha pronat aktive dhe në interes të bashkisë për realizimin e të ardhurave.</p> <p>Në bashkëpunim me DBNj të ngrejë Drejtorinë/Strukturën e administrimit të asetëve, si një strukturë e domosdoshme dhe efikase për administrimin e pronave të Bashkisë Sarandë.</p>
2	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton një gjendje e konsiderueshme në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 511,887,154 lekë, nga e cila: debitorët për taksat dhe tarifave vendore për vlerën 348,067,442 lekë ose 68 % të totalit dhe vlera e lartë e gjendjes prej 163,812,712 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat evidentohet fakti se nga Bashkia nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e tyre, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore duke kaluar afatet e kërimit.</p> <p>Gjithashtu evidentohet dhe fakti se megjithëse janë debitorë ndaj kësaj bashkie, këto shoqëri vijnë të lidhin kontrata me Bashkisë pa mundësuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe mos lejinin e tyre në procedura.</p> <p>Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se dhe kjo vlerë nuk është e saktë, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet debitorë nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ALUIZNI) në shumën 74,782,000 lekë dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë.</p> <p>Nga auditimi është konstatuar dhe fakti se detyrimet për shpërblim dëmi në vlerën 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9 datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022, <b>nuk janë të kontabilizuar</b> si detyrime dhe nuk është kryer asnjë verim për njoftimin e tyre, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022. (faqe 58-79 të RPA)</p>	E lartë	<p>- Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DPZHT dhe Drejtorinë e të ardhurave, të marrin masa për rakordimet vjetore të vlerës së debitorëve në fund të periudhës për të gjitha llojet e Taksave. Tarifave vendore, duke kryer kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare.</p> <p>Të kontabilizohet në llog 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 74,782,000 lekë për taksën e ndikimit nga ndërtimet informale (ALUIZNI) dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë, si dhe të kontabilizohen vlera shpërblim dëmi prej 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022.</p> <p>- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e procedurave të prokurimit të mos lidh kontrata shërbimi/ zbatimi në subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë për detyrimet debitorë të ardhura nga auditimet e KLSH apo institucionet të tjera.</p> <p>Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomikë të marrin të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për vjeljen e detyrimeve në <b>shumën 163,812,712 lekë</b>, sipas listës analitike që disponon Sektori i Financës në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.</p>
3	<p>Nga auditimi ka rezultuar se llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 115,397,833 lekë.</p> <p>Referuar analizës së inventarit kontabël të llog. 210 “Toka Troje Terrene”, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim <b>16 artikuj</b> aktive materiale në vlerën 78,696,463 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në shumën 38,169,299 lekë kjo për 4 artikuj dhe llog. 211 “Pyje dhe plantacione” në shumën 40,527,164 lekë kjo për 12 artikuj, pra kemi pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 210 “Toka Troje Terrene”, konkretisht pasqyra 1, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022. (faqe 58-79 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për analizimin e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në shumën totale prej 115,397,833 lekë dhe për <b>16 artikuj</b> në vlerën 78,696,463 lekë që nuk i përkasin kësaj llogaritë të kontabilizohen në llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në shumën 38,169,299 lekë për 4 artikuj dhe llog. 211 “Pyje dhe plantacione” në shumën 40,527,164 lekë për 12 artikuj, etj.</p>
4	<p>Nga auditimi ka rezultuar se llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,102,204,443 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,134,852,828 lekë.</p> <p>Referuar analizës së inventarit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer pra vlerës së ndërtesave nuk i është shtuar vlera e konstruksionit, por janë trajtuar si artikuj kontabël me vete.</p> <p>Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim <b>25 artikuj</b> aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog.</p>	E lartë	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për analizimin e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,852,828 lekë duke i shtuar vlerën e konstruksionit ndër vite (investimit), si dhe sistemimin <b>25 artikuj</b> aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog. 202 “Studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë, etj</p> <p>Të inventarizohet me analizë të veçantë për çdo artikull vlera prej 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”.</p>

	<p>213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog 202 “studime e projektme” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211-“Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987lekë.</p> <p>Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022. (faqe 58-79 të RPA)</p>		
5	<p>Nga auditimi ka rezultuar se llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,134,107,522 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,382,689,240 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 248,581,718 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj.</p> <p>Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, në këtë llogari rezultojnë asete të cilat i përkasin UK Sha, që duhet të zbriteshin nga kontabiliteti për <b>6 artikujaktiv në vlerën 582,222,531 lekë</b>. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022. (faqe 58-79 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për transferimin e të gjitha aktiveve që nuk i përkasin kësaj bashkie, kryesisht të <b>6 artikujnë vlerën 582,222,531 lekë</b> që i përkasin Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.</p> <p>Të analizohet me kujdes llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për investimet e kryera në fushën e ujësjellësit dhe për objektet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet transferimi i tyre në Ndërmarrjen së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.</p> <p>Të analizohet vlera prej 29,568,137 lekë e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson.</p>
6	<p>Nga auditimi ka rezultuar se llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerë bruto 76,117,705 lekë për të cilat ka inventar fizik. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim <b>8 artikuj</b> aktive materiale në vlerën <b>1,814,418 lekë</b>, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022. (faqe 58-79 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për analizimin e llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë bruto 76,117,705 lekë për kontabilizimin gabim të <b>8 artikuj</b> aktive materiale në vlerën <b>1,814,418 lekë</b>, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”.</p>
7	<p>Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:</p> <p><b>a-</b> me nr. 513, datë 31.05.2022, për subjektin ndërtues “E.D.S.M.C.” Shpk . (zhvilluesi Ll. L.), për objektin: “Godinë shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë”, Bashkia Sarandë.</p> <p>Nga plani i vendosjes konstatohet se distanca në orientimin verior është 4.2 metër nga 5 metër që është distanca minimale e lejuar për një objekt 4 kate,si dhe në pjesën jugore objekti është ngjitur me kufirin e pronës.</p> <p><b>b-</b> me nr. 491, datë 20.04.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk (zhvilluesit: S..Zh.) për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rr. ‘S.’, Bashkia Sarandë. Nga planvendosja e miratuar nga ana e DPZHTK, Bashkia Sarandë, konstatohet se distanca e objektit nga kufiri i pronës në anën perëndimore dhe veriore nuk është në përputhje me nenin 35 “Distanca e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Distanca duhet të ishte 7 metër jo 1 dhe 1,2 metër.</p> <p><b>c-</b> me nr. 484, datë 08 .04.2022, për subjektin ndërtues “M&amp;S K.” Shpk, (zhvilluesi OE “O.” Shpk) me, për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me 1 kat parkim”, Rr. ‘B.’, Bashkia Në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar, referuar VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 6 kate është 7 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.</p> <p><b>d-</b> me nr. 554, datë 18.10.2022, për subjektin ndërtues “M&amp;S K.” Shpk, (zhvilluesi I.I.) , për objektin: “Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë” Bashkia Sarandë. Në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar bazuar mbi rregulloren e planifikimit të territorit VKM nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 4 kate është 5 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.</p> <p><b>e-</b> me nr. 534, datë 25.07.2022 (2888) për subjektin ndërtues “M&amp;S K.” Shpk, (zhvilluesi: Th..R.) për objektin: “Strukturë 4 kate me 1 kat nën tokë” NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. Distanca e lejuar nga</p>	E lartë	<p>Nga DPKZHT të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.</p>

	<p>kufiri i pronës duhet të ishte jo më pak se 5 metër. Në këtë rast rezulton të jetë me vogël se 5 metër.</p> <p>f- me nr. 537, datë 04.10.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk, (zhvilluesit “S.E.G A.” Shpk) I. N. dhe S.Zh. për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, Rr. “B. G.”, Bashkia Sarandë.</p> <p>Nga planvendosja e miratuar konstatohet se edhe në këtë rast distanca nga kufiri i pronës nuk janë në përputhje me rregulloren e planifikimit të territorit në veri dhe jug janë pothuajse ngjitur me kufirin e pronës, ndërsa në lindje 1 metër nga kufiri i sajë. Distanca minimale për një objekt 4 kate duhet të ishte 5 metër. Distanca nga prona janë më të vogla se ato të lejuara. (faqe 130-135 të RPA)</p>		
8	<p>Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat: a. me nr. 550, datë 17.10.2022 për subjektin ndërtues “A. ” Shpk, (zhvilluesi H. H. ), për objektin: “Shtesë në lartësi 2 kate dhe shtesë anësore 1 kat në objekt ekzistues 3 kat në fuksion të turizmit”, Bashkia Sarandë.</p> <p>b. me nr. 551, datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues “A.” Shpk, (zhvilluesi G.S.), për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat me 1 kat nëntokë, në fuksion të Turizmit”, Bashkia Sarandë.</p> <p>c. me nr. 456 datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “M&amp;S K.” Shpk, (zhvilluesi Z. F.), me , për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat, në fuksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë</p> <p>d. me nr. 458, datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “I ” Shpk, (zhvilluesi A. Ç. dhe Zh. Ç.) për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat, në fuksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë.</p> <p>e. me nr. 499 datë 23.03.2022 për subjektin ndërtues “M&amp;S K.’ Shpk, (zhvilluesi L. Gj.) , për objektin: “Shtesë 2 kate dhe 1 kat parkim nën tokë në objekt ekzistues 1 kat” afati kohor i kësaj leje është 24 muaj. Për lejet e mësipërme të miratuara nga ana e urbanistikës, bashkia konstatohet se nuk janë kërkuar akt-ekspertiza nga inxhinier të licencuar për këto situata. Këto shtesa kati të miratuara a ndikojnë në qëndrueshmërinë e dhe aftësinë mbajtëse të strukturës dhe themeleve të objektit. (faqe 130-135 të RPA)</p>	E lartë	<p>Nga DPKZHT të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane, të merren masa për të miratuar leje ndërtimitin e shtesave të merret konfirmim nga inxhinieri i licencuar me anë të akt-ekspertizës se shtesa e ndërtuar mbi objektin ekzistues nuk ndikon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të strukturës.</p>
9	<p>Disa prej procesverbaleve nga të cilat janë nxjerrë vendime qoftë prishje qoftë vendim me gjobë deri në 500,000 lekë të reja janë nxjerrë pa emër të identifikuar. Për procesverbalin me nr. 0000168 me kundërvajtje “Hedhja e materialeve inerte në argjinaturë” nuk është mbajtur vendim prishje apo kthim në gjendjen fillestare. Kundërvajtja e konstatuar është lenë deri në fazën e proces-verbalit të kundërvajtjes dhe nuk ka vazhduar me fazat e tjera si vendim gjobë apo vendim prishje. (faqe 135-137 të RPA)</p>	E lartë	<p>Nga ana e IMT bashkia të merren që kundërvajtjet e konstatuara të dalin me vendime sipas legjislacionit në fuqi ligji 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” neni “Neni 13 Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/ kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.</p>
10	<p>Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, civile apo penale, sip as rastit.</p> <p>Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.</p> <p>Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që Bashkia ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës.</p> <p>Nga të dhënat, konstatohet se DTTV Bashkia menaxhon 36 subjekte me parkim me pagesë për vlerën 3,020,000 lekë, nga e cila likuiduar vlera 2,640,000 lekë dhe nuk është likuiduar vlera <b>prej 380,000 lekë</b>, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se për një numër vend parkimesh, bashkia nuk kishte informacion dhe nuk ishin taksuar për vendet që ato</p>	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar numrin e parkimeve të rezervuara nga subjekte private që operojnë në territorin e Bashkisë si dhe të shikohet mënyra e taksimit e të gjitha parkimeve të rezervuara. Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 380,000 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë nga parkimet e rezervuara.</p>

	shfrytëzimin dhe për të cilat kanë dhe të vendosur në tabelën. (faqe 25-58 të RPA)		
11	<p>Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në territorin e Bashkisë ushtrojnë aktivitet 2 subjekte për shfrytëzim karriere (gurore) në sipërfaqet pyjore/kullosore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18.</p> <p>1-OE “P.” Shpk, me NIP K0 ushtron aktivitet në parcelën 17 me emërtesë (Vollider) me sipërfaqe totale 37.02 ha.</p> <p>OE është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo shoqëri nuk ka kontratë qiraje me Bashkinë Sarandë. Nga OE janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.20201), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në <u>certifikatë pronësie</u>.</p> <p>Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasurinë shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.</p> <p>Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën <b>5,778,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 10.7), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varion në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.</b></p> <p>2-OE “I.-B.” Shpk me nip J6. ushtron aktivitet në parcelën 4 me emërtesë (C. U.) me sipërfaqe totale 92.08 ha.</p> <p>OE është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 – 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo OE nuk ka kontratë me Bashkinë Sarandë.</p> <p>OE disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje. Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.</p> <p>Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën <b>8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varion në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.</b></p> <p>Nga sa trajtohet më sipër, Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia duhet të vijojë me procedurat për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore/ kullosore në shfrytëzim nga subjektet e mësipërme, ku për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore dhe nuk janë lidhur kontrata, duhet të bëhet pezullimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore, deri në momentin e çregjistrimit nga fondi pyjorë kullosor për saktësimin e pronarit të pronës.</p> <p>Nëse pas daljes së VKM për destinacionin se kush është pronarë i ligjshëm i sipërfaqes për të cilën është lëshuar leja minerale dhe nëse ajo është në juridiksion të Bashkisë Sarandë, të lidhen kontratat e qirasë. (faqe 25-58 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për dy Subjektet “P. Shpk dhe “I.-B.” Shpk , të cilët nuk kanë kontratë me Bashkinë dhe kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.</p> <p>-Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P. Shpk e “I.-B.” Shpk pa kontratë qiraje deri më 31.12.2022, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për shoqërinë “P.” Shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë “I.-B.” Shpk në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.</p>
12	<p>Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia për taksimin dhe tarifimin e subjekteve me aktivitet “Hoteleri” rezulton se për vitin 2022 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 18,456 mijë lekë, ose 77% e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel. Pra nuk evidentohet, sa dhoma ka hoteli disponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në</p>	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.</p> <p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 13,433 mijë lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.</p>



	<p>strukturat akomoduese të Bashkisë Sarandë, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.</p> <p>-Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 13,433 mijë lekë për 494 subjekte. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e fjetjes në hotele, konstatohet se nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë, nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerë 13,433 mijë lekë. (faqe 25-58 të RPA)</p>		
13	<p>Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, u konstatua se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 2461 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 317,290 mijë lekë. Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 2567 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 321,676 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. (faqe 25-58 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 321,676 mijë lekë.</p>
14	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 37 kontrata qiraje për objekte dhe truall në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,987,800 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2022 vlera 1,363,860 lekë, <b>duke mbetur për likuidim vlera 3,195,540 lekë.</b></p> <p>Referuar kushteve të kontratës neni 7 pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet me nënshkrimin e kontratës për llogari të institucionit. Gjithashtu nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të këtij neni nga bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve të kontratës, veprime në kundërshtim me neni 7 të kontratës së qirave të subjekteve. (faqe 25-58 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej <b>3,195,540 lekë</b>, nga kontratat e qirave. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.</p>
15	<p>Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 85,315 mijë lekë për 2210 subjekte, nga të cilat 356 subjekte për vlerën 11,109 mijë lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga DPZHT Bashkia Sarandë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Sarandë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mos pagesës së TNI, t’i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. (faqe 25-58 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 85,315 mijë lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.</p> <p>Kryetari i Bashkisë nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi.</p>
16	<p>Nga auditimi i veprimtarisë në Drejtorinë e të Ardhurave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë dhe NJA për vitin 2022 janë taksuar 17508 familje. Me qëllim vlerësimit nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se</p>	E lartë	<p>Drejtoria e të Ardhurave Bashkia në bashkëpunim me Administratorin e Njësisë Administrative Ksamil, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataknuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrimit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2022,</p>

	për vitin 2022 janë taksuar 1189 familje më pak. -Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit, për numrin e familjeve të pa taksuara, do të kishim 3,600 lekë * 1189 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,280,400 lekë planifikuar më pak. (faqe 25-58 të RPA)		rezultojnë 4,280,400 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.
17	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IVMT Bashkia Sarandë, u konstatua se deri Më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 320,000 lekë, Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përbarimit gjyqësor. (faqe 25-58 të RPA)	E lartë	Kryeinspektori i IVMT Bashkia në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura. Kryeinspektori i IVMT Bashkia në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.
18	Nga auditimi i procedurave të ndjekura për miratimin e lejeve të ndërtimit, në një rast u konstatua përlllogaritje e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 228,066 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. (faqe 130-135 të RPA)	E lartë	Kryeinspektori i IVMT Bashkia në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura. Kryeinspektori i IVMT Bashkia në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.
19	Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e TNI për disa nga objektet me lej ndërtimi dhe përdorimi, rezulton se nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash për Bashkinë në shumën <b>2,887,019 lekë</b> , konkretisht: <b>1.</b> - Leja me nr. 536, datë 19.09.2022, për subjektin ndërtues “K.U.K” Shpk, me zhvillues Xh. M. , për objektin: “Hotel 4, 5 dhe 6 kate me 4 kate nëntokë” adresa e realizimit të punimeve: Rr. “B. ”, Bashkia Sarandë Nga fatura e ngarkuar në sistemin “e-Leje” për këtë praktik pasqyrohet se është paguar shuma 5,136,071 lekë. Duke u bazuar mbi vlerën e preventivit që është 263,582,227.43 lekë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paketës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe 263,582,227.43 lekë x0.03=7,907,466. Ka një diferencë prej <b>2,771,395 lekë</b> shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë. <b>2.</b> -Leja me nr. 456, datë 15.02.2022 (2415) dhënë subjektit ndërtues “M&S K.” Shpk, zhvilluesit: Z. F.,Leja e ndërtimit për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat, në funksion të Turizmit: NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. afati kohor i kësaj leje është: 24 muaj. Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paktës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe preventivi është 15,476,498 lekë x0.03=464,294. Kemi një diferencë prej <b>115,624 lekë</b> nga fatura e paguar me atë të llogarit, shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë. (faqe 26-76 të RPA)	E lartë	Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës <b>2,887,109 lekë</b> , duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, <i>respektivisht:</i> - <b>vlera 2,771,395 lekë</b> nga investitorit <b>Xh. M. .</b> - <b>vlera 115,624 lekë</b> nga investitori <b>Z. F. .</b>
20	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikualifikim .....”, Sarandë, me vlerë të kontratës <b>18,394,920 lekë</b> me Tvsh, fituar nga OE “J. K. ” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>190,000 lekë pa Tvsh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 17 prot., datë 06.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe OE “J. K. ” Shpk. (faqe 124-130 të RPA)	E lartë	Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>190,000 lekë pa Tvsh</b> nga OE “J. K. ” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 20.12.2020, me objekt “Rikualifikim .....”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
21	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Riveshje Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i Rr. “J. K.” Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës <b>10,512,051 lekë me</b>	E lartë	Nga Bashkia të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>52,000 pa Tvsh</b> nga OE “N. -” Shpk , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11 prot., datë 14.11.2022, me objekt: “Riveshje

	<b>Tvsh</b> , fituar nga OE “N. -” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>52,000 lekë pa Tvsh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 11 prot., datë 14.11.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia dhe OE “N. -” Shpk. (faqe 124-130 të RPA)		Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T.” dhe rikualifikim i Rr. “J, K.” Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
22	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi “A. Sh.”, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve në B., Ç., M.”, Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës lekë me Tvsh, fituar nga OE “M. /” Shpk , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>78,900 lekë pa Tvsh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 15 prot., datë 15.12.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia dhe OE “M. /” Shpk. (faqe 124-130 të RPA)	E lartë	Nga Bashkia të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>78,900 lekë pa Tvsh</b> nga OE “M. /” Shpk , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi “A. Sh.”, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve në B., Ç., M.”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
23	Nga auditimin e 9 procedurave me vlerë të fondit limit <b>137,262 mijë lekë</b> , janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura <b>me vlerë kontrate 130,882 mijë lekë</b> ose 95 % e vlerës së Fondit Limit, në të cilat kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nga auditimin e 9 procedurave në 2 (dy) procedura prokurimi me vlerë të fondit limit <b>69,595 mijë lekë</b> , janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP procedura <b>me vlerë kontrate 68,924 mijë lekë</b> ose 99 % e vlerës së Fondit Limit ofertat ekonomike të OE të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në 2 (katër) procedura për vlerë kontrate <b>68,924,867 lekë pa Tvsh</b> . (faqe 79-124 të RPA)	E lartë	Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike prej 69,959 mijë lekë. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës. Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysht tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret e vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

### 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (balance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes**, për llogaritë vjetore të Bashkisë Sarandë, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Sarandë, bazuar në analizën e riskut<sup>1</sup>, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriteret jo të plotësuar, materiale dhe të përhapura që janë baza për dhënien e një opinioni të kualifikuar, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë **69,595 mijë lekë**

#### Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 3 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **320 mijë lekë**.

- Në mos marrjen e masave për regjistrimin e pronave të bashkisë kaluar me VKM në pronësi të saje.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga;

<sup>1</sup>Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari te lidhura me to; 467-Kreditore te ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230-231-investime.

### **Opinion i auditimit:**

#### **Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Sarandë, për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, shënimet shpjeguese, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj, duke konkluduar në një

#### **Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje:**

*Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”. Këto anomali janë të shprehura te baza për opinionin e auditimit.*

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshtetur më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 1,187 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2022, si dhe anomali të mëposhtme:

**1.** Mos marrja e masave për arkëtimin e debitorëve të paraqitur në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 511,887,154 lekë, si dhe mos kontabilizimi në këtë llogari të detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale prej 74,782,000 lekë, të abonentëve familjarë me vlerë 259,314,461 lekë dhe detyrimeve shpërbllim dëmi prej 10,317,50 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022,

**2.** Mos analizimi i llog. 202 “Studime dhe projekte”, konstatohet se nga 114 studime dhe projekte në vlerën 119,561,177 lekë, për evidentimi e projekteve që janë vënë në zbatim dhe kapitalizimi i tyre sipas llogarive përkatës 212 ose 213.

**3.** Kontabilizimi gabim në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”, të **16 artikuj aktive** materiale në vlerën 78,696,463 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione” në shumën 38,169,299 lekë kjo për 4 artikuj dhe llog. 211 “Pyje dhe plantacione” në shumën 40,527,164 lekë kjo për 12 artikuj.

**4.** Kontabilizimi gabim në llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione”, të **25 artikuj aktive** materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog 202 “studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211-“Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë.

**5.** Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” , konstatohet se, në këtë llogari rezultojnë asete të cilat i përkasin UK që duhet të zbriteshin nga kontabiliteti për **6 artikuj aktiv** në vlerën **582,222,531 lekë**.

Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

**6.** Kontabilizimi gabim në llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, të **8 artikuj** aktive materiale në vlerën **1,814,418 lekë**, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”.

## **II- Opinion mbi përputhshmërinë.**

Në auditim ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar materialitetit sipas vlerës së popullatës 1,187 mijë lekë.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Sarandë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**.*

### **Baza për opinionin:**

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkinë Sarandë.

Bazuar në analizën e riskut nga **20** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 292,652 mijë lekë, janë audituar **9** procedura me fond limit **137,262 mijë lekë** ose 52.60% e totalit të procedurave, ku në **9** procedura me vlerë të kontratave **130,8822 mijë lekë** janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e zhvillimit të procedurës dhe **2** procedura me fond limit **69,595 mijë lekë**, OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK, materiale të por jo të përhapura, veprime në paligjshmëri të procedurave të zhvilluara.

Gjithashtu:

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike, ku nga auditimi i 3 kontratave u konstatua dëm ekonomik në vlerën **320 mijë lekë**.

- Në mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore në vlerën **2,887 mijë lekë**.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Sarandë:**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Sarandë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne

vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 314/1 Prot., datë 19.04.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.04.2023 deri në datë 02.06.2023, në subjektin Bashkia Sarandë, u krye Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. G. K. – *Përgjegjës Grupi*
2. K. Gj. – *Anëtar*
3. E. Rr. – *Anëtar*
4. A. D. – *Anëtar*
5. A. G. – *Anëtar*

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për Hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>2</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe Hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Sarandë, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë dhe përgjegjësitë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.11.2019-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

<sup>2</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Sarandë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

#### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

#### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Sarandë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”.
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar;

- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshhta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të



saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për Hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>3</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>4</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## 9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia përbëhet nga qytetet e Sarandës dhe qytezën e Ksamilit, si dhe nga fshatrat Çukë, Metoq, Gjashtë dhe Shelegar. Bashkia kufizohet në veri me bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me Bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia ka dy njësi administrative, qytetin e Sarandës dhe komunën e Ksamilit.

Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia e Sarandës ka një popullsi prej 20,227 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë si popullsi banuese 50,680 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 58.96 km<sup>2</sup>. Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 343 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrit civil, popullsia është 859.56 banorë/km<sup>2</sup>. Bashkia përbëhet tërësisht nga vija bregdetare nga Koka e Qefalit në veri deri te Kanali i Vivarit në jug, ku shërbimet e turizmit detar dhe kulturor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Asetet kryesore ekonomike të qytetit janë deti, peshkimi, liqeni i Butrintit dhe pasuritë e stërmëdha arkeologjike.

<sup>3</sup>ISSAI 1315

<sup>4</sup>*Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit*

## 2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

#### Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Sarandë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

#### **Titulli i gjetjes 1:** *Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*<sup>5</sup>.

**Situata:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

#### **“Mjedisi i kontrollit”**

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në rregulloren e brendshme nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, si për shembull shkëmbimin e informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitet në Bashkinë Sarandë.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.

-Për vitin 2022 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

-Në Bashkinë nuk është hartuar “Harta e procesit për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit”.

-Për vitin 2022 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

#### **“Menaxhimi i Riskut”**

-Nuk është hartuar regjistri dhe strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

<sup>5</sup> Trajtuar më hollësisht në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.1” të projektraportit të auditimit.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Sarandë.  
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengojnë marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

#### ***“Aktivitetet e Kontrollit”***

-Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm.  
-Në Bashkinë Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program kontabiliteti.  
-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.  
-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

#### ***“Informimi dhe komunikimi”***

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.  
- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.  
- Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit. Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive.

#### ***“Monitorimi dhe Raportimi”***

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.  
- Në Bashkinë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.  
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të eficientës dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.  
-Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

*Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Z. A. G. , Kryetar i Bashkisë Sarandë, Znj. T. S. , Drejtore e Financës dhe Buxhetit, Znj. F. E. , specialiste e Burimeve Njerëzore dhe M. M. , Drejtor i Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e regjistrit të riskut.*

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:** E Mesme.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për Hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësive si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.

**Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësive së auditit të brendshëm.**

**Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësive së auditit të brendshëm.**

Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 u miratua me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 61, datë 04.04.2022, si pjesë përbërëse e strukturës organizative për zbatimin e VKB nr. 225, datë 22.12.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Sarandë, Institucioneve në varësi dhe Njesisë Administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2022. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Sarandë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik dhe Kartën e Auditimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhrin nr. 28, e nr. 898 prot., datë 05.04.2022.

Auditi i Brendshëm i Bashkisë është i organizuar me 3 (tre) punonjës, 1 (një) Drejtor dhe 2 (dy) specialist auditë duke u bazuar në nenin 10 në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njesisë auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon;

Struktura e Njesisë AB për vitin 2022

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
	<b>Për vitin 2022</b>							
1	M. M.	Drejtor	13.08.2010	Ekonomi, Financë	43	13	2012	Po
2	K. H.	Specialiste	09.12.2017	Ekonomik, Statistikë	35	6	2018	Po
3	S. P.	Specialiste	05.03.2019	Ekonomik Adm. Biznes	7	4	2021	Po

Burimi: NJAB Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### **Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2022.**

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publike”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Nga auditimi rezultoi se:

**Për vitin 2022**, Plani strategjik 2022-2024 dhe plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr. 4886 prot., datë 04.10.2021, përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në MFE, raporti i veprimtarisë së sektorit të AB, sipas të cilit janë planifikuar për t’u kryer 8 auditime dhe janë realizuar 8, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr Auditim	Subjekte të audituara nga NJAB	Niveli i Riskut	Realizimi i angazhimeve të auditimit			Të përfunduar
					Nr Auditime	Përputhsh	Financiar	
1	Drejtoria Ekonomike	1	Drejtoria Ekonomike	I Lartë	1		1	1
2	Drejtoria e Juridikut	1	Drejtoria e Juridikut	I Mesëm	1	1		1
3	Drejtoria e Taksave Biznesi	1	Drejtoria e Taksave Biznesi	I Lartë	1	1		1
4	Zyra Ekonomike e Arsimit	1	Zyra Ekonomike e Arsimit	I Lartë	1		1	1
5	Ndërmarrja e Shërbimeve	1	Ndërmarrja e Shërbimeve	I Lartë	1		1	1
6	Shtëpia e Fëmijës	1	Shtëpia e Fëmijës	I Mesëm	1		1	1
7	Drejtoria e Shërbimeve	1	Drejtoria e Shërbimeve	I Mesëm	1	1		1
8	Personel, Taksat, Urbanist, Q.Poliv. Sht.Fëmij.Q	1	Detyrimet e prapambetura	I Mesëm	1	1		1
		<b>8</b>	<b>Totali</b>		<b>8</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>8</b>

Burimi: NJAB Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për aktivitetin e vitit 2022 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 383/1 prot., datë 27.01.2023.

-Karta e auditimit të brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë me urdhrin nr.28 prot., datë 05.04.2019.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2022, konstatojmë se janë dhënë 35 rekomandime gjithsej, Rekomandimet janë pranuar të gjitha, prej të cilave nuk është zbatuar asnjë rekomandim, 35 janë në proces zbatimi dhe 0 rekomandime janë pa zbatuar. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

*Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:*

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa Zbatuar
1	2022	35		35		2		3021	
<b>TOTALI</b>		<b>35</b>		<b>35</b>		<b>2</b>		<b>3021</b>	

Burimi: NJAB Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Titulli i Gjetjes 2:** *Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Sarandë, përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022.*

**Situata:** Për vitin 2022 nuk është hartuar plani vjetor i auditimit të brendshëm.

- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njesisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2022-2024 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së miratuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njesisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;

- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njesisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm;

- Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;

- Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2022, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.

- Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Sarandë, të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Zhvillimit Rural ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

- Për vitin 2022 nuk është realizuar auditimi i Personelit, Taksat, Urbanistika, Qendra Polivente, Shtëpia e Fëmijës. Qendra Kulturore, Klub Futboll në përputhje me planin strategjik dhe atij vjetor të vitit 2022 miratuar me shkresën nr. 4886 prot., datë 04.10.2021, si dhe konstatohet që është kryer auditim për detyrimet e prapambetura, por nuk administrohet relacion për ndryshimin e planit të auditimeve, apo të jetë bërë ndryshimi i planit të auditimeve.

Nr	Planifikuar	Kryer
1	Drejtoria Ekonomike	Drejtoria Ekonomike
2	Drejtoria e Juridikut	Drejtoria e Juridikut
3	Drejtoria e Taksave Biznesi	Drejtoria e Taksave Biznesi
4	Zyra Ekonomike e Arsimit	Zyra Ekonomike e Arsimit
5	Ndërmarja e Shërbimeve	Ndërmarja e Shërbimeve
6	Shtëpia e Fëmijës	Shtëpia e Fëmijës
7	Drejtoria e Shërbimeve	Drejtoria e Shërbimeve
8	Personel Taksat, Urbanist, Q. Poliv. Sht. Fëmij. Q. Kulturore. Klub. Futboll	Detyrimet e prapambetura
		<b>Totali</b>

### **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura rezultoi se, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, “Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB)”, pasi në dosje administrohen dokumente që vërtetonin se në çdo auditim është zbatuar programi i sigurimit të cilësisë së AB, në përputhje me Kap. VII, pika 7.1, dhe 7.1.1, të MAB.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shkronjat “i”, “c” dhe “ç” në nenin 6, shkronja “b” në nenin 12, neni 13, shkronjat “ii” dhe “iv” në nenin 14, shkronja “e” në nenin 16; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;

- Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;

- Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Rural apo Drejtorinë Juridike mbi procedurat e prokurimit publik.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Auditit të Brendshëm, të marrë masa për:

-Hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm.

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

**Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhënien e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, prokurimet publike, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

**Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

## 2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, viti 2022.

### - Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022, 2023 dhe 2024.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 178, datë 24.12.2021.

Me shkresën nr. 3902 prot., datë 3.8.2021 dhe Urdhrin nr. 106, datë 3.8.2021, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) si dhe ekipet e menaxhimit të programeve sipas njësive shpenzuese buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2022-2024.

Projekt buxheti afatmesëm për vitin 2022-2024 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në Hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr. 327, datë 28.05.2021 me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2022-2024. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për Hartimin e PBA 2022-2024, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve. Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 10 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2022	
		000/lekë	%
1	Menaxhim, Administrim, Planifikim	694,252	54
2	Mbrojtja nga zjarri	18,999	1
3	Ujitja dhe kullimi	6,576	1
4	Konvikti i shkollës së mesme	18,713	1
5	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	4,650	0
6	Arsimi parashkollor	102,336	8
7	Administrimi i pyjeve	2,716	0
8	Qendra kulturore & shume sportet	25,236	2
9	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	203,610	16

10	Mbrojtje Sociale (PAK)& Ndhimja ekonomike	218,000	17
<b>TOTALI</b>		<b>1,295,088</b>	<b>100</b>

Sipas PBA 2022-2024, tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

### Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2022

A	Të ardhurat	2022	2023	2024
1	Nga taksat	301,600	301,870	305,400
2	Jo tatimore	146,450	150,600	154,900
<b>I</b>	<b>Shuma</b>	<b>448,050</b>	<b>452,470</b>	<b>460,300</b>
1	Transferta e pakushtëzuar	130,312	139,710	149,613
2	Transfertsë specifike	106,800	106,800	106,800
3	Të tjera transf. Spec dhe kushtëzuara	433,852	586,348	491,284
4	Fondet IPA	3,000	3,000	3,100
<b>II</b>	<b>Shuma e transfertave</b>	<b>673,964</b>	<b>835,858</b>	<b>750,797</b>
<b>III</b>	<b>Totali i burimeve të veta (I+II)</b>	<b>1,122,014</b>	<b>1,288,328</b>	<b>1,211,097</b>

**Për vitin 2022** buxheti është miratuar me VKB nr. 179, datë 27.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 15 prot., datë 13.01.2022.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë për vitin 2022 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	V.K.B		Përshkrim	Të ardhura (në 000/lekë)	Struktura e shpenzimeve	Shpenzimet (në 000/lekë)
	Nr.	Datë				
	<b>179</b>	<b>27.12.2021</b>	<b>Miratim buxhetit fillestar</b>		<b>Miratim buxheti</b>	
1			Transferta e Pakushtëzuar	134,873	Shpenzime personeli (600+601)	293,162
2			Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	447,500	Shpenzime korrente (602-609)	309,550
3			Projektet IPA	2,500	Projektet IPA	2,500
4			Transferta e pakushtëzuar sektoriale	109,560	Shpenzime për investime (230+231)	89,221
5					Pagesa për prin cipalin dhe interesin	
			<b>Shuma</b>	<b>694,433</b>		<b>694,433</b>
			<b>Përdorimi i të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2022</b>	<b>230,000</b>		
1			Të ardhurat e trashëguara	230,000	Shpenzime personeli (600+601)	56,104
2			Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore		Shpenzime korrente (602-609)	61,910
3					Shpenzime për investime (230+231)	111,986
			<b>Shuma</b>	<b>230,000</b>	-	<b>230,000</b>
			<b>Total</b>	<b>924,433</b>		<b>924,433</b>

Nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e vetanë shumën 677,500 mijë lekë (të ardhurat e vitit në vlerën 447,500 mijë lekë dhe të trashëguara në vlerën 230,000 mijë lekë) ose në masën 73 %, nga transferata e pakushtëzuar në shumën 134,873 mijë lekë ose në masën 15%, transferata specifike sektoriale në shumën 112,060 mijë lekë ose në masën 12 %.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime janë për vlerën 349,266 mijë lekë ose 38 %, shpenzime korrente zënë 40 % ose për vlerën 371,460 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 22 % ose në vlerën 201,207mijë lekë.

= Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë enjesisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjithashtu gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet, pasi janë kryer shtesa dhe pakësime në artikuj të ndryshëm të buxhetit, sipas nevojave, ku në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me VKB.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të regjistruara e të rakorduara me Degën e Thesarit Sarandë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndryshimet në buxhet gjatë vitit ushtrimor ndërmjet zërave korrente brenda të njëjtit program dhe ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program janë bërë me vendim të Kryetarit të Bashkisë, ndërsa ndryshimet ndërmjet zërave të programeve të ndryshme dhe ndryshimet e ardhura nga rishikimi i buxhetit janë kryer me VKB.

- Ndryshimet buxhetore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Për vitin 2022 në fund të vitit sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Sarandë, buxheti është shtuar për vlerën 370,655 mijë lekë, pra plani sipas thesarit është për vlerën **gjithsej 1,295,088 mijë lekë**.

Grand shtesë për vlerën 88,058 mijë lekë (shtesë të ardhurash nga rakordimi me Degën e Thesarit Sarandë, të paparashikuara), miratuar me VKB nr. 116, datë 21.07.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 675/2, datë 27.07.2022, si më poshtë vijon:

Në 000/lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr. datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
01.01.2022-31.12.2022	179/27.12.2021	1,295,088	116/21.07.2022	88,058	231	88,058			
<b>Totali Viti 2022</b>		<b>1,295,088</b>				<b>88,058</b>		<b>1,383,146</b>	

Ndihmë ekonomike dhe paaftësi dhe shtesë fondi për investime të kryera nga fondet e Ministrisë në vlerën 370,655 mijë lekë.

- Shkalla e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Sarandë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikulle nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarandë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2022 referuar akt akordimeve me thesarin dhe sipas burimeve të financimit paraqitet si më poshtë:

**Për vitin 2022**, sipas situacioneve dhe akt rakordimit me thesarin buxheti i planifikuar për vlerën 1,295,088 mijë lekë dhe është realizuar për vlerën 1,128,213 mijë lekë (906,060 mijë Aparati i Bashkisë dhe 222,153 mijë lekë ndërmarrjet e varësisë), pasqyra:



	EMERTIMI	Viti 2022			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% realizimit
	<b>sipas artikujve te shpenzimeve</b>				
1	<b>Aparati Bashkia</b>	1,046,853	1,225,653	906,060	74
	Llog.600 - Paga	129,994	129,265	101,582	79
	Llog 601 -	19,480	23,658	16,989	72
	Llog 602-	279,377	285,153	230,263	81
	Llogaria 603	-	-	-	-
	Llogaria 604	31,000	33,614	15,807	47
	Llogaria 606	218,000	252,503	246,353	98
	Llogaria 466				
	Llog 230	-	-	-	-
	Llog 231	369,002	501,460	295,066	59
Llog 166+651	5,000	5,000	-	-	
	<b>Shuma</b>	<b>1,046,853</b>	<b>1,225,653</b>	<b>906,060</b>	<b>74</b>
2	<b>Ndërmarrja e Shërbimeve</b>	92,125	96,178	90,335	94
	Llog.600 - Paga	56,752	56,752	53,268	94
	Llog 601 -	11,363	11,363	9,004	79
	Llog 602-	24,010	28,063	28,063	100
	<b>Shuma</b>	<b>92,125</b>	<b>96,178</b>	<b>90,335</b>	<b>94</b>
3	<b>Qendra Kulturore dhe shume sportet</b>	<b>31,487</b>	<b>31,487</b>	<b>28,252</b>	<b>90</b>
	Llog.600 - Paga	18,172	18,172	15,600	86
	Llog 601 -	3,035	3,035	2,611	86
	Llog 602-	10,280	10,280	10,041	98
	<b>Shuma</b>	<b>31,487</b>	<b>31,487</b>	<b>28,252</b>	<b>90</b>
4	<b>Arsimibazeparashkollor</b>	89,684	95,448	73,526	77
	Llog.600 - Paga	58,266	64,030	50,057	78
	Llog 601 -	11,068	11,068	9,040	82
	Llog 602-	20,350	20,350	14,429	71
	<b>Shuma</b>	<b>89,684</b>	<b>95,448</b>	<b>73,526</b>	<b>77</b>
5	<b>Çerdhja e Fëmijëve</b>	15,351	15,351	14,750	96
	Llog.600 - Paga	10,640	10,640	10,460	98
	Llog 601 -	1,836	1,836	1,922	105
	Llog 602-	2,775	2,775	2,368	85
	Llog 606	100	100	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>15,351</b>	<b>15,351</b>	<b>14,750</b>	<b>96</b>
6	<b>Konvikti I shkollës se Mesme Ekonomike</b>	<b>14,938</b>	<b>14,938</b>	<b>10,957</b>	<b>73</b>
	Llog.600 - Paga	6,896	6,896	6,467	94
	Llog 601 -	1,400	1,400	1,066	76
	Llog 602-	6,642	6,642	3,424	52
	<b>Shuma</b>	<b>14,938</b>	<b>14,938</b>	<b>10,957</b>	<b>73</b>
	<b>Arsimiparauniversitar</b>	4,650	4,650	4,333	93
	Llog.600 - Paga	3,076	3,076	3,068	100
	Llog 601 -	514	514	380	74
	Llog 602-	1,000	1,000	885	89
	Llog.606 -	60	60	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>4,650</b>	<b>4,650</b>	<b>4,333</b>	<b>93</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>1,295,088</b>	<b>1,483,705</b>	<b>1,128,213</b>	<b>76</b>

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2022, buxheti është realizuar në masën 76%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,483,705 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,128,213 mijë lekë.

Ndërsa vetëm për aparatit e bashkisë realizimi është në nivelin 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë.

Zëri investime paraqitet në masën 59%, ku nga vlera e parashikuar prej 501,460 mijë lekë është realizuar vlera 295,066 mijë lekë. Shpenzimet operative paraqiten në masën 81%, ku nga vlera e parashikuar prej 285,153 mijë lekë është realizuar vlera 230,153 mijë lekë dhe shpenzimet për paga në masën 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225,653 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë. dhe shpenzime për paga në masën 74%.

Këto mos realizime vijnë nga fakti se struktura organike nuk është plotësuar për numrin e punonjësve të miratuar me VKB dhe se një pjesë e procedurave të parashikuara nuk janë zhvilluar për mungesë stafi, ndërsajpësa tjetër nuk është financuar pasi nga shoqëritë sipërmarrës nuk janë paraqitur për likuidim dokumentacioni i rregullt ligjorë.

Nga të ardhurat e veta planifikimi ka qenë 329,042,460 duke përdorur vlera 131,763,000 lekë ose 40.4%, kjo nga mos realizimi i procedurave të parashikuara në fillim të periudhës.

Nga fondet specifike (FSZH) planifikimi në vlerën 172,368,720 lekë duke realizuar vlerën 163,302,133 lekë ose 94.74%, diferenca vjen nga mos paraqitja e rregullt e dokumentacionit për likuidim.

- *Sipas burimeve të financimit (Aparati dhe njësitë e varësisë)*

**Për vitin 2022, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike (grandi) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 360,906 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 293,751 mijë lekë ose në masën 81 %.**

- *Tabela me të dhënat e buxhetit të parashikuar dhe të realizuar për vitin 2022 për transfertën e pakushtëzuar:*

	EMERTIMI sipas artikujve të shpenzimeve	Viti 2022			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% realizimit
<b>I</b>	<b>Bashkia</b>				
1	Llog.600	17,766	17,766	17,738	100
2	Llog 601 -	3,000	3,000	3,000	100
3	Llog 602-	118,572	118,572	66,802	56
4	Llogaria 603			-	
5	Llogaria 604	2,500	2,500	2,500	100
6	Llog 231	109,508	109,508	98,795	90
7	Llog 166+651				
	<b>Shuma</b>	<b>251,346</b>	<b>251,346</b>	<b>188,835</b>	<b>75</b>

**Për vitin 2022, nga transfertat specifike, (Aparati dhe njësitë e Varësisë) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 109,560 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 188,835 mijë lekë ose në masën 96 %.**

	EMERTIMI sipas artikujve të shpenzimeve	Viti 2022			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% realizimit
<b>I</b>	<b>Bashkia</b>				
1	Llog.600	75,990	75,990	83,097	109
2	Llog 601 -	14,819	14,819	13,778	93
3	Llog 602-	13,550	13,550	8,041	59
4	Llogaria 603			-	
5	Llogaria 604				
6	Llogaria 606	1426	1426		
8	Llog 231	3775	3775		
9	Llog 166+651				
	<b>Shuma</b>	<b>109,560</b>	<b>109,560</b>	<b>104,916</b>	<b>96</b>

*Shënim: Ne akt rakordimin me thesarin rezulton se nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike janë realizuar shpenzimet në vlerën **293,751 mijë lekë (104,916+188,83)***

**Për vitin 2022, nga të ardhurat e veta, (Aparati dhe njësitë e varësisë), treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 560,017 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 427,789 mijë lekë ose në masën 76%, sipas akt rakordimit me Thesarin në 31.12.2022.**

Nr	EMERTIMI sipas artikujve të shpenzimeve	Viti 2022			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% realizimit
<b>I</b>	<b>Bashkia</b>				
1	Llog.600	163,106	163,106	138,640	85
2	Llog 601 -	27,354	27,354	23,251	85
3	Llog 602-	258,319	258,319	216,333	84
4	Llogaria 603			-	
5	Llogaria 604	15,655	15,655	13,307	85
6	Llogaria 606	3,820	3,820	3,291	86
8	Llog 231	91,762	91,762	32,967	36
9	Llog 166+651				
	<b>Shuma</b>	<b>560,017</b>	<b>560,017</b>	<b>427,789</b>	<b>76</b>

**Për vitin 2022, nga transfertat e kushtëzuar, (Aparati dhe njësitë e varësisë) treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 374,165 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 406,673 mijë lekë ose në masën 76%, sipas situacionit të shpenzimeve rakorduar me Thesarin në 31.12.2022.**

Nr	EMERTIMI sipas artikujve të shpenzimeve	Viti 2022			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% realizimit
<b>I</b>	<b>Bashkia</b>				
1	Llog.600		5000	4,933	100
2	Llog 601 -		800	799	100
3	Llog 602-		12,000	11,323	100
4	Llogaria 603				
5	Llogaria 604				

6	Llogaria 606	221,500	226,232	226,232	100
7	llog 231 FSHZH	152,665	163,302	163,302	100
8	Llog 166+651		0		
	<b>Shuma</b>	<b>374,165</b>	<b>407,334</b>	<b>406,673</b>	<b>100</b>

*Tabela e detajuar e investimeve 2022 Bashki + Institucionet e Varësisë*

<b>Investimet 2022</b>					
<b>Institucioni</b>	<b>Përshkrimi i investimit</b>	<b>Pl 2022 rish</b>	<b>Vl e kontratës</b>	<b>Fakt 12m</b>	<b>Diferencë</b>
Bashkia	Riveshje e pjesshme e shtresave asfaltike ne rrugët e Sarandës	5,800	5,174	5,174	0
Bashkia	Blerje kontejnerët per mbeturina	6,173	6,114	6,114	0
Bashkia	Permiresimi i infrastrukturës rrugore dhe e ndriçimit ne periferinë e qytetit ne Metoq, Gjashte dhe Cuke	7,929	6,828	6,828	0
Bashkia	Sinjalistika horizontale, vertikale	8,500	6,544	6,544	1
Bashkia	Lyerje fasadash per Lagjen Nr.4, Kodër	15,600	12,691	9,636	3,054
Bashkia		-	-	3,054	0
Bashkia	Ndërhyrje emergjente per rikonstrukcionin e ures Metoq	14,397	13,680	12,996	683
Bashkia		-	-	682,200	0
Bashkia	Rehabilitim i ish vendgrumbullimit te mbetjeve, Volloder	7,000	5,155	4,932	223
Bashkia	Riveshje me Beton rruga 'Gjergj Araniti, 40 shenjtoret	4,000	3,305	3,305	0
Bashkia	Riveshje rruga "Musa Demi", Shiku & Trotuari rr.L. T. dhe rikualifikim i rrugës "J. K. "	11,200	10,512	10,504	7
Bashkia	Ndërtimi i varrezave publike ne Vulloder	8,000	6,714	6,714	0
Bashkia/ Ministria	Rikonstrukcion , Shkolla 9-vjecare"Adem Sheme", Sarandë	71,515	70,902	0	70,902
Bashkia	Rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen nr.3(Pjesa mbi Spital) dhe rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen "L. D. "	10,999	9,919	9,918	
Bashkia	Rikualifikim I rrugëve te brendshme Gjashte , Metoq, Shelegar	9,000	0	0	0
Bashkia	Investime ne ambientet e Konviktit i Shkollës Ekonomike	3,700	2,984	0	2,984
Bashkia	"Rikonstrukcion te godinës se QKF"	3,952	3,869	0	3,869
Bashkia	Mbjellje pemësh ne rrugët publike	6,000	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>234,267</b>	<b>202,782</b>	<b>89,877</b>	<b>112,905</b>

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se një pjesë e procedurave nuk janë zhvilluar ose janë në proces. Ndërsa pjesa tjetër kontratat nuk janë mbyllur ose nga subjektet sipërmarrës nuk janë paraqitur dokumentacioni i saktë për likuidimin e tyre.

**z. Mbi detyrimet e prapambetura të raportuara Janar-Dhjetor 2022 sipas raportimit në MFE.**

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "Detyrimet e prapambetura", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

<b>Detyrime</b>	<b>Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2021</b>	<b>Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2022-31.12.2022</b>	<b>Total Detyrime</b>	<b>Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022</b>	<b>Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022</b>
Investime	-	-	-	-	-
Investime nga FZSHH	-	-	-	-	-
Mallra dhe shërbime	26,277,310		26,277,310	21,691,163	4,586,147
Vendime gjyqësore	4,124,231	1,163,220	5,287,451	2,109,526	3,177,925
Të tjera			-	-	-
<b>Totali</b>	<b>30,401,541</b>	<b>1,163,220</b>	<b>31,564,761</b>	<b>23,800,689</b>	<b>7,764,072</b>

**Konstatimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 është në vlerën 11,454,695 lekë (nga e cila llog. 401-408 në vlerën 1,163,220 lekë dhe llog. 467 në vlerën 10,291,475 lekë), të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është në vlerën 7,764,072 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar për shumën 3,690,623 lekë më shumë në pasqyrat financiare.

**Situata financiare e Bashkisë Sarandë**

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi situatën financiare që paraqet Bashkia Sarandë, rezulton se është në nivelin e 1.2 %. Në këtë situatë nuk janë paraqitur faturat e palikuiduara me fonde të deleguara (specifike), pasqyra:

<b>N.R</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Stoku në vlerë</b>	<b>Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në</b>	<b>Stoku/ Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së</b>
------------	-----------------	-----------------------	---	--

<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>11,454,695</b>		<b>1.2%</b>
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>6,118,429</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime	5,749,367		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera	3,690,623		
<b>b</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>0</b>		
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>2,014,705</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime	2,014,705		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>11,454,695</b>	<b>924,433,000</b>	<b>1.2%</b>

**Konstatimi:** Situata financiare e Bashkisë Sarandë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 1.2 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

Tabela e detajuar e detyrimeve Janar-Dhjetor 2022

Llog ekonomi ke	Objekti	Subjekti	Fature			Gjendja me 31.12.2022
			Nr	Date	Vlere	
602	Kurora me lule	Y. H. PF	9466	07.05.2020	26,500	26,500
602	Energji	O...			22,446,410	4,542,447
602	Materiale speciale	Sh. V. PF	1	10.05.2018	17,200	17,200
602	Densinfektim	N. Shpk	979/2022	25.07.2022		1,115,520
602	Shpez pritje përcjellje	H. R. A. & S	15	29.11.2022		47,700
<b>Totali I detyrimit</b>					<b>22,490,110</b>	<b>5,749,367</b>

Detyrimet për fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore të pasqyruara në bilanc me datë 31.12.2022.

Nr	Subjekti	Faturat e palikuiduara në fund të vitit 2022			Vlera
1	Zyra Përmbartimore Blek, A.V.				1,884,625
2	Gjykata e apelit Vlore per "J."				130,080
	<b>Shuma</b>				<b>2,014,705</b>

= Fondi rezervë/dhe kontigjencës

Memirativinebuxheteve është parashikuarndemiratarfondirezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2022 në vlerën 5,000 mijë lekë, dhe nuk ështëpërdorur.

Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/investime etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Sarandë, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se nuk është likuiduarja në **2 fatura në vlerën 7,898,968 lekë** brenda afatit **30 ditorë** nga momenti i paraqitjes se tyre, sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
2	Viti 2022	17	4,342,516	4	3,556,452	21	7,898,968

Vlera e detyrimeve tëfaturave të palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore dhe planifikimi në buxhetet respektive, të dhëna sipas pasqyrës si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./Datë	Llog.602	Llog.230+231	Vendime gjyqësore
Viti 2021	30,401,541	25,000,000	204/24.12.2020	26,277,310		4,124,231
Viti 2022	7,764,072	10,000,000	179/27/12/2022	7,764,072		2,014,705
<b>Totali</b>	<b>38,165,613</b>	<b>35,000,000</b>	<b>0</b>	<b>34,041,382</b>	<b>0</b>	<b>6,138,936</b>

- Mbi vendimet gjyqësore

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 janë në vlerën 30,401 mijë lekë, nga e cila likuiduar vlera 23,800 mijë lekë.

Gjatë periudhës ushtrimore 2022, ka patur shtesa detyrimesh nga vendimet gjyqësore në vlerën 1,163 mijë lekë. Mbetet pa likuiduar në fund të vitit vlera prej 7,764 mijë lekë.

- Raportet e Monitorimit

Për vitet 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, por vetëm raporti vjetor me shkresën datë 4.4.2023 të miratuar me VKB nr. 31.3.2023.

- Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZHS dhe Ministrisë së linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financë/Buxhetit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

Nr	Objekti i prokurimeve	Burim	Vlera e kontratës me Tvsh	Kontrata		Firma fituese	Pagesat sipas periudhave në 000/lekë			Pa likuiduar
				Nr, Datë	Afati		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
1	Përfundim rrjet kryesor K.U.Z Sarandë	FSHZH	19,800,158	12.05.2021	30 dit	E.A.			19,800	-
2	Rehabilitim i kanalit ujitës pjesa e I	FSHZH	31,227,944	01.02.2021	90 dite	A.C.		13,596	17,631	-
3	“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe L. D. Faza e II (Loti Përfundimtar).”	FSHZH	378,836,979	12.10.2021	1 vit	E. K. & Sh.		77,349	64,612	236,875
4	Rikonstruksionujësjellësi Ksamil+ Depo rrjeti shpërndarës në lagjet 3+4	FSHZH	157,360,783	27.11.2020	365 dit	C.	1,490	70,000	77,142	8,728
5	Rikonstruksioni i Shkollës Adem Sheme	FSHZH	56,599,705	22.12.2022	8 muaj	V.K.	-	-	-	56,599
	<b>TOTALI</b>	-	<b>643,825,569</b>	-	-	-	<b>1,490</b>	<b>160,945</b>	<b>179,186</b>	<b>302,203</b>

**I.** Vlera e fondeve të **parashikuar (planifikuara)** për prokurim **për vitin 2022** në artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 229,730,368 lekë, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 199,505,122 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 30,225,246 lekë.

**I/a.** Vlera e fondeve të kontraktuara (realizuara në fakt), në vitin 2022, në artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 208,154,011 lekë, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 193,056,246 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 15,097,780 lekë.

**I/b.** Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) shprehur gjithsej në vlerë 1,115,520 lekë, nga e cila:

- Prokurimeve me vlera të larta për vlerën 0 lekë.
- Prokurime me vlera të vogla në vlerën 1,115,520 lekë.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se nga Bashkia Sarandë, nuk është likuiduar vlera 1,115,520 lekë, kjo për blerje me vlera të vogla për faktin se procedura është zhvilluar në muajin Dhjetor 2022 dhe likuidimi është bërë në janar 2023.

- Realizimi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre.

Për periudhën objekti auditim 01.01.2022 – 31.12.2022, nga auditim i evidencave të marra në Drejtorinë e Financë/Buxhetit dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Sarandë, përdorimi i të ardhurave:

Tabela nr.1 – Të ardhurat e vitit 2022

Përshkrimi	Plan2022	Fakt 2022
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2021	150,000	160,534
Të trashëguara nga transf. Specifike 2021	21,500	37,800
Të trashëguara nga transf. Pakushtëzuara 2021	58,500	120,025
Të ardhurat e veta të vitit 2022	450,000	551,778
Grante të pakushtëzuara viti 2022	134,873	134,873
<b>Grante specifike të vitit 2022, të detajuara:</b>	<b>480,215</b>	<b>492,239</b>
-Nga FZSH	152,655	163,303
-Nga Ministrinë e Linjës	109,560	109,560
-Donatorë të ndryshëm		
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	218,000	219,376
-Nga huatë		
<b>Totali</b>	<b>1,295,088</b>	<b>1,497,249</b>

Tabela nr.2 – Përdorimi i të ardhurave viti 2022

Emërtimi	Fakt 2022				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr. Kushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transfe pakushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte					
231-Investime	295,064	163,302	32,967	98,795	11
600-Paga	244,408	4,933	138,640	100,835	41
601-Sigurime shoqërore	40,828	799	23,251	16,778	57
602-Shpenzime operative	302,583	11,407	216,333	74,843	71
604-Transf.Institucioneve	15,807		13,307	2,500	84
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	229,523	226,232	3,291		1
Kuotë qarku	-				-
<b>Totali</b>	<b>1,128,213</b>	<b>406,673</b>	<b>427,789</b>	<b>293,751</b>	<b>38</b>

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se më të ardhura e veta bashkia mbulon 38% të shpenzimeve vjetore, ku vlerën më të lartë prej 71% e shpenzon për shpenzimet operative. Gjithashtu konstatohet se nga totali i arkëtimit të të ardhurave për vitin 2022, i cili është në shumën 427,789 mijë lekë, rezulton se 41% e tyre përdoren për mbulimin e fondit të pagave. Ndërsa pjesa tjetër shkon për shpenzime operative, investime etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

- Mbi auditimin e procedurave dhe dokumentacionit të administruar mbi aktet e dala për kalimin në pronësi a përdorim të pasurive të paluajtshme, të Bashkisë Sarandë.

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

Lidhur me miradministrimin e tyre rezulton se Bashkia Sarandë, nuk janë ndjekur si duhet menaxhimin e aseteve, identifikimin e gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasë

për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë nga bashkia në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre pasi shumica e aseteve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me Kapitullin e III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimin i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 e Urdhrit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial”.

### **Titulli gjetjes 3: Mbi zbatimin e buxhetit viti 2022**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacioni mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2022, rezulton se:

- Shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 677,500 mijë lekë, nga të cilat: të ardhurat e vitit në vlerën 447,500 mijë lekë dhe të trashëguara në vlerën 230,000 mijë lekë, ose në masën 73 %, nga transfertat e pakushtëzuar në shumën 134,873 mijë lekë ose në masën 15%, transfertat specifike sektoriale në shumën 112,060 mijë lekë ose në masën 12 %.

- Për vitin 2022, buxheti është realizuar në masën 76%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,483,705 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,128,213 mijë lekë. Ndërsa vetëm për aparatën e bashkisë realizimi është në nivelin 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë, nga e cila:

Zëri investime paraqitet në masën 59%, ku nga vlera e parashikuar prej 501,460 mijë lekë është realizuar vlera 295,066 mijë lekë. Shpenzimet operative paraqiten në masën 81%, ku nga vlera e parashikuar prej 285,153 mijë lekë është realizuar vlera 230,153 mijë lekë dhe shpenzimet për paga në masën 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225,653 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë. dhe shpenzime për paga në masën 74%.

Këto mos realizime vijnë nga fakti se struktura organike nuk është plotësuar për numrin e punonjësve të miratuar me VKB dhe se një pjesë e procedurave të parashikuara nuk janë zhvilluar për mungesë stafi, ndërsa pjesa tjetër nuk është financuar pasi nga shoqëritë sipërmarrës nuk janë paraqitur për likuidim dokumentacioni i rregullt ligjorë. *Konkretisht:*

- Nga të ardhurat e veta planifikimi ka qenë 329,042,460 duke përdorur vlera 131,763,000 lekë ose 40.4%, kjo nga mos realizimi i procedurave të parashikuara në fillim të periudhës. Nga fondet specifike (FSHZH) planifikimi në vlerën 172,368,720 lekë duke realizuar vlerën 163,302,133 lekë ose 94.74%, diferenca vjen nga mos paraqitja e rregullt e dokumentacionit për likuidim.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime janë për vlerën 349,266 mijë lekë ose 38 %, shpenzime korrente zënë 40 % ose për vlerën 371,460 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 22 % ose në vlerën 201,207 mijë lekë.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 është në vlerën 11,454,695 lekë (nga e cila llog. 401-408 në vlerën 1,163,220 lekë dhe llog. 467 në vlerën 10,291,475 lekë), të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është në vlerën 7,764,072 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar për shumën 3,690,623 lekë më shumë në pasqyrat financiare.

- Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/investime etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Sarandë, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se nuk është likuiduar janë **2 fatura në vlerën 7,898,968 lekë** brenda afatit **30 ditore** nga momenti i paraqitjes së tyre.

- Për vitet 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, por vetëm raporti vjetor me shkresën e datës 04.04.2023 të miratuar me VKB nr. datë 31.3.2023.

Me të ardhura e veta bashkia mbulon 38% të shpenzimeve vjetore, ku vlerën më të lartë prej 71% e zënë për shpenzimet operative dhe 41% e tyre përdoren për mbulimin e fondit të pagave.

Situata financiare e Bashkisë Sarandë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelin 1.2 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

**Kriteri:** Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 50 e 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 e

102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 51, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

**Ndikimi:** Mos planifikimi i saktë i buxhetit sipas nevojave të bashkisë, çon në mos realizim buxheti dhe mos planifikim të fondeve të sektorë të domosdoshëm për interesat e bashkisë.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit midis sektorëve të planifikimit të buxhetit në fillim të periudhave ushtrimore

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për Hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/ shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në çdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjorë. Në rast të evidentimit të vonësave të llogaritjet penalitet për kamatëvonesë, si dhe t’i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penalteteve për Tvsh e shitjes nga mos paraqitja në afat e faturave.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa dhe të miratojnë në Këshillin Bashkiak radhën e faturave të pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore, duke likuiduar fillimisht ato me të hershmet, si dhe të rakordojë me gjendjen e faturave të pa likuiduara në bilanc me të dhënat e Ministrisë së Financave.

Të miratojë raportet 4 mujorë dhe të vënë në dijeni Këshillin Bashkiak mbi për ecurinë e buxhetit dhe pritshmërinë.

**Titulli i gjetjes 4:** Mbi menaxhimin e pronave (aseteve), të Bashkisë Sarandë.

**Situata:** Nga auditimi i aseteve të pronësi dhe përdorim të Bashkisë Sarandë, kaluar me VKM, rezulton se miradministrimi i tyre nuk janë ndjekur si duhet identifikimin i gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasitet për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë nga Bashkia në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre pasi shumica e aseteve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël.

**Kriteri:** Në kundërshtim me Kapitullin e III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimin i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 e Urdhrit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial”, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

**Ndikimi:** Mos menaxhimi si duhet i pronave të bashkisë, çon në mungesë të ardhurash nëbuxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave drejtues të bashkisë në ngritjen e strukturës përkatëse në miradministrimin e pronave të kaluara në përdorim/ pronësi me VKM.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës për evidentimin në terren të të gjitha pronave (aseteve) të kaluara në pronësi/ përdorim bashkisë me VKM.



Të hartojë regjistrin e pronave, duke evidentuar pronat të pashfrytëzueshme, prona të zaptuara nga të tretë, pronë të shfrytëzueshme për interes të bashkisë, si dhe të përgatisë dhe regjistrojë në ASHK Dega të gjitha pronat e aktive dhe në interes të bashkisë për realizimin e të ardhurave.

Në bashkëpunim me DBNjtë ngrijnë Drejtorinë/Strukturën e administrimit të aseteve, si një strukturë e domosdoshme dhe efikase për administrimin e pronave të Bashkisë Sarandë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi strukturën organizative të Bashkisë Sarandë, rezulton se për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 53, datë 24.12.2021, me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Sarandë dhe NjA Ksamil për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 122/1 prot., datë 9.2.2022.

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Sipas strukturës së miratuar me VKB, pozicione pune të vlerësuara me status të nëpunësit civil, gjithsej 73 pozicione, nga të cilat: një pozicion i kategorisë së lartë, 11 pozicione të kategorisë së mesme drejtues, 60 pozicione të kategorive ekzistuese. Nga këto të lira 1 pozicion i kategorisë së lartë, 2 pozicione të kategorisë së mesme drejtues, dhe 10 pozicione të kategorive ekzistuese.

Për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil është në masën 54.7% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 82%.

Në strukturën e punonjësve civil i janë bashkuar edhe 33 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar, pra 33 pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar me punonjës me emërim apo kontratë të përkohshme dhe jo sipas procedurave të konkurrencës, veprime në kundërshtim me ligjin, pasi çdo marrëdhënie e re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të neneve 22, 23, 25 dhe 26, duhet të respektohen kërkesat e procedurave të rregullta konkurrencës, pasi çdo emërim që realizohet në kundërshtim me këtë rregull, është i pavlefshëm dhe në kundërshtim me nenin 10 pika “i” shkronja “a” dhe shkronja “ç” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Sarandë, duhet të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivel ekzekutiv për rastet e pozicioneve të lira në institucionin, sipas nevojave të strukturës në fuqi në momentin e zbatimit, në referim të pikës 9 të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Gjithashtu duhet të evidentohen nevojat për të rishikuar përshkrimin e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, duke e përshtatur me pozicionet e strukturës aktuale dhe kërkesave ligjore e nënligjore

**Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:**

**Z. A. G.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Sarandë, dhe në cilësinë e Nëpunës Autorizues.

**Znj. T. S.**, me detyrë Drejtoresh e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimit Social, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

**Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

### **1. Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore Bashkia (DAV).**

Për vitin 2022 me VKB nr. 225, datë 22.12.2021 është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me nr. 122/1 prot., datë 09.02.2022. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 61, me nr. 1386 prot., datë 04.04.2022 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe Drejtoria e të Ardhurave, si më poshtë vijon:

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore (këtu e vijim DAV Bashkia Sarandë), ka në strukturën e saj **12 punonjës** ndarë konkretisht, 1 (një) drejtor, 1 (një) specialist për menaxhimin e taksave dhe tarifave familjarëve, 1 (një) specialist për menaxhimin e borxhit, 2 specialist vlerësimi të detyrimeve fiskale, 1 (një) specialist kontabiliteti dhe 6 (gjashtë) specialist inspektimi në terren.

Struktura e DAV Bashkia Sarandë, dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	Ndryshimi gjatë 2022 nëse ka pasur
1	L. B.	Drejtor	Nr.18, dt/06.03.2020	
2	M. Sh	Specialist për taksat dhe tarifat e familjes	Nr.49, dt/22.05.2013	
3	N. A.	Specialist për mbledhjen e Borxhit	Nr.54, dt/02.04.2012	
4	P. T.	Specialist vlerësimi dhe plani të ardhurave	Nr.48, dt/07.05.2021	Leje lindje 22.08.2022
5	J. L.	Specialist vlerësimi dhe plani të ardhurave	dt/18.06.2019	
6	A. N.	Specialist Kontabiliteti	Nr.16, dt/18.02.2021	
7	R. M.	Specialist-inspektor veprimi në terren	Nr.63, dt/12.04.2012	
8	P. A.	Specialist-inspektor veprimi në terren	Nr.56, dt/21.04.2017	
9	L. O.	Specialist-inspektor veprimi në terren	Nr.57, dt/21.04.2017	
10	S. I.	Specialist-inspektor veprimi në terren	Nr.184, dt/16.09.2011	
11	A. Ç.	Specialist-inspektor veprimi në terren	dt/10.09.2003	
12	F. A.	Specialist-inspektor veprimi në terren	Nr.61, dt/08.06.2020	
13	K. Z.	Specialist vlerësimi (zëvendësuese)	Nr.271, dt/14.12.2022	
14	T. M.	Specialist vlerësimi (delegim detyre)	Nr.174, dt/29.08.2022	

*Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për vitin 2022, pranë Bashkisë ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave, struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Sarandë, nga taksat dhe tarifat. Kjo drejtori në aktivitetin e saj për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave duhet të bashkëpunojë edhe me drejtori/sector të tjerë pranë bashkisë, si ai i pronave, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimii autorizimit/faturës për arkëtim/sipas rastit ndjekja e arkëtimit, si dhe roli i DAV është kryesisht në hartimin dhe përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore, ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

#### **Titulli i gjetjes 5: Mangësi në strukturën organizative të Drejtorisë së Taksave Vendore.**

**Situata:** Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave si dhe kryqëzimi me VKB për miratimin e strukturës për vitin 2022 të Bashkisë Sarandë, rezulton se struktura e DAV Bashkia Sarandë nuk është plotësisht në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit Tatimor. Alternimi i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit në Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara. Gjithashtu theksojmë faktin se krijimi i këtij sektori është i domosdoshëm, duke pasur në konsideratë numrin e debitorëve të prapambetur në Bashkinë Sarandë, ku vetëm për kategorinë “Biznes” debitorë të trashëguar nga viti 2022 janë 3514 subjekte.

-Në strukturën organizative të DAV Bashkia Sarandë, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Sarandë.

**Kriteri:** Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.

Nenin 3 në Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Shkronja “d” në pikën 8 në nenin 8, shkronja “f” në pikën 4 në nenin 9, si dhe shkronjën “b” në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave. Gjithashtu në opinionin e grupit të auditimit, mungesa e pozicionit të përgjegjës të sektorit, krijon ngarkesë të shtuar për pozicionin e Drejtorit të DAV, çka mund të ndikojë negativisht në monitorimin e realizimit të objektivave të këtij sektori, si dhe marrjen e masave konkrete për arritjen e këtyre objektivave.

**Shkaku:** Mungesa e marrjes së masave nga niveli drejtues i Bashkisë për plotësimin e strukturës së DAV në funksion të realizimit të objektivave të kësaj drejtorie.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë, sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

#### **2. Taksat dhe Tarifat e aplikuar dhe arkëtuara nga Bashkia Sarandë.**

Për vitin 2022, paketa fiskale e Bashkisë është miratuar me VKB nr. 220, datë 06.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2022”, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Sarandë, sipas sektorëve përkatës, janë aplikuar/mbledhur 21 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2022 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori:

1. **Biznes;**
2. **Familjar;**
3. **Institucione.**

Kategoritë e mësipërme (përfshijtur institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

- Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh; Biznes i Vogël; Tregtarët Ambulant.
- Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Tabela nr.1 Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2022
1	Biznesi i Madh	404
2	Biznesi i Vogël	3110
3	Ambulant	134
4	Institucione	18
6	Familje	17508

*Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Veç taksave dhe tarifave të mësipërme Bashkia Sarandë ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjoha nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, policia bashkiake etj.

*-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në mijë lekë, për vitin 2022, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:*

	Emërtimi	Viti 2022		%
		Plan	Fakt	
<b>A</b>	<b>Te ardhura tatimore</b>	<b>500</b>	<b>1,055</b>	<b>211</b>
1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	500	1,055	211
2	Tatim mbi te ardhurat personale	0	0	0
<b>B</b>	<b>Te ardhura nga taksat</b>	<b>302,000</b>	<b>407,226</b>	<b>126</b>
1	Taksa mbi ndërtesat	99,000	75,901	77
2	Taksa mbi token bujqësore	6,000	3,809	63
3	Takse trualli	1,500	592	39
4	Taksa e mjeteve te përdorura	19,000	25,442	134
5	Taksa per zënien e hapësirave publike	60,000	67,225	112
6	Taksa e fjetjes ne hotel	24,000	18,456	77
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	73,000	195,513	268
8	Taksa mbi kalimin e se drejtës se pronësisë	8,500	17,085	201
9	Taksa per tabelën	3,000	774	26
10	Taksa per zënien e hapësirave publike me reklama	6,000	1,535	26
11	Te ardhura nga vitet e kaluara	2,000	895	45
<b>C</b>	<b>Te ardhura jo tatimore</b>	<b>147,500</b>	<b>130,685</b>	<b>89</b>
<i>i</i>	<i>Te ardhura nga tarifave</i>	124,620	107,804	87
1	Tarife shërbimi publik	102,920	85,555	83
2	Tarife parkimi	2,500	3,699	148
3	Tarifa te tjera administrative	19,200	18,550	97
<b>II</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>16,080</b>	<b>17,755</b>	<b>110</b>
1	Shitje trualli	8,000	12,263	153
2	Qera trualli + ndërtesë	5,000	4,221	84
3	Bileta kulture+sporte	580	346	60
4	Sponsorizime gjithsej	2,500	0	
5	Te ardhura nga gjobat	0	925	
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga institucionet</b>	<b>6,800</b>	<b>5,126</b>	<b>75</b>
1	Te ardhura nga kopshte + cerdhe+konvikt	6,800	5,126	75
	<b>TOTALI A + B + C</b>	<b>450,000</b>	<b>538,966</b>	<b>120</b>

*Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 450,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 538,966 mijë lekë ose 120 % më shumë se planifikimi.

Me tejkalim paraqiten zërat, si:

1.- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 211%, kjo pasi nga DAV Bashkia është planifikuar një vlerë simbolike prej 500 mijë lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 1,055 mijë lekë, pra DAV Bashkia Sarandë nuk ka bërë planifikim të saktë, **duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 e cila është në shumën 7,452 mijë lekë;**

2.- Taksa e mjeteve të përdorura, paraqitet me realizim në masën 134%, ku nga vlera e planifikuar prej 19,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 25,442 mijë lekë. Nga DAV Bashkia nuk është bërë planifikimi i saktë, nisur kjo dhe nga fakti i vitit të kaluar ku megjithëse fakti është në vlerën 24,690 mijë lekë planifikimi është bërë sa një vit më parë;

3.- Taksa e hapësirave publike nga 60,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 67,225 mijë lekë ose 112 %.

4.- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga 73,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 195,513 mijë lekë ose 268 %.

### Debitorët sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmblëdhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022 (të trashëguar nga vitet e mëparshme) – 31.12.2022 (krijuar brenda vitit, si dhe në mënyrë progresive në fund të vitit 2022).

Përmblëdhëse makro për debitorët				
Në fund të vitit 2021 (progresive)	Nr	Vlerë 000/leke	Principal	Kamat-Vonesë
Biznesi	2,461	317,290	317,290	0
Institucione	18	0	0	0
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	6,512	84,061	84,061	0
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	1,854	74,206	74,206	0
Taksa e tokës bujqësore	1,664	23,639	23,639	0
Taksa e fjetjes në hotel	630	30,761	30,761	0
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0
Qira toke bujqësore	0	0	0	0
Gjoha të policisë bashkiake	0	0	0	0
Tarifa e licencimit për karburantet	16	17,600	17,600	0
<b>Krijuar brenda vitit 2022</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>
Biznesi	106	4,386	4,385	0
Institucione	18	0	0	0
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	4,865	3,335	3,335	0
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	356	11,109	11,109	0
<b>Taksa e tokës bujqësore</b>	<b>1277</b>	<b>4,381</b>	<b>4,381</b>	
Taksa e fjetjes në hotel	494	13,433	13,433	0
Qira toke bujqësore	0	0	0	0
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	38	22,515	22,515	0
Gjoha të policisë bashkiake	36	521	521	0
Tarifa e licencimit për karburantet		3,520	3,520	0
<b>Në fund të vitit 2022 (progresive)</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>
Biznesi	2,567	321,676	321,676	0
Institucione	18	0	0	0
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	11,377	87,396	87,396	0
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	2,210	85,315	85,315	0
Taksa e tokës bujqësore	1,652	25,675	25,675	0
Taksa e fjetjes në hotel	1,124	44,194	44,194	0
Gjoha të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	38	22,515	22,515	0
Qira toke bujqësore	0	0	0	0
Gjoha të policisë bashkiake	36	521	521	0
Tarifa e licencimit për karburantet	16	20,805	20,805	0
<b>Total</b>	<b>19,038</b>	<b>608,097</b>	<b>608,097</b>	

Burimi: DAV Bashkia Sarandë, Drejtoria e Kadastrës, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Urbanistikës, IMTV, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Në fillim të vitit 2022 vlera debitore për taksa, tarifa, gjoha dhe qira është në vlerën 547,557 mijë lekë;

-Përgjatë vitit 2022 janë krijuar 63,200 mijë lekë vlerë debitore për 7190 subjekte gjithsej;

-Në fund të vitit 2022 vlera debitore është 608,097 mijë lekë, pra me një rritje të konsiderueshme në krahasim me fillimin e vitit 2022.

Situata e mësipërme tregon një punë të dobët të Bashkisë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

### III.1. Kategoria “Biznes”.

**Titulli gjetjes 6:** Debitorët “Biznes”, të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

**Situata:** Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DAV, rezulton se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 2461 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 317,290 mijë lekë.

-Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 2567 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 321,676 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Konkretisht në fillim të vitit 2022 janë debitor 2461 subjekte për vlerën 317,290 mijë lekë, ndërkohë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022, vlera debitore e krijuar nga kategoria “Biznes” është 321,676 mijë lekë. Konkretisht gjatë vitit 2022 janë krijuar 106 subjekte debitor për vlerën 4,386 mijë lekë.

-Për debitorët e mësipërm nga DAV Bashkia Sarandë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje për të aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti si dhe nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokimi i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

-Për debitorët e mësipërm, DAV pranë Bashkisë dhe zyra e taksave dhe tarifave vendore në NJA Ksamil, nuk kanë përllogaritur rast pas rasti kamatëvonesë për subjektet debitore.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. L. B. , Drejtor i DAV, zj. N. A. , Specialiste e sektorit për mbledhjen e Borxhit dhe z. E. V. , Specialist i taksave ne NJA Ksamil.

**Kriteri:** Neni 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

-Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

-VKB nr.225, datë 22.12.2021 Për miratimin e buxhetit të vitit 2022;

**Efekti:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 321,676 mijë lekë.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokimi të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 321,676 mijë lekë.

### III.2.Familjet.

**Titulli i Gjetjes 7:** *Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.*

**Situata:** Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Sarandë, dhe NJA taksohen gjithsej 17508 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohet si më poshtë:

Nr	Njësi Administrative	2022	
		Familje gjithsej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022	
		Nr.	
1	Sarandë	15416	
2	Ksamil	2 922	
	<b>TOTAL</b>	<b>18338</b>	

*Burimi: DAV Bashkia Sarandë*

- Me qëllim vlerësimin nëse nga DAV Bashkia Sarandë, është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Sarandë, me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Sarandë, e NJA.

- Nga përllogaritjet e kryera rezultoi se gjithsej nuk janë përfshirë në taksat dhe tarifave vendore 1189 familje, ku diferenca më e lartë është në Qytetin e Sarandës për 1119 familje dhe NJA Ksamil për 70 familje.

Nr	Njësi Administrative	2022		
		Familje gjithsej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022	Sipas Gjendjes Civile	Diferenca
		Nr	Nr	Nr
1	Sarandë	15416	16535	1119
2	Ksamil	2922	2992	70
	<b>TOTAL</b>	<b>18338</b>	<b>19527</b>	<b>1189</b>

*Burimi: DAV Bashkia dhe Zyra e Gjendjes Civile Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Sarandë nga kategoria “Familjar”, për shëmbull, nëse do të bënim përlllogaritjet për Qytetin e Sarandës vetëm për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 3,600 lekë (tarifë pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi) \* 1189 familje diferencë = 4,280,400 lekë më pak planifikuar për tarifën vendore të pastrimit ndriçimit dhe gjelbërimit.

Situata e mësipërme tregon se DAV Bashkia nuk ka një regjistrë të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018<sup>6</sup>, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë dhe zj. M. Sh. , Specialiste për taksat dhe tarifën e familjes.

**Kriteri:** Pika 7 në nenin 4, nenin 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika B.1.3. në Paketën Fiskale të Bashkisë për vitin 2022.

**Ndikimi:** Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojnë Bashkia nga kategoria “Familjar”.

**Shkaku:** Mungesa e përditësimit të regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga DAV Bashkia Sarandë.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** DAV Bashkia në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë Administrative Ksamil, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrin të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2022, rezultojnë 4,280,400 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

**Titulli i gjetjes 8:** Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifën vendore në Bashkinë Sarandë.

**Situata:** Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore:

Tabela nr.2 Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

Nr	Njësi Administrative	2022			
		Familje Debitorë në fillim të vitit 2022	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022	Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2022	Progresive deri në vitin 2022
		Nr	Nr	Nr	Nr
1	Sarandë	5471	15416	2805	8276
2	Ksamil	1041	2092	2060	3101
	<b>TOTAL</b>	<b>6512</b>	<b>17508</b>	<b>4865</b>	<b>11377</b>

Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 janë 11377 familje debitorë, nga të cilat brenda vitit 2022 janë krijuar gjithsej 4865 familje debitorë për një ose disa taksa dhe tarifa vendore, çka do të thotë se 43 % e familjeve që taksohen janë debitor.

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se numri i familjeve debitorë në mënyrë të grupuar, ndarë sipas Njësive Administrative, në fund të vitit 2022 është:

- 2805 familje nga 15416 gjithsej të taksuara për Qytetin e Sarandë, ose 18.2 % e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-2060 familje nga 2092 gjithsej të taksuara për NJA Ksamil, ose 98.5 % e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

Tabela nr.3 Familje debitorë sipas llojit të taksës/tarifës në vlerë

Nr.	Lloji i Taksës dhe Tarifës	Debitor deri në fillim të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Debitorët krijuar brenda vitit	Totali Debi
		2022	2022	2022	2022	Progressive

<sup>6</sup> Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

1	Ndërtesë	29,124	38,456	36,865	1,591	30,715
2	Tarife Shërbimi Pastrim, ndriç, gjelb	54,937	63,029	61,285	1,744	56,681
<b>Totali</b>		<b>84,061</b>	<b>101,485</b>	<b>98,150</b>	<b>3,335</b>	<b>87,396</b>

Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifave vendore, në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 3,335 mijë lekë, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se në fund të vitit 2022 në Bashkinë dhe NJA, janë gjithësej 11377 familje debitore për vlerën 87,396 mijë lekë, nga të cilat 4865 familje për vlerën 3,335 mijë lekë janë debitor të krijuar brenda vitit 2022.

Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nga zyrat e taksave në NJA janë përcjellë debitorët në DAV pranë Bashkisë Sarandë, por konstatohet se nga specialisti i mbledhjes së borxhit nuk është marrë asnjë masë ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë.

- Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë, zj. N. A. , specialiste për mbledhjen e Borxhit.

**Kriteri:** Pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Paketa Fiskale e Bashkisë Sarandë, për vitin 2022.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, në vlerën 87,396 mijë lekë.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 87,396 mijë lekë.

### III.3.Taksa e tokës bujqësore.

**Titulli i Gjetjes 9:** *Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.*

**Situata:** Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 63% ose nga vlera e planifikuar prej 6,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,809 mijë lekë.

Sipas të dhënave të marrë nga Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Sarandë, disponon gjithsej 2375 ha tokë, nga e cila: NJA disponon sipërfaqen 1970 ha, NJA Ksamil disponon sipërfaqe 405 dhe tokë bujqësore e zënë me ndërtime informate me sipërfaqe 140 ha.

Në pronësi private janë 1452 ha dhe në pronësi shtetërore me sipërfaqe 923 ha.

Sipërfaqja e tokës me pronësi shtetërore prej 710 ha me origjinë nga ish ndërmarrjet bujqësore, vjen: 180 ha nga diferenca azhornimi, 405 ha NJA Ksamil dhe 125 ha dhënë me qira nga MBZHR.

Ndërsa sipërfaqja prej 213 ha me origjinë tokë e ish ndërmarrjeve bujqësore dhënë në përdorim institucioneve të tjera.

Sipërfaqja prej 1452 ha është ndarë me ligjin nr. 7501.

Përmbledhja e pritshmërisë të taksës së tokës bujqësore për vitin 2022 në Bashkinë Sarandë, e llogaritur në bazë të sipërfaqes, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4. Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë për vitin 2022

Kategoria e tokës	Sip/HA Fshati Gjashtë	Sip/HA Fshati Metoq	Sip/HA Fshati Shelegar	Sip/HA Fshati Çukë	Sip/HA NjA.	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II				100	100	4,900	490,000
Kategoria III	230	336	42	410	1018	4,200	4,275,600
Kategoria IV	260	119+40 (SP B)	5	110	534	3,600	1,922,400
<b>Totali</b>	<b>490</b>	<b>495</b>	<b>47</b>	<b>620</b>	<b>1652</b>		<b>6,688,000</b>

Burimi: Bashkia Sarandë

Nga krahasimi i të dhënave me evidencën e realizimit të të ardhurave, konstatohet se planifikimi është bërë me rezerva afërsisht 10% ose e shprehur në vlerën prej 688,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë.

**Kriteri:** Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika A.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022.

**Ndikimi:** Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj dhe mosadministrim me efektivitet dhe eficiencë të fondeve në vlerën 688,000 lekë, që ndikojnë negativisht në të ardhurat që mund të arkëtohen nga taksa e tokës bujqësore.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit midis zyrave të taksave në NJA me agronomët sipas NJA-ve.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë Administrative Ksamil, Specialistët e taksave familjare, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të agronomëve të Bashkisë Sarandë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

**Titulli i Gjetjes 10:** *Mosndjekja e procedurave ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.*

**Situata:** Në fund të vitit 2022 rezulton se në Bashkinë Sarandë, vlera debitore për taksën e tokës bujqësore është 25,675 mijë lekë, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2022 është rritur me 2,036 mije lekë.

-Përgjatë vitit 2022 janë gjithsej 1277 familje debitore për vlerën 4,381 mijë lekë.

Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në Bashkinë Sarandë, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore nuk njoftohen ose të merren masa të tjera shtrënguese ndaj tyre, me qëllim arkëtimin e kësaj takse. DAV Bashkia Sarandë arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Më poshtë pasqyrohet ecuria e debitorëve të rezultuar për taksën e tokës bujqësore:

Debitor toka bujqësore 2022					
N.J.A.	Debitor të trashëguar deri në fillim të vitit 2022	Debitorë krijuar në vitin 2022 (Lekë)			DEBIA PROGRESIVE
		Familje me tokë bujqësore	Familje debitore (Nr)	Familje debitore (vlerë)	
Sarandë	23,639	1,652	1,277	4,381	25,675

*Burimi: DAV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë.

**Kriteri:** Pika 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pika A.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 25,675 mijë lekë.

**Shkaku:** Mungesa e marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e kësaj takse.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** DAV Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin e detyrimit tatimor dhe njoftimin e subjekteve me qëllim arkëtimin e vlerës prej 3,047 mijë lekë, si rrjedhojë e taksimit jo të drejtë dhe të plotë të familjeve që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore.

**Titulli i Gjetjes 11:** *Keqadministrimi dhe mos arkëtim i taksës së fjetjes në hotele.*

**Situata:** Për vitin 2022 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 18,456 mijë lekë, ose 77% e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel. Pra nuk evidentohet, sa dhoma ka hoteli disponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Sarandë, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Debitor deri në 2022	Subjekte	Principal	Kamatvonesë	Paguar	Diferenca
Gjithësej	494	23,430,045	-	10,000,930	13,433,115
Nga të cilat në 2022	494	23,430,045	-	10,000,930	13,433,115



**Kriteri:** Pika A.3 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, në vlerën 13,433,115 lekë.

**Shkaku:** Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

**Rekomandimi:** Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 13,433,115 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

-Për situatën e mësipërme (hotelet për të cilat administrohet informacion dhe kanë rezultuar me problematikë në arkëtimin e tyre, mbajnë përgjegjësi z. L. B. , Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, zj. P. T. dhe zj. J. A. , specialiste për taksën e biznesit dhe z. E. V. specialist në zyrën e taksave në NJA Ksamil.

-Për situatën e mësipërme (hotele për të cilat nuk administrohet informacion) mbajnë përgjegjësi grupi i verifikimit në terren z. A. Ç. , z. S. I. , z. R. M. , z. P. A. , z. L. O. dhe F. A. të cilët janë ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Sarandë, dhe NJA Ksamil.

### **Parkimet e rezervuara**

Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, civile apo penale, sipas rastit.

Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.

Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që bashkia ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës.

### **Titulli i Gjetjes 12: Keqmenaxhimi mbi arkëtimin e tarifimit për parkimet e rezervuara.**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për parkimet e rezervuara, që Bashkia ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 36 kontrata qiraje për parkime të rezervuara me vlerë 3,020,000 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2022 vlera 2,640,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 380,000 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

*Tabela nr.5 Të dhënat për parkimet e rezervuara*

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Rruga	Nr. Vendeve	Detyrimi	Data e pagesës	Pa paguar
1	"A. N. F"	Farmacit	"Skënderbeu"	1	60,000	25.2.2022	
2	"N&N" Shpk	Dyqan	"Abedin Dino"	1	60,000	04.05.2022	
3	F. i P.s	Posta	"Skënderbeu"	2	120,000	28.02.2022	
4	"R. " B.	Bank	"Skënderbeu"	1	60,000	01.02.2022	
5	Y. H.	Zyrë Funerale	"Abedin Dino"	1	60,000	10.05.2022	
6	A. A.	Argjendari S.	"Abedin Dino"	1	60,000	15.02.2022	
7	"A-S."	Dyqan Mishi	"L. T. "	1	60,000	19.04.2022	
8	"A"	Dyqan Mishi	"Skënderbeu"	1	60,000		40,000
9	S. M.	Dyqan	"Idriz Alidhima"	1	60,000		40,000
10	R. L.	Librari	"Abedin Dino"	1	60,000	20.04.2022	
11	"Al. F. D.	Dyqan Mobileri	"Abedin Dino"	1	60,000	18.02.2022	
12	"F-B"	Bank	"Skënderbeu"	2	120,000	15.04.2022	
13	"I. S"	Bank	"Skënderbeu"	2	120,000	11.05.2022	
14	"B. S"	Market	"L. T. "	1	60,000		60,000
15	M. M.	Tenda Dielli	"Adem Sheme"	1	60,000	15.04.2022	
16	"S. I."	Shoqër Sigurimi	"Onhezmi"	1	60,000	15.08.2022	
17	"O. " Shpk	Kmbim Valute	"Onhezmi"	1	60,000		40,000
18	L. I.	Tregti Celular	"Onhezmi"	1	60,000		60,000
19	A. Ç.	Fast-Food	"Onhezmi"	1	60,000	04.02.2022	
20	D.	Dyqan Bojrash	"L. T. "	1	60,000	02.02.2022	

21	B. D.	Hotel	“Flamurit”	2	120,000	04.02.2022	
22	M. J.	Hotel	Rr.“Flamurit”	2	120,000	07.02.2022	
23	R. L.	Market	Lagja Nr.2	2	120,000	04.04.2022	
24	N. P.	Hotel	Rr. Flamurit	3	180,000	15.04.2022	
25	C. B.	Bank	Rr.Telat Noga	2	120,000	20.04.2022	
26	A. V.	Hotel	Rr.Telat Noga	1	60,000	21.04.2022	
27	E. B.	Hotel	Rr.Skënderbeu	1	60,000	28.04.2022	
28	M. P.	Agjenci Postare	Rr. Skënderbeu	1	60,000	20.05.2022	
29	R. M.	Hotel	Rr.Jonianët	2	120,000	27.05.2022	
30	A. V.	Hotel	Rr.Flamurit	1	60,000	27.05.2022	
31	A. B.	Hotel	Rr.Flamurit	2	120,000	27.05.2022	
32	B. G.	Biznes	Rr. M. H.	2	120,000	22.06.2022	
33	A.-	Hotel	Rr. M. H.	1	60,000	22.06.2022	
34	A. B	Bank	Rr.Skënderbeu	1	60,000	13.09.2022	
35	O. T.			1	60,000		60,000
36	R. Gj.	Biznes	Rr.Flamurit	2	120,000	25.07.2022	
37	A.-A			1	40,000		40,000
38	M. B			1	40,000		40,000
	<b>Total</b>				<b>3,020,000</b>		<b>380,000</b>

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. R. S. , Drejtor i Shërbimeve Publike.

**Kriteri:** Pkatea Fiskale 2022, pika B.2.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në vlerën 380,000 lekë në buxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave që menaxhojnë kontratat e qirave për parkimet e rezervuara

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar numrin e parkimeve të rezervuara nga subjekte private që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë si dhe të shikohet mënyra e taksimit e të gjitha parkimeve të rezervuara.

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 380,000 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë nga parkimet e rezervuara.

### **Agjentët tatimorë**

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga AKSH derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Sarandë brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Sarandë janë paraqitur në Tabelë.

Tabela nr. 6 Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Sarandë, në 000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2022
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	1,055
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	25,442
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	17,084
DPT & DPD	Renta Minerare	
Ujësjetës-Kanalizime	Taksë ndërtese	33,229
	Tarifë shërbimi	46,942
<b>TOTALI</b>		<b>123,752</b>

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale (banim ose e kombinuar), objekt legalizimit.**

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria

Vendore e ASHK Sarandë, si dhe Drejtoria Vendore e ASHK, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Sarandë.

Nga DVASHK Sarandë, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI). Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Sarandë, nuk janë marrë masat në mënyrë shteruese për tarifimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Sarandë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen specialistes së mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve.

*Tabela nr.7 TNI për legalizimin e objekteve informale - Viti 2022*

Debitor TNI	Subjekte	Vlera/000/L
<b>Gjithësej progresive</b>	<b>2210</b>	<b>85,315</b>
Nga të cilat në 2022	<b>356</b>	<b>11,109</b>
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2021	<b>1854</b>	<b>74,206</b>

*Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

**Titulli i Gjetjes 13:** *Keqmenaxhimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.*

**Situata:** Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Bashkisë Sarandë, u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK Sarandë konkretisht:

- Vlera debitore progresive është 85,315 mijë lekë për 2210 subjekte (nga të cilat 356 subjekte për vlerën 11,109 mijë lekë krijuar në vitin 2022).

Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar si rrjedhojë e mos likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, si dhe ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Sarandë, për shkëmbimin e informacionit si dhe ndjekjen e procedurave ligjore nga sektori i mbledhjes së borxhit, për arkëtimin e TNI.

- *Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. R. P. , Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe z. L. B. Drejtori i DAV.*

**Kriteri:** Paketa Fiskale 2022, pika A.4.

Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara në vlerën 85,315 mijë lekë.

**Shkaku:** Mungesa e marrjes së masave shtrënguesenë mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative eligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 85,315,000 lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi.

### **Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se përgjatë vitit 2022 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, të cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë gjithsej 38 subjekte të gjobitura për vlerën 23,315,000 lekë, nga të cilat 2 gjoba në vlerën 800,000 lekë janë likuiduar. Pasqyruar në tabelën përmbledhëse<sup>7</sup> si më poshtë:

<sup>7</sup>Tabela analitike bashkëlidhur akt-konstatimit.

Tabela nr.8 Gjobat e IMTV Bashkia Sarandë

Debitor IMTV 2019-2021	Subjekte	Principal	Kamatëvonesë	Paguar	Gjithsej
Krijuar përgjatë vitit 2022	38	23,315,000	-	800,000	22,515,000

Burimi: IMTV Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Titulli i Gjetjes 14:** Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Sarandë.

**Situata:** Konstatohet se gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A. M. , Kryeinspektor i IMTV Sarandë.

**Kriteri:** Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurës administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara në vlerën 22,515,000 lekë.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës dhe mosndjekja e procesit të arkëtimin të gjobave të vendosura.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës 22,515,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**Rekomandimi:** Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

#### **Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se përgjatë vitit 2022 nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake Sarandë, është në vlerën 531,000 lekë, nga e cila 1 gjobë në vlerën 10,000 lekë është likuiduar. Pasqyruar në tabelën përmbledhëse<sup>8</sup> si më poshtë:

Tabela nr.9 Gjobat e Policisë Bashkiake Sarandë

Debitor deri në 2022	Subjekte	Principal	Kamatëvonesë	Paguar	Vlerë
Gjithësej	36	531,000	-	10,000	521,000
Nga të cilat në 2022	36	531,000	-	10,000	521,000

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

**Titulli i Gjetjes 15:** Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake Sarandë.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë 36 gjoba në vlerën 521,000 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse<sup>9</sup>.

**Kriteri:** Neni 13 në Ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara në vlerën 521,000 lekë.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës dhe mosndjekja plotësisht e procesit të arkëtimin të gjobave të vendosura.

**Rëndësia:** I lartë.

<sup>8</sup> Tabela analitike bashkëlidhur.

<sup>9</sup> Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 521,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

### **Kontratat e qirave.**

Për auditimin e kontratave të qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë, dhe subjekteve juridik/fizik, saktësinë e tarifave të aplikuara dhe arkëtimin e tyre, të cilat e shtrijnë efektin e tyre deri Më datë 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligj nr.9385, datë 5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligj nr.57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar;
- Kontratat e lidhura me subjektet juridike/fizike për përdorim të fondit pyjor/kullosor/tokës bujqësore, banesave sociale, dyqaneve.

-Në përfundim të auditimit u konstatua se janë gjithsej 14 subjekte debitor në vlerën 3,195 mijë lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Sarandë, për marrjen me qira të objekteve të ndryshme, pasqyruar si më poshtë:

Subjekte Qiramarrës Debitor	Principal	Kamatëvonesë	Gjithsej
14	3,195	-	3,195

*Burimi: Bashkia Sarandë*

### **Titulli i Gjetjes 16: Keqadministrim dhemos arkëtim i kontratave të qirave.**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë, ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 37 kontrata qiraje për objekte dhe truall në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,987,800 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2022 vlera 1,363,860 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 3,195,540 lekë.**

Referuar kushteve të kontratës neni 7 pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet me nënshkrimin e kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të këtij neni nga bashkia zgjidhet kontrata për mospërbushje të kushteve të kontratës.

**Kriteri:** Mos zbatimi i nenit 7 të kontratës, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. G.K me detyrë specialiste jurist dhe znj. N. A. , specialiste për mbledhjen e Borxhit.

**Ndikimi:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave që menaxhojnë kontratat e qirave.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Drejtorja e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **3,195,540 lekë**, nga kontratat e qirave. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë, të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

### **Toka bujqësore dhe pyjore e dhënë me qira.**

Nga të dhënat e Drejtorisë Bujqësisë Bashkia Sarandë, konstatohet se janë lidhur 27 kontrata për kullota dimërore/verore, 2 kontrata Akuakulturë, 1 kontrate për vendosje antene dhe 1 kontratë për shfrytëzim karriere gurore për një vlerë prej 2,444,044 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht.

Nga përpunimi i të dhënave, evidentohet fakti se sipërfaqja e tokës së dhënë me qira nuk korrespondon me numrin e krerëve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, pasi numri i krerëve është më i lartë se sipërfaqeve së dhënë me qira. Sipas Drejtorisë së Bujqësisë ky fenomen është evident, por pamundësia e sipërfaqes për shfrytëzim dhe numrin të personave që kërkojnë kullota e bën të pamundur që për çdo person të jepet sipërfaqe për kullotë në raport me bagëtinë.

Gjithashtu në dosjet nuk evidentohet që të jenë kryqëzuar të dhënat me AZHBR mbi numrin krerëve që ato kanë të deklaruar dhe numrit të krerëve mbi të cilët është lidhur kontrata.

**Titulli i Gjetjes 17:** *Mungesë të ardhurash, nga mos lidhja e kontratave të qirave me subjektet që shfrytëzojnë për karrierë sipërfaqe pyjore/kullosore, viti 2022.*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se në territorin e Bashkisë Sarandë, ushtrojnë aktivitet 2 subjekte për shfrytëzim karriere (gurore) në sipërfaqet pyjore/kullosore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18.

1-OE “P .” Shpk (me nip K0) ushtron aktivitet në parcelën 17 me emërtesë (Vollider) me sipërfaqe totale 37.02 ha.

OE është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo shoqëri nuk ka kontratë qiraje me Bashkinë Sarandë. Nga OE janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.2021), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në certifikatë pronësie.

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasurinë shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të VKM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **5,778,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 10.7), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

2-OE “I.-B. ” Shpk (me nip J6) ushtron aktivitet në parcelën 4 me emërtesë (C. U) me sipërfaqe totale 92.08 ha.

OE është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 – 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo OE nuk ka kontratë me Bashkinë Sarandë.

OE disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje.

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.**

Subjektet “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk, të cilët nuk kanë kontratë me Bashkinë Sarandë dhe kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kollusore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

-Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk pa kontratë qiraje deri më 31.12.2022, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për OE “P.” Shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe OE “I.-B.” Shpk në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

#### **Hapësira e plazhit e dhënë me qira.**

Në paketën fiskale të Bashkisë për vitin 2022, konkretisht në Pikën B.6 “Tarifë e zënies së hapësirës publike për zonën e plazhit”, është përcaktuar niveli i taksës 800 lekë/m<sup>2</sup>/sezon dhe 100 lekë/m<sup>2</sup>/sezon tarifë shërbimi. Nga auditimi i faturave për arkëtim lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve, për kontratat e qirasë të lidhura në vitin 2022, vlera e faturuar është llogaritur sipërfaqe \* lekë/m<sup>2</sup>/sezon.

Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”, rezultoi se Bashkia në vitin 2022 ka në administrim 144 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit. Në përfundim konstatohet se në fund të vitit 2022 janë gjithsej 15 subjekte të cilët nuk kanë kryer likuidimin e tarifës vjetore të qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit, *gjithsej në vlerën 6,106,500 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.*

Subjekti	Vendodhja	Nr Inus	M <sup>2</sup>	Tarifa/siperf/800/l/m2	tarife/shërbimi 100/l/m2	Gjithsej	Detyrimi total
Y. Sh.	Ksamil	159	249	800	100	24,900	224,100
A. & T. D.	Sarandë	46	1003	800	100	100,300	902,700
A. R.	Ksamil	90	498	800	100	49,800	448,200
E. M.	Sarandë	57	333	800	100	33,300	299,700
I. Shpk	Ksamil	117	714	800	100	71,400	642,600
O. C.	Ksamil	177	382	800	100	38,200	343,800
M. J.	Sarandë		312	800	100	31,200	280,800
S. C.	Sarandë	116	484	800	100	48,400	435,600
K. H.		544	750	800	100	75,000	675,000
M. P.	Ksamil	170	248	800	100	24,800	223,200
T. L.		55	178	800	100	17,800	160,200
E. C.		160	700	800	100	70,000	630,000
E. M.		56	334	800	100	33,400	300,600
Z. F.	Ksamil	138	185	800	100	18,500	166,500
M. P.	Ksamil	170	415	800	100	41,500	373,500
<b>Total</b>			<b>6785</b>				<b>6,106,500</b>

*Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

- Për subjektet e mësipërme nuk është aplikuar penalitetet për mos likuidimin e tarifës së qirasë, si dhe për arkëtimin e detyrimit nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, bllokimin e llogarisë bankare, kërkesë padi në gjykatë etj.

Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 8 të VKM nr. 569, datë 17.07.2019 “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të agjencisë kombëtare të bregdetit”, i ndryshuar, nenin 8 në kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet palëve, pikën 2 në nenin 89 të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, si dhe nenin 32 në Ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i procedurës civile”, i ndryshuar.

*-Sa më sipër, sipas detyrave që kryejnë, mbajnë përgjegjësi z. L. C. , Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë.*

#### **Titulli i Gjetjes 18: Mbi Hartimin e kontratave dhe menaxhimin e të ardhurave nga qiradhënia e hapësirave të plazhit.**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Bashkia Sarandë, u përzgjedhën 11 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, rezulton se për vitin 2022, u konstatuan mangësi si:

-Në rastet e lidhjes së kontratave 2-5 vjeçare, janë lidhur kryesisht në muajt korrik dhe gusht, dhe jo në fillim sezoni (në maj).

Në disa raste subjektet nuk kanë paraqitur vërtetimet për detyrimet që kanë ndaj DPTR dhe DTTV. Në një pjesë të rasteve mungojnë ekstrakti i QKB apo Plan-bizneset. Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera. Në një pjesë të madhe të kontratave nuk shoqëroheshin me planvendosje, por edhe

ku ishin nuk evidentoheshin përmasat e parcelës, mungonin të dhënat për largësinë e parcelës nga vija bregdetare për respektimin apo jo distancës të paktën prej 7.5 m nga vija e bregut të detit, nuk evidentoheshin shpërndarja e çadrave nëse është respektuar largësia ndërmjet tyre prej 2.5 m, si dhe nëse është lënë e lirë hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave për t'u shfrytëzuar nga publiku. Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar. Në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20% sipërfaqe në përdorim publik. Mungonin aktet e monitorimit të kontratave të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit si detyrim ligjore dhe pse në pjesën më të madhe subjektet ishin të njëjtë në çdo vit. Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur grupe pune për të kryer verifikime në terren. Në disa raste, pagesa e qirasë është kryer shumë me vonesë deri disa muaj pas mbarimit të sezonit dhe jo në momentin e lidhjes së kontratës apo aktmarrëveshjes sipas kushteve të kontratës.

- Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit "Stacion plazhi", rezultoi se Bashkia Sarandë, në vitin 2022 ka në administrim 144 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit. Në përfundim konstatohet se në fund të vitit 2022 janë gjithsej 15 subjekte të cilët nuk kanë kryer likuidimin e tarifës vjetore të qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit, gjithsej në vlerën **6,106,500 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

**Kriteri:** Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 27.3.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar me VKM nr. 424, datë 27.05.2020 neni 14 pika 10, nën-pika b. me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" neni 4, pika 3, neni 5, pika 1, neni 4, pika 8, me VKM nr. 321, 28.05.2014 "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore" i ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, Kreu III, pika 9, Kreu IV pika 1 shtojca B-3, me kontratë tip të miratuar të lidhur ndërmjet palëve neni 6 "Pagesa e qirasë" neni 5, "Detyrimet e qiramarrësit".

**Ndikimi:** Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

**Shkaku:** Mos përgjegjësi e plotë e strukturave përgjegjëse në lidhjen e kontratave dhe ndjekjen e tyre në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtorja e Shërbimeve duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të kryer verifikime në terren për të gjitha kontratat e lidhura me subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara.

**Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Financiar, të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej **6,106,500 lekë**, nga subjektet e individ private.

### **Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Sarandë.**

-Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, në zbatim të legjislacionit në fuqi:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;

- Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;

- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

- VKM nr. 212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)";

- Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

**Titulli i gjetjes 19:** Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i Liçencave/Autorizimeve të subjekteve që tregtojnë karburante,



**Situata:** Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.

Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitëve të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifave vendore janë pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Pajisur me Licencë	Detyrimi 31.12.2022	Detyrimi i krijuar 2022		Diferenca 31.12.2022	
					Për karburante	Për lëndë djegëse		
1	K.	Qafë-Gjashta, 1-km larg nga qyteti i Sarandës	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
2	2.-L.O.	Lagja nr.1, ne hyrje te Sarandës	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
3	A. GJ.-Ç	Cukë, Godine 1-kateshe,Fshati Çukë, Komuna Aliko	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
4	C. Shpk	Ksamil, Lagja nr.2,Perballe Parkut te Lojrave	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
5	D. O.	Lagjia Nr. 1 Pike Karburanti	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
6	E. K.	Ksamil, Rruga nacionale Sarandë-Ksamil, godine 1-ka	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
7	E. O	Sarandë, Lagja nr.1, Rruga Tre Bilbilenjte, Nenstacioni	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
8	G. G.	Berdenesh Sarandë	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
9	I.j	Qafë-Gjashte	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
10	O	Lagja nr. 3, 49 portit	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
11	S. G.	Lagja nr. 1, Rruga Skënderbeu, Sarandë	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
12	S. G.	Lagjia 26 Marsi, Ksamil, Sarandë	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
13	T. O.	Cukë, Godine 1-kateshe,Rruga Nacionale Metoq Konis	Jo	1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
14	A. & C.	Rruga Peshkatari, (ish Toni - Oil)		1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
15	V. I.	Gjashtë		1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
16	Z.	Berdenesh, Fshati Çukë, Te Ura e Çukes Berdenesh		1,100,000	200,000	20,000	1,320,000	
<b>TOTALI</b>					<b>17,600,000</b>	<b>3,200,000</b>	<b>320,000</b>	<b>21,120,000</b>

*Burimi: Drejtoria e Shërbimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Sarandë, përgjatë vitit 2022 nuk i është drejtuar me shkresë subjekteve për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu gjatë vitit 2022, nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.

- Për subjektet e mësipërme nuk administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarive bankare).

- Pra sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2022, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 16 subjekte për 16 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 3,520,000 lekë dhe në fund të periudhës 31.12.2022 vlera debitore është 21,120,000 lekë.

- Sa më sipër mban përgjegjësi z. R. S. , Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Kriteri:** Pika 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

**Ndikimi:** Veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë me vlerë 21,120,000 lekë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

**Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Sarandë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrimit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 21,120,000 lekë.

**Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Sarandë.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Sarandë, mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në Bashkinë Sarandë, si dhe për subjekte të cilat kanë kryer punime ndërtimi si rrjedhojë e lejeve të ndërtimit të dhëna për subjekte të ndryshme, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Paketa fiskale e vitit 2022;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2022 - 31.12.2022;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit të punimeve dhe certifikatë përdorimi;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:*

**1. Përshkrimi i situatës.**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Sarandë) ku rezultoi se përgjatë vitit 2022 (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2021, por kanë përfunduar në vitin 2022) kanë kryer punime ndërtimi gjithsej 12 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me NIPT sekondar e për rrjedhojë nuk janë taksuar për tarifën e pastrimit dhe shërbimit, pasqyruar si më poshtë vijon:

Viti 2022					
Nr.	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	OE/Ndërtues	Nipt	Tarifat vendore	Detyrimi
					(Lekë)
1	Riveshje e pjeseshme e shtresave asfaltike ne rruget e Sarandës	“S. “ Shpk	K5	95,000	95,000
2	Blerje kontiniere per mbeturina	“L. B.” Shpk	L7	95,000	95,000
3	Permiresimi i infrastruktures rrugore dhe e ndricimit ne periferin e qytetit ne Metoq, Gjashte dhe Cuke	A “ Shpk	J6	95,000	95,000
4	Sinjalistika horizontale, vertikale	“S. R. S. S” Shpk	L6	95,000	95,000
5	Lyerje fasadash per Lagjen Nr.4, Koder	“V. K.” Shpk	K2	95,000	95,000
6	Nderhyrje emergjente per rikonstruksin e ures Metoq	“H. E” & “O.B K.” Shpk	M1 & K9	95,000	95,000
7	Riveshje me Beton rruga ‘Gjergj Araniti, 40 shenjtoret	“T.” Shpk	K3	95,000	95,000
8	Ndertimi i varrezave publike ne Volloder	“A. C” Shpk	K5	95,000	95,000
9	Rikonstruksin, Shkolla 9-vjecare [”Adem Sheme”, Sarandë	“V. K” Shpk	K2	95,000	95,000
10	Rikonstruksin, te salles se mbledhjeve ne Bashki	“A. C” Shpk	K5	95,000	95,000
11	Rikualifikim I rrugeve te brendeshme Gjashte, Metoq, Shelegar	“A. C” Shpk	K5	95,000	95,000
12	Investime ne ambientet e Konviktit I Shkolles Ekonomike	“A. C” Shpk	K5	95,000	95,000
13	Godinë hotelerie, banimi dhe shërbimi 3-4-5 dhe 6 kate me 1-2 kat parkim nëntokë	“E. H” Shpk	L9	95,000	95,000
14	Strukturë 4-5 kat dhe 1 kat nëntokë, me funksion Hotelieri	“2-B” Shpk	L8	95,000	95,000
15	Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë	“S.E.G A.” Shpk	M1	95,000	95,000
16	Hotel 3 katësh	“A” Shpk		95,000	95,000
17	Hotel 2 kate me 1 kat nëntokë podrum	“K.” Shpk		95,000	95,000
18	Hotel 4 kate me 2 kate parkim nëntokë	“D./S” Shpk	K2	95,000	95,000
19	Strukturë banimi 3 kate	“E” Shpk	J8	95,000	95,000
20	Rikonstruksin dhe shtesë anësore, në strukturë hotelerie 5 kate	“K. K.” Shpk	K5	95,000	95,000
	<b>Total</b>				<b>1,900,000</b>

*Burimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Sektori i Prokurimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

**Titulli i Gjetjes 20:** Keqmenaxhimi i tarifës së pastrimit dhe shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Sarandë.

**Situata:** Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Sarandë të cilat kanë kryer punime ndërtimi.

Në vijim të sa më sipër, po parashtrijmë kuadrin rregullator mbi të cilin është mbështetur ky akt-konstatim:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar:

**Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:  
b) vendosin taksat vendore e **tarifa për shërbimet**, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

**Neni 35 Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore**

5. Bashkitë **krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për:**

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

**Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

f) **vendos për taksat e tarifatat vendore**, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

-Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

**Neni 3 Përkufizime**

10. “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik **bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur** apo të drejta të dhënë nga njësisia e vetëqeverisjes vendore.

**Neni 12 Rregulla të përbashkëta për taksat vendore**

2. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, **çdo përjashtim apo ulje**, afati i pagesave, si dhe gjokat e kamatëvonesat e aplikueshme, **në përputhje me legjislacionin në fuqi**, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.

**Neni 14 Tarifa vendore**

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga këto tarifa vendore:

b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;

**Neni 18 Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve të tjera publike**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore propozojnë ose miratojnë, sipas legjislacionit në fuqi, tarifa për mbledhjen dhe heqjen e mbetjeve, si dhe për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

2. **Niveli i tarifave të shërbimeve publike**, si rregull, synon mbulimin e kostos dhe është në përputhje të drejtë me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë.

-Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit regjistrimet e tjera”, i ndryshuar

**Neni 2 Përkufizime**

6. “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.

**Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme**

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

-Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

**Neni 40 Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare**

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Udhëzimi nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**KREU III Dispozita të përgjithshme administrative**

**23. Komunikimi me personat e tatuashëm**

23.3.3 Komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, bëhet me postë elektronike ose në rrugë elektronike, nëpërmjet dërgimit të tyre në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në sistemin elektronik të shërbimit tatimor, ose nëpërmjet dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të

tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore, sipas udhëzimit për pëlqimin e formës elektronike.

40. Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare  
Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të ndryshëm nga adresa kryesore, **personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.**

40.4 Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPT unik.

43. Ndryshimet në regjistrim 43.1  
Sipas nenit 43 të ligjit, personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare, janë të detyruar të deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, krijimin e mbylljen e degëve, ndryshimin e llojit të veprimtarisë, etj., siç përcaktohet në dispozitat ligjore për QKR. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

- VKB nr.220, datë 06.12.2021 për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022, tabela B.1.2, pika 2/1, paragrafi II:

Përfshihen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga Buxheti i Bashkisë apo Buxheti i Shtetit.

- Sa më sipër, konstatohet se në paketën fiskale për vitin 2022, **janë përjashtuar nga pagesa e tarifës shërbimeve publike** (gjelbërim, pastrim, ndriçim) subjektet të cilat kryejnë punime ndërtimi në Bashkinë dhe NJA, financuar nga fondet publike, megjithëse ato kanë përfituar prej shërbimeve publike të ofruara (pastrim, gjelbërim, ndriçim) nga Bashkia Sarandë. Ky përjashtim që i është bërë këtyre subjekteve, bie në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën “b” të nënpikës 1.3 të pikës 1 në nenin 9, shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35, shkronjën “f” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikën 10 të nenit 3 dhe pikën 2 të nenit 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

#### Arkëtimi i tarifës së shërbimit dhe pastrimit.

-Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifatat vendore për pastrimin dhe shërbimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga DAV, Bashkia Sarandë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuara tarifa e pastrimit dhe shërbimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2022 në 20 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit në vlerën 1,900,000 lekë gjithësej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

-Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë DAV Bashkia Sarandë, të lejeve të ndërtimit të dhëna për subjektet e mësipërme, por edhe nga puna e pamjaftueshme DAV Bashkia në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Sarandë.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. R. P. , Drejtor i Urbanistikës, z. E. L. , Specialist i NjP dhe z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë.

**Kriteri:** Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;  
Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pika B.1.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 1,900,000 lekë.

**Shkaku:** Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Sarandë, si dhe puna e pamjaftueshme e verifikimit në terren.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** DAV Bashkia në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Drejtorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën **1,900,000 lekë** ndaj **20 subjekteve**.

• **Përdorimi i të ardhurave.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 427,789 mijë lekë, ose **38%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për shpenzime operative, paga dhe investime.

*Tabela nr.10 Përdorimi i të ardhurave 2022*

Art.	Emërtimi	Te ardhurat e veta
600	Paga	138,640
601	Sigurime Shoqërore	23,251
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	216,333
604	Trans. Institucioneve	13,307
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	3,291
231	Kapitale të Trupëzuara	32,967
	<b>Total</b>	<b>427,789</b>

*Burimi: Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së*

- Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen mbajnë përgjegjësi:

1. z. A. G. , Kryetar i Bashkisë Sarandë,
1. z. L. B. , Drejtor i DAV Bashkia Sarandë,
3. z. R. P. , Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës,
4. z. G. A. , Inspektor i Policisë Bashkiake,
5. z. A. M. , Kryeinspektor i IMT,
4. zj. G. K. , Specialiste në Drejtorinë Juridike,
5. z. R. S. , Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
6. z. L. C. , specialist i Shërbimeve Publike,
7. z. N. A. , specialiste për mbledhjen e Borxhit,
8. z. E. V. , specialist për taksat NJA Ksamil,
9. z. A. Ç. , z. S. I. , z. R. M. , z. P. A. , z. L. O. dhe z. F. A. , Inspektor Terreni.

**2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.**

- Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2022.

**Për vitin 2022**, Pasqyrat financiare janë të nënshkruar nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Sarandë për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr. 1568 prot., datë 27.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Nënkryetari Bashkisë z. R. Ç. dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Drejtorisë Ekonomike znj. T. S. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

- Hartimii pasqyrave financiare:

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, D datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (*dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj*) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.*

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dheme saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.
- Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- *Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.*

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel” dhe jo me program të veçantë.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.
- Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datë n dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (*ose në bazë të të drejtave të konstatuara*), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Sarandë

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022 kanë dalë tre urdhra inventarizimi, konkretisht:

Urdhri nr. 240, datë 11.11.2022 “Për krijimin e komisionit për inventarizimit të aktiveve (mjete transporti), nga komisioni: R. S. , N. H. , E. M. , D. M. dhe G. A. .

Urdhri nr. 242 prot, datë 11.11.2022 “Për inventarizimin e materialeve në magazinë dhe inventari në përdorim (31/32), nga komisioni: E. S. , E. S. dhe E. L. .

Urdhri nr. 241, datë 11.11.2022 “Për inventarizimin e makineri paisje (214)”, nga komisioni A. P. , N. H. , A. B. , D. M. dhe R. S. .

Nga të dhënat konstatohet se inventarizimi i llog. 214 për shumën 45,660,439 lekë është kryer vetëm për një artkull, konkretisht artikullinkontejnerë mbeturinash në vlerën 6,114,240 lekë. Gjithashtu është kryer dhe inventarizimi i llog. 215 “Mjete transporti” në shumën 45,240,160 lekë, si dhe për llog. 31 “Mallra” për shumën 4,080,020 lekë.

Për llogaritë 32 “Inventari imët”.

Për vitin 2022 nuk janë nxjerrë aktive afatgjata ose mjete motorike jashtë përdorimit.

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 85, germa “c”, ku përcaktohet që:

*Pika 85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:*

*Germa “c”. Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.*

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit të aktiveve afat shkurtër dhe aktive afat gjatë. Gjithashtu dhe në raste kur ai është kryer nuk është i plotë **por vetëm për një pjesë**, ku në Hartimin e pasqyrave financiare është marrë për bazë gjendja kontabël e tyre dhe jo ajo fizike, **veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare** dhe në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar Bashkia Sarandë; *Formati nr.1*, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitet dhe pasivitet, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 9,357,132,780 lekë.**

Aktivet	5,013,284,380 lekë
Pasivet	574,537,445 lekë
Aktivet neto	4,438,746,935 lekë.

**Aktivet afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra Më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **992,630,706 lekë** dhe përbëhen nga:  
 Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 447,533,416 lekë;  
 Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 11,044,824 lekë;  
 Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 534,052,466 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare në organizma financiare krediti			
520	Disponibilitete në thesar	447,533,416	353,005,397	94,528,019
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>447,533,416</b>	<b>353,005,397</b>	<b>94,528,019</b>

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 353,005,397 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 447,533,416 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte” .

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 353,005,397 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 447,533,416 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit dhe përbëhet si më poshtë:

1. Të ardhura të trashëguara të vitit 2022 në verën 407,048,437 lekë.
2. Llogaria 466 “mjete në ruajtje” në shumën 40,484,979 lekë, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.3 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022”

- Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	4,080,020	3,556,859	523,161
32	Inventar i imët	6,964,804	5,984,841	979,963
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>11,044,824</b>	<b>9,541,700</b>	<b>1,503,124</b>

Llogaritë e Klasës 3, “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,541,700 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,044,824 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 1,503,124 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:



**Llogaria312 “Materiale”,** ka vlerën 4,080,020lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	<b>3,556,859</b>
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	28,261,868
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	27,738,707
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>4,080,020</b>

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton me një rritje për vitin ushtrimor prej 523,161 lekë, e cila përfaqëson rritje të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2022. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2022 në shumën 4,080,020 lekë, duke bërë sondazhe për 30 artikujne inventarin fizik rezultoi se nuk ka diferenca.

**Llogaria327 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 6,964,841lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	5,984,841
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	979,963
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	0
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>6,964,804</b>

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton me një rritje për vitin ushtrimor prej 979,963 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2022 **dhe për të cilën nuk është kryer inventar fizik.**

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”** përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	511,887,154	481,241,985	30,645,169
4342	Te tjera operatione me shtetin(debitor)	22,165,312	16,199,735	5,965,577
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>534,052,466</b>	<b>497,441,720</b>	<b>36,610,746</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>			
409	Furnitorë (Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”,** paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 497,441,720 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 534,052,466 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës.

**Llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 511,887,154 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	481,241,985
Shtesat gjatë vitit 2022	30,777,169
Pakësimet gjatë vitit 2022	132,000
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>511,887,154</b>

Debitorët analitik në fund të vitit 2022 paraqiten në *Aneks 3.1, bashkëlidhur Projektraport Auditimit.*

**Titulli gjetjes 21:** *Mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare viti 2022.*

**Situata:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton një gjendje e konsiderueshme në llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” prej 511,887,154 lekë, nga e cila: debitorët për taksat dhe tarifatat vendore për vlerën 348,067,442 lekë ose 68 % të totalit dhe vlera e lartë e gjendjes prej 163,812,712 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat evidentohet fakti se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer asnjë veprime për arkëtimin e tyre, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore duke kaluar afatet e kërimit.

Gjithashtu evidentohet dhe fakti se megjithëse janë debitorë ndaj kësaj bashkie, këto shoqëri vijnë të lidhin kontrata me Bashkisë Sarandë pa mundurë likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe mos lejimin e tyre në procedura.

Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se dhe kjo vlerë nuk është e saktë, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ALUIZNI) në shumën 74,782,000 lekë dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd. UK Sarandë në shumën 259,314,461 lekë.

Nga auditimi është konstatuar dhe fakti se detyrimet për shpërblim dëmi në vlerën 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 2.2022, **nuk janë të kontabilizuar** si detyrime dhe nuk është kryer asnjë veprim për njoftimin e tyre.

**Kriteri:** Në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9,11 dhe 12, ligji nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 40, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare dhe mos zbatimin e kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve debitorë.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DPZHT dhe Drejtorinë e të ardhurave, të marrin masa për rakordimet vjetore të vlerës së debitorëve në fund të periudhës për të gjitha llojet e taksave. Tarifave vendore, duke kryer kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare.

Të kontabilizohet në llog 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, vlera prej 74,782,000 lekë për taksën e ndikimit nga ndërtimet informale (ALUZNI) dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë, si dhe të kontabilizohen vlera shpërblim dëmi prej 10,317,550 lekë të rekomanduar dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e procedurave të prokurimit të mos lidhi kontrata shërbimi/ zbatimi në subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë për detyrimet debitorë të ardhur nga auditimet e KLSH apo institucione të tjera.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomikë të marrin të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për vjeljen e detyrimeve në shumën 163,812,712 lekë, sipas listës analitike që disponon Sektori i Financës në llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*”.

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”**, në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 22,165,312 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022, që trashëgohen në vitin 2023.

Kjo gjendje në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit:

llog.42 “*Detyrime ndaj personelit*” për vlerën 7,475,731 lekë,

llog.431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” për vlerën 617,791 lekë,

llog.435 “*Sigurime shoqërore*” për vlerën 2,252,136 lekë,

llog.436 “*Sigurime shëndetësore*” për vlerën 312,595 lekë,

llog.401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” me vlerën 1,163,220 lekë,

llog.437-438 “*Organizma të tjerë shtetëror*” me vlerën 52,364 lekë,

**llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me vlerën 10,291,475 lekë**

**Konstatim:** Totali 11,873,837 lekë e cila nuk rakordon me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 14,401,241 lekë **për vlerën 2,527,404 lekë.**

### Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”,** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën prej 15,940,245 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13,549,208 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 119,561,177 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 119,561,177 lekë, që i përket 114 projekt-studimeve për investime. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar dhe paraqitet në Aneksin 3.2, bashkëlidhur aktit.

**Titulli gjetjes 22: Pasaktësitë e llogarisë 202 “Studime dhe projekte”.**

**Situata:** Nga verifikimi analitik i llogarisë 202 “Studime dhe projekte”, konstatohet se nga 114 studime dhe projekte në vlerën 119,561,177 lekë, ku disa prej tyre janë projekte të hartuara ndërvite dhe gjendje në magazinën e Bashkisë Sarandë, evidentohet fakti se një pjesë e këtyre projekteve janë vënë në zbatim por që me mbylljen e vlerës së investimit nuk është i është bashkuar investimit, duke bërë klasifikim nga llog. 202 në llog. 212 ose 213.

**Kriteri:** Në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektorin e Menaxhimit të kontratave), Bashkia të marrin masa për analizimin e llog. 202 “Studime dhe projekte”, duke evidentuar të gjitha projekteve të prokuruar dhe vënë në zbatim gjatë periudhave ushtrimore dhe vlera e tyre ti kapitalizohet investimet sipas destinacionit të llogarive 212 ose 213.

### Aktivitet e afatgjata materiale (AAM)

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivitet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, paraqiten në shumën 4,826,249,599lekë (sipas koston historike). Në vitin paraardhës 2021, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 4,530,560,466 lekë, me një rritje të AAM-ve në shumën **295,689,133lekë** (sipas koston historike) që përfaqësojnë shtesat e tyre gjatë vitit 2022 (llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 32,648,385 lekë, llog. 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” në vlerën 248,581,718 lekë dhe llog. 214 “Instalime teknike makineri e pajisje e vegla pune” në vlerën 14,459,030 lekë).

Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 115,397,833 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2022**

NR	LLOG	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2021	Viti 2022	Gjendja me 31.12.2022
	210	TOKA TROJE TERRENE	<b>115,397,833</b>	-	<b>115,397,833</b>
1	210	Investime gjelbërimi	1,788,653		1,788,653
2	210	Mbjellje peme	8,483,448	211	8,483,448
3	210	Rikonstruksion plazhi +Rritja e kap. Te Gjelbërta ne Qytet	9,497,630		9,497,630
4	210	Lulishte	73,739		73,739
5	210	Parqe	1,669,977		1,669,977
6	210	Gjelberimi i shëtitores	173,303		173,303
7	210	Sistemimi I plazhit te ri Sarandë	2,483,350		2,483,350
8	210	Sistemimi I plazhit te vjetër Sarandë	4,985,914		4,985,914
9	210	Per mbrojtjen e tokës bujqësore	519,068		519,068
10	210	Sipërfaqja e rrethuar e Shtëpisë se Pushimit te Ushtrakeve	166,800	212	166,800
11	210	Mbjellje peme Dekorative rruga nr 4, lot 1+super.	3,526,241	211	3,526,241
12	210	Mbjellje peme Dekorative rruga nr 5,lot 2+super.	3,526,260	211	3,526,260
13	210	Mbjellje peme Dekorative rruga Limjon,L.Dardhes,rrugaV.Pandi	3,022,880	211	3,022,880

NR	LLOG	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2021	Viti 2022	Gjendja me 31.12.2022
14	210	Rikonstruksion I Stadiumit te Futbollit Sarandë	33,220,160	212	33,220,160
15	210	Rikonst. I Stadiumit te Futbollit Sarandë (tapeti pjesa e Federatës)	12,685,938		12,685,938
16	210	Sistemimi I Tregut Fruta Perime (mbulesa)	3,285,939	212	3,285,939
17	210	Rritja e kapaciteteve te Gjelbërta mbjellje peme	3,585,535	211	3,585,535
18	210	Permiresimi I kushteve te Plazheve ne Qytet	430,920		430,920
19	210	Rritja dhe përmirësimi I kapaciteteve te plazheve urbane	1,068,750		1,068,750
20	210	Mbjellje peme dekorative rruga Hyrëse	5,240,064	211	5,240,064
21	210	Vendosje vazo dekorative ne Qytet	447,192		447,192
22	210	Investim per token bujqes,rehabilim kanaleve ujitës e kullues	1,632,427		1,632,427
23	210	Investim per rinovim infrastrukurë agrare per fshatin Metoq-Gjashte	1,394,898	212	1,394,898
24	210	Investim per rinovim infrastrukture agrare per fshatin Shelegar	199,200		199,200
25	210	Ndertim lulishte 2005	1,285,766		1,285,766
26	210	Ndertim lulishte 2007	7,403,000		7,403,000
27	210	Peme dekorative 2008	921,601	211	921,601
28	210	Vendqëndrim mbeturinash 2008	1,182,780		1,182,780
29	210	Ndertim memorial 2010	1,496,400	212	1,496,400

### Titulli gjetjes 23: Pasaktësitë e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene".

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 115,397,833 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 210 "Toka Troje Terrene", konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **16 artikuj** aktive materiale në vlerën 78,696,463 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione" në shumën 38,169,299 lekë kjo për 4 artikuj dhe llog. 211 "Pyje dhe plantacione" në shumën 40,527,164 lekë kjo për 12 artikuj, pra kemi pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 210 "Toka Troje Terrene", konkretisht pasqyra 1.

#### Pasqyra 1. A. kujt që nuk i përkasin llog 210 "Toka Troje Terrene"

NR	LLOG	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2021	Viti 2022	Gjendja me 31.12.2022
1	211	Investime gjelbërimi	1,788,653		1,788,653
2	211	Mbjellje peme	8,483,448		8,483,448
3	211	Lulishte	73,739		73,739
4	211	Parqe	1,669,977		1,669,977
5	212	Sipërfaqja e rrethuar e Shtëpisë se Pushimit te Ushtarakeve	166,800		166,800
6	211	Mbjellje peme Dekorative rruga nr 4, lot 1+super.	3,526,241		3,526,241
7	211	Mbjellje peme Dekorative rruga nr 5,lot 2+super.	3,526,260		3,526,260
8	211	Mbjellje peme Dekorative rruga Limjon,L.Dardhes,rruga V.Pandi	3,022,880		3,022,880
9	212	Rikonstruksion I Stadiumit te Futbollit Sarandë	33,220,160		33,220,160
10	212	Sistemimi I Tregut Fruta Perime (mbulesa)	3,285,939		3,285,939
11	211	Rritja e kapaciteteve te Gjelbërta mbjellje peme	3,585,535		3,585,535
12	211	Mbjellje peme dekorative rruga Hyrëse	5,240,064		5,240,064
13	211	Ndertim lulishte 2005	1,285,766		1,285,766
14	211	Ndertim lulishte 2007	7,403,000		7,403,000
15	211	Peme dekorative 2008	921,601		921,601
16	212	Ndertim memorial 2010	1,496,400		1,496,400
		<b>SHUMA</b>	<b>78,696,463</b>		<b>78,696,463</b>

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël), "Klasifikimi kontabël", me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në shumën totale prej 115,397,833 lekë dhe për **16 artikuj** në vlerën 78,696,463 lekë që nuk i përkasin kësaj llogaritë të kontabilizohen në llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione" në shumën 38,169,299 lekë për 4 artikuj dhe llog. 211 "Pyje dhe plantacione" në shumën 40,527,164 lekë për 12 artikuj, etj.

**Llog. 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 31,804,000 lekë. Kjo gjendje paraqitet e analizuar sipas vlerës bruto ne tabelën e mëposhtme:

NR	Emërtimi	Gjendje me 31.12.2021	Sasia	Çmimi	Shtesa 2022	Gjendja me 31.12.2022
	PYJE,KULLOTA, PLANTACIONE	<b>31,804,000</b>				<b>31,804,000</b>
1	Ullinj(Ish Komuna Ksamil)	11884000	23,768	500		11,884,000
2	Pyllëzimi e gjelbërimit I kurorës se qytetit Sarandës	19920000	1	19,920,000		19,920,000

**Llog. 212 “Ndërtesa konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 954,853,065 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 932,391,228 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(kosto historike)”, paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,102,204,443 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022, paraqitet në vlerën 1,134,852,828 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 32,648,385 lekë, që përbëjnë shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM, sipas Aneksit 3.3 bashkëlidhur aktkonstatimi.

**Titulli gjetjes 24: Pasaktësitë e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,102,204,443 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,134,852,828 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer pra vlerës së ndërtesave nuk i është shtuar vlera e konstruksionit, por janë trajtuar si artikuj kontabël më vete.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **25 artikuj**aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog 202 “Studime e projektme” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211-“Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë.

Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

*Pasqyra e artikujve që nuk i përkasin llog 212 “Ndërtesa Konstruksione”*

	Ndërtesa konstruksione (Kosto Historike)	Gjendja me 01.01.2022	Shtesat (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2022
202	Projekti Varrezave	272,152			272,152
210	Zgjerimi i varrezave	2,997,798			2,997,798
210	Varrezat publike Metoq	20,800			20,800
210	Shtese varrezash Sarandë	950,183			950,183
210	Varrezat e Deshmoreve+rik.Godines Muze+ Obelisku	828,419			828,419
210	Zgjerimi dhe rrethimi i varrezave Gjashte	2,739,058			2,739,058
210	Sistemi i varrezave te vjetra	3,808,956			3,808,956
210	Sistemi i varrezave publike	2,353,073			2,353,073
210	Rrethimi dhe zgjerimi i Varrezave Sarandë+ supervizimi	4,057,297			4,057,297
210	Permiresimi i kushteve te plazheve ne Qytet	246,680			246,680
210	Rritja dhe përmirësimi kapaciteteve te plazheve urbane	1,484,166			1,484,166
210	Rikonst.kthim ne identit te teren spor stad.lojrr. Dore	6,937,705			6,937,705
210	Krijim dhe vendosje vepra A. ne ambiente publike	678,400			678,400
210	Rikonstruksion terrene sportive shkolla "A.Thanas" Palestra+sup	3,328,779			3,328,779
210	Rehabilitim amb.sportive shkolla 9 vjeçare "A.Sheme"	1,087,920			1,087,920
210	Këndlojërash per femijësh	599,851			599,851
211	Ndertim lulishte 2013	1,250,000			1,250,000
213	Sinjalistikavertikale, vijëzime	2,155,248			2,155,248
210	Sistemim varrezave Ksamil	1,497,720			1,497,720
210	Sistemimi i varrezave ne Metoq e Gjashte + sup	1,342,830			1,342,830
210	Këndlojërash e rehabilitim sheshesh ne Ksamil	4,347,840			4,347,840
213	Blerje tabela per sinjalistikën rrugore vertikale	2,126,880			2,126,880
213	Sinjalistika horizontale	4,000,000			4,000,000
210	Sistemim hapësira ne varreza	1,069,200			1,069,200
211	Hapësirë e gjelbër,rekreative,sportive ne lagjen nr 4 Sarandë 17.10.2022		4,840,987		4,840,987
	<b>SHUMA</b>	<b>50,180,955</b>	<b>4,840,987</b>		<b>55,021,942</b>

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me nomenklaturën e llogarive

te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë të marrin masa për analizimin e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,852,828 lekë duke i shtuar vlerën e konstruksionit ndërvite (investimit), si dhe sistemimin **25 artikuj** aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog 202 “Studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë, etj. Të inventarizohet me analizë të veçantë për çdo artikull vlera prej 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”.

**Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”,** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,768,771,332 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,860,647,676lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,134,107,522 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,382,689,240 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 248,581,718 lekë, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Analiza e kësaj llogarie paraqitet, sipas Aneksit 3.4 bashkëlidhur Raportit.

**Titulli gjetjes 25:** Pasaktësitë e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,134,107,522 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,382,689,240 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 248,581,718 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, në këtë llogari rezultojnë asetë të cilat i përkasin UK Sarandë që duhet të zbriteshin nga kontabiliteti për **6 artikujaktiv në vlerën 582,222,531 lekë**.

Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për transferimin e të gjitha aktiveve që nuk i përkasin kësaj bashkie, kryesisht të **6 artikujnë vlerën 582,222,531 lekë** që nuk i përkasin Bashkisë por Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Të analizohet me kujdes llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për investimet e kryera në fushën e ujësjellësit dhe për objektet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet transferimi i natyrë në Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Të analizohet vlera prej 29,568,137 lekë e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson.

**Llog 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 34,284,343 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 45,660,439 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,658,675 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 76,117,705 lekë për të cilat ka inventar fizik. Shtesa prej 14,459,030lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 ne krahasim me vitin 2021 përfaqëson shtesa pa pagese (dhuratë nga GIZ)

për vegla pune (Prese) dhe kontejnerë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqitet sipas *Aneksit 3.5, bashkëlidhur Raportit*.

**Titulli gjetjes 26:** *Pasaktësitë e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*.

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerë bruto 76,117,705 lekë për të cilat ka inventar fizik. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **8 artikuj** aktive materiale në vlerën **1,814,418 lekë**, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 "Inventar Ekonomik".

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2. Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël), "Klasifikimi kontabël", me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia: I mesëm**

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për analizimin e llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë bruto 76,117,705 lekë për kontabilizimin gabim të **8 artikujve** aktive materiale në vlerën **1,814,418 lekë**, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 "Inventar Ekonomik".

**Llogaria 215 "Mjete transporti"**, në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,781,097 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,525,082 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 45,240,160 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 45,240,160 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabël i llogarisë 215 "mjete transporti" me 31.12.2022**

Nr	EMERTIMI	Gjendja 31.12.2021	Shtesa për vitin 2021	Pakësime per vitin 2021	Gjendja 31.12.2022
	<b>Mjete Transporti</b>	<b>38,132,960</b>	<b>7,107,200</b>	<b>0</b>	<b>45,240,160</b>
1	Autoveturë e Policisë(Benz) AA081BY	2,400,000			2,400,000
2	Automjet PIAGGIO SR4849B	400,000			400,000
3	Makine e Policisë Bashkiake (xhip) AA811HB	2,071,200			2,071,200
4	Blerje automjeti me funksionet dyfisht (kosh+karroce)SR6137B	2,676,000			2,676,000
5	Autoveturë CHEVROLET Targa AA637BT (Dhurate Raiffeisen Bank)	1,400,000			1,400,000
6	Blerje automjeti vetëshkarkues me kapacitet 2/3 tonAA695FR	1,641,600			1,641,600
7	Autoveturë Ford Fiesta AA3971U prodh 2006 (dhurat nga proj. IADSA)	698,600			698,600
8	Makine mbeturinash Ksamil	2,496,000			2,496,000
9	Blerje makine automjet KsamilAA575FR	1,330,000			1,330,000
10	Makina Denisa (24.05.2008) MKZ	2,000,000			2,000,000
11	Automjeti internacional MKZ	700,000			700,000
12	Automjet Zjarrfikës Stajer 680 MKZ	1,000,000			1,000,000
13	Makina Magirus (27.05.2006)MKZ	1,500,000			1,500,000
14	Blerje Autoveturë tip Benz AA0800TD(19.01.2018)	2,485,000			2,485,000
15	Blerje fadromë2019(AGMT66)	4,908,000			4,908,000
16	Blerje automjet e paisje zjarrfikës2019 (AA934VR) MKZ	3,588,000			3,588,000
17	Blerje automjet 4x4 me karroceri 2019(AA481UB)MKZ	1,594,560			1,594,560
18	Blerje makine tip kamioncinë 2019 (AA979TX)	1,068,000			1,068,000
19	Blerje kamion 10 tonesh me vinç 2019 (AA792UG)	4,176,000			4,176,000
20	Mercedes benzatego AB047DB) (Dhurate giz)	5,927,200			5,927,200
21	Pirun(Forklift)(Dhurate giz)	1,180,000			1,180,000

**Personat përgjegjës që i kanë në ngarkim "Mjete transporti"**

Nr	Emërtimi	Sipas të dhënave kontabël		
		Personi përgjegjës	Sasia	Vlera
	<b>Mjete Transporti</b>			<b>45,240,160</b>
1	Autoveturë e Policisë(Benz) AA081BY	G. A.	1	2,400,000
2	Automjet PIAGGIO SR4849B	A. Gj.	1	400,000
3	Makine e Policisë Bashkiake (xhip) AA811HB	G. A.	1	2,071,200

Nr	Emërtimi	Sipas të dhënave kontabël		
		Personi përgjegjës	Sasia	Vlera
4	Blerje automjeti me funksion te dyfisht (kosh+karroce)SR6137B	F. H.	1	2,676,000
5	Autoveture CHEVROLET Targa AA637BT (Dhurate Raiffeisen bank)	G. A.	1	1,400,000
6	Blerje automjeti vetshkarkues me kapacitet 2/3 tonAA695FR	A. N.	1	1,641,600
7	Autoveture Ford Fiesta AA3971U vit prodh 2006(dhurate projekti IADSA)	L. B.	1	698,600
8	Makine mbeturinash Ksamil	Nuk eshte ne perdorim	1	2,496,000
9	Blerje makine automjet KsamilAA575FR	G. A.	1	1,330,000
10	Makina Denisa (24.05.2008) MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	2,000,000
11	Automjet internacional MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	700,000
12	Automjet Zjarrfikës Stajer 680 MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	1,000,000
13	Makina Magirus (27.05.2006)MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	1,500,000
14	Blerje autoveture tip benz AA0800TD(19.01.2018)	L. C.	1	2,485,000
15	Blerje fadrom2019(AGMT66)	S. Gj.	1	4,908,000
16	Blerje automjet e paisje zjarrfikse2019 (AA934VR) MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	3,588,000
17	Blerje automjet 4x4 me karroceri 2019(AA481UB)MKZ	S. L. , E. R. ,V. T. ,A. B.	1	1,594,560
18	Blerje makine tip kamjocin 2019 (AA979TX)	Th. S.	1	1,068,000
19	Blerje kamion 10 tonesh me vinç 2019 (AA792UG)	A. N.	1	4,176,000
20	Mercedes benz atego AB047DB) (Dhurate giz)	S. Gj.	1	5,927,200
21	Pirun(Forklift)(Dhurate giz)	K.	1	1,180,000

**Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”,** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,775,340 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,678,208 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 40,147,835 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 40,147,835 lekë, sipas Aneks 3.6 bashkëlidhur Raportit.

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a dhe nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata(kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refer Llogari	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Teprica ne Fund		Teprica Neto
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	
b	c	1	2	3	4	5	8	9	10
20	<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>119,561,177</b>	<b>103,620,932</b>	<b>15,940,245</b>	<b>0</b>	<b>2,391,037</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>119,561,177</b>
201	Prime emisi e rimbursim huave			0					0
202	Studime dhe kërkime	119,561,177	103,620,932	15,940,245		2,391,037			119,561,177
203	Konces.patent,licenc e tjera			0					0
21- 28	<b>II. AAGJ/MATERIALE</b>	<b>4,530,560,466</b>	<b>596,893,456</b>	<b>3,933,667,010</b>	<b>295,689,133</b>	<b>222,251,677</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4,826,249,599</b>
210	Toka,troje, Terene	115,397,833		115,397,833					115,397,833
211	Pyje, Kullota Plantacione	31,804,000		31,804,000					31,804,000
212	Ndërtime e Konstruksione	1,102,204,443	147,351,378	954,853,065	32,648,385	55,110,222			1,134,852,828
213	Rrugë,rrije,vepra ujore	3,134,107,522	365,336,188	2,768,771,334	248,581,718	156,705,376			3,382,689,240
214	Instal tekn,makin,pais,vegl pun	61,658,675	27,374,332	34,284,343	14,459,030	3,082,934			76,117,705
215	Mjete transporti	45,240,160	25,459,063	19,781,097		5,256,015			45,240,160
216	Rezerva shtetore			0					0
217	Kafshe pune e prodhimi			0					0
218	Inventar ekonomik	40,147,833	31,372,495	8,775,338		2,097,130			40,147,833
24	AQT te dëmtuara			0					0
28	Caktime			0					0
	<b>TOTALI (I + II)</b>	<b>4,650,121,643</b>	<b>700,514,388</b>	<b>3,949,607,255</b>	<b>295,689,133</b>	<b>224,642,714</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4,945,810,776</b>

- Rubrika “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale” për vitin 2022 paraqitet në bilanc në vlerën 224,642,714 lekë. “Amortizimi i AQ të trupëzuara dhe të patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr. 5, datë 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 36, Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Sarandë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25 %
- për mjetet e transportit 20 %
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.



**Titulli gjetjes 27:** *Pasaktësitë e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”.*

**Situata:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën 4,826,249,599 lekë është paraqitur e plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv.

**Inventari kontabël i aktiveve materiale** gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 115,397,833 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 31,804,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,552,828 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,382,659,240 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 76,117,705 lekë, **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Kjo mënyrë e evidentimit dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë në kundërshtim me.

**Kriteri:** Në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit të llogarive 21 “Aktive afatgjata materiale” në lidhje me blerjen, krijimin apo shtesat e tyre.

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e personave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia të marrin masa për zbërthimin e llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 115,397,833 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 31,804,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,552,828 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,382,659,240 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 76,117,705 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, të vlerës së plotë të çdo aktiv, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

Të hapen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

**Titulli gjetjes 28:** *Pasaktësitë e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”.*

**Situata:** Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, konstatohet se nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave, si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, **në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël**, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, **pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet.**

Gjithashtu këto objekte nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull

pronësia (*certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor*), pasi dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

**Kriteri:** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6;
- Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, Kapitulli III, pika 35, pika 74;
- Udhëzimin nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, ku cilësohet:
  1. *Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.*
  2. *NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.*

**Ndikimi:** Veprime të cilat nuk japin garanci mbi saktësinë e pasqyrave financiare 2022.

**Shkaku:** Përgjegjësi e peronave përgjegjës në Hartimin e pasqyrave financiare.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë të marrin masa për hartimin e një regjistri të saktë të aktiveve duke evidentuar vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datë n e daljes nga pronësia.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësi dhe në bashkëpunim me Eksperte vlerësuar të licencuar të aseteve për pronat e certifikuar me certifikatë pronësi por pa vlerë të bëhet vlerësimi i tyre dhe të futen në kontabilitet.

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje dhe në çelje të vitit ushtrimore 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, por në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat gjatë vitit 2022 janë kryer pagesat, për vlerën prej 179,186,144 lekë që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, sipas pasqyrës si më poshtë;

Nr.	Objekti i prokurimeve	Burim	Vlera e kontratës me Tvsh	Kontrata		Firma fituese	Pagesat sipas periudhave			Pa likuiduar
				Nr. date	Afati		Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	
1	Përfundim rrjet kryesor K.U.Z	FSHZH	19,800,158	12.05.2021	30 dit	E.-A.			19,800,158	-
2	Rëhabilitim i kanalit ujitës pjesa e I	FSHZH	31,227,944	01.02.2021	90 dite	A. C.		13,596,576	17,631,368	-
3	“Furnizimi me ujë i zonës B. Rr. dhe L. D. Faza e II	FSHZH	378,836,979	12.10.2021	1 vit	E. K		77,349,275	64,612,618	236,875,086
4	Rik. U K.+ Depo rrjeti shpër në L 3+4	FSHZH	157,360,783	27.11.2020	365 dit	Curri	1,490,000	70,000,000	77,142,000	8,728,783
5	Riko. i shko A. Sh.	FSHZH	56,599,705	22.12.2022	8 muaj	V. K.	-	-	-	56,599,705
	<b>TOTALI</b>	-	<b>643,825,569</b>	-	-	-	<b>1,490,000</b>	<b>160,945,851</b>	<b>179,186,144</b>	<b>302,203,574</b>

Nga të dhënat e mësipërme, gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 0 lekë, pasi ka investime në proces, pra vlera e kësaj llogarie duhej pasqyruar në vlerën gjithsej 643,825,569 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23, ku përcaktohet që:

“Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:

- Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve.  
 - Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, "Investime".  
 - Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, "Investime" ndahet në dy llogari treshifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatëshifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.  
 - Llog.230, "Investime për aktive afatgjata jomateriale", të analizuar në llogari shtatëshifrore; dhe  
 - Llog. 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", të analizuar në llogari shtatëshifrore."  
 Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara."

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Sarandë më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>574.537.445</b>	<b>562.790.071</b>	<b>Diferenca</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1.163.220	6.953.128	
42	Detyrime ndaj personelit	7.475.731	6.464.869	
16,17,18	Hua Afat shkurtra	0	0	
460	Huadhënës	0	0	
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	617.791	512.675	
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal	0	0	
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	2.252.136	1.999.317	
436	Sigurime Shëndetësore	312.595	269.746	
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore	52.364	0	
44	Institucione te tjera publike	0	0	
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	
464	Det. Për tu paguar për bl.letrave me vlere		0	
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	40.484.979	34.946.810	
467	Kreditore te ndryshëm	10.291.475	30.401.541	
4341	Operacione me shtetin(detyrime	511.887.154	481.241.985	
49	Shuma te parashikuara për xhvleresim(-)	0	0	
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
419	Kreditore, Parapagime	0	0	
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhëse	0	0	
478	Diferenca konvertimi pasive	0	0	
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar	0	0	
487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit	0	0	
	<b>II. Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
Klase 4	Llogari te pagueshme	0	0	
16,17,18	Huatë Afat gjata	0	0	
	Provizionet afatgjata	0	0	

**Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to",** në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,163,320 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Sarandë më datë 31.12.2022. Lëvizja e llog. 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelën si më poshtë:

### Lëvizjet për shtesa e pakësime gjatë vitit 2022

<b>Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"</b>	
Çelje e vitit 2022	<b>6,953,128</b>
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	5,798,908
<b>Gjendja në 31.12.2022 (K)</b>	<b>1,163,220</b>

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 1,163,220lekë përbëhet nga fatura të pa likuiduara për detyrime dezinfektim i ambienteve publike dhe shpenzime pritje përcjellje, etj sipas pasqyrës si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Objekti</b>	<b>OE</b>	<b>Vlera</b>
1	Dizifektim i ambienteve publike	"N." Shpk	1115520
2	Shpenzime pritje -përcjellje	H. R. A.	47700
	<b>TOTALI</b>		<b>1163220</b>

**-Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Sarandë, paraqitet në vlerën 7,475,731 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

**Lëvizjet për shtesa e pakësime gjatë vitit 2022**

<b>Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"</b>	
Çelje e vitit 2021	6,464,869
Shtesa (K)	85,014,635
Pakësime (D)	84,003,773
<b>Gjendja në 31.12.2022(K)</b>	<b>7,475,731</b>

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2022, ka rezultuar:

<b>Urdhër shpenzimi</b>		
<b>Numër</b>	<b>Datë</b>	<b>Vlera</b>
1	06.01.2023	6,050,655
2	04.01.2023	75,418
3	04.01.2023	994,229
4	04.01.2023	58,810
5	11.01.2023	276,219
6	12.01.2023	20,400
<b>Totali</b>		<b>7,475,731</b>

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 617,791 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

<b>Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"</b>	
Çelje e vitit 2021	512,675
Shtesa (K)	7,065,032
Pakësime (D)	6,959,916
<b>Gjendja në 31.12.2021 (K)</b>	<b>617,791</b>

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

<b>Urdhër shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>
<b>Numër</b>	<b>Datë</b>	
6	04.01.2023	617,791
<b>Totali</b>		<b>617,791</b>

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,347,742 lekë dhe 451,178 lekë.

<b>Llog. 435 "Sigurime shoqërore"</b>	
Çelje e vitit 2022	<b>1,999,317</b>
Shtesa	24,319,303
Pakësime	24,066,484
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>2,225,136</b>
<b>Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"</b>	
Çelje e vitit 2022	<b>269,746</b>
Shtesa	3,584,165
Pakësime	3,541,316
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>312,595</b>

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

<b>Urdhër shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>
<b>Numër</b>	<b>Datë</b>	
7	04.01.2023	2,252,136
8	04.01.2023	312,595
<b>Totali</b>		<b>2,564,731</b>

**Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 40,484,979 lekë, cila përfaqëson 5% garanci punimesh, sipas aneksit 3.9 bashkëlidhur aktit.

Për 78 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia janë ngurtësuar fonde në vlerën 36,267,256 lekë (sipas Aneksit 3.10, bashkëlidhur), për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Sarandë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e PZHT, Drejtoria e menaxhimit të Kontratave dhe

Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,267,256 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10, ku përcaktohet se:

*Pika 29. Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.*

*Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.*

*Pika 39. Këto pasqyra i'u dërgohen njësitë të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.*

*Pika 50. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordimet me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordimet, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizime dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*

*Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.*

#### Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”,

Llog. 466 " Kreditorë për mjete nën ruajtje "	
Çelje e vitit 2022	34,946,810
Shtesa (K)	14,880,452
Pakësime (D)	9,342,283
<b>Gjendja në 31.12.2022 (K)</b>	<b>40,484,979</b>

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në *Aneksin 3.7 bashkëlidhur Raportit.*

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”,** paraqiten faturat e pa likuiduara shërbime të cilat për vitin 2022 paraqiten në shumën 10,291,475 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2022	30,401,541
Shtesa	0
Pakësime	20,110,066
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>10,291,475</b>

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr.	Faturën.	Datë	Emërtimi i detyrimit. Llog 467 v. 2022	Shuma Lekë
			Objekti	
1	1	10.05.2018	Shpenz materiale	17,200
2	15	29.11.2022	Pritje përcjellje	47,700
3	9466	07.05.2020	Shpenzime te ndryshme	26,500
4		31.12.2015	Shpenzime gjyqësorepër Jordil sha	130,080
5		31.12.2015	Shpenzime energjie	4,593,759
6		31.12.2012	Shpenzime gjyqësore per Vogli Shpk	1,884,625
7	426,732,578,426,691,000	31.12.2022	Shërbime telefoni	22,118
8	329,553,329,552,329,000	31.12.2022	Shpenzime uji	90,396
9	426737998	31.12.2022	Shërbime telefoni	2,671
10	443294065	30.12.2022	Shërbime telefoni	6,551
11	Përmbledhëse e faturave.	30.12.2022	Shpenzime energjie	3,076,831
12		30.12.2022	Pagës për këshilltarët+ kryepleqtë	374,044
13		30.12.2022	Pagës për ASHK	9,000
14		30.12.2022	Rimbursim telefoni kryetarit	10,000
			<b>TOTALI(Llog467)</b>	<b>10,291,475</b>

**Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”**, paraqiten në fund të vitit 2022 në vlerën 511,887,154 lekë, lëvizjet për shtesa e pakësime për vitin, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

<b>Llog. 4341 “Operacione me shtetin(detyrime)”</b>	
Çelje e vitit 2022	481,241,985
Shtesa	30,777,169
Pakësime	132,000
<b>Gjendja në 31.12.2021</b>	<b>511,887,154</b>

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 1,082,487,980 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin paraqitet më poshtë:

*Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2022, në vlerën 381,943,238 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.*

*a. Gjendja e llogarisë analitike 7000 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022, në vlerën 1,055,352 lekë e cila përfshin tatimin mbi të ardhurat personale, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.*

*b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 80,301,609 lekë e cila përfshin tatim mbi pasurinë e paluajtshme, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.*

*c. Gjendja e llogarisë 7029 “Te tjera tatime mbi pasurinë” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 17,083,992 lekë e cila përfshin taksën e kalimit të pronësisë së mjeteve, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.*

*ç. Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 283,502,285 lekë e cila përfshin taksave ndërtimeve të reja, taksa e fjetjes në hotel, taksë për zënie hapësire publike, taksë tabele, reklame, etj*

*- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 121,706,746 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.*

*a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2022, në vlerën 4,220,860 lekë, e cila përfshin të ardhurat nga qiratë (ndërtesë & truall), e cila kuadron me akt-rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.*

*- Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” paraqitet në bilancin e 2022, në vlerën 116,591,113 lekë, e cila përfshin llogarinë 7110 “Tarifa administrative dhe rregullatore” ku përfshihen tarifatat për shërbimin e pastrimit, për leje transporti, licenca etj, në vlerën 104,104,725 lekë, llogaria 7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”, ku përfshihen tarifa parkimi, të ardhura nga çerdhe e kopshte” në vlerë 10,531,559 lekë, llogaria 7113 “Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve” në vlerë 540,910 lekë llogaria 7114 “Te ardhura nga biletat” në vlerë 346,500 lekë llogaria 7115 “Te ardhura nga gjocat e ç’dëmtime” në vlerë 1,067,419 lekë. Kjo vlerë me akt-rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.*

*-Gjendja e llogarisë 719 “Të ardhura të tjera jo tatimore” në vlerë 894,773 lekë. e cila kuadron me akt-rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.*

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 809,892,981 lekë paraqitet më poshtë:

*- Gjendja e llogarisë 600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’ për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 102,645,724 lekë.*

*- Gjendja e llogarisë 601 ‘Kontribute për sigurime’ për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 17,284,659 lekë.*

*- Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2022, në vlerën 204,363,254 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 198,984,402 lekë, diferenca nuk ka.*

*- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 240,749,173 lekë ku përfshihen transfertat për degët e varësisë për klubin e futbollit dhe per Prefekturën Vlorë dhe sipas aktrakordimet me Thesarin është në vlerën 240,749,173 lekë, diferenca nuk ka.*

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për buxhetet familjare e individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2022, në vlerën 246,353,295 lekë, ku përfshihen pagesa paaftësie, ndihme ekonomike, bursa etj, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

**Për vitin 2022** totali i te ardhurave në vlerë është 1,082,487,980 lekë, dhe totali shpenzimeve është 827,032,507 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 255,455,473 lekë, rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022, është në vlerën -1,503,124 lekë.

#### **Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”.**

Zëri “Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale” formati 6 e plotësuar për shumën 300,530,120 lekë në analizë nuk rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b, që është në vlerën 295,689,133 lekë, për shumën **4,840,987 lekë**. Sipas financës kemi një lapsus në formulë pasi gjendja është 295,689,133 lekë dhe nuk ka diferenca.

- Nga testi kontrollit për vitin 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:
- Rregullaritetin i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit tarifave administrative vendore dhe pagesate kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 gërmat “a”, “b” dhe “c” të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3, të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 31 raste janë zhvilluar projekte A. stike, aktivitete kulturore me vlerë 19,100,802 lekë (sipas aneksit 3.8 bashkëlidhur aktit), për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7, 9, 65 e 70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

**Vlera 19,100,802 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.**

- Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën dhe administrimi i karburantit. Veprimet nëpërmjet magazinës.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve

dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartelae zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

#### **Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:**

**Z. A. G.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe në cilësinë e Nëpunës Autorizues.

**Znj. T. S.**, me detyrë Drejtoresh e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Administrimit Financiar dhe Shërbimit Social, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

#### *- Mbi strukturën dhe nivelin e pagave.*

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 53, datë 24.12.2021, të me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Sarandë dhe NjA Ksamil për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 122/1 prot., datë 9.2.2022. Nëpunësit e Bashkisë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kapitullit III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, ku përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
- Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;
- Një sistem stimujsh për punonjësit për t'i nxitur të rrisin cilësinë e kryerjes së detyrave të caktuara;
- Një sistem për qarkullimin e punonjësve për të lejuar punonjësit të përftojnë një eksperiencë të gjerë në njësinë ku punojnë;
- Një sistem transparent sanksionesh, që të përcjellë një ide të qartë të qëndrimit të titullarit të njësisë ndaj shkeljes së rregullave të vendosura dhe një tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla;
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Kështu janë marrë në punë punonjës me kontrata pa zbatuar asnjë procedurë, pasqyra:

Viti 2022

Periudha	Largimet	Arsyeja	Emërimet	Me status/kontrate	Procedura e ndjekur
2022	R..P	Larguar me dëshirën e vet	K. X.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	Gj. M.	Përfundon Kontrata e Punës	B. B.	Me kontrate	Me kod Pune



Periudha	Largimet	Arsyeja	Emërimet	Me status/kontrate	Procedura e ndjekur
2022	Sh.A.	Larguar me dëshirën e vet	V. N.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	Th. K.	Dalje ne pension	E. M.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	M. I.	Dalje ne pension	K. B.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	P. Zh.	Pezullim dhe largim nga detyra	T. S.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	E. Gj.	Larguar me dëshirën e vet dhe pezullim te statusit te nëpunësit civil	K. A.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	H. J.	Larguar me dëshirën e vet	O. V.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	A. B.	Larguar me dëshirën e vet	R. P.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	A. B.	Pezullim dhe largim nga detyra	O. Q.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	A. H.	Transferohet ne detyre tjetërShtëpinë e Fëmijës	A. B.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	M. Zh.	Larguar me dëshirën e vet	A. M.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	M. K.	Dalje ne pension	J. N.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	F. Dh	Dalje ne pension	K. S.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	K. V.	Larguar me dëshirën e vet	Q. N.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	M. A.	Larguar me dëshirën e vet	K. Z.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	N. J.	Larguar me dëshirën e vet	P. V.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	L. H.	Larguar me dëshirën e vet	E. Z.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	A. K.	Larguar me dëshirën e vet	S. A.	Me kontrate	Me kod Pune
2022	R. H.	Larguar me dëshirën e vet	B. B.	Me kontrate	Me kod Pune
2022			A. Sh	Me kontrate	Me kod Pune
2022			Ç. Sh	Me kontrate	Me kod Pune
2022			S. M.	Me kontrate	Me kod Pune
2022			A. K.	Me kontrate	Me kod Pune

Sipas strukturës së miratuar me VKB,

- a. Pozicione pune të vlerësuara me status të Nëpunësit Civil, gjithsej 73 pozicione, nga të cilat:

\_\_\_\_\_1\_\_\_\_\_ pozicion i kategorisë së lartë,  
 \_\_\_\_\_11\_\_\_\_\_ pozicione të kategorisë së mesme drejtues,  
 \_\_\_\_\_1\_\_\_\_\_ pozicione të kategorisë së ulët drejtuese  
 \_\_\_\_\_60\_\_\_\_\_ pozicione të kategorive ekzistuese.

- b. Nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuara)?

\_\_\_\_\_1\_\_\_\_\_ pozicion i kategorisë së lartë,  
 \_\_\_\_\_2\_\_\_\_\_ pozicione të kategorisë së mesme drejtues,  
 \_\_\_\_\_0\_\_\_\_\_ pozicione të kategorisë së ulët drejtuese  
 \_\_\_\_\_10\_\_\_\_\_ pozicione të kategorive ekzistuese

*Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet si më poshtë:*

Viti	Muajt	Plani/Numër punonjës Nëpunës Civil	Realizimi/Numër punonjës Nëpunës Civilë	Diferenca K. Pune +Vakant	Plani/Numër punonjës Kod Pune	Realizimi/Numër punonjës Kod Pune	Diferenca
2022	Janar	73	41	32	51	40	11
2022	Shkurt	73	41	32	51	40	11
2022	Mars	73	41	32	51	36	15
2022	Prill	73	41	32	51	40	11
2022	Maj	73	43	30	57	44	13
2022	Qershor	73	41	32	57	44	13
2022	Korrik	73	41	32	57	44	13
2022	Gusht	73	41	32	57	44	13
2022	Shtator	73	40	33	57	47	10
2022	Tetor	73	40	33	57	47	10
2022	Nëntor	73	41	32	57	42	15
2022	Dhjetor	73	40	33	57	42	15

*Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë*

Duke u bazuar në të dhënat e sipërpërmendura konstatohet se, për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil realizimi i strukturës është në masën 54.7% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 82%.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Sarandë konstatohet se në total struktura është e përbërë nga 73 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbim Civil dhe 57 punonjës me Kod Pune. Në strukturën e punonjësve civil janë bashkuar edhe 33 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar.

Nga të dhënat e pasqyrës evidentohet fakti se 33 pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar me punonjës me emërim apo kontratë të përkohshme dhe jo sipas procedurave të konkurrimit. Ndërsa 13 pozicione pune rezultuan të lira.

Emërimi i punonjësve sa më sipër është në kundërshtim me ligjin, pasi çdo marrëdhënie e re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të neneve 22, 23, 25 dhe 26, duhet të respektohen kërkesat e procedurave të rregullta konkurrimi, pasi çdo emërim që realizohet në kundërshtim me këtë rregullt, është i pavlefshëm dhe në kundërshtim me nenin 10 pika (i) shkronja (a) dhe shkronja (ç) të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Bashkia Sarandë duhet të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivel ekzekutiv për rastet e pozicioneve të lira në institucion, sipas nevojave të strukturës në fuqi në momentin e zbatimit, në referim të pikës 9 të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Gjithashtu duhet të evidentohen nevojat për të rishikuar përshkrimin e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, duke e përshtatur me pozicionet e strukturës aktuale dhe kërkesave ligjore e nënligjore. Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

**z. A. G.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Sarandë

**znj. F. E.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

#### **2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

##### *- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësi vendore për punë e shërbime mallra, sipas *Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Raporti Auditimit.*

##### *- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.*

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH<sup>se</sup>, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022 nga subjekti Bashkia Sarandë, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej **20** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 292,652 mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

*Në 000/lekë*

Periudha viti 202	Proc. me vlera të larta			Diferenca me fond limit	
	Nr.	Fond limit	Vlere kontrate	Vlera	%
<b>I. Procedura të realizuara gjithsej, nga të cila</b>	<b>20</b>	<b>292,652,064</b>	<b>277,975,114</b>	<b>14,676,950</b>	<b>10</b>
- Të hapura	4	97,095,833	94,830,128	2,265,705	4
- E hapur e thjeshtuar	16	195,556,231	183,144,986	12,411,245	6
<b>Vlerësuar për auditim</b>	<b>9</b>	<b>137,262,498</b>	<b>130,882,112.40</b>	<b>6,380,376.60</b>	
Shprehur ne %	50	52.60	47.08	47,08	

Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratave të lidhura është me një diferencë për verën 14,676 mijë lekë ose 5% e vlerës së fondit.

Mbi bazën e materialitetit të bërë nga grupi i KLSH, nga **20** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 292,652 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim nga **9** procedura me fond limit **137,262** mijë lekë ose 52.60 % e totalit të procedurave.

Nga auditimi i **9 procedura** me fond limit **137,262** mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 9 procedura me vlerë të kontratës 130,882 mijë lekë ose 95.35% e vlerës së fondit limit të audituar. Shkeljet kanë konsistuar në këto drejtime:

**Titulli i gjetjes 29:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt OE, duke përdorur kriterë të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe të pa-argumentuara, konstatuar kjo në 4 procedura prokurimi.*

**Situata:** Nga auditimi i **9 procedura** me fond limit **137,262** mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara, kriterë të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE me oferta në të leverdishme në përputhje me LPP dhe VKM nr. 285, konkretisht:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit
1	Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare	59,595,833
2	Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh.	7,500,000
3	Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. "A. Ç. ' " mbi A. Sh, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër	10,000,000
4	Rikualifikim i rrugëve të brendshme në L. nr. dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme në lagjen "L. D.	9,166,666
5	Sinjalistika horizontale, vertikale	7,083,333
6	Lyerje fasadash për L. nr. , Kodër	10,833,333
7	Riveshje Rr. "M. D. " Sh. & Trotuari Rr. "L. T. " dhe rikualifikim i rrugës "J. K. "	9,333,333
8	Rikualifikim dhe shtrim të rrjetit rrugor Ksamil	16,666,667
9	Rikonstruksion të sallës së mbledhjes në bashki	7,083,333
		<b>137,262,498</b>

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit, Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Drejtues teknik në kundërshtim me kreun I/201 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" ku parashikohet se, për punime deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier, certifikata ISO jo në përputhje me tipologjinë e objektit të prokuruar, të cilat gjejnë pasqyrim në trajtimin e çdo procedure si më poshtë. Vendosija si kriterë e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit "Për prokurimin publik", pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

**Kriteri:** Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve" dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**Ndikimi:** Aplikimi i kriterëve jo të mirëargumetuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (*Njësia e Prokurimit*), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, eficensë dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**Titulli i gjetjes 30:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 9 procedura prokurimi.

**Situata:** Nga auditimi i **9 procedura** me fond limit **137,262** mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **2 procedura** me vlerë të fondit limit **69,595** mijë lekë ose 45.31 % e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit
1	Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare Adem Sheme, Sarandë	59,595,833
2	Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. "A. Ç." mbi Adem Sheme, mbi Komisarjat dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër	10,000,000

**Kriteri:** Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit".

**Ndikimi:** KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (KVO).

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

### **Rastet e shkeljeve sipas procedurave paraqiten si vijon:**

**1- Në tenderin e zhvilluar me objekt:** "Rikonstrukcion i shkollës 9-vjeçare "A. Sh", Sarandë", me këto të dhëna:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare A. Sh., Sarandë.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 13, datë 26.9.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 13, datë 26.9.2022	<b>4. Komision i VO</b> nr. 13/1, datë 26.9.2022
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur",	A. Sh. R. H. K. A.	J. M. R. Ç. B. D.
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 59,595,833 lekë, .	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> "V. K." Shpk me vlerën e ofertës 59,085,587 lekë pa Tvsh, me afat 8 muaj.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh) 99 %.</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 10.11.2022 REF -43901-09-29-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Financës + Bashkia Sarandë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 3:</b> a- Skualifikuar 2 OE b- Kualifikuar 1 OE:
<b>11. Ankimim</b> JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 13, datë 22.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b> 59,085,587.5 lekë me afat 8 muaj	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me urdhrin e prokurimit nr. 13, datë 26.9.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 59,595,833 lekë pa Tvsh, forma e procedurës e tenderit "E hapur" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 13/1, datë 26.9.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 10.11.2022.

Nga NjP është mbajtur PV nr. 1, datë 10.10.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 13, datë 26.09.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 10.11.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe DT të firmosura nga njësia e prokurimit.

### Vlerësimi i kritereve:

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.1/atë DT** është kërkuar që: “*OE të disponojnë kategorinë e licencave, si vijon:*

*N.P – 4/A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale*

*N.P -12/A Punime te inxhinierisë se mjedisit*

*N.S – 8/A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.”*

Kategoritë e mësipërme nuk janë të mirëargumentuara me tipologjinë e procedurës, pasi sipas zërave të preventivit nuk ka punime që përfaqësojnë këto zëra.

Në lidhje me kategorinë NP-12A Punime te inxhinierisë se mjedisit këto janë mbyllur në fazën e hartimit të projekt-preventivit dhe jo në zbatim.

**2. Në DT është kërkuar** që: “*OE pjesëmarrjes të ketë licencë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve inerte që kanë ndikim në mjedis (kodi III.2.B).*”

Në zbatim të pikës (a) e nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Këto ekspertiza janë ezauruar gjatë fazës së h A. mit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis.

Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, diskriminues, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme.

**3. Në pikën 2.3.4 të DT** është kërkuar që: “*OE të paraqesë ISO 3834-2:2006 (Kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike).*”

**Për certifikatë ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit te cilësisë se saldimit”, kërkesë e gabuar pasi** shërben për prodhimin me saldim, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën e shkrirjes me saldim. Standardit EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standardet janë përdorur si bazë për vlerësimin e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi. Nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrirjes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standardin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, kjo certifikatë nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqin këtë kërkesë.

**4. Në DT** është kërkuar që: “*OE pjesëmarrjes të paraqesin ing. Mjedisit dhe ing. A. tekt.*”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se kërkesat për inxhinierët e mësipërme nuk janë në përputhshmëri me tipologjinë e kontratës, pasi referuar zërave të preventivit që ato përfaqësojnë nuk ka punime që kërkon ekzistencën e këtyre inxhinierëve.

Kërkesa për 1 (një) Arkitekt, është e paargumentuar, pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri ose hartimii projekti, por me zbatim punimesh (rikonstruksion). Gjithashtu ky kriter është ezauruar gjatë fazës së h A. mit të preventivit.

**5. Në pikën 2.3.7 DT** është kërkuar që: “*OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm.*”

Në lidhje me kriterin për mjek, rezulton se, në VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011”, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma “b” dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: VKM nr. 692, datë 13.13.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se: “shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim”.

Sa më sipër, konstatohet kriter kualifikues i shfuqizuar. Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit, rezulton të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listë pagesa.

**4.Në DT është kërkuar që: “1 (një) person tw certifikuar si “Ekspert zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certificate/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe kontrata e punës.”**

Ekspert zjarrfikës kërkohet në rastet kur duhet të bëhet ekspertize apo një projekt për mbrojtjen nga zjarri. **Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: A. Sh. , R. H. dhe K. A. .**

#### **Zhvillim i procedurës.**

Me PV e datës 10.11.2022 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

1. OE “V. K. ” Shpk, me ofertë 59,085,588 lekë.

2. OE “N. ” Shpk, me ofertë ekonomike 59,486,559 lekë.

3. BOE “N. S” & “G. “ & “A. S. “ Shpk, me ofertë 54,904,341 lekë.

Me PV nr. 2, datë 7.12.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku kundërshtim me nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, **pasi nuk është respektuar afati 20 ditor.**

Sipas PV vlerësimit nga 3 OE pjesëmarrjes janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 OE, konkretisht:

#### **Janë skualifikuar:**

1 OE “N. ” Shpk është skualifikuar pasi nuk është paraqitur formulari i vetë deklarimit, sigurimi i ofertës.

2. BOE “N.S” & “G. Shpk & “A. S. “ Shpk është skualifikuar pasi:

OE “N. S. “ Shpk, mbulon 69.8% të punimeve nuk ka deklaruar asnjë punonjës të specializuar sipas kërkesave të DT Ndërsa OE “A. S. “ Shpk që mbulon 10.97% të punimeve duhet të deklaronte 1 punëtor duralumin, 1 specialist të kondicionimit të ngrojes-ftofjes, 1 specialist elektronik, 1 punime gips, 1 hidroizoluesin, 1 hekurkthyes. OE “G. “ Shpk që ka marrë përsipër 19.23% të punimeve duhet të deklaronte 1 bojaxhi, 1 punime durale, 1 specialist sistem ngrohje-ftoje, 1 specialist elektronik.

Nga BOE nuk është paraqitur licenca QKL III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje e mbetjeve urbane.

Nga BOE nuk është plotësuar pika 2.4 Kërkesa të veçanta për kualifikim, ku OE duhet të paraqesin autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/disibratori me të cilin prodhuesi/disibratori autorizon kapani në pjesëmarrëse të ofroje këto pajisje/mallra, si: materiale elektrike, hidraulike, rrjeti ngrohës, sistemi i mbrojtës nga zjarri, gips, kollë, fino, Hidroizoluese, materiale termoizolues, paisje hidrosanitare, pllaka dhe Bojra. Nga BOE nuk është paraqitur autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/disibratori me të cilën prodhuesi/disibratori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje, për materiale elektrike, hidraulike, rrjeti ngrohës dhe gipsi.

Pajisje hidrosanitare nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi por është paraqitur vetëm autorizim distributori.

Pllaka mungon përkthimi i autorizimit të prodhuesit.

Nga BOE nuk është plotësua pika 2.4, ku për kabull elektrik nuk është paraqitur katalog/skeda teknike e shoqëruar me raportet e testimit nga laboratorët e akredituar, tjera.

Ndërsa OE “V. K. ” Shpk, me ofertë 59,085,588 lekë, plotëson kriteret e DT dhe shpallet fitues.

Me shkresën e datës 22.12.2022, është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 179, datë 22.12.2022.

Me shkresën e datës 19.12.2022, është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë “V. K. ” Shpk, dhe Bashkia Sarandë, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 13, datë 22.12.2022 me objekt:“Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare A Sh.” me vlerën 59,085,588 lekë pa Tvsh. me afat punimesh 16 muaj nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

#### **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “V. K. ” Shpk, në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DT të miratuara nga AK, konkretisht:

Nga OE nuk është deklaruar në formularin e vetë deklarimit (shtojca 9), OE duhet të disponojë *punonjës të specializuar/të kualifikuar*, si më poshtë:

**1 (një) specialistë për ndihmën e shpejte**, shoqëruar me kontrate pune dhe certificate nga Kryqi i Kuq Shqiptar si Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave. Në rast BOE, këto certificate duhet ti këtë secili OE

**1 (një) Punonjës me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë”.** Kontratë individuale të punës si dhe certifikatë trajnimi “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, lëshuar nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj. Ne rast BOE, këto certifikata duhet ti këtë secili OE

**1 (një) person te certifikuar si “Ekspert zjarrfikës”** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet te paraqitet Certificate/dëshmi për ekspert zjarrfikës te lëshuar nga Ministria e Punëve te Brendshme dhe kontrata e punës

**2 (dy) Punonjës Specialist te Certifikuar dhe trajnuar për Punimet ne lartësi.** D.P.I. Rënia nga lartësitë, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj shoqëruar me kontrate pune dhe çertifikatë tëpërkatese te kualifikimit.

*Këto kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga OE të formularit përmbledhës të vetë deklarimit, sipas shtojcës 9, të Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuar më sipër OE “V. K. ” Shpk , nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën me kriterë më favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrjes në procedurë dhe përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”,si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”,**duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: z. J. M. me detyrë Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, R. Ç. me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe B. D. me detyrë specialiste Drejtoria e zhvillimit ekonomik financiar.**

**2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh. ”,** me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh. .</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 18, datë 18.10.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 18, datë 18.10.2022	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 18/1, datë 18.10.2022
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar”,	B. D. M. Zh. R. H.	R. Ç. J. M. K. A.
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 7,500,000 lekë, .	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> “A. C” Shpk me vlerën e ofertës 6,751,810 lekë pa Tvsh, me afat 8 muaj.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh) 90 %.</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 16.01.2023	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Sarandë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 7:</b> a- Skualifikuar 4 OE b- Kualifikuar 3 OE:
<b>11. Ankimim JO</b>	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\KJO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 18, datë 23.3.23023	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b> 6,751,810lekë me afat 30 ditë.	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Preventivi është hartuar nga specialistët ing. K. K. , bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Me urdhrin e prokurimit nr. 18, datë 18.10.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 7,500,000 lekë pa Tvsh, forma e procedurës e tenderit “E hapur e thjeshtuar” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 18/1, datë 18.10.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 16.01.2023.

Nga NjP është mbajtur PV e datës 30.12.2022, për hartimin e DT referuar urdhrin të prokurimit 18, datë 18.10.2022, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 16.01.2023), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe DT të firmosura nga Njësia e Prokurimit.

### **Vlerësimi i kritereve:**

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.4. DT** është kërkuar që: “Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo me pak se 20 punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave.”

Referuar zërave të punimeve, numri prej 20 punonjësish është i paargumentuar dhe zbërthyer me manual sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

**1. Në pikën 2.3.5 të DT** është kërkuar që: “OE Ofertues duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve.”

Kërkesa për drejtues teknik bie ndesh me Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet se, për punime deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier.

**Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e NJP, respektivisht: M. Zh. me detyrë ish-Specialist projektimi dhe infrastrukture Drejtoria e Shërbimeve Publike, R. H. specialist IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe B. D.**

### **Zhvillim i procedurës.**

Me PV e datës 16.01.2023 në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 7 OE, konkretisht:

1. OE “A. C” Shpk me NIPT:K5 dhe ofertë 6,751,810 lekë pa Tvsh.

2. OE “M. /” Shpk me NIPT:J.....dhe ofertë 6,547,000 lekë pa Tvsh.

3. OE “J. K. ” Shpk me NIPT:J9 dhe ofertë 6,160,200 lekë pa Tvsh

4. OE “K. ” Shpk , me NIPT:J6 dhe ofertë 5 999 900 lekë pa Tvsh

5. OE “S. ” Shpk , me NIPT:K5 dhe ofertë 6,895,100 lekë pa Tvsh

6. OE “Sh. ” Shpk me NIPT:K0 dhe ofertë 6,504,200 lekë pa Tvsh

7. OE “T. ” Shpk me NIPT:K3 dhe ofertë 7,273,680 lekë pa Tvsh

Me PV nr. 2, datë 01.2.2023 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku nga 7 OE pjesëmarrjes janë skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 3 OE, konkretisht:

### **Janë skualifikuar:**

1. OE “M. /” Shpk, pasi stafi teknik dhe mjetet janë të angazhuara në një kontratë tjetër të shpallur fitues po në këtë AK, ku pas verifikimit në dosje dhe sistem rezulton se konstatimi qëndron për fadromë dhe 2 specialist shtrues rrugësh.

2. OE “J. K. ” Shpk, pasi stafi teknik dhe mjetet janë të angazhuara në një kontratë tjetër të shpallur fitues po në këtë AK, ku pas verifikimit në dosje dhe sistem rezulton se konstatimi qëndron për fadromë dhe 2 specialist shtrues rrugësh.

3, OE “K. ” Shpk, pasi nuk ka të deklaruar në shtojcën 8 (vetëdeklarim) 2 shtrues rrugësh, dhe se mjete tip fadromë me goma copë 1 (një), nuk është shoqëruar me dokumentacion rrugorë, ku pas verifikimit në sistem rezulton se konstatimi qëndron për fadromë dhe 2 specialist shtrues rrugësh.

4. OE “Sh. ” Shpk, pasi nuk ka të deklaruar në shtojcën 8 (vetëdeklarim) fadromë me goma copë 1 (një), ku pas verifikimit në sistem rezulton se konstatimi qëndron për fadromë dhe 2 specialist shtrues rrugësh.

Ndërsa OE “A. C. ” Shpk me ofertë 6,751,810 lekë plotëson kriteret e DT dhe shpallet fitues nga OE të mbetur në garë.

Me shkresën nr. --, datë 4.2.2023 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 17, datë 20.02.2023.

Me shkresën nr. --, datë 14.2.2023 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis shoqërisë “A. C” Shpk dhe Bashkia Sarandë, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 18, datë 23.3.2023 me objekt: “Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh. ” me vlerën 6,751,810 lekë pa Tvsh, me afat punimesh 30 ditë kalendarike.

- **Vlerësimi i procedurës:**



Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE "A. C " Shpk në dosjen e procedurës dhe SPE, rezulton se OE plotëson kriteret e DT të miratuara nga AK.

**3- Në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. "A. Ç. " mbi "A. Sh", mbi k dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër", me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. "A. Ç. " mbi "A. Sh", mbi komisarariat dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 15, datë 18.10.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 15, datë 18.10.2022 M. Zh. B. D. R. H.	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 18/1, datë 18.10.2022 R. Ç. J. M. K. A.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur e thjeshtuar",		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 10,000,000 lekë, .	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> "M. /" Shpk me vlerën e ofertës 9,839,280 lekë pa Tvsh, me afat 8 muaj.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh) 98 %.</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 11.11.2022 REF -47926-10-31-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Sarandë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 4:</b> a- Skualifikuar 3 OE b- Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimim</b> JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 15, datë 15.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh) 9,839,280lekë</b> me afat 30 ditë.	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Preventivi është hartuar nga specialistët ing. A. T., bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", i ndryshuar.

Me urdhrin e prokurimit nr. 15, datë 18.10.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 10,000,000 lekë pa Tvsh, forma e procedurës e tenderit "E hapur e thjeshtuar" ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 18/1, datë 18.10.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 11.11.2022.

Nga NjP është mbajtur PV Më datë 31.10.2022, për Hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 15, datë 18.10.2022, ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (DT 11.11.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe DT të firmosura nga njësia e prokurimit.

**Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuan kriteret jo në përputhje me kushtet zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 "Për prokurimin publik", si dhe neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të DT** është kërkuar që: "Vlerësimi i përvojës së suksesshme të OE do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

*Për kontrata të realizuara me ente publike, OE duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:*

**Certifikatën e marrjes në dorëzim.**

*Ose për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqes/ dokumentacionin e mëposhtëm:*

**Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;**

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 – 2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5<sup>10</sup>, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

<sup>10</sup>Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë “

**2. Në pikën 2.3.5 të DT** është kërkuar që: “*OE Ofertues duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve.*”

Kërkesa për drejtues teknik bie ndesh me Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet se, për punime deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier.

**Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: M. Zh. , R. H. dhe B. D.**

**Zhvillimi i procedurës.**

Me PV e datës 11.11.2022, në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

1. OE “M. /” Shpk , me NIPT:J.....dhe ofertë 9,839,280 lekë pa Tvsh.

2. OE “E. A. ” Shpk ,me NIPT:K.....dhe ofertë 8,809,120 lekë pa Tvsh.

3. OE “K. K. ” Shpk, me NIPT:K.....dhe ofertë 9,920,280 lekë pa Tvsh.

4. OE “MF I. G. ” Shpk, me NIPT:L.....dhe ofertë 9,871,680 lekë pa Tvsh.

Me PV nr. 2, datë 23.11.2022 është bërë vlerësimi i OE pjesëmarrës në procedurë, ku nga 4 OE pjesëmarrjes janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 OE, konkretisht:

**Janë skualifikuar:**

1. OE “E. A. ” Shpk, me, pasi formulari vetë deklarimit (shtojca 8), nuk është plotësuar në përputhje me pikën 3 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika C: Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive, pasi mjeti Asfaltoshtuese nuk ka të dhënë asnjë lloj informacioni, po kështu dhe për mjetin kriko pjastër (deflektometër). Nga auditimi rezulton se skualifikimi qëndron.

2. OE “K. K. ” Shpk, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. Nga auditimi rezulton se skualifikimi qëndron.

3. OE “MF I. G. ” Shpk, pasi formulari vetë deklarimit (shtojca 8), nuk është plotësuar në përputhje me pikën 3 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika C: Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive. Nga auditimi rezulton se skualifikimi qëndron.

Ndërsa OE “M. /” Shpk plotëson kriteret e DT dhe shpallet fitues nga OE të mbetur në garë.

Me shkresën e datës 30.11.2022 është plotësuar formulari i njoftim fituesit. Shpallur në buletin e APP nr. 167, datë 5.1.2022.

Me shkresën e datës 13.12.2022 është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis OE “M. /” Shpk, dhe Bashkia Sarandë, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 15 prot., datë 15.12.2022, me objekt: “*Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç. ‘ ” mbi A. Sh., mbi komisarjat dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër*” me vlerën 9,839,280 lekë pa Tvsh, me afat punimesh 30 ditë kalendarike.

**Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “M. /” Shpk, në dosjen e procedurës dhe SPE, rezulton se OE **nuk** plotëson kriteret e DT të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson pikën 2.3.3 të DT, pasi nga OE nuk është depozituar **certifikata SO 45001:2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente.

- Në formularin e vetë deklarimit (shtojca 8), nuk është deklaruar sipas pikës 2.3.6 të DT, një **Teknik Gjeometër dhe një Karpentjer**.

- Nuk plotëson pikën 2.3.7 të DT, pasi nga OE nuk paraqet kriko mbi pjastër (deflektometer) për testimin e ngjeshmërisë së dheut në bazamentin e rrugës.

**Konkluzioni:** Nga sa trajtuar më sipër OE “M. /” Shpk nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën me kritere më favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrjes në procedurë dhe përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, **duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: z. J. M. me detyrë Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, R. Ç. me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe K. A. me detyrë specialiste IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore.**

**4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen nr.3(Pjesa mbi Spital) dhe rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen “L. D. ”, me këto të dhëna:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen nr. 3 (Pjesa mbi Spital) dhe rikualifikim i rrugëve te brendshme ne lagjen “L. D. ”</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 14, datë 29.9.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 14, datë 29.9.2022 R. H. K. A. A. Sh.	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 14/1, datë 29.09.25022 R. Ç. J. M. B. D.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar”,		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> <b>9,166,666 lekë.</b>	<b>6. Oferta fituese (pa Tvsh)</b> “I. /D. ” Shpk me vlerën e ofertës 8,265,875 lekë, me afat 8 muaj.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa Tvsh) 90 %.</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 19.10.2022 REF -43904-09-29-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Sarandë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 4:</b> a- Skualifikuar 2 OE b- Kualifikuar 2 OE:
<b>11. Ankimim</b> JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 14, datë 01.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh) 8,265,875 lekë</b> me afat 30 ditë.	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Preventivi është hartuar nga specialistët ing. A. K. , bazuar në çmimet sipas VKM nr. 627, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve e punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, i ndryshuar.

Me urdhrin e prokurimit nr. 14, datë 29.9.2022 nxjerrë nga Titullari i AK është përcaktuar fondi limit 9,166,666 lekë pa Tvsh, forma e procedurës e tenderit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike” ku është përcaktuar NjP dhe me urdhrin nr. 14/1, datë 29.9.2022, KVO dhe data e hapjes së tenderit në datën 19.10.2022.

Nga NjP është mbajtur PV Më datë 29.9.2022 për hartimin e DT referuar urdhrin të prokurimit 14, datë 29.9.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 19.10.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe DT të firmosura nga NjP.

#### **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2 të DT** është kërkuar që: “OE të disponojnë kategorinë e liçensave, si vijon:

N.S – 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

N.S – 18 A Punime topogjeodezike.”

Kategoritë e mësipërme nuk janë të mirëargumentuara me tipologjinë e procedurës, pasi sipas zërave të preventivit nuk ka punime që përfaqësojnë këto zëra.

N.S – 14 Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Në lidhje me kategorinë NS-18- Punime topogjeodezi se mjedisit këto janë mbyllur në fazën e hartimit të projekt-preventivit dhe jo në zbatim.

Konsiderohet zbatimi i riveimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Po kështu dhe kategoria. Gjithashtu referuar zërave të preventivit nuk ka punime për këtë lloj kategori linecës.

**2. Në pikën 2.3.2 të DT** është kërkuar që: “Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatori/ët ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

**Certifikatën e marrjes në dorëzim.**

Ose për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/ët ekonomik duhet të paraqes/dokumentacionin e mëposhtëm:

**Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit;”**

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së marrjes në dorëzim, është kërkesë e tejkualuar e nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1-2 vjeçare, duke tejkualuar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu në zbatim të nenit 39, pika 5<sup>11</sup>, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Sa më sipër kjo kërkesë e pengon OE për të marrë pjesë në garë për një punë për të cilën ende nuk e kanë marrë certifikatën e marrjes në dorëzim.

**3. Në pikën 2.3.5 të DT** është kërkuar që: “OE Ofertues duhet të këtë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve.”

Kërkesa për drejtues teknik bie ndesh me Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet se, për punime deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier.

**Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi ing. A. T. në cilësinë e personit të ngarkuar për kërkesat për kualifikim sipas urdhrin nr. 15, datë 2.10.2022 dhe anëtarët e NJP, respektivisht: R. A., K. A. dhe A. Sh. .**

**Zhvillimi procedurës.**

Me PV e datës 19.10.2022, në prani të komisionit të NJHDT dhe KVO është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

1. OE “I. /D. ” Shpk, me ofertë 8,265,875 lekë pa Tvsh.
2. OE “T. ” Shpk, me ofertë 7,354,250 lekë pa Tvsh.
3. OE “A. C. ” Shpk, me ofertë 8,201,900 lekë pa Tvsh.
4. OE “S. ” Shpk, me ofertë 8,523,836 lekë pa Tvsh.

**Janë skualifikuar:**

1. OE “T. ” Shpk, pasi nuk përmbush kriterin e punëve të ngjashme, pasi kontrata e paraqitur është jashtë afatit 5 vjeçare.

2. OE “A. C” Shpk, pasi nuk stafi teknik dhe mjetet janë të angazhuar në kontrata të tjera

Nga KVO janë kualifikuar 2 OE e mbetur në garë, duke shpallur fitues OE “I. /D. ” Shpk me ofertë 8,265,875 lekë plotëson kriteret e DT dhe me ofertë më të leverdishme se OE i mbetur në garë (OE “S. ” Shpk me ofertë 8,523,836 lekë pa Tvsh).

Me shkresën e datës 15.11.2022, është hartuar Raporti Përmbledhës sipas përcaktimeve ligjore, duke përshkruar të gjithë procedurën.

Midis OE “I. /D. ” Shpk dhe Bashkia Sarandë, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 14 prot., datë 01.12.2022 me objekt: “Rikualifikim i rrugëve të brendshme në L. nr. dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme në lagjen “L. D. ” me vlerën 8,265,875 lekë pa Tvsh, me afat punimesh 30 ditë kalendarike.

**Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “I. /D. ” Shpk në dosjen e procedurës dhe SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri plotëson kriteret e DT të miratuara nga AK.

**Konstatimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi skualifikimin e OE “T./D” Shpk, ku sipas KVO është skualifikuar pasi nuk plotëson kriterin e punëve të ngjashme, rezulton se nga verifikimi në sistem ky OE e plotëson këtë kriter, konkretisht:

<sup>11</sup>Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Nga OE për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur kontrata nr. 712, datë 24.8.2017 me vlerë kontrate 7,805,340 lekë me Tvsh me NJA P., Gjirokastër me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të NJA P., Gjirokastër”.

Afati i zbatimit të punimeve sipas certifikatës së përfundimit të punimeve është nga data 15.7.2017 deri me datë 13.10.2017. Procedura në Bashkinë Sarandë do zhvillohet me datë 19.10.2022. Pra kontrata është brenda afatit 5 vjeçar.

## 5. Procedura e prokurimit me objekt: “Riveshje Rr. “M. D. “ Sh.& T. Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i rrugës “J. K. ” Bashkia Sarandë, viti 2022.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riveshje Rr. “M. D. “ Sh.&amp; Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i rrugës “J. K. ”” Bashkia Sarandë, viti 2022</b>		
<b>1. Urdhër-Prokurimi</b> Nr.11 datë 07.09.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A. Sh. (Jurist) 2.B. D. (Ekonomiste) 3. R. H. (Ing.Elektronik)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave -Urdhër</b> nr.11/1 prot., datë.07.09.2022: 1. R. Ç. (Kryetar) Jurist 2. J. M. (Ekonomist) 3. K. A. (Ing Elektronik)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 9,333,333 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “N. ” Shpk, vlera e ofertës: 8,760,043 lekë paTvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 573,290 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> datë 15.08.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e veta	<b>10. OE</b> 1. OE “N. -” Shpk 2. OE “I./D. ” Shpk 3.OE “A. C” Shpk
<b>11. Ankimime AK: JO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b. Kontrata nr. 11 prot., datë 14.11 2022</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 14.11. 2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b>	<b>10,512,051 lekë</b>

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Kontratën e shërbim-projektimit për objektin: “Riveshje rruga “M. D. “ Sh.& Trotuari Rr. “L. T.” dhe rikualifikim me asfalt i rrugës “J. K. ”, Bashkia Sarandë, datë 19.08.2022, të Titullari i AK z. A. G. dhe z. A. T., me licencë N.

Projektpreventivi, specifikimet teknike, grafiku i punimeve janë pjesë e dosjes së prokurimit, formuluar nga z. A. T. e miratuar nga z. R. Ç. , Nënkryetar i Bashkisë Sarandë.

Me Urdhrin nr. 11, datë 07.09.2022, Titullari i AK z. AdrianGurma ka urdhëruar NjP të përberë nga z. A. Sh. , znj. B. D. dhe z. R. H. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 11/1, datë 07.09.2022, është ngritur KVOi përbërë nga: z. J. M. (Kryetar), z. R. Ç. e z. K. A. (Anëtar) dhe Financimi i projektit realizohet nga Buxheti i Bashkisë, sipas projekteve të miratuara për investime për vitin 2022.

### Hartimi i kriterevetë DT:

Më datë 14.10.2022, Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim (panumër protokolli).

### Vlerësimi i kritereve:

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuan kritere jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

OE duhet të disponojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, e vlefshme me kategoritë:

»NP-1A Punime gërmimi në tokë

»NP-4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, pista aeroportuale

»NP-7A Ujësjellësa, gazësjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje

»NS-18A Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Në rast BOE, këto licenca duhet ti ketë secili OE në bazë të përqindjes së punimeve që merr përsipër në akt-marrëveshje”.

Vendosja e kërkesave për disponimin e kategorive së mësipërme, nuk ipërmbahet përcaktimeve të pikës 1, nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Pë rrregullat e prokurimit

publik”, indryshuar, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriter që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, AK nuk i përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 3, të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me certifikatë të akredituar nga DPA, SSH/EN ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:

EN-ISO9001:2015-Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente;

ISO 14001:2015- Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit;

ISO 45001:2018 -(Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë); Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës.

Në rast BOE, këto certifikata duhet ti ketë secili OE në bazëtë përqindjes së punimeve që merr përsipër në akt-marrëveshje.”

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, çdo kriteri veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

**3. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 25 (njëzetë e pesë) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave, vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave.

b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. OE i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit dokumentin e deklaruar si mëlart”).

Në lidhje me numrin e kërkuar 25 (njëzetë e pesë) punonjës, duke ju referuar tipologjisë së objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nga AK nuk është argumentuar e nuk është në përputhje me;

- Pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë Kapacitetin Teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish seai i vendosur në këtë kriter.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “..Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

- Pikën 6/9, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “fuqinë minimale punëtore të OE, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

**4. Në pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE ofertues duhet të ketë drejtues teknik në licencën e zbatimit të punimeve, të paktën:

a. 1 (një) Ing. Ndërtimi

b. 1 (një) Ing. Hidroteknik

c. 1 (një) Ing. Topograf

**5. Në pikën 2.3.6 të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE ofertuesi duhet të ketë të përfshirë në stafin e tij, të certifikuar nga një organ i akredituar certifikues personeli (trup certifikues), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave, jo më pak se:

> Teknik gjeometër -1 (një);

> Shtruesr rugësh -3 (tre);

*Për punonjësit e kualifikuar si mësipër, ofertuesi duhet të paraqesë:*

*Për stafin e mësipërm të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe certifikata/diploma profesionale për secilin, si dhe certifikatat e sigurimit teknik. Certifikatat/diplomat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSh”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është në përputhje me vendimin nr. 441/2020, datë 09.10.2020 të KPP. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumente të rremë të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike”.*

Për sa trajtuar mësipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomik të caktuar.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

KVO ka hartuar/nënshkruar Procesverbalin nr. 1, datë 07.10.202, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali nr. 2 i KVO, datë 17.08.2022 “Për shqyrtimin e ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar të 3 (tre) OE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “N.” Shpk

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofertës ekonomike:

**1. OE “N.-” Shpk** (me Nipt: K) vlera ekonomike e ofertës **8,760,043** (tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyzetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “A. - C.” Shpk** (me Nipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës **8,857,044.06** (tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyzetë e katër pikë zero gjashtë) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “I./D.” Shpk** (me Nipt:L), me vlerë ekonomike të ofertës **8,905,273** (tetë milion e nëntë qindë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

Oferta e paraqitur nga OE “N.-” Shpk, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin ekontrates dheDT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, OE “N.-” Shpk, është kualifikuar përsa i përket dokumentacionit administrativ e ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO ka konstatuar që oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “I./D.” Shpk, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, OE është kualifikuar përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO ka konstatuar që oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “A. C” Shpk , është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, OE “A. C” Shpk është kualifikuar përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Bazuar në nenin 93 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO ka konstatuar që oferta nuk është anomalisht e ulët.

Nga pjesëmarrësit nuk ka OE të skualifikuar.

Oferta e paraqitur nga OE “N.” Shpk, është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DT dhe është oferta më e leverdishme.

Raporti Përmbledhës për procedurën e prokurimit është hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z. A. G. Më datë 08.11.2022, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “N.” Shpk.

Më datë 30.10.2022 “Formulari injoftimit të fituesit”, është botuar në Buletinin nr. 152, datë 7 Nëntor 2022, të APP në faqet 189-190/580.

Kontrata me OE “N” Shpk , me nr. prot., datë 14.11.2022. Vlera totale e kontratës, 10,512,051(dhjetë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e një), lekë me Tvsh.

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve Ing. A. T., me Licencë MK., në zbatim të Vendimit nr. 11/1 prot., datë 14.11.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. A. G.. Vlera totale e kontratës: 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë meTvsh.

Kontrata me kolaudatorin e punimeve Ing. K. K., me Licencë MK, sipas Vendimit nr. 11/2 prot., DT 14.11.2022 të Titullarit të AK z. A.. Vlera totale e kontratës: 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë meTvsh.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jonë përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike”, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga znj. A. Sh., z. R. H. e znj. B. D. në cilësinë e anëtarëve të NjP.

#### 6. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikualifikim .....” Bashkia Sarandë, viti 2022.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikim dhe shtrim të rrjetit rrugor Kl “Bashkia Sarandë, viti 2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr.17 datë 18.10.2022	2. Njësia e Prokurimit: 1. M. Zh. (Ing.Ndertimi) 2.B. D. (Ekonomiste) 3. R. H. (Ing.Elektronik)	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave -Urdhër nr.17/1 prot., datë 18.10.2022: 1. R. Ç. (Kryetar) Jurist 2. J. M. (Ekonomist) 3. K. A. (Ing.Elektronik)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E Hapur, Pune”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 16,666,667 lekë	6. Oferta fituese: OE “J. K. ” Shpk, vlera e ofertës: 15,329,100 lekë pa Tvsh	7. Diferenca me fondin limit 1,337,567 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 30.12.2022	9. Burimi Financimit: Të ardhurat e veta	10. OE 1. OE “D. J. ” Shpk 2. OE “J. K. ” Shpk 3. OE “S. ” Shpk
11. Ankimime AK: JO	12. Përgjigje ankesës nga AK,	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.
b. Kontrata nr. 17 prot., datë 06. 02 2023		
14. Lidhja e kontratës 06.02.2023	15. Vlera e kontratës (me Tvsh)	18,394,920 lekë

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Urdhrin nr. 17, datë 03.10.2022, “Për caktimin e personit për Hartimin e projektit dhe specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e vlerës së kontratës” Titullari i AK z. A. G. ka urdhëruar z. K. K. për objektin: “Rikualifikim .....”.

Hartimi i projektit është realizuar nga z.K. K. me licencë N.0354, në zbatim të kontratës së datës 03.10.2022, e lidhur me titullarin e AK z.A. G. .

Projektpreventivi: specifikimet teknike; Grafiku i punime janë pjesë e dosjes së prokurimit, formuluar nga z. K. K. e miratuar ngaz R. Ç., Nën kryetar i Bashkisë Sarandë.

Me Urdhrin nr. 17, datë 18.10.2022, Titullari i AK z. A. G. ka urdhëruar NjP të përbërë nga znj. B. D., z. R. H. dhe z. M. Zh. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 17/1, datë 18.10.2022, është ngritur KVO i përbër nga: Z. R. Ç. (Kryetar), z. K. A. dhe z. J. M. (Anëtar).

Financimi i projektit realizohet nga Buxheti i Bashkisë, sipas projekteve të miratuara për investime për vitin 2022, me vlerën e plotë të investimit 20,150 mijë lekë.

#### Hartimi i kritereve të DT:

Më datë 30.11.2022, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”.

#### Vlerësimi i kritereve:

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “OE duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.



*Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".*

*Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme: Punime të përgjithshme ndërtimi*

- *Përpunimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:*

*NP- 1 A Punime gërmimi në tokë.*

*N.P.-4 A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale*

*N.P-7A Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje*

*Punime speciale ndërtimi*

- *Përpunimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:*

*NS-18 A Punime topogjeodezike*

*Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës;"*

Vendosja e kërkesave për disponimin e kategorive së mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriter që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, AK nuk i përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 3, të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "OE duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- *ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)-ose ekuivalent*
- *ISO 14001-2015 (Sistemi imenaxhimit mjedisor)-ose ekuivalent*
- *SO 45001-2018 (Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë)-ose ekuivalent*

*Të gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organi vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH. Në rast BOE, këto certifikata duhet ti ketë secili OE".*

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet epikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit" ku përcaktohet që: "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo OE duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit."

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

**3. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** "OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 19 (nëntëmbëdhjetë) persona për periudhën minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave, vërtetuar me:

- *Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, në periudhën e mësipërme.*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e mësipërme."*

Në lidhje me numrin e kërkuar 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës, duke ju referuar tipologjisë së objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nga AK nuk është argumentuar e nuk është në përputhje me;

-Pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter.

-Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: "...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës."

-Pikën 6/c, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: "fuqinë minimale punëtore të OE; të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit".

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktorpër të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kritereve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

**4. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Operatori duhet të dëshmojë se ka drejtues teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin e mëposhtëm:

Inxhinier Ndërtimi 1(një)

Inxhinier Gjeodet 1(një)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në listë pagesat të paktën për periudhën minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme

- diplomat përkatëse.”

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”.

Kërkesa që diplomat e punonjësve të jenë të lëshuara nga shkolla profesionale shtetërore, kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e OE ofertues që disponojnë punonjës të kualifikuar, me diplomat përkatëse, të vlefshme, të lëshuara nga institucione të tjera, joshitetërore.

**5. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Greider	1 cope	Në pronësi/me qira
2	Kamion mekapacitet mbajtësmbi5ton	2cope	Në pronësi/me qira
3	Asfaltoshtruese	1 cope	Në pronësi/me qira
4	Fadrome megoma	1 cope	Në pronësi/meqira
5	Rul ngjeshes	1 cope	Në pronësi/me qira
6	Makine(autoboot meaksesoretperkatës)Dhe pastrimtiujravetëzeza)	1 cope	Në pronësi/me qira
7	Auto betoniere	1 cope	Në pronësi/me qira
8	Fabrikëpërprodhim asfaltbeton jomëpakse50kmngaobjekti	1cope	Në pronësi/me qira/me kontrate furnizimi.

d. Për mjetin Makinë (autobot me aksesoret përkatës) për pastrim të ujërave të zeza duhet të jetë i pajisur me leje nga QKL-ja.

Shënim: Ky kriter (6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga OE të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Në lidhje me kërkesën për “Makinë (autobot me aksesoret përkatës) për pastrim të ujërave të zeza”, duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nuk është i argumentuar, referuar përcaktimit të pikës 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët makinerish se ai i vendosur në këtë kriter.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali nr. 1, i KVO, datë 30.12.2022 për hapjen e procedurës nga rezulton që 3 (tre) OE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike të ofertë përkatëse të ofruara.

Procesverbali nr. 2 i KVO, datë 13.01.2023, “Për shqyrtimin e ofertave elektronike dhe inventarifizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar 1 (një) OE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT, ajo e paraqitur nga OE “J. C.” Shpk.

Në procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

**1. OE “D. J.” Shpk** (me NIPT K) pa vlerë ekonomike të ofertës.

**2. OE “S.” Shpk** (me NIPT K) me vlerë ekonomike të ofertës **15,176,121** (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e një) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “J. C.” Shpk** (me NIPT K) me vlerë ekonomike të ofertës **15,329,100** (pesëmbëdhjetë milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind) **lekë pa Tvsh.**

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. OE “D. J. ” Shpk. Oferta e paraqitur nga OE, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo-ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Nuk përmbush kriteret e DT pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në SPE.

2. OE “S. ” Shpk. Oferta e paraqitur nga OE “S. ” Shpk, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Nuk përmbush kriteret e DT.

Në pikën 6 të DT është kërkuar: Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: “Fabrikë për prodhim asfaltobetonit jo më pak se 50km nga objekti 1 (një) copë” – Në pronësi ose kontratë furnizimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky OE fabrika e asfaltobetonit e paraqitur nga ky OE është jashtë distancës së kërkuar në DT

KVO pasi shqyrtimit të dokumenteve të OE të paraqitura në SPE konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga OE “J. K. ” Shpk, është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Raporti Përmbledhës për procedurën e prokurimit është hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z. A. G. , Më datë 26.01.2023, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT, ajo e paraqitur nga OE “J. C. ” Shpk .

Kontrata me OE “J. C. ” Shpk, fitues me nr.17 prot., datë 06.02.2023. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **18,394,920** (tetëmbëdhjetë milion e treqindë e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqindë e njëzetë) lekë me Tvsh.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jonë përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga: z. M. Zh. , znj. B. D. e z. R. H. në cilësinë e anëtarëve të NjP.

**7. Procedura e prokurimit me objekt: “Lyerje fasadash për L. nr. , Kodër” Bashkia Sarandë, viti 2022**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Lyerje fasadash për L. nr. , Kodër” Bashkia Sarandë, viti 2022		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. datë 7 01.08. 2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. Gj. (Jurist) 2. E. L. (Ing.Ndertimi) 3. R. H. (IT)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave -Urdhër</b> nr.7/1 prot., datë 01.08. 2022: 1. R. Ç. (Kryetar) Jurist 2. J. M. (Ekonomist) 3. K. A. (Ing Elektronik)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 10,833,333 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “V. K. ” Shpk, vlera e ofertës: 10,576,160 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 257,173 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 27.10.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e veta	<b>10. OE</b> 1. OE “A. C” Shpk 2. BOE “C. ” & “A. & C” Shpk 3. OE “J. K. ” Shpk 4. OE “M. K & R. E.” Shpk 5. OE “N. ” Shpk 6. OE “Sh. ” Shpk 7. OE “T. ” Shpk 8. OE “V. K. ” Shpk
<b>11. Ankimime AK: JO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
b. Kontrata nr. 7 prot., datw 11.10 2022		
<b>14. Lidhja e kontratës 11.10. 2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b>	<b>12,691,392lekë</b>

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me kontratën e shërbimprojektimit për objektin: “Lyerje fasadash për l. nr .4, Kodër”, datë 15.07.2022, të Titullar i AK z. A. G. dhe z. A. T. , me Licencë N..

Projekt preventive, specifikimet teknike; Grafiku i punime janë pjesë e dosjes së prokurimit, formuluar nga z.A. T. e miratuar nga z. R. Ç. , Nënkryetar i Bashkisë Sarandë.

Me Urdhrin nr. 7, datë 01.08.2022, Titullari i AK z. A. G. ka urdhëruar NJP të përbërë nga z. E. Gj. , z. E. L. dhe z. R. H. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 7/1, datë 01.08.2022, është ngritur KVO i përbër nga: z. R. Ç. (Kryetar), z. K. A. dhe z. J. M. (Anëtar).

Financimi i projektit realizohet nga Buxheti i Bashkisë, sipas projekteve të miratuara për investime për vitin 2022.

### **Hartimii kritereve të DT:**

Nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, pa DT dhe numër protokolli.

### **Vlerësimi i kritereve:**

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “*OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga MIE bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*

*Punime të përgjithshme ndërtimi*

- *Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:*

*NP- 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash*

*Punime speciale ndërtimi.*

- *Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:*

*NS-1 A –Punime për prishjen e ndërtimeve*

*NS- 4A –Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura mematerial druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.*

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pronë MJE, (ose ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.”*

Vendosja e kërkesave për disponimin e kategorive së mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr .285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriter që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhetë mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, AK nuk i përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 3, të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në pikën 2.3.4, të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar:“*OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:*

*Inxhinier Ndërtimi I(një)*

*Drejtuesi teknik i mësipërm, duhet të jetë në listëpagesat të paktën për periudhën prill 2022 - qershor 2022 si dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtareve të stafit duhet tëparaqitet:kontratë noteriale pune e vlefshme diplomat përkatëse.”*

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se:“*Kontrata e punës lidhetnë formë të shkruar... ”.*

**3. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar:“*OE duhet të disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:*

• *1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë: “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga*

RSh. Për këtë duhet të paraqite tcertifikata e trajnimit si ekspert për dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave” e dhënë nga një organizëmi licencuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

• 1 (një) punonjës të disponojë certifikatësi “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, DT 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

• 3(tre) Punonjës specialist të certifikuar dhe trajnuar për punimet në lartësi. D.P.1 Rënie nga lartësitë, punime në fasadë, etj sipas VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhënë nga një organizatë certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këto duhet të paraqitet:certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar osei huaj, kontratë pune e vlefshme.”

Referuar objektit të kësaj kontrate dhe punimet konkrete që do të kryhen, të përfshira në preventivin e punimeve. Disponimi i punonjësve të cituar nuk është argumentuar domosdoshmëria dhe kualifikimi i punonjësve për realizimin e kontratës, veprim në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Pë rregullat e prokurimit publik”.

**4. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar:“OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 35 persona për periudhën prill 2022 - qershor 2022 e vërtetuar kjo me:

• Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën prill 2022 - qershor 2022.

• Listë pagesat e punonjësve sipas formatit si kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën prill 2022 - qershor 2022.

Për përmbushjen e këtij kriteri, OE duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.”

Në lidhje me numrin e kërkuar 35 (tridhjetë e pesë) punonjës, duke ju referuar tipologjisë së objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nga AK nuk është argumentuar e nuk është në përputhje me:

- Pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet se: “fuqinë minimale punëtore të OE, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

**5. Në Pikën 2.3.7. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar:“OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar:

Teknik ndërtimi 1 (një)

Specialist ndërtimi 1 (një)

Muratorë 3 (tre)

Suvatues 2 (dy)

Bojaxhinj 8 (tetë)

Të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën prill 2022 – qershor 2022.”

Referuar objektit të kësaj kontrate dhe punimet konkrete që do të kryhen, të përfshira në preventivin e punimeve. Disponimi i punonjësve të cituar nuk është argumentuar domosdoshmëria dhe kualifikimi i punonjësve për realizimin e kontratës, veprim në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”.

**6. Në Pikën 2.4.1. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar:“OE duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata tëvlefshme:

- EN-ISO9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.  
- EN-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.  
- ISO45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.  
Të gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali nr. 1 i KVO, datë 15.08.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 8 (tetë) OE kanë marrë pjesë, me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali nr. 2 i KVO, datë 17.08.2022 “Për shqyrtimin e ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar të 1 (një) OE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “V. K” Shpk.

#### **Në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. OE “A. C.” Shpk (me Nipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës **9,377,300** (nëntë milion e treqindë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqindë) **lekë pa Tvsh.**

2. BOE “C. ” Shpk & “A. & C. ” Shpk (me Nipt-e respektive: J & K), me vlerë ekonomike të ofertës **8,888,810**(tetë milion e tetëqindë e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqindë e dhjetë) **lekë pa Tvsh.**

3.OE “J. K. ” Shpk (me Nipt: J), me vlerë ekonomike të ofertës **9,284,753** (nëntë milion e dyqindë e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqindë e pesëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

4. OE “M.” & “R. E. ” Shpk (Nipt:J), me vlerë ekonomike të ofertës **9,271,530** (nëntë milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë) **lekë pa Tvsh.**

5. OE “N. ” Shpk (me Nipt: K1), me vlerë ekonomike të ofertës **10,777,700** (dhjetë milion e shtatëqindë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) **lekë pa Tvsh.**

6. OE “Sh. ” Shpk (me Nipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës **10,833,333**(dhjetë milion e tetëqindë e tridhjetë e tremijë e treqindë e tridhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

7. OE “T. ” Shpk (me Nipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës **7,823,700**(shtatë milion e tetëqindë e njëzetë e tremijë e shtatëqind) **lekë pa Tvsh.**

8. OE “V. K. ” Shpk (meNipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës **10,576,160** (dhjetë milion e pesëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë) **lekë pa Tvsh.**

#### **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. OE “A. C.” Shpk, oferta e paraqitur nga OE, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

OE nuk përmbush kriteret e DT pika 2.4.3 ku është kërkuar: “Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, OE ofertues për materialet (bojë hidroplastike cilësi e lartë, bojë vaji, grafiato, llaç), të pasqyruara në Shtojcën 5 Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/distributorëve zyrtare ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtare, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të

mallrave sipas kërkesave të DT me qëllim që AK të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Skeda teknike e paraqitur për bojën "S.N." nuk përmbush specifikimet e kërkuara. Kërkohet që norma e hapjes të jetë më e madhe se 15m<sup>2</sup>/litër. Në skedën teknike të paraqitur ky specifikim është 14m<sup>2</sup>/litër.

Për bojë vaji,llaç dhe grafiato nuk ka paraqitur skeda teknike.

OE nuk përmbush pikën 2.4.4 të DT ku kërkohet: "OE ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë certifikatë konfirmimit CE/Certifikate "Ecolabel" për këto produkte, të lëshuara nga /organizëm certifikuesi akredituar ose raportet e testimit të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara".

OE ka paraqitur certifikatë "Ecolabel" vetëm për bojën hidroplastike cilësie I. Për produktet e tjera nuk kaparaqitur as certifikatë "Ecolabel"as raportet e testimit.

2. BOE "C." Shpk & "A. & C" Shpk, oferta e paraqitur nga BOE nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nuk është kualifikuar dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. BOE nuk përmbush kriteret e DT pasi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 në seksionin B për disponimin e personelit nuk janë vendosur të dhënat e specialistëve të kërkuar.

Vërtetimi i OSHE i OE "C." Shpk nuk përfshin muajin Qershor.

BOE nuk përmbush kriteret e DT pika 2.4.3 ku është kërkuar: Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, OE ofertues për materialet (bojë hidroplastike cilësi e lartë, bojë vaji, grafiato, llaç, të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë: "Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/distributorëve zyrtare ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtare, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DT me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat dotë përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sipas katalogut "Pinto Color" të paraqitur asnjë skedë e bojërave akrilike nuk është në përputhje me specifikimet e kërkuara - Kërkohet që norma e hapjes të jetë më e madhe se 15m<sup>2</sup>/litër.

Sipas katalogut "Pinto Color", të paraqitur asnjë skedë e astarëve akrilike nuk është në përputhje me specifikimet e kërkuara – nuk plotësojnë: Viskoziteti: 100 ±20KU dhe norma e hapjes: >25 m<sup>2</sup>/litër, të treja skedat normën e hapjes e kanë 15-20m<sup>2</sup>/litër.

Skeda teknike e paraqitur për materialin grafiato nuk përmban specifikat e kërkuara për Viskozitetin dhe peshën specifike. Nuk përmbush pikën 2.4.4 të DT ku kërkohet: "OE ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë certifikatë konfirmimit CE/; Certifikatë "Ecolabel" për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian/organizëm certifikues i akredituar ose raportet e testimit të lëshuara nga organizma të notifikuar europian/organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara. Kjo BOE: nuk ka paraqitur as certifikatë "Ecolabel"as raportet e testimit. Për llaçin dhe grafiaton ka paraqitur deklaratë konformiteti nga prodhuesi që nuk janë të vlefshme dhe janë të papërkthyer.

3. OE "J. K." Shpk, oferta e paraqitur, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, duke rënë ndeshme përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

OE nuk përmbush kriteret e pikave 2.4.2, 2.4.3, 2.4.4 të DT pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar se i përmbush këto kriteret.

4. OE "M. K & R. E." Shpk, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrative ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. OE nuk përmbush kriteret e DT 2.3.7 ku kërkohet: "OE ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar: Teknik Ndërtimi 1 (një) Specialist Ndërtimi 1 (një); Muratorë 3 (tre); Suvatues 2 (dy); Bojaxhinj 8 (tetë), të vërtetuar me: diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH", kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të

*sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, librezë pune dhe të figurojë në listë pagesa për periudhën prill 2022 – qershor 2022”*

Teknikun i ndërtimit: M. M. nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë për muajin Prill 2022 siç kërkohet në DT

C. V. deklaruar në formularin përmbledhës si bojaxhi nuk figuron në prill si dhe për muajt maj - qershor OE nuk përmbush kriteret e DT pika 2.4.3, ku është kërkuar: “Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, OE ofertues për materialet (bojë hidroplastike cilësie lartë, bojë vaji, grafiato, llaç), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/distributorëve zyrtare ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DT me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Skeda teknike e paraqitur nga OE është për bojë të brendshme, katalogët e firmës “Isaval” nuk janë të përkthyer.

Sipas katalogut “Pintocolor” të paraqitur asnjë skedë e astareve akrilike nuk është në përputhje me specifikimet e kërkuara, nuk plotësojnë: Viskoзитetin  $100\pm 20$ KU dhe norma e hapjes: 25 m<sup>2</sup>/litër –të treja skedat normën e hapjes e kanë 15-20 m<sup>2</sup>/litër.

Skeda teknike e paraqitur nuk përmban specifikat e kërkuara për grafiato.

Nuk përmbush pikën 2.4.4 të DT ku kërkohet: “OE ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë certifikatë konfirmimit CE/certifikate “Ecolabel” për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian/organizëm certifikues i akredituar ose raportet e testimit të lëshuara nga organizmatë notifikuar europian/ organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara.”

OE: “Nuk ka paraqitur as certifikatë “Ecolabel” as raportet e testimit. Raport testi i paraqitur është për bojë të brendshme.

Certifikata “Ecolabel” e paraqitur nga firma “Isaval” nuk specifikon se për kë produkt është e vlefshme”.

5. OE “N. ” Shpk, oferta e paraqitur nuk është në përputhje me specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Kjo OE nuk përmbush kriteret e DT, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës nuk përmbush pikën 2.4.1 të DT, pasi nuk ka paraqitur certifikatat ISO, nuk përmbush pikat: 2.4.2; 2.4.3 e 2.4.4 të DT pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.

6. OE “Sh. ” Shpk, oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk është kualifikuar përsa i përket dokumentacionit administrative ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. OE nuk përmbush kriteret e DT Pikat: 2.1; 2.2.1; 2.2.2; 2.3.1 e 2.3.6 etj të DT

7. OE “T. ” Shpk, oferta e paraqitur nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, duke rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12,2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk është kualifikuar përsa i përket dokumentacionit administrative ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. OE nuk përmbush kriteret e DT konkretisht pikën 2.4.3 ku kërkohet: “Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, OE ofertues për materialet (bojë hidroplastike cilësi e lartë, bojë vaji, grafiato, llaç), të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike, duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DT me qëllim që AK të gjykojë nëse mallrat e ofruar të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Skeda teknike e paraqitur për bojën “Pinto Cryl Master” nuk përmbush specifikimet e kërkuara, “Norma e hapjes të jete më e madhe se 15m<sup>2</sup>/litër”. Në skedën teknike të paraqitur ky specifikim është 10-12m<sup>2</sup>/litër.



Skeda teknike e paraqitur për astarin “Universal” nuk përmbush specifikimet e kërkuara: “Norma e hapjes të jetë më e madhe se 25m2/litër. Në skedën teknike të paraqitur ky specifikim është 15-20m2/litër.

Nuk përmbush pikën 2.4.4 të DT ku kërkohet. “OE ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara dhe të pasqyruara në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”, duhet të paraqesë certifikatë konfirmimit CE/Certifikate “Ecolabel” për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian/organizëm certifikuesi akredituar ose raportet e testimit të lëshuar nga organizma të notifikuar europian/ organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushje standardeve të kërkuara”.

OE nuk ka paraqitur as certifikatë “Ecolabel” as raportet e testimit.

Konstatohet që: Oferta e paraqitur nga OE “V. K. ” Shpk , me vlerë 10,576,160 (dhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me nenin 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo-ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KVO ka konstatuar që oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “V. K. ” Shpk , është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Raporti Përmbledhës për procedurën e prokurimit është hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z. A. G. më datë 15.03.2020, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT Më datë 11.10.2022 është nënshkruara kontrata dhe është botuar “Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar”, në Buletinin nr. 143, datë 17 Tetor 2022, të APP në faqet 350-351/478.

Kontrata me OE “V. K. ” Shpk, me nr. 7 prot., datë 11.10.2022. Vlera totale e kontratës 12,691,392 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqindë e nëntëdhjetë e dy), lekë me Tvsh.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jonë përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga: z. E. Gj. , z. E. L. e z. R. H. në cilësinë e anëtarëve të NjP.

## 8. Procedura e prokurimit me objekt: “Sinjalistika horizontale, vertikale”, Bashkia Sarandë, zhvilluar në vitin 2022.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sinjalistika horizontale, vertikale” Bashkia Sarandë, viti 2022		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.6 datë 25.05.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. L. H. (Jurist)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave -Urdhër</b> nr.6/1 prot., datë 25.05.2022: 1. E. Gj. (Kryetar) Jurist 2. R. Ç. (Jurist) 3. K. A. (Ing Elektronik)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur e thjeshtuar”	2. E. L. (Ing.Ndertimi) 3. R. H. (IT)	
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 7,083,333 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “S. &R. S. S.” Shpk, vlera e ofertës: 5,454,092.40 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,629,240.60lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 13.06.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e veta	<b>10. OE</b> 1. OE “S. R. S. S. ” Shpk 2. OE “R.S.&M” Shpk 3. OE “T. ” Shpk 4. OE “I. K. ” Shpk
<b>11. Ankimime AK: JO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
b. Kontrata nr. 6 prot., datw 29.06.2022		
<b>14. Lidhja e kontratës 29.06. 2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b>	<b>6,544,910.88lekë</b>

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Urdhrin nr. 6, datë 25.05.2022, “Për caktimin e personit për hartimin e projektit dhe specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës”, Titullari i AK z. A. G., ka urdhëruar z. E. M. për objektin: “Sinjalistika horizontale, vertikale”.

Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me projektin, kapacitetin teknik dhe informacion tjetër për hartimin e DT është realizuar nga z. E. M. .

Projektpreventivi: specifikimet teknike; grafiku i punime janë pjesë e dosjes së prokurimit, formuluar nga: z. E. M. miratuar nga z. R. Ç., Nënkyetar i Bashkisë Sarandë.

Me Urdhrin nr. 16, datë 25.05.2022, Titullari i AK z. A. G. ka urdhëruar NjP të përbërë nga: znj. L. H. , z. R. H. dhe z. E. L. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 16/1, datë 18.10.2022, është ngritur KVO i përbërë nga: z. E. Gj. (Kryetar), z. R. Ç. e z. K. A. (Anëtar).

#### **Hartimii kriterëve të DT:**

Më datë 01.06.2022, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, me objekt: “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

Njoftimi i kontratës së shkurtuar, botuar në Buletin me nr. 72, datë 06 Qershor 2022, në faqet 45-46/384 të APP.

#### **Vlerësimi i kriterëve:**

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.4.1 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, në DT** është kërkuar: “Ofertuesi duhet të jete i pajisur me certifikatë të akredituar nga DPA, SSH/EN ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:

*EN-ISO 9001: 2015 –Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente;*

*ISO-14001:2015- Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit;*

*ISO- 45001:2018 -(Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë); Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës.*

*Në rast BOE, këto certifikata duhet ti ketë secili OE në bazë të përqindjes së punimeve që merr përsipër në aktmarrëveshje.”*

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt. Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, çdo kriteri veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht.

**2. Në pikën 2.4.1. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune.

*Grafiku i punimeve dhe afati i përcaktuar janë pjesë e dokumentacionit të tenderit të hartuar dhe kontrolluar nga struktura teknike e posaçme.*

**3. Në pikën 2.4.3. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, në DT** është kërkuar: “OE duhet të paraqesë për bojërat, fosforin, adezivin dhe tabelat, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon etij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

**Përsa trajtuar më sipër,** kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar OE të caktuara.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali nr. 1, i KVO, datë 13.06.2022, i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 (katër) OE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

Procesverbali nr. 2 i KVO, datë 13.06.2023 “Për shqyrtimin e ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”, nga ku ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë:

**1. OE “S. R. S. S. ” Shpk,** (me Nipt: L) me vlerë ekonomike të ofertës **5,454,092.40** (pesë milion e katërqindë epesëdhjetë katër mijë e nëntëdhjetë e dy presje dyzetë) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “R.S.&M” Shpk,** (me Nipt: K) me vlerë ekonomike të ofertës **6,065,400** (gjashtë milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “T. ” Shpk**, (me Nipt: K) me vlerë ekonomike të ofertës **6,730,260** (*gjashtë milion e shtatëqindë e tridhjetë mijë e dyqindë e gjashtëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

**4. OE “I. K. ” Shpk**, (me NIPT: K), me vlerë ekonomike të ofertës **6,921,460** (*gjashtë milion e nëntëqindë e njëzetë e një mijë katërqindë e gjashtëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

Oferta e paraqitur nga OE “S. R. ” Shpk, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nënjoftimin e kontratës dhe DT pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhje është kualifikuar, referuar dokumentacionit administrativo ligjor dhe dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Referuar nenit 93 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikës 4 të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO ka konstatuar që oferta është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “R.S.&M” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 6,065,400 (*gjashtë milion e gjashtëdhjetë e pesëmijë e katërqind*) lekë pa Tvsh, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për rrjedhje është kualifikohet referuar dokumentacionit administrative ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Referuar nenit 93 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikës 4 të nenit 82, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO ka konstatuar që oferta është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “T. ” Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës 6,730,260 (*gjashtë milion e shtatëqindë e tridhjetë mijë e dyqindë e gjashtëdhjetë*) lekë pa Tvsh, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhje nuk kualifikohet referuar dokumentacionit administrativ e ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, pasi nuk përmbush kriteret e DT pikën 2.4.3 Ku kërkohet që: *“OE duhet të paraqesë për bojërat, fosforin, adezivin dhe tabelat, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.”*

OE “T. ” Shpk, nuk përmbush kriterin pasi nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni në lidhje me kriterin e pikës 2.4.3 të DT

Oferta e paraqitur nga OE “I. K. ” Shpk, (me Nipt: K), me vlerë ekonomike të ofertës 6,921,460 (*gjashtë milion e nëntëqindë e njëzetë e një mijë e katërqindë e gjashtëdhjetë*) lekë pa Tvsh, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhje kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Sa mësipër KVO ka shqyrtuar dokumentete paraqitura nga OE dhe ka konkluduar që:

Oferta e paraqitur nga OE “I. K. ” Shpk, është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DT

Raporti Përmbledhës për procedurën e prokurimit është hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z.A. G. Më datë 23.06.2022, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “I. K. ” Shpk.

Kontrata me OE “I. K. ” Shpk, nr. 16 prot., datë 12.12.2022. Vlera totale e kontratës: **8,184,270** (*tetë milion e njëqindë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqindë eshtatëdhjetë*) **lekë meTvsh.**

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve Ing. A. K. , me Licencë K0754/3, në bazë të Vendimit nr. 6/1, datë 29.06.2022. Vlera totale e kontratës: 0 (*zero*)lekë.

Me urdhrin nr. 6/4, datë 29.06.2022 “Për delegim kompetencash” z. R. S. (Drejtori Shërbimeve Publike) është urdhëruar për verifikimin e situacioneve të punimeve dhe nënshkrimin e dokumentacionit përkatës për objektin: “Sinjalistika horizontale edhe vertikale”.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jonë përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të

cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga: znj. L. H. , z. E. L. e z. R. H. në cilësinë e anëtarëve të NjP, si dhe titullari i AK, z. A. G., në cilësinë e miratuesit të tyre.

**9. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion të sallës së mbledhjes në bashki”, Bashkia Sarandë, zhvilluar në vitin 2022.**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion të sallës së mbledhjes në bashki”, Bashkia Sarandë, viti 2022</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.16 datë 18.10.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. B. D. (Ekonomiste) 2. M. Zh. (Ing.Ndërtimi) 3. R. H. (Ing.Elektronik)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave -Urdhër</b> nr.16/1 prot., datë 18.10.2022: 1. R. Ç. (Kryetar) Jurist 2. J. M. (Ekonomist) 3. K. A. (Ing.Elektronik)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur e thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 7,083,333 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “A. C” Shpk , vlera e ofertës: 6,820,225 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 263,108lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 19.10.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Të ardhurat e veta	<b>10. OE</b> 1. OE “A. C” Shpk
<b>11. Ankimime AK: JO</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP.</b>
<b>b.Kontrata nr.17 prot., datë 06.02.2023</b>		
<b>Lidhja e kontratës</b> 06.02.2023	15.Vlera e kontratës (me Tvsh)	<b>8,184,270lekë</b>

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me Urdhrin nr. 16, datë 02.10.2022, “Për caktimin e personit për Hartimin e projektit dhe specifikimeve teknike, përlllogaritjen e vlerës së kontratës”, Titullari i AK z. A. G., ka urdhëruar z. K. K. për objektin: “Rikonstruksion të sallës së mbledhjeve në bashki”.

Hartimii projektit është realizuar nga z. K. K. me licencë N., në zbatim të kontratës së datës 02.10.2022 e lidhur me titullarin e AK z. A. G.

Projektpreventivi, specifikimet teknike, grafiku i punime janë pjesë e dosjes së prokurimit, formuluar nga z. K. K. e miratuar nga z. R. Ç., Nënkyetar i Bashkisë Sarandë.

Me Urdhrin nr. 16, datë 18.10.2022, Titullari i AK z. A. G., ka urdhëruar NjP të përbërë nga znj. B. D. , z. R. H. dhe z. M. Zh. për kryerjen e prokurimit.

Me Urdhrin nr. 16/1, datë 18.10.2022, është ngritur KVOi përbër nga: Z. R. Ç. (Kryetar), z. K. A. dhe z. J. M. (Anëtar).

**Hartimii kritereve të DT:**

Më datë 31.10.2022, nga Njësia e Prokurimit është hartuar procesverbali, me objekt: “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”.

Njoftimi i kontratës së shkurtuar, botuar në Buletin me nr. 152, datë 07 Nëntor 2022, në faqet 51-52/580 të APP.

**Vlerësimi i kritereve:**

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtete zhvillimit të procedurës dhe zbatim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

**1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

OE duhet të disponojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga ministria përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, e vlefshme me kategoritë:

- Përpunimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N.P – 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.

**Punime speciale ndërtimi**

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:

N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S – 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.”

Referuar punimeve të përfshira në DT të procedurës, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojin e punimeve të përfshirë në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

**2. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit Teknik, në DT** është kërkuar: “Ofertuesi duhet të jetë i

*Pajisur me certifikatë të akredituar nga DPA, SSH/EN ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:*

*EN-ISO 9001:2015 – Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, ISO14001:2015 – Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të mjedisit.*

*ISO45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë),*

*Certifikatat duhet të jenë në gjuhën e ofertës*

*Në rast BOE, këto certifikata duhet ti ketë secili OE në bazë të përqindjes së punimeve që merr përsipër në aktmarrëveshje.”*

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt.

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

**3. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:** *“Ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 20 (njëzetë) punonjës (numër i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për kryerjen e punimeve në kohë, sipas analizës, bazuar në preventivin dhe grafikun e punimeve), të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave, vërtetuar me: “*

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

Formularët e deklaramentit të mospasjes së konfliktit të interesit janë nënshkruar nga Njësia e Prokurimit Më datë 18.10.2022 dhe KVO më datë 11.11.2022.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali nr. 1 i KVO, datë 11.11.2022, i hapjes së procedurës, ku ka rezultuar se 1 (një) OE ka marrë pjesë me vlerë ekonomike të ofruara:

**1.OE “A. C.” Shpk, (me Nipt: K) me vlerë ekonomike të ofertës 6,820,225 (gjashtë milion e tetëqindë e njëzetë mijë e dyqindë e njëzetë e pesë) lekë pa Tvsh.**

Procesverbali nr. 2 i KVO, datë 13.01.2023 “Për shqyrtimin e ofertave elektronike dhe inventari fizik i dokumenteve kualifikuese dhe ofertat ekonomike”, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar dhe shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson të gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “A. C.” Shpk.

Sa mësipër KVO ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e OE dhe ka konkluduar që: Oferta e paraqitur nga OE “A. C.” Shpk, është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe DT

Raporti Përmbledhës për procedurën e prokurimit është hartuar nga KVO dhe miratuar nga Titullari i AK z. A. G., më datë 30.11.2022, është shpallur oferta e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “A. C.” Shpk.

Më datë 30.11.2022 është hartuar “Formulari i njoftimit të fituesit”, botuar në Buletinin nr. 167, datë 05 Dhjetor 2022, të APP në faqen 110/385.

Kontrata me OE “A. C.” Shpk, fitues nr. 16 prot., datë 12.12.2022. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **8,184,270 (tetë milion e njëqindë e tetëdhjetë e katër mijë e dyqindë e shtatëdhjetë) lekë me Tvsh.**

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve Ing. K. K., me Licencë MK., me nr.16/1 prot., datë 12.12.2022. Vlera totale e kontratës: 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë me Tvsh.

Kontrata me kolaudatorin e punimeve Ing. A. T., me Licencë MK., me nr. 16/2 prot., datë 12.12.2022. Vlera totale e kontratës: 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë me Tvsh.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jonë përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në kundë me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të

cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Sa më sipër *ngarkohen me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga: z. M. Zh., znj. B. D. e z. R. H. në cilësinë e anëtarëve të NjP.*

### **Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.**

#### **Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Në auditimin e regjistrit të realizimit të fondeve rezultoi se, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, janë realizuar 28 procedura prokurimi “*Blerje me vlerë të vogël*” me vlerë kontrate 15,097,780 lekë. Për auditim u përzgjedhën 10 procedura me vlerë kontrate 8,986,641 lekë, ose 59% e tyre.

**Titulli i Gjetjes 31:** *Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).*

**Situata:** Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 10 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 10 raste urdhri i prokurimit nuk ka numër protokolli, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Në 10 raste ftesa për ofertë nuk ka numër protokolli dhe DT;
- Në 10 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 10 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 10 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;
- Në 2 raste punonjësi i cili është anëtar në komisionin e blerjeve të vogla rezulton të jetë edhe anëtar në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar;
- Në 10 raste nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Në 5 raste afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, si dhe nga komisioni i blerjeve të vogla nuk është përllogaritur penalitet;
- Në 10 raste nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

**Kriteri:** Neni 2, pika 3 në nenin 34, pika 4 në nenin 36 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Pika 2 në nenin 26, neni 27, pika 1 në nenin 45, pika 3 në nenin 56, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pika 1 dhe pika 4 në nenin 75, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 2 në nenin 80 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 2 dhe pika 17 në Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Shkronja “b” në pikën 3 të nenit 22 në Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Pika 43 në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Udhëzimi i MFE nr. 9 datë, 20.03.2018” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; Neni 12 dhe 13 i Ligjit “Për normat tekniko profesionale për arkivat”.

**Ndikimi:** Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

**Shkaku:** Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

**Rëndësia:** I Lartë.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të angazhojë persona të kualifikuar në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

**Rekomandimi:** Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

**Rekomandimi:** Gjithashtu për 5 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

*Më hollësisht rastet trajtuar si më poshtë vijon:*

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “**Densifikim të ambienteve publike**”

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, E. S. , R. H. , L. H. , K. A. dhe B. D.;

-Urdhri nr. 15, nr. prot., 07.07.2022, i prokurimit për densifikim të ambienteve publike.

-Fondi limit është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur si dhe OE i renditur në vendin e parë përpara se të shpallet fitues duhet të dorëzoj dokumentacionin pranë AK;

-Urdhri i datës 22.07.2022, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, i përbër nga: A. K. , R. S. dhe J. B. ;

-Procesverbali i datës 22.07.2022 për marrjen e punës në dorëzim mbi shërbimin e desinfektimit të ambienteve publike;

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore nr. 9792022, datë 25.07.2022, në vlerën e **1,115,520 lekë me Tvsh**;

- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje E. S. , R. H. dhe K. A. , ku është shpallur fitues OE “M. B. ” i renditur në vendin e parë në bazë të vlerës më të ulët, me ofertën 728,000 lekë pa Tvsh;

OE fitues është njoftuar në datë 14.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.07.2022 OE “M. B. ” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “M. B. ” ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye të llogaritjes gabim, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “A. Sh. P. ” Shpk, i renditur i dyti me ofertën 855,555 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 14.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.07.2022, OE “A. Sh. P. ” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A. Sh. P. ” ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye objektive, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes pa firmë pa datë;

AK ka vazhduar me OE “A. ” Shpk, i renditur i treti me ofertën 895,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 14.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.07.2022 OE “A. ” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A. ” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “G. A. ” Shpk, i renditur në vendin e katërt me ofertën 899,900 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 18.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 18.07.2022 OE “G. A. ” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “G. A. ” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “N. ” i renditur në vendin e pestë me ofertën 929,600 lekë pa Tvsh.

Diferenca me fondin limit është 70,400 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 18.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

***Nga auditimi i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se komisioni i blerjeve të vogla nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përcaktimin e sipërfaqeve dhe zonave problematike ku duhet të kryhet shërbimi i dezinfektimit si dhe nuk janë bërë matjet në terren dhe sipërfaqja e përcaktuar në ftesën për ofertë nuk është e argumentuar dhe dokumentuar.

- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

- Në këtë procedure prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vulë të thesarit;

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE pjesmarrës;

- Në ftesën për ofertë në pikën 13 është kërkuar përdorimi i agjentit biologjik *Bacillus thuringensis israelensis*, shtami AM65-52 i kombinuar me *bacillus sphaericus*, shtami ABTS 1743, i cili do të përdoret në të gjitha sipërfaqet me ujë të ndenjtur ku depozitohen larvat e mushkonjave”.

- Nuk argumentohet pse duhet kërkuar një produkt specifik ndërkohë që në treg ka edhe produkte ekuivalente dhe efektive të cilët nuk kushtëzojnë pjesmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomike,

si psh produktet me bazë vetëm Bti me 3000 ITU në formë të tretshme në ujë dhe gjithashtu është një produkt efektiv.

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “N.” Shpk, i shpallur fitues nuk ka dorëzuar kriteret e kërkuara në ftesën për ofertë si më poshtë:

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim, dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar;

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk është respektuar afati për realizimin e kryerjes së shërbimit sipas përcaktimit të bërë në ftesën për ofertë, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte skualifikimin e tij dhe anulimin e procedurës.

**Konkluzion:** Përcaktimi i një produkti apo marke tregtare specifike është në kundërshtim me neni 2 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet që AK duhet të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike, të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, të nxisë konkurrencën, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues etj, si dhe në **nenin 36**, pika 2 ku citohet se: “*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. pika 4 ku citohet se “Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objektin e kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një OE specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit: z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .***

**2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje Karburanti për B.K. dhe P.-në”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon, znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr. 08, pa nr. prot., datë 06.06.2022, i prokurimit për blerje karburanti për bordin e kullimit dhe PMNZSH-në.

-Fondi limit është përcaktuar 1,000,000 lekë pa Tvsh me marzh fitimi 14 lekë/litër;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzojë dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.1493, datë 21.06.2022, në vlerën e 599,865 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje z. R. H. , znj. E. S. dhe znj. L. H.;

Procesverbali i mbajtur nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël (pa nr. prot.) datë 14.06.2022 rezultoi se OE “A&T” i renditur në vendin e parë me vlerë 1,199,731 lekë me Tvsh;

OE fitues është njoftuar në DT 14.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës<sup>12</sup> me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE pjesëmarrës;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

<sup>12</sup> Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.



- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e DTs së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
  - OE “A&” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
  - Në ftesën për ofertë në “Specifikimet teknike” është kërkuar që furnizimi i mjeteve të realizohet nëpërmjet tollonave, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të VKM nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duhet që njësitë e qeverisjes së përgjithshme sigurojnë që shërbimi i furnizimit me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.
  - Nuk administrohet deklarata nga OE shpallur fitues ku të disponojë minimumi një pikë karburanti brenda territorit të Bashkisë Sarandë.
  - Midis Bashkisë dhe OE “A&” Shpk, rezulton se nuk është lidhur kontratë për mallra për “Blerje karburanti për B.K. dhe P.-në” sipas ftesës për ofertë.
  - Nuk administrohet vërtetim që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, konkretisht për muajin maj.
  - Nuk administrohet vërtetim që OE nuk është në proces falimentimi (status aktiv).
  - Nuk administrohet vërtetim nga Administrata Tatimore ku të vërtetojë që OE ka paguar detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore, konkretisht për muajin maj dhe qershor.
  - Nuk administrohet QKL (II/A) për ushtrim aktiviteti në fushën e tregtimit të karburanteve.
  - Nuk administrohet vërtetim teknik të lëshuar nga ISHTI për respektimin e normave teknike për tregtimin e karburanteve.
  - Nuk administrohet vërtetim ku të garantohet se cilësia e karburanteve të jetë sipas standardeve Shqiptare dhe atyre Europiane.
  - Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim si dhe kopje e vlefshme e kontratës lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen Software.
- Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhet të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, R. H. , L. H. dhe E. S. .***

### **3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Paisje elektronike për administratën”.**

Përshkrimi i veprimeve;

- Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, znj. E. S. , z. R. H. , z. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;
- Urdhri nr. 30, pa numër prot., datë 04.11.2022, i prokurimit për paisje elektronike në funksion të administratës.
- Fondi limit është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh;
- Urdhri nr.263, me nr.5355 prot., datë 05.12.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje si vijon: A. P. , J. K. dhe R. H. ;
- Procesverbali pa nr. prot., datë 01.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;
- Në dosje administrohet ftesa për ofertë (pa nr. prot., pa datë), me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 42/2022, datë 01.12.2022, në vlerën e 1,175,880 lekë me Tvsh;
- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. , ku është shpallur fituesi OE “M.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 829,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.11.2022 OE “M.” Shpk, nuk është paraqitur pranë AK brenda afateve të përcaktuara.

AK ka vazhduar me OE “L. S.” Shpk, i renditur në vendin e dytë me ofertën 878,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.11.2022 OE “L. S” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave,

OE "L. S." Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye gabim në kuotim, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "H.-G." Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 979,900 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 20,100 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 14.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

**Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:**

-Punonjësi R. H. i cili është anëtar në komisionin e blerjeve të vogla rezultoi në jetë njëkohësisht edhe anëtar në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar.

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

- Në këtë procedurë prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vulë të thesarit;

**Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:**

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e DTs së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "H.-G." Shpk, i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Në ftesën për ofertë në "Specifikimet teknike" është kërkuar që OE i shpallur fitues të plotësojë parametrat dhe specifikimet për mallin e prokuruar.

- Nuk administrohet asnjë dokument justifikues për mallin e prokuruar nëse OE i shpallur fitues i plotëson parametrat dhe specifikimet e kërkuara në ftesën për ofertë.

-Nuk administrohet fletë garanci për mallin e prokuruar.

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhet të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit, z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .**

**4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje materiale të ndryshme marangozie për çeljen e sezonit turistik".**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr. 07, pa nr. prot., datë 16.05.2022, i prokurimit për blerje materiale të ndryshme marangozie për çeljen e sezonit turistik.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.123, me nr.2736 prot., datë 21.06.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. A. B. dhe z. E. M. ;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 21.06.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë (pa nr. prot., pa date), me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzojë dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.54/2022, datë 21.06.2022, në vlerën e 1,161,600 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. dhe znj. L. H. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE "S. Rr." Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 560,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 19.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezultoi se në datë 23.05.2022 OE "S. Rr." Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "S. Rr." Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "D-&C." Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 890,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 23.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.05.2022 OE “D-&C.” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “D- & C.” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye objektive, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “N. H.” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 918,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 24.05.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.05.2022 OE “N. H.” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “N. H.” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye objektive, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “A. 18” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 943,200 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 25.05.2022 në SPE.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 26.05.2022 OE “A. .18” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka bërë kërkesë tërheqje;

AK ka vazhduar me OE “H.-G.” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 945,801 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 27.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 27.05.2022 OE “H-G.” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “H.-G.” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë Bashkisë Sarandë;

AK ka vazhduar me OE “O. T.” Shpk i renditur në vendin e shtatë me ofertën 950,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 27.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 30.05.2022 OE “O. T.” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “O. T.” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë bashkisë.

AK ka vazhduar me OE “J. G.” Shpk, i renditur në vendin e tetë me ofertën 950,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 30.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 30.05.2022 OE “J. G.” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “J. G.” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë bashkisë Sarandë;

AK ka vazhduar me OE “E. A.” Shpk i renditur në vendin e nëntë me ofertën 955,000 lekë pa Tvsh. OE fitues është njoftuar në datë 30.05.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 31.05.2022 OE “E. A.” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “E. A.” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara dhe nuk është paraqitur pranë bashkisë.

AK ka vazhduar me OE “O. H.” Shpk, i renditur në vendin e dhjetë me ofertën 968,000 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 32,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 31.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datë s së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “O. H.” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet oferta ekonomike me çmimet e ofruara;

-Nuk administrohet vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk administrohet vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk administrohet kopje e çertifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

-Nuk administrohen specifikimet teknike nga OE sipas ftesës për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar Më datë 31.05.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 01.06.2021, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar Më datë 21.06.2022, pra 20 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, R. H. , K. A. dhe E. S. .***

**5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rehabilitim emergjent i murit mbajtës tek rruga B.”**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr. 12, pa nr. prot., datë 21.06.2022, i prokurimit për rehabilitim emergjent i murit tek Rr. B.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 979,786 lekë pa Tvsh;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim.

-Procesverbali pa nr. prot., datë 03.10.2022 i marrjes në dorëzim i objektit, me përbërje: z. R. H. , z. HE. L. dhe z. K. A. ;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i rënditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.92 datë 03.10.2022, në vlerën e 1,018,338 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje:znj. E. S. , z. R. H. dhe znj. L. H. , ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A. B.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 837,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 27.06.2022 OE “A. B.” Shpk, nuk është paraqitur pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “4 C.o” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 838,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 28.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.07.2022 OE “4. C.” Shpk nuk është paraqitur pranë AK;

AK ka vazhduar me OE “J.-K.” Shpk, i renditur në vendin e tretë me ofertën 848,615 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 01.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 131,171 lekë pa Tvsh.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Në ftesën për ofertë janë kërkuar mjetet si vijon;

Kamion mbi 3 ton;

Mjet Gjermimi;

Betoniere- por nuk është kërkuar shofer dhe manovrator për përdorimin e këtyre mjeteve;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

-Punonjësi R. H. i cili është anëtar në komisionin e bërjeve të vogla rezulton të jetë njëkohësisht edhe anëtar në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar.

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

- Në këtë procedure prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vullë të thesarit;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "J. -K." Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:  
 -Në preventivin e dorëzuar ka punime gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator me zinxhir por tek mjetet OE disponon eskavator me goma.  
 -Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar se realizimi i punës do bëhet brenda 7 ditëve duke filluar nga data e paraqitjes së dokumentave të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar Më datë 01.06.2022 dhe në datën 02.06.2022 OE shpallur fitues duhet të dorëzonte dokumentacionin e kërkuar nga AK, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 09.06.2022, ndërkohë marrja në dorëzim e objektit është realizuar Më datë 03.10.2022, pra 116 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.  
**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .**

**6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Shpenzime për materiale administrative të paparashikueshme".**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr. 32, pa nr. prot., datë 23.11.2022, i prokurimit për shpenzime për materiale administrative të paparashikueshme.

-Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje është 900,000 lekë pa Tvsh, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i cili i është drejtuar 3 OE të ndryshëm (A. M., M.P dhe M.A.), në dosje nuk administrohen ofertat e marra nga OE;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim;

-Procesverbali pa nr. prot., datë 13.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar, me përbërje: z. A. B. dhe z. E. M. ;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 195/2022 datë 13.12.2022, në vlerën e 1,005,242 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje:znj. E. S. , z. R. H. dhe z. K. A. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE "A. D." Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 750,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 30.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.12.2022 OE "A. D." Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "A. D." Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "O. T." Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 783,333 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 01.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 02.12.2022 OE "O. T." Shpk nuk është paraqitur pranë AK;

AK ka vazhduar me OE "S.-.22" Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 833,333 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 02.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 05.12.2022 OE "S.-.22" Shpk, nuk është paraqitur pranë AK;

AK ka vazhduar me OE "S. N." Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 837,777 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 62,223 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 05.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore të OE shpallur fitues;

**Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:**

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlogaritur fondin limit;

- Nuk dokumentohet përlogaritja e fondit limit.
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Në këtë procedurë prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vullë të thesarit;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datë s së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- OE “S . N.” Shpk , i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
- Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softwar-ike;
- Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues ku duhet të marrë përsipër montimin e banerave në pozicionet e përcaktuara nga AK sipas ftesës për ofertë;
- Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar Më datë 05.12.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 06.12.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar Më datë 13.12.2022, pra 7 ditë vonesë.Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .***

**7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzime mirëmbajtje mjete transporti për B.K.”.**

Përshkrimi i veprimeve;

- Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;
- Urdhri nr.05, pa nr. prot., datë 13.05.2022, i prokurimit për shpenzime mirëmbajtje mjete transporti për Bordin e Kullimit.
- Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje është 800,000 lekë pa Tvsh, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i cili i është drejtuar 3 OE të ndryshëm (V. Gj., E. M. dhe Th> V.), në dosje nuk administrohen ofertat e marra nga OE;
- Nuk administrohet urdhrii titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim.
- Procesverbali pa nr. prot., datë 30.09.2022 i marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar, me përbërje si vijon: M. L. , A. O. dhe L.I.;
- Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.195/2022 datë 13.12.2022, në vlerën e 947,998 lekë me Tvsh;
- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje”znj. E. S. , z. R. H. dhe z. K. A. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “L. S.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 500,000 lekë pa Tvsh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 26.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 27.07.2022 OE “L. S.” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “L. S.” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;
- AK ka vazhduar me OE “N.” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 549,000 lekë pa Tvsh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 27.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.
- Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 29.07.2022 OE “N.” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “N.” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;
- AK ka vazhduar me OE “V. Gj.” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 789,999 lekë pa Tvsh.
- Diferenca me fondin limit është 10,001 lekë pa Tvsh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 29.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;
- Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Në këtë procedure prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vullë të thesarit;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- OE “V. Gj.” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
- Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues i cili të deklarojë se nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Sarandë.
- Nuk administrohet fletë garancie për pjesët e këmbimit/mallit të prokuruar.
- Nuk administrohet dokumentacioni i cili OE shpallur fitues të ketë seli dhe objekt shërbimi brenda territorit të Bashkisë Sarandë.

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 29.07.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 01.08.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 30.09.2022, pra 60 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, R. H. , K. A. dhe E. S. .***

**8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Riparim i mjeteve për Bashkinë Sarandë”.**

Përshkrimi i veprimeve;

- Urdhri nr. 10, me nr. 186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje si vijon: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;
  - Urdhri nr .22, (pa numër protokolli) datë 09.08.2022, i prokurimit për riparimin e mjeteve të Bashkisë Sarandë.
  - Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje është 1,000,000 lekë pa Tvsh, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i cili i është drejtuar 3 OE të ndryshëm (V. Gj., E. M.dhe Th. V.), në dosje nuk administrohen ofertat e marra nga OE;
  - Urdhri nr. 245, me nr. 4995 prot., datë 14.11.2022, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. G. A. , z. L. B. dhe z. R. S. ;
  - Procesverbali (pa numër protokolli) 14.11.2022 i marrjes në dorëzim i mallit të prokuruar;
  - Në dosje administrohet ftesa për ofertë (pa numër protokolli dhe datë), me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoi dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.
  - Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 35/2022, dhe faturës nr. 31, datë 08.09.2022, në vlerën 975,000 lekë me Tvsh.
  - Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. dhe z. K. A. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “B. A.” Shpk , me ofertën më të ulët, në vlerën 744,000 lekë pa Tvsh.
- OE Fitues është njoftuar në datë 18.08.2022 nëpërmjet SPE. Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezultoi se në datë 12.08.2022 OE “B. A.” Shpk, është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “B. A.” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;
- AK ka vazhduar me OE “C. ” Shpk,i renditur në vendin e dytë me ofertën 900,000 lekë pa Tvsh, njoftuar në datë 12.08.2022 nëpërmjet SPE. Rezulton se në datë 16.08.2022 OE “C. ” Shpk, nuk është paraqitur pranë AK;

AK ka vazhduar me OE "E. M." Shpk, i renditur në vendin e tretë me ofertën 975,000 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 25,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 16.08.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

***Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:***

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlogaritur fondin limit;
- Nuk dokumentohet përlogaritja e fondit limit.

- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Në këtë procedurë prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vulë të thesarit;

***Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:***

-OE "E. M." Shpk, i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet Ekstrakt i thjeshtë i QKB, leje e mjetit e tipit C për riparim të pjesëve motorrike dhe motoçikletave si dhe riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorrit të mjeteve rrugore.

-Nuk administrohet dëshmi aftësie profesionale për përgjegjësinë teknike të autoriparimit.

-Nuk administrohet vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale.

-Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues i cili të deklarojë se nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Sarandë.

-Nuk administrohet fletë garancie për pjesët e këmbimit/mallit të prokuruar.

-Nuk administrohet dokumentacion i cili OE shpallur fitues të ketë seli dhe objekt shërbimi brenda territorit të Bashkisë Sarandë.

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

***Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje, z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .***

**9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje dokumentacioni promocion turizmi, banera, harta etj".**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr.02, pa nr. prot., datë 19.04.2021, i prokurimit për blerje dokumentacioni promocion turizmi, banera, harta etj.

-Urdhri pa nr. prot., datë 19.04.2022 për Hartimin e përlogaritjes së findit limit;

-Fondi limit sipas preventivit të administruar në dosje është 791,666 lekë pa Tvsh, e cila është përcaktuar nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, i cili i është drejtuar 3 OE të ndryshëm (A. M., "M." Shpk dhe K. R.), në dosje nuk administrohen ofertat e marra nga OE;

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim.

-Procesverbali pa nr. prot., datë 30.09.2022 i marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar, me përbërje: z. M. L. , z. A. O. dhe z. L. I.;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 664/2022, datë 05.05.2022, në vlerën e 757,750 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje:znj. E. S. , z. R. H. dhe znj. L. H. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE "O. T. " Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 666,667 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.04.2022 OE "O. T." Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "O. T." Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;



AK ka vazhduar me OE "E. H." Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 744,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.04.2022 OE "E. H." Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "E. H." Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "J. G." Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 750,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.04.2022 OE "J. G." Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE "J. G." Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE "M." Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 757,750 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 33,916 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 26.04.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

**Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

**Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:**

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit, nuk administrohen ofertat e marra nga 3 operatorë ekonomik të ndryshëm.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

**Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:**

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE "M." Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga OE shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike;

-Nuk administrohet vërtetim për shlyerjen e detyrimeve nga njësia vendore për taksat dhe tarifat vendore;

-Nuk administrohet vërtetim për shlyerjen e detyrimit për faturat e energjisë elektrike, lëshuar nga OSSHE;

-Nuk administrohet vërtetim nga OE shpallur fitues që nuk është në proces falimentimi;

-Nuk administrohet vërtetim nga OE shpallur fitues që nuk është i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë që lidhet me aktivitetin profesional, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Botimit;

-Nuk administrohet kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim;

-Nuk administrohet deklaratë ku OE shpallur fitues të marrë përsipër transportimin e të gjitha pajisjeve teknike të nevojshme me mjetin e tij;

-Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 24-orë, duke filluar nga data e njoftimit të fituesit. OE shpallur fitues është njoftuar më datë 26.04.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës së 27.04.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 05.05.2022, pra 8 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me përbërje: z. R. H. , z. K. A. dhe znj. E. S. .**

**10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Rehabilitim i rrjetit të lagjes nr.1".**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.10, me nr.186 prot., datë 18.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje: znj. E. S. , z. R. H. , znj. L. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;

-Urdhri nr.36, pa nr. prot., datë 19.12.2022, i prokurimit për rehabilitim i rrjetit të lagjes nr.1.

-Fondi limit është planifikuar 1,000,000 lekë pa Tvsh;

-Nuk administrohet urdhrii titullarit për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim.

-Procesverbali pa nr. prot., datë 28.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar, me përbërje: z. A. B. , z. R. H. dhe z. K. A.;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë pa nr. prot., pa datë, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.59/2022, datë 28.12.2022, në vlerën e 1,080,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. R. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “S. ” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 893,000 lekë pa Tvsh.

OE fitues është njoftuar në datë 21.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezultoi se në datë 24.12.2022 OE “S. ” Shpk, nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar kërkesë për tërheqje nga procedura e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “N. -” Shpk , i renditur në vendin e dytë me ofertën 900,000 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 100,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

#### **Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;**

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Në ftesën për ofertë janë kërkuar 2 makina (autobot me aksesoret përkatës) por në asnjë rast nuk janë kërkuar edhe shoferët të cilët duhet ti përdorin këto mjete.

#### **Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:**

-Punonjësit z. R. H. dhe z. K. A. të cilët janë anëtar në komisionin e blerjeve të vogla rezultoi të jenë njëkohësisht edhe anëtar në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar.

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

-Në këtë procedurë prokurimi, referuar dokumentacionit të dosjes së tenderit, urdhri i prokurimit nuk është depozituar në degën e thesarit dhe nuk ka vulë të thesarit;

#### **Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:**

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “N. -” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Midis OE “J. K. ” Shpk , me administrator z. S. Ç. dhe “OE N. 6” Shpk , kanë lidhur një kontratë qiraje për 2 mjete (Autobot Pastrimi), kjo kontratë është lidhur në datë 16.12.2022. (kontratë noteriale).

-Mjetet (Autobot Pastrimi) me targa AA..PA dhe A.IK (marrë me qira) nuk disponojnë Siguracion, çertifikatën e kontrollit teknik, taksën vjetore si dhe çertifikate për transportin e mallrave për të tretë dhe me qira. Në certifikatën e pronësisë në të 2 këto mjete është cituar se mjetet janë për përdorim vetjak.

Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

**Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit: z. R. H. , z. K. A. dhe znj. B. D. ;**

### **2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.**

#### **I. “Rikualifikim .....” OE “J. K. ” Shpk**

##### Kontratatë (Sipërmarrje mbikëqyrje kolaudimi).

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 17 prot., datë 06.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari **Z. A. G.** dhe **“J. K.” Shpk** , me përfaqësues **Z. S. Ç.** me licencë profesionale NZ. , datë 13.03.2017. Vlera e kontratës është **18,394,920 lekë me Tvsh.** Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore **40** ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve **12** muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 17/1 prot., datë 06.02.2023, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K. K. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. **0453/3**, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit **80,000 lekë pa Tvsh.**

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 17/2, datë 06.02.2023, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A. K. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK **1011** përfaqësuar nga **z. A. K.** dhe me vlerë të kontratës së shërbimit **35,000 lekë pa Tvsh.**

### Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. K. K. në vitin **2022**.

### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë **13.02.2023** dhe kanë përfunduar me datë **24.03.2023**, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 13.02.2023, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës nr. 17 date 06.02.2023 të lidhur midis Investitorit dhe sipërmarrësit për: objektin “Rikualifikim dhe shtrim të rrjetit rrugor Ksamil.

Punimet kanë përfunduar Më datë **24.03.2023**, janë marrë në dorëzim paraprak Më datë **03.04.2023**.

Garancia e punimeve është **12 Muaj**.

<b>Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikualifikim .....”, Bashkia 2021.</b>				
<b>14.Lidhja e kontratës</b> nr. 17 prot., datë 06.02.2023	<b>15.Vlera e kontratës (me Tvsh)</b> <b>18,394,920</b> lekë me Tvsh <b>OE fitues “J. C.” Shpk</b>		<b>16. Likuiduar lekë</b> <b>Lekë 12,691,392</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> datë <b>-Vlera 12,691,392 me Tvsh lekë</b> <b>-Vlera 10,576,160 pa Tvsh lekë</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 40 ditë, Zbatuar 40 ditë. Fillimi punimeve: 13.02.2023 Përfundimi punimeve: 24.03.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Z. K. K.	Licenca Nr: MK 0453/3	Kontrata nr.17/1 prot., datë 06.02.2023	Vlera e Kontratës 96,000 (me Tvsh) lekë me Tvsh	Likuiduar (me Tvsh) 96.000 lekë
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Z. A. K.	Licenca Nr: MK. 1010/1	Kontrata nr.17/2 prot., datë 06.02.2023	Vlera e Kontratës 42.000 (me Tvsh)	Likuiduar (me Tvsh) 42.000
<b>22.Akt Kolaudimi</b> datë 03.04.2023	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> datë 03.04.2023			

Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Sarandë, në vlerën **190,000 lekë pa Tvsh**.

Tabela nr. 1

	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	<b>B. Rr. Nënë Tereza (b=5m, L=380 ml)</b>							
1	Rafshim, nivelim, skarifikim t=10cm	m <sup>2</sup>	250	2,660	2,660	1,900	760	190,000
							<b>Total</b>	<b>190,000</b>

*Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:*

**Rr. “Nënë Tereza”(b=5m,L=380ml.)**

**1. Zëri 1. A “Rafshim, nivelim, sakrifikim t=10 cm”.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 1,900m<sup>2</sup>. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2,660m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 2,660m<sup>2</sup>, i detajuar në të gjithë gjatësinë e rrugës “Nënë Tereza” (5mx380m). Në fakt volumi i këtij zëri pune është 1,900m<sup>2</sup> (5mx380m), ose 760m<sup>2</sup> me pak se volumi i situacionuar, për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Titulli i Gjetjes 32:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin:

“Rikualifikim .....” nga zbatuesi i punimeve OE “J. K.” Shpk, për zërin e punimeve A.1.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca nëvolumedhe cmime nëzërin epunës “Rafshim, nivelim, sakrifikim t=10 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, KreuIII, neni7 dhe neni 12.

-Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 17 prot., datë 06.02.2023.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr.17/1 prot., datë 06.02.2023.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. 17/2 prot., datë 06.02.2023

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të më sipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rendesia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Bashkia të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 190,000 lekë pa Tvsh nga OE “J. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.17 prot., datë 06.02.2022 me objekt: “Rikualifikim .....”, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar më tepër në vlerën **190,000 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Përsa më sipër ngarkohen m epërgjegjësi si vijon:

**- Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Ing. K. K.** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Pë rkontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 17/1 prot., datë 06.02.2019.

Nga ana e kolaudatorit të punimeve Ing. A. K. nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. Objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. Objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. cmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4 në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”.

2) Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

c. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit pa nr. 17/2 prot., datë 06.02.2023.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mesiperme ngarkohen me përgjegjësi:*

1. Z. K. K. , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. A. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

## II. “Riveshje Rr. “M. D. “ Sh.& Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i rrugës “J. K. ”.

Kontratata (Sipërmarrje mbikëqyrje kolaudimi).

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 11 prot., datë 14.11.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari Z. A. G. dhe OE “N. -” Shpk, me përfaqësues Z. S. K. me licencë profesionale NZ. ( Vlera e kontratës është 10.512.051 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr.11/1 prot., datë 14.11.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing.A. T., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 45,000 lekë pa Tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr.11/2, datë 14.11.2022 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K. K. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. përfqësuar nga z. K. K. dhe me vlerë të kontratës së shërbimit **15,000 lekë pa Tvsh.**

#### Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. A. T. vitin 2022.

#### Zbatimi i punimeve

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 15.11.2022, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet kanë përfunduar Më datë 10.12.2022, janë marrë në dorëzim paraprak Më datë 15.12.2022.

Garancia e punimeve është 12 Muaj.

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Riveshje Rr. “M. D. “ Sh.& Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i rrugës “J. K. ”.				
14.Lidhja e kontratës nr. 11 prot., datë 14.11.2022	15.Vlera e kontratës (me Tvsh) 10.512.051 lekë me Tvsh OE fitues “N. -” Shpk		16. Likuiduar lekë Lekë10,512,051	
17- Situacioni Përfundimtar datë 01-10.12.2022 -Vlera me Tvsh lekë 10.504.824 -Vlera pa Tvsh lekë 8.754.020	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 15.11.2022 Përfundimi punimeve : 15.12.2022		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve “A. T. ”	Licenca MK.1010/1	Kontrata nr.11/1 prot., datë 14.11.2022	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 54,000 lekë me Tvsh	Likuiduar (me Tvsh) 54,000 leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: “K. K. ”	Licenca Nr: MK 0453/3	Kontrata nr.11/2 prot., datë 14.11.2022	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 18,000	Likuiduar (me Tvsh) 18,000
22.Akt Kolaudimi datë 12.12.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 15.12.2022			

Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Sarandë, në vlerën **52,000 lekë pa Tvsh.**

Tabela nr. 1

	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A	Shtrim me beton i degëzimit në rrugën “J. K. ”							
1	Shtresë stabilizant t=10cm	m <sup>2</sup>	400	280	150	0	150	52,000
							<b>Total</b>	<b>52,000</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

### **3. Shtrim me beton i degëzimit në rrugën “ J. K. ”.**

#### **2. Zëri 3.161.A “Shtresë stabilizant t=10 cm”.**

Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 400 m2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë punë figuron në sasinë 150 m2.

Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1500 m2, i detajuar në të gjithë gjatësinë e rrugës, në fakt volumi i këtij zëri pune nuk është realizuar në objekt, për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Titulli i Gjetjes 33:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin:

“Riveshje Rr. “M. D. “ Sh.& Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i rrugës “J. K. ” për zërin e punimeve A.3 (3.61).

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe cmime në zërin e punës “Rafshim, nivelim, sakrifikim t=10 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11 prot., datë 14.11.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11/1 prot., datë 14.11.2022.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. 11/2 prot., datë 14.11.2022.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rendesia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Bashkia të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 52,500 lekë pa Tvsh nga OE “N. 6” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11 prot., datë 14.11.2022 me objekt: “Riveshje Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T. ” dhe rikualifikim i Rr. “J, K.” Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar më tepër në vlerën **52,500 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Ing. A. T.** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 11/1 prot., datë 14.11.2022.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve Ing. K. K.** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t’i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. cmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontrates; 4 në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”.

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
- Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin perfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit nr. 11/2 prot., datë 14.11.2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mesiperme ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. A. T. , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
- Z. K. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**III. “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç. ‘ ” mbi “A. Sh. ”, mbi Komisarariat dhe rikualifikim i rrugëve në B. Ç. M. ”. Bashkia 2022.**

Kontratat (Sipërmarrje, mbikëqyrje e kolaudimi).

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr.15 prot., datë 15.12.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari **Z. A. G.** dhe OE “**M. /” Shpk**, me përfaqësues **Z. M. M.** me licencë profesionale **NZ 0440/21**. Vlera e kontratës është **11,800,920 lekë**

**me Tvsh.** Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore **30** ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve **12** muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr.15/1 prot., datë 15.12.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A. T. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. **1010/1**, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit **50,000 lekë pa Tvsh.**

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata 15/2 prot., datë 14.04.2023 e këtij shërbimi me Ing. K. K. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK **0453/3**, datë 10.04.2018, përfqësuar nga z. **K. K.** dhe me vlerë të kontratës së shërbimit **15,000 lekë pa Tvsh.**

#### Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. A. T. në vitin **2022.**

#### Zbatimi i punimeve

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën **13.03.2023**, sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet kanë përfunduar Më datë **06.04.2023**, janë marrë në dorëzim paraprak Më datë **11.04.2023.**

Garancia e punimeve është **12 Muaj.**

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç. ‘ ” mbi “A. Sh. ”, mbi Komisarjat dhe rikualifikim i rrugëve në B. Ç. M. ”. Bashkia 2022.				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> nr. prot., datë 15.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me Tvsh)</b> <b>11.800.920</b> lekë me Tvsh <b>OE fitues “M./” Shpk</b>		<b>16. Likuiduar lekë</b> <b>Lekë 11.800.920</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar datë</b> <b>-Vlera me Tvsh lekë 11.800.920</b> <b>-Vlera pa Tvsh lekë 9.834.100</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 13.03.2023 Përfundimi punimeve : 14.04.2023		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka.	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> “A. T. ”	Licenca Nr:1010/1 MK.	Kontrata nr.15/1 prot., datë 15.12.2022	Vlera e Kontratës 66.000 (me Tvsh) lekë me Tvsh	Likuiduar (me Tvsh) 66.000 leke
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Emri Mbiemri: “K. K. ”	Licenca Nr: MK 0453/3	Kontrata nr 15/2. prot., datë	Vlera e Kontratës 18.000 (me Tvsh)	Likuiduar (me Tvsh) 18.000
<b>22. Akt Kolaudimi</b> datë 06.04.2023	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim datë</b> 11.04.2023			

Nga auditimi i situacioneve pjesore progresive dhe situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Sarandë, në vlerën **78,900 lekë pa Tvsh.**

Tabela nr. 1

	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>4</b>	<b>Rikualifikimi i rrugëve të brendshme beton në Cukë, Manastir</b>							
1	Shtresë stabilizant t=10cm	m <sup>2</sup>	300	563	563	300	263	78,900
							<b>Total</b>	<b>78,900</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

3. Shtirim me beton i degëzimit në rrugën “J. K. ”

**2. Zëri 3.161. A “Shtresë stabilizant t=10cm”** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 300 m<sup>2</sup>. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 563 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 563 m<sup>2</sup>, i detajuar sipas ne te gjithë gjatësinë e rrugës. Në fakt volumi këtij zëri pune është 300 m<sup>2</sup>, ose 263 m<sup>2</sup> më pak se volumi i tuacionuar, për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Titulli i Gjetjes 34:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç. ‘ ” mbi “A. Sh. ”, mbi Komisarjat dhe rikualifikim i rrugëve në B. Ç. M. ”. Bashkia Sarandë 2022.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe cmime në zërin e punës “Shtresë stabilizant t= 10cm, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë perfitur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 15 prot., datë 15.12.2022.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 15/1 prot., datë 15.12.2022.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. 15/2 prot., datë 14.04.2023

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rendesia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Sarandë. të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 78,000 lekë pa Tvsh nga OE “M.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 15 prot., datë 15.12.2022 me objekt: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi “A. Sh.”, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve në B., Ç., M.”, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar më tepër në vlerën **78,900 lekë pa Tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Ing. A. T.** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 15/1 prot., datë 15.12.2022.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve Ing. K. K.** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. cmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontrates; 4 në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”.

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

c. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin perfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit pa nr. 15/2 prot., datë 14.04.2023.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. A. T. , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. K. K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

## 2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimin të territorit.



**Titulli i Gjetjes 35:** *Nga auditiminë sistemin “e-Leje” u konstatua se nuk është respektuar distanca nga kufiri i pronës.*

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a-** me nr. 513, datë 31.05.2022, për subjektin ndërtues “E.D.S.M C.” Shpk . (zhvilluesi Ll. L.), për objektin: “Godinë shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë”, Bashkia Sarandë.

Nga plani i vendosjes konstatohet se distanca në orientimin verior është 4.2 metër nga 5 metër që është distanca minimale e lejuar për një objekt 4 kate, si dhe në pjesën jugore objekti është ngjitur me kufirin e pronës.

**b-** me nr. 491, datë 20.04.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A...” Shpk (zhvilluesit: S.Zh.) për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rr. “S. ”, Bashkia Sarandë. Nga planvendosja e miratuar nga ana e DPZHKT, Bashkia Sarandë, konstatohet se distanca e objektit nga kufiri i pronës në anën perëndimore dhe veriore nuk është në përputhje me nenin 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Distanca duhet të ishte 7 metër jo 1 dhe 1,2 metër.

**c-** me nr. 484, datë 08 .04.2022, për subjektin ndërtues “M&S K...” Shpk, (zhvillues OE “O.” Shpk) me, për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me 1 kat parkim”, Rr. “B...”, Bashkia Sarandë, në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar, referuar VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 6 kate është 7 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.

**d-** me nr. 554, datë 18.10.2022, për subjektin ndërtues “M&S K...” Shpk, (zhvilluesi I.I.) , për objektin: “Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë” Bashkia Sarandë. Në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar bazuar mbi rregulloren e planifikimit të territorit VKM nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 4 kate është 5 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.

**e-** me nr. 534, datë 25.07.2022 (2888) për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi: Th..R.) për objektin: “Strukturë 4 kate me 1 kat nëntokë” NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. Distanca e lejuar nga kufiri i pronës duhet të ishte jo më pak se 5 metër. Në këtë rast rezultoi të jetë me vogël se 5 metër.

**f-** me nr. 537, datë 04.10.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk, (zhvilluesit “S.E.G A.” Shpk) I. N. dhe S.Zh. për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë”, Rr. “B. G.”, Bashkia Sarandë.

Nga planvendosja e miratuar konstatohet se edhe në këtë rast distancat nga kufiri i pronës nuk janë në përputhje me rregulloren e planifikimit të territorit në veri dhe jug janë pothuajse ngjitur me kufirin e pronës, ndërsa në lindje 1 metër nga kufiri i sajë. Distanca minimale për një objekt 4 kate duhet të ishte 5 metër. Distancat nga prona janë më të vogla se ato të lejuara.

**Kriteri:** Neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” i VKM nr. 408, datë 13.5.2015, “Rregullorja e planifikimit”. ku citohet: *“Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve”.*

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. , ish drejtor pranë DPZHKT dhe z. A. G. , Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 36:** *Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se distanca nga objekti në objekt nuk është respektuar.*

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se leja e ndërtimit me nr. 513, datë 31.05.2022 dhënë subjektin ndërtues “E.D.S.M C.” Shpk, (zhvilluesit Ll. L.) për objektin: “Godinë shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë”, Bashkia Sarandë.

Distanca minimale ndërmjet dy objekteve ku njëri është 4 kate dhe tjetri është 5 kate sipas rregullores së planifikimit duhet të ishte 11 metër. Nga planvendosja dallon se këto distanca janë më të vogla.

**Kriteri:** Neni 34 “Distancat minimale midis ndërtimeve” i VKM nr. 408, “Rregullorja e planifikimit”. ku citohet: 1. *Distancat minimale midis dy faqeve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.* 2. *Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:  $d = nr. k \text{ obj.}A + nr. k \text{ obj.}B + 2m$ , ku:  $d$  - distanca minimale midis dy ndërtimeve.  $nr. k$  - numri i kateve.*

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me planin e përgjithshëm vendor dhe rregulloren e planifikimit sjell efekte negativë në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHTK dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 37:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se numri i kateve nuk është në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor.

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se në lejet e poshtë shënuara numri i kateve është më i lartë se Plani i Përgjithshëm Vendor.

**a.** me nr. 554, datë 18.10.2022, subjektit ndërtues “M&S K..” Shpk, (zhvilluesit: I.I.)me, për objektin: “Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë”, Bashkia Sarandë. Nga projekti i miratuar konstatohet që në fasadën e pasqyruar objekti në fjalë 2 katet e parkimit i ka mbi kuotën e sistemimit dhe jo nën tokë. Objekti në fjalë rezulton me 6 kate. Numri i kateve të lejuara në zonë është 4 kate.

**b.** me nr. 537, datë 04.10.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk (zhvilluesit: “S.E.G A.” Shpk, I. N. dhe S.Zh. ) për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rr. “B. G.”, Bashkia Sarandë. Objekti konstatohet që është 5 katësh dhe jo 4 katësh. Plani i Përgjithshëm Vendor për zonën është për objekte deri në 4 kate.

**c.** me nr. 540, datë 05.10.2022, për subjektin ndërtues “A. K. ” Shpk (zhvilluesit: “A. K. ” Shpk), për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me 2 kate nëntokë”. Objekti është në lartësinë e 6 kateve pasi 2 katet e parkimit janë të vendosur mbi kuotën e sistemimit.

**Kriteri:** Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Sarandë.

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negativë në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHTK dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 38:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se intesiteti i ndërtimit të miratuar nuk është në përputhje me intesitetin e lejuar.

**Situata:** Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a.** me nr. 554, datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi I.I.), me , për objektin: “Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë”, Bashkia Sarandë. Intesiteti në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është  $1.8m^2/m^2$ .

**b.** me nr. 537, datë 04.10.2022, dhënë subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk, (zhvilluesi “S.E.G A.” Shpk, I. N. dhe S.Zh.), për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rr. “B. G.”, Bashkia Sarandë. Intesiteti në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 1.8.

**Kriteri:** Plani e përgjithshëm vendor sipas pasaportave të njësive strukturore dhe Neni 38 “Intensiteti i ndërtimit” tëVKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

*“1. Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.*

*2. Intensiteti (I) ekzistues në nivel njësie strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e (I) për njësinë nuk përfshihen rrugët dhe hapësirat publike, përveç sa përcaktohet në legjislacionin sektorial në fuqi.*

*3. Intensiteti (I) për çdo njësi pa PDV, përcaktohet nga dokumenti i planifikimit dhe zbatohet në çdo parcelë të ndërtueshme brenda njësisë përkatëse, përjashtuar rrugët dhe hapësirën publike. 4. Intensiteti (I) për një zonë përcaktohet në përputhje me këtë rregullore, ligjin dhe legjislacionin e posaçëm në fuqi.”*

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, PPV dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHTK dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 39:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se ka mospërputhje mes koeficientit të shfrytëzimit të lejes së miratuar dhe koeficientit të shfrytëzimit të lejuar.

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a.** Leja me nr. 554, datë 18.10.2022, për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi I.I.) me , për objektin: “Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë”, Bashkia Sarandë. Koeficienti i shfrytëzimit në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 50%.

**b.** Leja me nr. 537, datë 04.10.2022 për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk, (zhvilluesit “S.E.G A.” Shpk, I. N. dhe S.Zh.), për objektin: “Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rruga “B. G. ”, Bashkia Sarandë

Koeficienti i shfrytëzimit në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 50%.

**Kriteri:** Plani e përgjithshëm vendor, Bashkia Sarandë, sipas pasaportave të njërive strukturore dhe nenit 39 “Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim” i VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, ku citohet:

*“1. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (KSHT) për ndërtim është raporti i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së ndërtueshme.*

*2. KSHT-ja për ndërtim matet në përqindje (%). 41 3. Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme.”*

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sjell efekte negative në urbanizimin e zonave duke ndikuar direkt ose indirekt në jetën e banorëve që do jetojnë në atë zonë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me PPV dhe legjislacionin në fuqi dhe (KTP).

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHTK dhe z. A. G. , Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 40:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se planvendosja e miratuar nuk është e saktë.

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a.** me nr. 484, datë 08.04.2022 për subjektin ndërtues “M&S K...” Shpk, (zhvilluesi “O. 2.” Shpk), me, për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me 1 kat parkim”, Rr. “B...”, Bashkia Sarandë. Në planvendosje nuk janë pasqyruar objektet kufitare, të specifikuar me norma katesh dhe distanca që kanë me objektin.

**b.** nr. 491, datë 20.04.2022 për subjektin ndërtues “S.E.G A. ” Shpk, (zhvilluesi S.Zh.), për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rruga “Skënderbeu”, Bashkia Sarandë. Planvendosja e miratuar nuk ka të pasqyruara distancat e objektit në fjalë nga objektet kufitarë të cilët e rrethojnë.

**c.** Leja me nr. 551 datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues “ A. 2. ” Shpk (zhvilluesi G. S), për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat me 1 kat nëntokë, në funksion të Turizmit”, Bashkia Sarandë.

Planvendosja e miratuar nuk ka të pasqyruara distancat e objektit në fjalë nga objektet kufitarë të cilët e rrethojnë.

**Kriteri:** Kushtet teknike të projektimit (KTP)

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me (KTP) ndikon në miratim të projekteve të gabuara të cilat kur konkretizohen në terren mund të kenë efekt negativ në urabizimin e zonës.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe (KTP).

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: A. B. ish drejtor pranë DPZHKT dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 41:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur saktë.

**Situata:** Nga kontrolli në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a.** me nr. 536 datë 19.09.2022 për subjektin ndërtues “K U.” Shpk (zhvilluesi Xh. M.), me Licencë NZ.5970/1, për objektin: “Hotel 4,5 dhe 6 kate me 4 kate nëntokë”. Rr. “B.”, Bashkia Sarandë.

Nga fatura e ngarkuar në sistemin “e-Leje” për këtë praktik pasqyrohet se është paguar shuma 5,136,071 lekë. Duke u bazuar mbi vlerën e preventivit që është 263,582,227.43 lekë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paketës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe 263,582,227.43 lekë  $\times 0.03 = 7,907,466$ . Ka një diferencë prej **2,771,395** lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të bashkisë Sarandë.

**b.** me nr. 456, datë 15.02.2022, për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi Z. F.), me , për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat”, në funksion të turizmit. NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. afati kohor i kësaj leje është: 24 muaj.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paketës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe preventivi është 15,476,498 lekë  $\times 0.03 = 464,294$ . Kemi një diferencë prej **115,624** lekë nga fatura e paguar me atë të llogaritur, shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

**Kriteri:** Neni 46 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ku citohet:

“1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritjet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit si dhe paketën fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak i Bashkisë Sarandë.”

**Ndikimi:** Vlera prej 2,771,395 lekë dhe vlera prej 115,624 lekë përbëjnë dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Sarandë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPKZHT të merren masa për të arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Sarandë vlera prej 2,771,395 lekë, nga subjekti: Xh. M. dhe 115,624 lekë, nga subjekti Z. F. .

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHKT dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 42:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se për lejet e ndërtimit shtesë kati nuk janë këkuar akt-ekspertiza.

**Situata:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a.** me nr. 550, datë 17.10.2022 për subjektin ndërtues “A. ” Shpk, (zhvilluesi H. H.), për objektin: “Shtesë në lartësi 2 kate dhe shtesë anësore 1 kat në objekt ekzistues 3 kat në funksion të turizmit”, Bashkia Sarandë.

**b.** me nr. 551, datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues “A. ” Shpk, (zhvilluesi G. S) , për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat me 1 kat nëntokë, në funksion të Turizmit”, Bashkia Sarandë.

**c.** me nr. 456 datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi Z. F.), me , për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat, në funksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë

**d.** me nr. 458, datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “I “ Shpk, (zhvilluesi A. Ç. dhe Zh. Ç.) për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat,në funksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë

**e.** me nr. 499 datë 23.03.2022 për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi L. Gj.), për objektin: “Shtesë 2 kate dhe 1 kat parkim nën tokë në objekt ekzistues 1 kat” afati kohor i kësaj leje është 24 muaj. Për lejet e mësipërme të miratuara nga ana e urbanistikës, Bashkia Sarandë konstatohet se nuk janë kërkuar akt-ekspertiza nga inxhinier të licensuar për këto situata. Këto shtesa kati të miratuara a ndikojnë në qëndrueshmërinë e dhe aftësinë mbajtëse të strukturës dhe themeleve të objektit.

**Kriteri:** Kushtet Teknike te Projektimit (KTP).

**Ndikimi:** Miratimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me KTP rrezikon direkt jetën e banorëve në ato objekte pasi nuk ka dhënë miratimin inxhinieri konstruktor nëse ky objekt është i qëndrueshëm edhe pas ndërtimit të shtesës së katit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga DPKZHT të merren masa për të miratuar leje ndërtimi shtesa kati duke marrë konfirmim nga inxhinieri i licensuar me anë të akt-ekspertizës se shtesa e ndërtuar mbi objektin ekzistues nuk ndikon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të strukturës.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. B. ish drejtor pranë DPZHTK dhe z. A. G. Kryetar i Bashkisë Sarandë.*

## 2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.

**Titulli i Gjetjes 43:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e IMT Bashkia Sarandë u konstatua se vendimet e marra nuk ishin sipas legjislacionit në fuqi.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e IMT Bashkia Sarandë u konstatua se për procesverbalin me nr. 0000160 serie. Dalja nga kushtet e deklaratës paraprake të lejes së ndërtimit është mbajtur vendim me gjobë 50,000 lekë. Për procesverbalin e kundravajtjes më nr. 0000161 serie me kundravajtjes “Ndërtimi i një strukture metalike i mbuluar me sanduiç dhe i veshur” është mbajtur vendim me gjobë 50,000 lekë.

**Kriteri:** Pika “e”, neni 52 i Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, “ kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.”

**Ndikimi:** Ndryshimi i vlerës së gjobës nga ana e IMT ka efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IMT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë të merren masa për të vendosur gjoba për kundravajtjet e konstatuara për kryerjen e punimeve pa leje, me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. Sh. A. me pozicion ish kryeinspektor i IMTV, Bashkia Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 44:** Për procesverbalin me nr. 0000163 serie, është mbajtur vendim gjobe, në shumën 5,320,000 lekë. Nuk na janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo procedurë të mbajtur ku të shpjegojë më fjalë apo imazhe fotografike se çfarë situatë është sipas çdo rasti.

**Situata:** Për procesverbalin me nr. 0000163 serie, është mbajtur vendim gjobe në shumën 5,320,000 lekë. Nuk na janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo procedurë të mbajtur ku të shpjegojë më fjalë apo imazhe fotografike se çfarë situatë është sipas çdo rasti. Gjoba në këtë rast është vendosur sipas vlerës së punimeve të kryera por nuk është vënë në dispozicion të audituesve të KLSH, dokumentacion justifikues se si është përlllogaritur vlera e gjobës.

**Kriteri:** Pika “e”, neni 52 e Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, “ kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.”

**Ndikimi:** Fakti që nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni justifikues për vlerën e gjobës nuk mund të japim opinion nëse kjo gjobë është llogaritur saktë apo jo. Vlera e gjobës mund të jetë dhe më e madhe dhe më e vogël por këtë mendim nuk e japim dot pa parë dokumentacionin.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IMT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa për gjobat e vendosura të shoqërohen më relacion përkatës dhe shpjegues se çfarë lloj shkelje është konstatuar e shoqëruar me imazhe dhe sipërfaqe ekzakte.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. Sh. A. me pozicion ish kryeinspektor i IMTV Bashkia Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 45:** Disa prej procesverbaleve të mësipërm nga të cilat janë nxjerrë vendime prishje dhe gjobë deri në 500,000 lekë të reja janë nxjerrë pa emër të identifikuar. Për procesverbalin me nr. 0000168, me kundravajtje “Hedhja e materialeve inerte në argjinaturë”, nuk është mbajtur vendim prishje apo kthim në gjëndjen fillestare.

**Situata:** Disa prej procesverbaleve të mësipërm nga të cilat janë nxjerrë vendime prishje e vendim me gjobë deri në 500,000 lekë të reja janë nxjerrë pa emër të identifikuar. Për procesverbalin me nr. 0000168, me kundravajtje “Hedhja e materialeve inerte në argjinaturë”, nuk është mbajtur vendim prishje apo kthim në gjëndjen fillestare. Kundravajtja e konstatuar është lenë deri në fazën e proces-verbalit të kundravajtjes dhe nuk ka vazhduar me fazat e tejra si vendim gjobe apo vendim prishje.

**Kriteri:** Neni 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet” i ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”

*“Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.”*

**Ndikimi:** Mosmarrja e vendimeve nga ana e IMT për kundravajtjet e konstatuara ndikon negativisht në mbrojtjen dhe ruajtjen e territorit nga ndërtime të paligjshme.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IMT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren që kundravajtjet e konstatuara të dalin me vendime sipas legjislacionit në fuqi.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: G. A. me detyrë ish kryeinspektor i IMTV Bashkia Sarandë.*

**Titulli i Gjetjes 46:** Nga kontrolli i dokumentacionit në fuqi është konstatuar se në 4 raste të procerverbaleve të kundravajtjes të cilat janë me vendim prishje nuk janë ekzekutuar.

**Situata:** Nga kontrolli i dokumentacionit në fuqi është konstatuar se në 4 raste të procerverbaleve të kundravajtjes të cilat janë me vendim prishje nuk janë ekzekutuar.

**Kriteri:** Neni 13 “Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet” i ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

*“Vendimet e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë, sipas llojit të shkeljes. Përgjashtimisht, vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm kanë afat deri në 30 ditë për zbatimin e tyre.”*

**Ndikimi:** Mosekzekutimi i vendimeve nga ana e IMT për kundravajtjet e konstatuara ndikon negativisht në mbrojtjen dhe ruajtjen e territorit nga ndërtime të paligjshme.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e IMT Sarandë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren që kundravajtjet e konstatuara dhe vendimet e mbajtura të ekzekutohen sipas legjilacionit në fuqi, Dhënia e vendimeve administrative të inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë të zbatohen Brenda 60 ditëve, sipas llojit të shkeljes, dhe vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm brenda 30 ditë.

*Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: A. M. me detyrë kryeinspektor në IMTV Bashkia Sarandë.*

## **2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

**Titulli gjetjes 47.** Statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 370/9 prot., datë 26.7.2022.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

KLSH-ja ka dërguar në Bashkinë Sarandë, rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 370/9, datë 26.7.2022, për të cilën Bashkia Sarandë, duhet të kthente përgjigje brenda afatit të 20 ditëve. Ndërsa nga Bashkia për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje, **duke mos respektuar afatin brenda afatit 20 ditor.**

Gjithashtu nga Bashkia Sarandë, nuk është raportuar brenda afatit të 6 muajve, veprime në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH”.

Me urdhër nr. 163, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë z. A. G. është hartuar plani i punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtoritë përkatëse. Me shkresën nr. 164, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë është urdhëruar marrja e masave për shpërblim dëmi sipas vlerave të përcaktuara në shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 (rubrika shpërblim dëmi).

Me urdhër nr. 3516, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni Disiplinorë për Nëpunësit Civil të Institucionit të Bashkisë Sarandë.

Bashkia Sarandë, nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm.

*Nga auditimi i rekomandimeve, rezulton se:*

**a. Për 15 masa organizative**, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 5 masa dhe nuk është zbatuar **10 masa.**

**b. Për masa mungesë të ardhurash** janë rekomanduar **6 masë** me vlerë **200,267 mijë lekë**, të pranuar plotësisht, rezulton se janë në proces zbatimi 6 masa, ku nga vlera e rekomanduar prej 200,267 mijë lekë është arkëtuar vlera 18,215 mijë lekë, duke mbetur për arkëtim vlera **182,052 mijë lekë.**

**d. Për masa disiplinore**, janë rekomanduar gjithsej **4 masa** të pranuar plotësisht, rezulton se nuk është zbatuar asnjë masë, konkretisht kërkohet zbatimi i masave të pazbatuara si vijon:

#### **A. Masa organizative**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton gjendje e konsiderueshme e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 481,241,985 lekë, ku përveç debitorëve të taksave ka ndikuar dhe vlera e lartë e gjendjes në vlerën 162,031,719 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH-ja në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtim, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12, me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 40.

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike të marrë masat që për vlerën e debitorë prej 162,031,719 lekë të rekomanduar në vite nga KLSH-ja por të pa arkëtuara, të cilave po ju kalon afati ligjor i kërimit. Të analizojë dokumentacionin ligjor për to, duke i klasifikuar sipas afateve dhe për detyrimet deri në 5 vjet të nxjerrë akte administrative për rivendosjen e afateve dhe kërkimin e tyre në rrugë administrative dhe ligjore.

#### **Statusi: Pa zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llog. 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me vlerë neto 15,940,245 lekë dhe me vlerë bruto prej 119,561,177 lekë (kosto historike), që i përket 113 projekt-studimeve për investime. Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 14,433,919 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llog. 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, pika 3.3 nënpika 62.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa që gjendja prej 14,433,919 lekë e llog. 202 “Studime dhe kërkime”, të analizohet dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për

shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij.

**Statusi: Pa zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 210 *"Toka Troje Terrene"*, rezulton se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 14 artikuj aktive materiale në vlerën 38,081,192 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"*. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, Aneksi 1, pika 2. Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 210 *"Toka Troje Terrene"*, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"*.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"* rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 8 artikuj aktive materiale në vlerën 9,074,339 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 7,343,493 lekë, llog. 210 *"Toka, Troje, Terrene"* në vlerën 1,730,846 lekë.

Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar "Aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)", vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.8.2022 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"* sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* dhe llog. 210 *"Toka, Troje, Terrene"*.

**9.2. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa për inventarizimin e aktiveve në vlerën 1,761,146 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"*. Të kryej zbrëthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 19 artikuj aktive materiale në vlerën 48,367,346 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"* në vlerën 36,403,544 lekë dhe llog. 210 *"Toka, Troje, Terrene"* në vlerën 11,963,802 lekë. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar *"Rikonstruksion"*, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 pika 2. Klasa 2, , me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.



**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione ” llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”.

**10.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të ngrëjë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në vlerën 29,568,137 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të kryejë zberthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**Statusi: Pa zbatuar**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për vitin 2021, rezulton se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e Bashkisë Sarandë.

- Disa procedura prokurimi, projektet/ preventivat janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Sarandë dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Sarandë, por të pa pajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse, konkretisht procedurat:

a- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Ksamil (rruga e varrezave, parajsa, rr. sherifi “, me fond limit 11,090 mijë lekë.*

b- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni në rrugën K. , P. , P. Gj. P. i II dhe riveshje gropash “, me fond limit 10,976 mijë lekë.*

c- *Procedura me objekt “Sistemin i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni rruga Gj. F., N.F., A. , K. “, me fond limit 8,560 mijë lekë.*

d- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve me asfaltbetoni (rr. Q. S. Ç., A. J. “, me fond limit 9,597 mijë lekë.*

- Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, dhe përgjegjësit të Sektorit të Procedurave janë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve pa bërë më parë miratimin dhe marrjen e lejes së ndërtimit ose infrastrukturës.

- Janë pranuar në procedura prokurimi, shpallur fitues dhe lidhura kontrata zbatimi me subjekte të cilat nuk janë pajisur me Nipt sekondar për kohën e shtrirjes së kontratës, si dhe janë debitorë karshi Bashkisë Sarandë, ndër vite, nga auditimet e kryera nga KLSH për mos zbatim të kontratave të punëve publike sipas preventivit.

Veprime në kundërshtim me Kreu III, neni 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, neni 16 “Licenca –kategoritë e punimeve”. Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; nenin 4/26 2021.

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

**Statusi: Pa zbatuar.**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH rezulton se:

Nga Bashkia është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve (shkresa nr. 4891/2, datë 19.10.2021).

Nuk është respektuar afati që brenda periudhën 6 mujore, Bashkia Sarandë, duhet të informojë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, **nuk është raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij. Është hartuar “Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve” në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Gjithashtu rezulton se:

**a. Janë rekomanduar 16 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, është në proces zbatimi 1 (një) masë dhe nuk janë zbatuar 6 masa.

**b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 6,748,993 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, por janë në proces zbatimi pasi janë kontabilizuar.

**c. Për masa mos efektivitet dhe efikasitet**, janë rekomanduar gjithsej **3 masa** me vlerë **11.236.480 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar 3 masa me vlerë **6,748,993 lekë**.

**d. Për masa mungesë të ardhurash**, janë rekomanduar gjithsej **4 masa** me vlerë **495,505,008 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar vlera prej **495,505,008 lekë**.

**e. Për masa disiplinore**, janë rekomanduar gjithsej **6 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.201 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **7 masa** organizative, ku 6 prej tyre nuk janë zbatuar.
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** mungesë të ardhurash në shumën **495,505,008 lekë**.

**Statusi: Pa zbatuar**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në institucionin e KLSH, nëpërmjet postës elektronike është paraqitur ankesë nga qytetari L. H., hyrë në KLSH nr. 1067, datë 11.10.2021, në të cilën kërkohet të auditohet procedura e dhënies së autorizimit nga DPZHT Bashkia të një rame të vendosur në hyrje të pallatit përpara njësisë tregtare, përfituar sipas Deklaratës Noteriale hartuar nga noteri A. A. me nr. 2038rep., nr. 524 kol., si dhe kontratë sipërmarrje me nr. 2307 rep., 523 kol., datë 14.5.2004 për ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup> dhe vlerë 63000 mijë dollarë, ku sipas qytetarit përcaktohet tek dyqani do të bëhet parapet i dyqanit dhe shkallët përkatëse në këtë sipërfaqe të shtuar (nuk ka dokument që vërteton hipotekën e dyqanit).

Sipas qytetarit L. H., pretendohet së akti administrativ (Autorizimi nr. 2044/1, datë 31.07.2018) është i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm në zbatim të nenit 108 dhe 109 të K.P. Administrative.

Pretendimi i ngritur nga L. H. në lidhje me dhënien e autorizimit nga DPZHT Bashkia Sarandë, për vendosjen e një rame për personat me aftësi të kufizuar, nuk qëndron pasi autorizimi është dhënë në përputhje me nenin 7 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillim territorit” i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 93/2014 datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, pasi personat që e kanë përfituar atë janë me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu referuar Vendim nr. 46, datë 22.11.2021, Gjykata Administrative Gjirokastrë, kërkesë padia e L. H. nuk qëndron, duke e rrëzuar atë.

Ndërsa në lidhje me ankesën e qytetarit T. M., për lirim të verandës si ambient i përbashkët i pallatit ku banojë, çështja është në shqyrtim.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit Zhvillim Territorit të marrë masat dhe të informojë ankimesin L. H. në lidhje me lëshimin e autorizimit nr. 2044/1 prot., datë 31.7.2018 nga Bashkia në adresë të qytetarit z. T. M. me aftësi të kufizuar, duke bërë sqarimet përkatëse ligjore mbi domosdoshmërinë e këtij autorizimi për personat me aftësi të kufizuar.

**Statusi: Pa zbatuar.**

## **B. Masa shpërblim dëmi**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “*Kodi i procedurave administrative në R.SH*” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 93, nga **Kryetari i Bashkisë Sarandë**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **10,317,550 lekë** ndaj **6 personave**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Rr: “K.”, “P.”, “P. Gj. P.” dhe riveshje gropash*”, Bashkia Sarandë, me vlerë kontrate (pa Tvsh) 10,814,530 lekë, realizuar nga OE “A.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **235,200 lekë pa Tvsh**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot., datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe OE “A.” Shpk.

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Sarandë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **235,200 lekë** pa Tvsh nga OE “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5 prot., datë 03.05.2021 me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Rrugët: “K.”, “P.”, “P. Gj. P.” dhe riveshje gropash*”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Pa zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Rr. “I. Q.” “Ç.”, “A. J.”*”, me vlerë kontrate (pa Tvsh) 9,392,610 lekë, realizuar nga OE “2.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 317,148lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot, datë 03.05.2021 të lidhur mes AK Bashkia Sarandës dhe shoqërisë “2-”.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **317,148 lekë pa Tvsh** nga OE “2.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot., datë 03.05.2021 me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Rr: “Sistemim i rrugëve*

të brendshme me asfaltobeton Rr. "I. Q." "Ç.", "A. J.", vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gj. F., N. F., A., K.*", me vlerë të kontratës (pa Tvsh) 8,530,800 lekë, realizuar nga OE "M." Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 77,400 lekë pa Tvsh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7 prot., datë 26.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe OE "M." Shpk.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,400 lekë pa Tvsh** nga OE "M." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë 26.04.2024 me objekt: "*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gj. F., N. F., A., K.*", vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e L. D.*", me vlerë të kontratës (pa Tvsh) 4,098,081 lekë, realizuar nga OE "I. /D." Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 125,400 lekë pa Tvsh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8 prot., datë 30.04.2021 të lidhur mes AK Bashkia Sarandës dhe shoqërinë "I. /D." Shpk.

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **125,400lekë** pa Tvsh nga OE "I. /D." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot., datë 30.04.2024 me objekt: "*Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e L. D.*", vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: "*Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë*", me vlerë të kontratës (pa Tvsh)48,466,088lekë, realizuar nga OE "A.-I. G. C. n" Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 4,363,338.20lekë pa Tvsh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 25 prot., datë 01.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërisë "A.- I. G. C." Shpk.

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,363,338 lekë pa Tvsh** nga OE "A.-I. G. C." Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 25 prot., datë 01.12.2020, me objekt: "*Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Q. S.*", Bashkia Sarandë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi: Pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike dhe pagesave të kryera me bankë në lidhje me procedurën me objekt: "*Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z S.*", rezulton se nga sipërmarrësi i punimeve OE "E. -A." Shpk, me të cilën është lidhur kontratë nr. 9, datë 6.3.2021, është paraqitur për likuidim fatura nr. 5/2022, datë 28.2.2022.

Nga të dhënave të situacionit përfundimtare, vlerë e cila nuk është likuiduar pasi OE nuk ka mbyllur punimet sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka aktkolaudim.

Sipas të dhënave të njësisë së procedurave (*sektori i zbatimit të kontratave*), nga OE nuk është paraqitur shkresë për përfundimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë, si dhe nuk ka shtesë afat punimesh.

Referuar të dhënave të situacionit përfundimtar që disponon Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, punimet kanë përfunduar me datë 28.2.2022 ose 257 dite vonesë nga afati i kontratës, nisur nga data e faturës së paraqitur për likuidim.

Nga Bashkia Sarandë, (*personat përgjegjës*) nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesave në masën 4/1000 për çdo ditë vonesë por jo më pak se 25%, në zbatim të nenit 27 të kontratës, në vlerën **4,950,064 lekë** (19,800,158 x 25%), veprime financiare me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi OE "E. -A." Shpk, si përgjegjëse për mos përfundim të punimeve dhe shtyrjen e afatit të dorëzimit të punimeve.

Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se për makineritë dhe pajisjet është llogaritur Tvsh-ja kreditore (e zbritshme), duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve.

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin përkatëse parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar Tvsh-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.

Pra nuk ka më Tvsh për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa Tvsh-së.

Si pasojë e përfshirjes në situacion të Tvsh – së janë likuiduar tepër në vlerën **249,000 lekë**.

Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 249,000 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së Tvsh së pajisjeve në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Referuar zërave të preventivit të hartuar nga ing. Kristal Kali, konstatohet se në numrin 18 të saj, thuhet se: "*Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë (demontim i panelit të vjetër, **transport në magazinë**)*).

Nga të dhënat e marra nga magazina Bashkia Sarandë, dhe informacionit të marrë në Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë, rezulton se nga OE "E. -A." **nuk është bërë hyrje pjesa e vjetër e panelit e cila është zëvendësuar.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën nr. 9, datë 6.3.2021 të lidhur midis Bashkisë Sarandë, dhe shoqërisë "E. -A." Shpk;

i) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*", Kreu I/I "*Klasifikimi i punimeve të ndërtimit*", gwrma "a", paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit.

ii) VKM nr. 514, datë 15.8.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe Hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*", ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26.9.2012, pika 8.

iii) UKM nr. 1, datë 16.6.2011 "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*", të ndryshuar, pika 1, gwrma "c", paragrafi i fundit.

Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, për nenet 34-41.

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, të marrin pasa për:

a. Llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së kamatëvonesës për mos përfundim në afat të punimeve në objektin "*Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z*", për vlerën **4,950,064 lekë** nga OE "E. -A." Shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

b. Arkëtimin e vlerës së Tvsh kreditore të pajisjeve prej **249,000 lekë**, zbritur padrejtësisht në vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti "E. -A." Shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

c. Mos kryerjen e pagesave të asnjë vlerë të situacioneve pa bërë dorëzimin e mallit sipas preventivit zërit18, ku thuhet se: “Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kW secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kW (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë), nga OE “E. -A.” Shpk.

**Statusi: Pa zbatuar**

### **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e regjistrimit të procedurave të prokurimit, rezulton se për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, rezulton se janë zhvilluar gjithsej 19 procedura me fond limit 433,430 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur 427,638 mijë lekë, me një ulje nga fondi limit prej 1.3%.

Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit të vlerësuara për auditim me fond limit 401,045 mijë lekë ose 92.5% e fondit total dhe në përfundim të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi gjetjet e konstatuara, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si më poshtë:

a. Në **6 procedura prokurimi**, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedurë.

b. Në **5 procedura prokurimi**, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DT të miratuara nga AK, pasi ka kriteret të cilat nuk janë plotësuar dhe nga KVO janë vlerësuar si të rregullt. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar në vlerën **362,987 mijë lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me objektin e kontratës, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave kualifikuese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, veprime të cilat çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet.

**Statusi: Pa zbatuar**

### **D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se taksa e ndërtesës për një pjesë të konsiderueshme të familjeve aplikohet në mungesë të

dokumentacionit ligjorë (*genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK*), duke përdorur tarifë fikse 70 -100 m<sup>2</sup>, mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m<sup>2</sup> dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit dhe përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Referuar të dhënave të marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit/përdorimit të lëshuara nga kjo strukturë, konstatohet se për 3 leje taksa e pasurisë (taksa ndërtese), nuk është llogaritur e saktë për sipërfaqen që ato disponojnë, duke evidentuar një të ardhur të munguar.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat vendore” i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).

**Statusi: Pa zbatuar.**

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **285,062 lekë**, të taksës së ndërtesës nga **3** investitorë, *respektivisht:*

- vlera **134,064 lekë** nga investitori **E. O.;**
- vlera **40,320 lekë** nga investitori **D. D.;**
- vlera **110,678 lekë** nga investitori **G. A.;**

**Statusi: Pa zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk është lidhur asnjë kontratë, ndërkohë që rrugët kudo janë të mbushura me tabela treguese për parkime të rezervuara dhe me vijëzimet përkatëse.

Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.

Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që Bashkia ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës.

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se DTTV Bashkia Sarandë menaxhon 28 subjekte me parkim me pagesë për vlerën 1,120,000 lekë, nga e cila likuiduar vlera 640,000 lekë dhe nuk është likuiduar vlera prej **480,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu konstatohet se për një numër vend parkimesh, bashkia nuk kishte informacion dhe nuk ishin taksuar për vendet që ato shfrytëzonin dhe për të cilat kanë dhe të vendosur në tabelën.

Nga tabela, shihet për 18 vend parkime nuk është paguar vlera e taksës prej **720,000 lekë**, si ardhur e munguar në buxhet për tabelat dhe vijëzimet që vazhdojnë të qëndrojnë në rrugët e qytetit të Sarandës, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

**Personat përgjegjës janë: z. G. D.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike bashkia Sarandë dhe Inspektori i Zyrës së Shërbimeve për transportin **Th. K.**

Veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”; VKM nr. 170, datë 25.04.2002, nr. 344, datë 19.4.2017 dhe nr. 970, datë 02.12.2015 “Për liçencat e tregtimit të hidrokarbureve”; UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe nr. 12, datë 4.4.2017, “Për taksat kombëtare”, etj.

**2.1. Rekomandimi:** Nga administrata e Bashkisë Sarandë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, sipas rastit. Për personat të cilët i kanë tabelat dhe vijëzimet dhe nuk kanë bërë kërkesa për ndërprerjen e kontratës me bashkinë, të bëhet menjëherë faturimi i vlerës totale të debisë, për të gjithë periudhën e përdorimit të tabelave.

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Sarandë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **720,000 lekë të 18 vend parkime** të cilëve nuk ju është maturuara detyrimi, pavarësisht faktit se ato i shfrytëzojnë vendparkimit e rezervuara, *konkretisht:* subjekti “**N&**” për një vendparkime me vlerë **40,000 lekë**, subjekti “**A. Zh.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**A. B.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**S.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**A. A.**” për dy vendparkime **80,000 lekë**, subjekti “**B.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**C. & O.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**E. B.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**F. D.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**I. A.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**K.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**L. H.**” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “**R. Gj.**” për një vendparkime **40,000 lekë** dhe subjekti “**V. M. (ADM)**” për katër vendparkime **160,000 lekë**

**2.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë nga 12 subjekte.**

**Statusi: Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Kështu, nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Sarandë, figurojnë rreth **40 subjekte** (NUIS-e sekondare, përfshirë autobotet) të cilët kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj.

Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.

Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër.

**Nga sa mësipërm vlera 17,600,000 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.**

Veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “9. *Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion)*”



lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **17,600,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të licencohen apo të pezullohen, sipas rastit.

**3.2. Rekomandimi:** Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektorati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

**Statusi: Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditim:** Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë, ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 39 kontrata qiraje për objekte dhe truall me pretendimin se janë në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,864,860 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2021 vlera 3,642,560 lekë, duke mbetur për likuidim **vlera 1,222,300 lekë**.

Për asetet e dhëna me qira nga Bashkia, nga auditimi u konstatua se për asnjë rast nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, asnjë nga objektet e dhëna me qira nuk figuron i regjistruar në AKSH, pra në asnjë rast Bashkia Sarandë, nuk rezulton të disponojë Titull (Certifikatë) Pronësie për objektet e kontraktuara. Nga sa më sipër, rezulton se ligjërisht, Bashkia ka lidhur kontrata për objekte që nuk janë të vetat.

Referuar kushteve të kontratës (neni 7 i tyre), të gjithë personat të cilat nuk ka likuiduar në afat detyrimin mbi kontratën e qirasë duhet të paralizohen në masën 0.5% për çdo ditë vonesë, **pra në vlerën 2,945,743 lekë** ( $1,222,300 \text{ lekë} \times 0.5\% \times 482 \text{ ditë vonesë}$ ), **e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë**, (të dhënat sipas aneks 1), veprime në kundërshtim me nenit 7 të kontratës së qirave të subjekteve.

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,222,300 lekë** të kontratave të pa likuiduara.

Gjithashtu për të gjithë subjektet që nuk kanë likuiduar në afat detyrimin e qirasë sipas kushteve të kontratës të llogariten penalitetet (kamatëvonesat) në shumën **2,945,743 lekë**, dhe të arkëtohen vlera e detyrimit. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë, të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

**4.2. Rekomandimi:** Bashkia të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ASHK Dega (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qera dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.

**Statusi: Pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditim:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në territorin e Bashkisë Sarandë, ushtrojnë aktivitet 3 subjekte për shfrytëzim karriere (gurorë) në sipërfaqet pyjore/kullosore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020

“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18. Nga grupi i KLSH u kërkua informacion në lidhje me këto subjekte, por që nuk disponohej asnjë e dhënë.

Grupi i KLSH në zbatim të nenit 15 dhe 26, të ligjit 154/20214 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, Bashkia Sarandë, me shkresën nr. 1804 prot., datë 28.4.2022, ju kërkua Kryetarit të Bashkisë Sarandë, ngritjen e një grupi pune mbi verifikimin në terren të këtyre subjekte.

Me datë 15.5.2019 nga z. M. L. me detyrë specialist i menaxhimit te pyjeve dhe kullotave, konfirmon se:

Në zbatim të urdhrin të Kryetarit të Bashkisë nr. 78, datë 29.4.2022 është ngritur grupi i punës për verifikimin e problemit, nga ku rezulton se në territorin e Bashkisë Sarandë, ushtrojnë aktivitet shfrytëzim gurore 3 subjekte, konkretisht: “A.” Shpk, “I. B.” Shpk dhe “P.” Shpk.

Me shkresat nr. 1893/1,2,3 datë 4.5.2022 i është kërkuar informacion subjekteve në lidhje me detyrimet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore, duke konkluduar se:

**1. OE “A.” Shpk me Nipt J6.** ushtron aktivitet në parcelën kullosore 18 me emërtimin (Gurrës Volllder), me sipërfaqe 69.71 ha me leje minerale nr. 59, datë 24.4.2012 për periudhën 3.9.2012 deri më 3.7.2022 me sipërfaqe shfrytëzimi 0.5 km = 5 ha, deri në fund të lejes.

Subjekti ka kontratë me Bashkinë Himarë për një periudhë 4 vjeçare e cila fillon me datë 23.5.2018 dhe mbaron me datë 22.5.2022 për tarifën **148,500 lekë/viti**.

Referuar dispozitave të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), konstatohet se kontrata e qirasë për shfrytëzim të sipërfaqeve është llogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, tabela 6, pasi për sipërfaqen në shfrytëzim detyrimi i qirasë vjetore do duhej të ishte në vlerën **2,475,000 lekë** (5 ha x 495,000 lekë/ha/viti x 4 vite).

Pra për kontratën 4 vjeçare OE ka paguar 148,500 lekë x 4 vite = 594,000 lekë ose më pak se vlera reale për shumën **1,881,000 lekë** (2,475,000 – 594,000), **e ardhur e munguar**.

Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, në zbatim të VKM nr. 684, datë 2.9.2020 duhet të kishte kërkuar në Bashkinë Himarë dosjen e subjektit dhe arkëtimin e detyrimit që nga datë 2.9.2020, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe reflektimin e ndryshimeve për kontratën e qirasë.

**2. OE “P.” Shpk me nip K0.** ushtron aktivitet në parcelën 17 me emërtesë (Volllder) me sipërfaqe totale 37.02 ha.

OE është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo OE nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë. Nga OE janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.2020), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në certifikatë pronësie. Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasurinë shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, detyrimi i pa kontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **5,778,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 10.7)**, **e ardhura munguar në buxhet**. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.

**3. OE “I-B.” Shpk me nip J6** ushtron aktivitet në parcelën 4 me emërtesë (Cerek Uaturica) me sipërfaqe totale 92.08 ha.

OE është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 – 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo OE nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë.

OE disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje.

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë. Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet**. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.

Nga sa trajtuam më sipër, Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, duhet të vijojë me procedurat për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore/kullimore në shfrytëzim nga subjektet e mësipërme, ku për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullimore dhe nuk janë lidhur kontrata, duhet të bëhet pezullimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullimore, deri në momentin e çregjistrimit nga fondi pyjorë kullimor për saktësimin e pronarit të pronës.

Nëse pas daljes së VKM për destinacionin se kush është pronarë i ligjshëm i sipërfaqes për të cilën është lëshuar leja minerale dhe nëse ajo është në juridiksion të Bashkisë Sarandë, të lidhen kontratat e qirasë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullimor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullimor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, të marrë masa për:

- Tërheqjen e dokumentacionit të subjektit ”A.” Shpk, me kontratë qiraje me Bashkinë Himarë, por që janë kaluar në juridiksion të Bashkisë Sarandë, si dhe të bëhet rillogaritja e detyrimit për kontratën e qirasë të llogaritur në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke krijuar një të ardhur të munguar në vlerën **1,881,000 lekë**, kjo për shoqërinë “A.” Shpk.

Për sipërfaqet e mbyllura të kërkohet nga subjekti zbatimi i raportit teknik për ripyllëzim e zonës së shfrytëzueshme.

- Subjektet “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk, të cilët nuk kanë kontratë as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë, por kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullimore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

- Për sipërfaqen rrugë kalimi dhe vend depozitim që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Sarandë.

- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk pa kontratë qiraje deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në **vlerën 13,932,000 lekë** për sipërfaqen e shfrytëzuar në vite, nga e cila: për shoqërinë “P.” Shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë “I.-B.” Shpk në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

**Statusi: Pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël, konstatohet se janë lidhur kontrata për blerje mallrash dhe investime me subjekte të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të Bashkisë Sarandë.

Sipas të dhënave mbi aplikimin e detyrimeve për vitin nga DTV Bashkia Sarandë, konstatohet se për këto subjekte nuk është kërkuar pajisje me Nipt sekondarë për periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe nuk është bërë maturimi i detyrimeve për taksa/tarifa vendore në masën 95,000 lekë, siç është përcaktuar në VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020“*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*”. Gjithsej evidentohet një detyrim i patakshuar në vlerën **1,650,000** lekë, kjo për 20 subjekte, si e ardhur e munguar, sipas tabelës faqe 60-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu nga auditimi mbi procedurën e njoftimit të subjekteve tatimpagues të detyrimeve vjetore për taksa e tarifa vendore, u konstatua se DTV Bashkia Sarandë nuk vepronte në përputhje me dispozitat ligjore, pasi pas nxjerrjes së njoftim detyrimit, po nga administrata e DTV Bashkia Sarandë, me kërkesë të subjektit nxirrej një mandat pagesë për një shumë të caktuar, e cila nuk është sa shuma e njoftim detyrimit por më e vogël.

Kjo lloje procedura e ndjekur është e kundërligjshme ose një marrëveshje për pagesë me këste e pa ligjëruar, veprime të cilat çojnë në mos arkëtimin e detyrimeve vjetor dhe rritjen e nivelit të borxhit në fund të periudhave ushtrimore, ku për këtë njësi vendore është shumë e lartë prej 430 milionë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar, nenin 22 i ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “*Për Qendër Kombëtare të Regjistrimit*” (QKB), i ndryshuar; nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020“*Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*”.

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondarë dhe matarimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

**6.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të eliminojë praktikat e nxjerrjes së mandat pagesave pjesore të detyrimeve, pasi subjektet të jenë pajisur me njoftim detyrimi vjetorë ku të ngarkohet dhe për detyrimin e prapambetur.

**6.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa matuaruar në vlerën **1,650,000 lekë** ndajë **20 subjekteve**, sipas tabelës faqe 62-63 të Raport Auditimit.

**Statusi: Pa zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e TNI për disa nga objektet me lej ndërtimi dhe përdorimi, rezulton se nuk është llogaritur në zbatim t dispozitave ligjore, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash për Bashkinë Sarandë në shumën **150,332 lekë**, konkretisht:

**1. E. R. dhe O. J.** - Leje Ndërtimi me nr.1887 prot., datë 20.04.2021 është miratuar me Vendim nr. 409, datë 16.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: "*Ndërtim pishine dhe 1 kat parkimi nëntokë ne godine banimi 2-kate*"me subjekt zhvillues “M&S K. ” Shpk.

Llogaritja e taksës se ndikimit ne infrastrukture behet në bazë të çmimit te shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 02.06.2021 është 144,735 lekë, fatura e aplikimit datë 02.06.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 18.03.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit është 127m<sup>2</sup>. Duke e përlllogaritur me 3% x 127 m<sup>2</sup> x 32,739 = 124,735lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi.

**TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 127 m<sup>2</sup> x 32,739 = 124,735 lekë (paguar) nga zhvilluesi.**

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit;

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të TNI, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 6,111,021 lekë.

**TNI = Vlerë preventivi 6,111,021 lekë x 3% = 183,330 lekë.**

*Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 124,735 lekë ose më pak për vlerën 58,595 lekë (183,330 – 124,735), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.*

**2. F. P.** - Leje Ndërtimi me nr.2018 prot., datë 13.07.2021 është miratuar me Vendim nr. 425 datë 13.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objektin: “Hotel 4 kate me 2 kate nën tokë, podrum dhe garazhe” me subjekt zhvillues “M&S K” Shpk, me përdorim të lejuar shërbime, Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 04.10.2021 është 990,077 lekë, fatura e aplikimit datë 04.10.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Duke e përlllogaritur me 3% x 1008 m<sup>2</sup> x 32,739= 990,077 lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi.

**TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar në vlerën 3% x 1008 m<sup>2</sup> x 32,739 = 990,077 lekë (paguar) nga zhvilluesi.**

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 35,082,531 lekë.

**TNI = Vlerë preventivi 35,082,531 lekë x 3% = 1,052,476 lekë.**

*Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 990,077 lekë ose më pak për vlerën 62,399 lekë (1,052,476 – 990,077), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.*

**3. V. Gj.** - Leje Ndërtimi me nr. 1707 prot., datë 17.11.2020 është miratuar me Vendim nr. 395, datë 11.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: ‘ ‘Shtese 3 kate ne objekt ekzistues 1 kat, ne funksion te Turizmit’ ’ me subjekt zhvillues “LBC G. K.” Shpk, me përdorim të lejuar shërbime, adresë njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 18.01.2021 është 327,062 lekë fatura e aplikimit datë 18.01.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit që shtohet është 333m<sup>2</sup> (147m<sup>2</sup> kati i pare +147m<sup>2</sup> kati i dyte +39m<sup>2</sup> kati i trete). Duke e përlllogaritur me 3% x 333 m<sup>2</sup> x 32,739= 327 062 lekë.

**TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 333 m<sup>2</sup> x 32,739= 327 062 lekë (paguar) nga zhvilluesi.**

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 11,880,000 lekë.

**TNI = Vlerë preventivi 11,880,000 lekë x 3% = 356,400 lekë.**

*Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 327,062 lekë ose më pak për vlerën 29,338 lekë (356,400 – 327,062), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.*

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **150,332 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera 58,595 lekë nga investitorit **E. R. dhe O. J. .**
- vlera 62,393 lekë nga investitori **F. P. .**

- vlera 29,338 lekë ndaj investitorit V. Gj.

**Statusi: Pa zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacion teknik e ligjore të subjekteve të pajisur me certifikatë përdorimi, konstatohet se për 19 rastet e dhënies e certifikatës së përdorimit është e njëjta me atë të lejes së ndërtimit.

Por konstatohet se në tre raste situacionet përfundimtare të paraqitura nga investitorët janë me vlerë më të lartë se vlera e preventivit ose çmimit mbi të cilën është llogaritur TNI, për të cilën nga personat përgjegjës nuk është llogaritur diferenca e krijuar në vlerën **677,218 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ në buxhet, konkretisht:**

1- Objekti me zhvillues “A. D. E. D. ”, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 44,745,876 lekë, ku TNI është në shumën 1,342,763 lekë (44,745,876 x 3%). Investitori fillimisht ka likuiduar TNI në shumën 805,476 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 536,900 lekë (1,342,763 – 805,476).**

2- Objekti me zhvillues “N. R. ”, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 73,842,414 lekë, ku TNI është në shumën 2,215,272 lekë (73,842,414 x 3%). Investitori fillimisht ka likuiduar TNI në shumën 2,137,630 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 77,642 lekë (2,215,272 – 2,137,630).**

3- Objekti me zhvillues “E. D. ”, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 7,819,224 lekë, ku TNI është në shumën 234,576 lekë (7,819,224 x 3%). Investitori fillimisht ka likuiduar TNI në shumën 171,900 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 62,676 lekë (234,576 – 171,900).**

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **677,218 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera 536,900 lekë nga zhvilluesi “A. D. E. D. ”.
- vlera 77,642 lekë nga zhvilluesi “N. R. ”.
- vlera 62,676 lekë nga zhvilluesi “E. D. ”.

**Statusi: Pa zbatuar**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DTV Bashkia Sarandë, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve të pa arkëtuara nga subjektet fizik/juridik në vlerën 317,290,273 lekë.

Nisur nga fakti se numri i debitorëve është i lartë (aktualisht 2461 me vlerë 317,290,273 lekë), nuk mund t'i paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.

Konstatohet se nga një periudhë në tjetër, niveli i detyrimeve të pa arkëtuara vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 31,021,793 lekë, pasi nga vlera 286,268,480 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera **317,290,273 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifatat vendore të papaguara, **borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë.**

Nga DTV Bashkia Sarandë, nuk janë llogaritur kamatëvonesat për mos likuidimin në afat të detyrimeve në shumën **69,486,569 lekë.**

Evidentohet fakti që peshën kryesore e zënë debitorët e subjekteve fizik/juridik në vlerën 317,222 mijë lekë ose 78.8% e totalit.

Gjithashtu evidentohet fakti se nga DAV Bashkia Sarandë, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash në bashki.

Referuar të dhënave të buxhetit, vlera e detyrimeve nga taksat e tarifatat vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentë familjarë është 30.5% e planit të buxhetit.

Gjithashtu evidentohet një numër i konsiderueshëm subjektsh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndër vite.

Në lidhje me njoftimin për debitorë, nga inspektorët tatimorë janë bërë disa herë njoftime vlerësimi për detyrimet tatimore vendore për të gjithë subjektet dhe taksapaguesit familjare debitorë, por nga niveli menaxherial nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të kaluar në masat shtrënguese dhe në mbledhjen me forcë të detyrimit.

Nga të dhënat evidentohet se një numër i konsiderueshëm subjektet me status pasiv/mbyllur me detyrime të pa arkëtuara, gjithsej nga 138 subjekte që kanë mbyllur aktivitetin, 60 prej tyre janë me detyrime me vlerë **9,971,459 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Sarandë, po ashtu dhe DTV, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh **të pa arkëtueshme ose të keq.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve<sup>13</sup>, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifavat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **317,290,273 lekë.**

**9.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për llogaritjen e saktë të vlerë së kamatëvonesave në masën 0.06% për detyrimet e maturuara por të padredhura sipas afateve ligjore nga subjektet dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.

**9.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të bashkëpunojë me QKB Dega që në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit për procedurat tatimore dhe QKB, të mos lejojnë që për subjektet debitorë të bëhet mbyllja e aktivitetit ose lejimin e administratorëve për hapjen e aktiviteteve të tjera me Nipt tjetër, kjo për të eliminuar në maksimum borxhin e keq.

**Statusi: Pa zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me abonentët familjarë situata është pak më mirë, kjo si rezultat i bashkëpunimit me agjentin tatimorë Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Sarandë.  
*Kështu:*

Për periudhën 2015 – 2021 është faturuar gjithsej vlera 558,989,049 lekë, nga e cila: tarifë shërbimi 350,056,918 lekë dhe taksa ndërtesë në vlerën 208,932,032 lekë. Janë likuiduar për këtë periudhë shuma 474,057,147 lekë, kjo sipas akt akordimeve mujore dhe vjetore me agjentin tatimorë, **duke mbetur për likuidim shuma 84,931,902 lekë për 16067 familje, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.**

Referuar të dhënave të paraqitura mbi likuidimet, konstatohet se sipas akt akordimeve që abonentët familjarë të kenë paguar më shumë se detyrimi, gjë e cila nuk mund të ndodh, por nga DTTV Bashkia Sarandë, nuk ka informacion të saktë mbi debitorët familjarë që janë të kontabilizuar në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Sha.

Gjithashtu, konstatohet se nga DTV Bashkia Sarandë, nuk ka informacion mbi familjet që janë pa kontratë me ujësjellësin, duke mos aplikuar detyrimet fiskale për taksat e tarifavat vendore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e

<sup>13</sup>“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

*Shqipërisë*”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, me ndryshime.

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkërendojë punën me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Sarandë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur më 31.12.2021 prej **84,931,902 lekë**.

**Statusi: Pa zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat konstatohet se në vitin 2021 kemi një rënie të nivelit të arkëtimeve nga taksa e ndikimit të infrastrukturë (TNI), ku nga 113,920 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2020 në vitin 2021 është arkëtuar vlera prej 55,704 mijë lekë, kjo si rezultat i uljes së kërkesave për leje ndërtimi.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (*ALUIZNI*), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 74,206,014 lekë.

Vlera prej **74,206,014 lekë**, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e Taksave Vendore.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim*” i ndryshuar.

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **74,206,014 lekë**, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Statusi: Pa zbatuar**

## **E. Masa disiplinore**

Mbështetur në nenin 57 “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*” dhe nenin 59 “*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*”, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenit 9 – *Masat disiplinore*, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë** vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve dhe dhënien e masës disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga puna*”, ndaj **4 (katër) punonjësve**, si më poshtë:

**1. L. B.**, me detyrë Drejtor i DTTV Bashkia Sarandë.

**2. N. A.**, me detyrë Specialiste e borxhit fizik/juridik.

**3. K. K.**, me detyrë Drejt/Drejtoria e Bujqësisë Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.



4. **G. D.**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike.

**Statusi: Pa zbatuar**

#### **G. Masa administrative:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (kapitulli III/2.3 faqen 35-67), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshime) dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose masë disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **6 (gjashtë) punonjësve**, si më poshtë:

1. **z. R. H.**, me detyrë Specialist IT në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore.
2. **z. L. H.**, me detyrë Specialist Drejtoria Juridike .
3. **z. E. L.**, me detyrë Specialist në NjP në Drejtorinë Juridike.
4. **z. R. Ç.**, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Sarandë.
5. **z. E. Gj.**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm.
6. **z. K. A.**, me detyrë Specialist IT në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore.

**Statusi: Pa zbatuar**

#### **I. Për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmerret veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**Statusi: Pa zbatuar**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me nenet 15 dhe 30 të nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, ngarkohen me përgjegjësi z. A. G. me detyrë Kryetar i Bashkisë dhe**

1. **Znj. T. S.**, me funksion Drejtor Finance.
2. **Z. L. B.** me funksion Drejtor i Taksave Bashkia Sarandë.
3. **Znj. F. E.**, me funksion specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
4. **Z. R. P.**, me detyrë Drejtor i PZHT.
5. **Z. M. L.**, me detyrë Drejtor Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit veterinar, pyjeve, ujitjes dhe kullimit.
6. **Z. M. M.**, me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm.
7. **Z. A. Sh.**, me detyrë Specialist Drejtoria Juridike, **si persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve në zbatim të urdhrin nr. 163, datë 12.8.2022.**

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa për përsheptimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë”.

## 2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

**Verifikim i ankesave të dërguara në KLSH, në lidhje me disa problematika në territorin e Bashkisë Sarandë.**

*A. Në postën elektronike të KLSH (me nr. 955 prot., datë 17.10.2022), nga z. K. K. është formular/dërguar lënda: “Denoncim për korrupsion pasiv, si dhe përsheptërorim detyre të shefit të tatimeve S. L. ”.*

Në ankesë shprehen: “Kërkoj të bëj një denoncim për korrupsion pasiv, si edhe përsheptërorim detyre të shefit të tatimeve Sarandë, S. L. i cili para 1 viti bleu një godinë të vjetër në krah të hotelit të familjes time, objektin që bleu, në emrin e prindërve të tij, ishte komplet i rrënuar si edhe me shumë probleme të tjera. Probleme që sipas tij, i zgjidh shumë kollaj me postin që ai ka. duke na e përmendur shpesh se shefi i tatimeve dhe askush nuk guxon t’ja prishë. Nuk vonoi të na e tregoj këte S. L. me të vet gjithçka të paligjshme e bëri të “ligjshme”. Duke filluar nga ndërtimi tërësor i objektit të rrënuar që ai bleu. Askund nuk pamë. Leje Ndërtimi të shpallur për ndërtimet që bëri. Shumë shpejt, afër 8 muaj. e atë rrënojë, në një hotel luksoz, me emrin “P. ” shpesh degjonim grindjet dhe ankesat e dhjetra puntorëve, të cilit punonin në çdo orë të ditës pa pushim, nuk pamë dikë të vijë e ta kontrollojë a të siguar apo jo. Edhe pse ne ankohehim për zhurmën e kompresoreve në orët e drekës të pushonin pak. S. L. nuk donte t’ja dinte dhe askush nuk e ndalonte.

Kur ne i jemi ankuar për prishjen e qetësisë në drekë, në kohën që kishim pushues në hotel, S. L. nuk ka nguruar aspak të na tregojë i që mban në një çantë supi. që të mos guxojmë të ngrëjmë zërin. Kur prinderit e mi filluan të kundërshtojnë e të mos e durojnë më për shumë abuzime që bëri në pronën tonë, duke na e dëmtuar me mjete të rënda që ai kalonte në oborrin tonë, për pluhurin dhe zhurmën në orët e drekës, S. L. me sjellje huligani navandalizon pronën, duke na prishur mure për ti dhënë më tepër hapësira nga prona jonë, për të pasur parking të lirshëm për hotelin e tij. Pjesa më e madhe e “denoncimit” nuk është objekt auditimi. Nga grupi i auditimit u kërkua gjithë dokumentacioni që ndodhej në Bashkinë Sarandë, në lidhje me objektin Hotel “P. ”, ku konstatohet që:

Certifikata e regjistrimit të pronësisë e datë s 16.06.2021, me Kod Unik 864103 1226. Për pasurinë me nr. 22/1 6; ZK 8641, Sipërfaqe pasurisë 400 m2 truall, 280 m2 ndërtesë, është nëpronësi të J. S. L. dhe P. Ll. L. (secili nga 50% të pasurisë).

Me prokurë të posaçme Më datë 10.11.2021, J. S. L. dhe P. Ll. L. Ka caktuar si përfaqësues të tyre të posaçëm ligjor arkitektin “ që të aplikojë pranë portalit "e Albania" për “Deklaratë paraprake punimesh”.

Në dosje gjendej “Deklarata e përgjegjësisë profesionale” e E. LL. , me profesion arkitekt, me licencë A.2058/1.

Relacioni teknik punime mirëmbajtje të zakonshme, punime të brendshme dhe rifiniture në objektin 5 kat, rruga “M. H. ”.

Z. J. L. ka dorëzuar në datë 14.11.2021, deklaratën paraprake për kryerje punimesh për objektin: “Hotel”, të ndodhur në pasurinë me nr. 22/16 pasurie, ZK 8641, Sarandë,

Me vendimin nr. 391, datë 18.11.2021 "Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh të Kryetarit z. A. G. , ngarkohen autoritetet përgjegjëse të inspektimit të respektojë këtë vendim.

**B. Kërkesa me nr. 25/3 prot., datë 25.04.2023 (me nr. 416 prot., datë 08.05.2023 në KLSH), nga studio ligjore "J." përfaqësues z. N. S. e L. S. .**

**Kërkesues:**, e bja e B. dhe e D., e datlindjes 982, banues në Sarandë, lagja "T. H. ", , përfaqësuar nga Studio Ligjore "J." avokat A. Ll. dhe O. S., me adresë Rr: "T. K."

**N. S. ,** i datlindjes 27.02. 1974, , S. ndë, dhe banues në Sarandë, lagja "T. H. ", ndërtesa 44, Hyrja 1, Aparatamenti I, përfaqësuar nga Studio Ligjore "J." avokat A. Ll. dhe O. S. , me adresë Rr: "T. K."

**Objekti:** Kërkojmë të na informoni në lidhje me kërkesën për ndjekje të rastit kriminal të parashtruar nga ana jonë për ndërtimin pa leje të kryer nga shtetasit F. K. dhe L.L., si dhe të na vini në dispozicion një kopje të njëhësuar me origjinalin të të gjithë dokumentacionit/ praktikës dhe vendimarrjes që ju keni marrë për këtë rast.

Z. F. K. është pajisur me një leje ndërtimi të marrë nga Bashkia Sarandë, me Vendim të KRRT-së nr. 3/92, datë 17.11.2006. Pas paisjes me leje ndërtimi subjektin ndërtues "F. K. " ka vazhduar me fillimin e punimeve për një periudhë 6 (gjashtë) mujore dhe më pas këto punime janë ndërprerë për mungesë fondesh. Më vonë në vitin 2020, F. K. i është drejtuar Bashkisë për vazhdimin e punimeve dhe paisje me leje për shtyrjen e afatit të punimeve. Nga Bashkia Sarandë, për arsye se leja kishte kaluar afatin 10-vjecar që duhej të ishte ezaurua në bazë të ligjit nr. 107/2014, është kthyer përgjigje negative (Refuzimi i kërkesës për shtyrjen e afat të lejes së ndërtimit me vendimin nr. 98, datë 03.02.2020) për shtyrjen e afatit të kësaj leje dhe për rrjedhojë është kërkuar nga subjekti investitor "F. K." aplikimi për leje të re ndërtimi. Subjekti ndërtues "F. K. " duke mos qenë dakord me këtë vendim të Bashkisë Sarandë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër për të kërkuar rrëzimin e këtij vendimi të bashkisë dhe njëkohësisht shtyrjen e afatit të kësaj leje dhe me Vendimin nr. 360 (85-2020-912), datë 27.10.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër është bërë miratimi i shtyrjes se afatit të lejes. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë T 26.12.2020. Më pas subjekti zbatues ka kërkuar nëpërmjet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër zëvendësimin e aktit administrative dhe me vendimin nr.14985-202 1-1640, date 31.03.2021, është bërë aprovimi i kërkesës nga gjykata dhe është kryer zëvendësimi i akteve administrative (ky zëvendësim është ndërmarrë nga zyra përbarimore dhe bashkangjitur këtij aktverifikimi janë dhe aktet përkatëse të zyrës përbarimore) Subjekti zbatues më vonë ka bërë dorëzimin e dosjes në IVMT dhe ka vazhduar me punimet e mbetura. Gjatë zbatimit të punimeve nga vetë subjekti zbatues si dhe mbikqyrësi drejtuesi teknik dhe ligjor janë kryer aktet e kontroleve në objekt dhe pikërisht:

-Akt kontrolli (Aksi themeleve) datë 15.04.2021

-Akt kontrolli (Kuota 0.00) datë 10.05.2021

-Akt kontrolli (karabinasë) datë 13.01.2022

Subjekti ndërtues ka vazhduar me zbatimin e lejes së ndërtimit dhe ndërkohë nga pala kufitare është hapur një proces gjyqësor i cili ka kërkuar pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit dhe marrjen e masës së sigurisë për të mos e lejuar vazhdimin e punimeve. Ky proces gjyqësor ka nr. regj., Them. 339 (31157-0025 1-85-2021), datë 24.05.2021 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Në vazhdim të këtij procesi gjyqësor është marrë vendim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër vendim i cili ka rrëzuar këtë padi (Vendimi me nr. 475, datë 26.11.2021).

Gjatë inspektimit të kryer nga IKMT shtë konstatuar se subjekti ndërtues ka kryer punime në tejkallim të lejes së ndërtimit dhe ka realizuar shtesë sipërfaqe prej 228.64 m2.Për këtë subjekt është marrë vendim nr. 13. datë datë datë 09.11.2022 "Për konfiskimin për interes publik" nga KKT. Bashkangjitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me nr. 360 (85-2020-912) datë 27.10.2020, që ka marrë vendim të formës së prerë në datën 16.12.2020.
- Lajmërim ekzekutimi vullnetar nr. 158 Prot.. nr. 1393 regj., datë 18.12.2020, për zbatimin e Vendimit nr. 360, datë 27.10.2020.
- Vendim për kalim menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm nr. 02 prot., nr. 1393 regj., datë 11.01.2021 për zbatimin e vendimit nr. 360, datë 27.10.2020.
- Kërkesë e përsëritur për ekzekutim me nr. 12 prot., nr. 1393.regj., datë 27.01.2021, për zbatimin e vendimit nr. 360, datë 27.10.2020.
- Vendim për caktimin e ekspertit nr.13prot., datë 28.01.2021 për zbatimin e vendimit nr.360, datë 27.10.2020
- Vendimi për zëvendësimin e aktit administrativ, vendimi nr. 14 (85-2021-1-64), datë 31.03.2021.
- Akt ekspertimi përgatitur nga inxhinjere I. L..
- Aktet e lejes së ndërtimit me numër 3/92, datë 17.11.2006-Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me Vendimin nr. 475, datë 26.11.2021 për heqjen poshtë të masës së sigurisë dhe konstatimit të pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit me nr 3/92, datë 17.11.2006.
- Aktet e kontroleve të objektit.
- Akt konstatimi i IKMT Tiranë.

**C. Në adresë të KLSH me shkresën nr. s'ka prot, datë 26.5.2023 (prot KLSH nr. 489, datë 29.5.2023) është depozituar ankesa e qytetarit z. B. Ç. , në të cilën kërkohet:**

Sipas ankesës qytetari z. Ç. thuhet se:

*Në vitin 1995 i kam bërë kërkesë Bashkisë Sarandë, për trajtimin me truall ndërtimi për banesë. Në datë 28.8.1999 sipas studimit urbanistik të miratuar nga K.RR.T.SH në datën 19.2.1999 me vendim të K.RR.T-së Bashkia dhe VKB më është miratuar sheshi i ndërtimit. Trualli ndodhet në zonën e studiuar "H.T.K. Ç.", parcela nr. 5, blloku B-9, me sipërfaqe 451.3 m<sup>2</sup>.*

*Në datë 01.9.2002 është bërë piktimi i truallit nga inxh. H. B. e N. R. Më datë 31.12.2004 është bërë aktvlerësimi i truallit me vlerë 270,780 lekë, e nënshkruar nga zyra kadastrale e Urbanistikës Bashkia Sarandë, përfaqësuar nga B. A. dhe drejtori N. Ç., si dhe Zv/Kryetari i bashkisë z. F. M. Më datë 3.2.2005 është bërë pagesa e truallit pranë T. B. në vlerën 270,790 lekë.*

*I kam kërkuar në vazhdimësi bashkisë Sarandë, dokumentacionin përkatës për regjistrimin në hipotekë dhe nuk kam marrë përgjigje. Kërkesa e fundit e dokumentuar me protokoll është në datë 5.8.2019 së cilës i kam bashkëlidhur gjithë dokumentacionin përkatës.*

Nga auditimi i kësaj ankesë në dokumentacioni e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit me shkresën datë 31.5.2023, rezulton se gjendja juridike e pronës sipas dhe përgjigjes së ASHK me shkresën nr. 11341/1 prot., datë 12.11.2021 parcela me vend ndodhje pranë blloku B9 P5 me posedues z. B. Ç. kaluar me vendim të KB nr. 1, datë 28.8.1999, **prek pasuri të të tretëve në masën 451.3 m<sup>2</sup>, pra sipërfaqja totale e miratuar me VKB.**

Në zbatim të VKM nr. 329, datë 22.5.2019, kur situata ka mbivendosje së titujve procedura **nuk mund të zgjidhet në mënyrë administrative por vetëm me gjykatë.**

Gjithashtu u kërkua bashkëpunim dhe me grupin që ndodhet për auditim tek ASHK **dhe situata është e njëjtë me përgjigjen e ASHK (mbivendosje).**

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në rregulloren e brendshme nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm të bashkisë, si për shembull shkëmbimin e informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, për subjektet të cilat janë pajisur me leje për kryerjen e punimeve ndërtimore dhe që duhet të pajisen me NIPT sekondar, për të ushtruar aktivitet në Bashkinë Sarandë.
- Në Bashki nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Në Bashkinë Sarandë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.
- Nuk është hartuar regjistri dhe strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Sarandë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
- 1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.
- 1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit.
- 1.3. Rekomandimi:** Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore të marrë masa për:
  - Kryerjen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hariminin e dokumentit “Harta e proceseve të punës”.
  - Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

- 2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Sarandë, përgjatë vitit 2022, u konstatua se:
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.
  - Nuk është realizuar plani vjetor i auditimeve.
  - Në auditimet e kryera për vitin 2022, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
  - Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore.
  - Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet

dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Sarandë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Zhvillimit Rural, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *“Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”*.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjat “i”, “c” dhe “ç” në nenin 6, shkronja “b” në nenin 12 nenin 13, shkronjat “ii” dhe “iv” në nenin 14, shkronja “e” në nenin 16 në Ligjin nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*; Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *“Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”*; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 *“Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”*; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, Drejtori i Personelit dhe i Burimeve Njerëzore dhe Drejtori i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Hartimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm.

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

**2.2. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

#### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023**

**2.3. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve, ndërmarrjen e shërbimit publik etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucionale.

#### **Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2022, rezulton se:

- Për vitit 2022, buxheti është realizuar në masën 76%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,483,705 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,128,213 mijë lekë. Ndërsa vetëm për aparatit e bashkisë realizimi është në nivelit 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë, nga e cila:

Zëri investime paraqitet në masën 59%, ku nga vlera e parashikuar prej 501,460 mijë lekë është realizuar vlera 295,066 mijë lekë. Shpenzimet operative paraqiten në masën 81%, ku nga vlera e parashikuar prej 285,153 mijë lekë është realizuar vlera 230,153 mijë lekë dhe shpenzimet për paga në masën 74%, ku nga vlera e parashikuar prej 1,225,653 mijë lekë është realizuar vlera 906,060 mijë lekë. dhe shpenzime për paga në masën 74%.

Këto mos realizime vijnë nga fakti se struktura organike nuk është plotësuar për numrin e punonjësve të miratuar me VKB dhe se një pjesë e procedurave të parashikuara nuk janë zhvilluar për mungesë stafi, ndërsa pjesa tjetër nuk është financuar pasi nga shoqëritë sipërmarrës nuk janë paraqitur për likuidim dokumentacioni i rregullt ligjorë. *Konkretisht:*

- Nga të ardhurat e veta planifikimi ka qenë 329,042,460 duke përdorur vlera 131,763,000 lekë ose 40.4%, kjo nga mos realizimi i procedurave të parashikuara në fillim të periudhës. Nga fondet specifike (FSHZH) planifikimi në vlerën 172,368,720 lekë duke realizuar vlerën 163,302,133 lekë ose 94.74%, diferenca vjen nga mos paraqitja e rregullt e dokumentacionit për likuidim.

Shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 677,500 mijë lekë, nga të cilat: *të ardhurat e vitit në vlerën 447,500 mijë lekë dhe të trashëguara në vlerën 230,000 mijë lekë*, ose në masën 73 %, nga transfertat e pakushtëzuar në shumën 134,873 mijë lekë ose në masën 15%, transfertat specifike sektoriale në shumën 112,060 mijë lekë ose në masën 12 %.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime janë për vlerën 349,266 mijë lekë ose 38 %, shpenzime korrente zënë 40 % ose për vlerën 371,460 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 22 % ose në vlerën 201,207 mijë lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Sarandë, ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 është në vlerën 11,454,695 lekë (*nga e cila llog. 401-408 në vlerën 1,163,220 lekë dhe llog. 467 në vlerën 10,291,475 lekë*), të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është në vlerën 7,764,072 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar për shumën 3,690,623 lekë më shumë në pasqyrat financiare.

Nga auditimi i pagesave për shpenzime operative/investime/ etj, të realizuara nga ana e Bashkisë Sarandë, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se nuk janë likuiduar **2 fatura në vlerën 7,898,968 lekë** brenda afatit **30 ditor** nga momenti i paraqitjes së tyre,

Për vitet 2022, nuk janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, por vetëm raporti vjetor me shkresën datë 4.4.2023 të miratuar me VKB nr. 31.3.2023.

Me të ardhura e veta bashkia mbulon 38% të shpenzimeve vjetore, ku vlerën më të lartë prej 71% e zënë për shpenzimet operative dhe 41% e tyre përdoren për mbulimin e fondit të pagave.

Situata financiare e Bashkisë Sarandë, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 1.2 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenet 79 -80 -81 dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 ndryshuar me UMF nr. 5/1, datë 21.5.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për Hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

**3.2. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (*Spektori i Menaxhimit të kontratave*), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në çdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave. Në rast të evidentimit të vonësive të llogaritit penalitetet për

kamatëvonesë për mos mbyllje në afat të punimeve ose në rastet e paraqitjen me vonës të faturës nga vetë subjektet (pa shkak), t'i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penaliteteve për Tvsh e shitjes për mos deklarim në kohë të faturave.

**3.3. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa dhe të miratojnë në Këshillin Bashkiak radhën e faturave të pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore, duke likuiduar fillimisht ato me të hershmet, si dhe të rakordojë mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në bilanc me të dhënat e Ministrisë së Financave.

Të miratojë raportet 4 mujorë dhe të vënë në dijeni Këshillin Bashkiak mbi për ecurinë e buxhetit dhe pritshmërinë.

#### Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aseteve në pronësi/përdorim të Bashkisë Sarandë, kaluar me VKM respektive, rezulton se për miradministrimi e tyre nuk janë ndjekur si duhet identifikimin i gjendjes fizike, teknike dhe juridike të tyre për përdorimin dhe vënien në efikasësi për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë nga Bashkia në plotësimin e nevojave për komunitetin dhe krijimin e të ardhurave vendore nga përdorimi i tyre, pasi shumica e aseteve që zotëron dhe ka në administrim, nuk janë të vlerësuara dhe të regjistruara në kontabilitet kuptohet qartë se për këtë kategori nuk është hapur regjistri kontabël, veprime në kundërshtim me Kapitullin e III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimin i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 e Urdhrit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kërkesat e VKM nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo– territorial”, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për evidentimin në terren të të gjitha pronave (aseteve) të kaluara në pronësi/ përdorim bashkisë me VKM.

Të hartojë regjistrin e pronave, duke evidentuar pronat të pashfrytëzueshme, prona të zaptuara nga të tretë, pronë të shfrytëzueshme për interes të bashkisë, si dhe të përgatisë dhe regjistrojë në ASHK Dega të gjitha pronat aktive dhe në interes të bashkisë për realizimin e të ardhurave.

Në bashkëpunim me DBNj të ngrijnë Drejtorinë/Strukturën e administrimit të aseteve, si një strukturë e domosdoshme dhe efikase për administrimin e pronave të Bashkisë Sarandë.

#### Brenda datës 31.12.2023

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi strukturën organizative të Bashkisë Sarandë, rezulton se për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 53, datë 24.12.2021, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Sarandë, dhe NJA Ksamil për vitin 2022”, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 122/1 prot., datë 9.2.2022.

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Sipas strukturës së miratuar me VKB, pozicione pune të vlerësuara me Status të Nëpunësit Civil, gjithsej 73 pozicione, nga të cilat: një pozicion i kategorisë së lartë, 11 pozicione të kategorisë së mesme drejtues, 60 pozicione të kategorive ekzistuese. Nga këto të lira 1 pozicion i kategorisë së lartë, 2 pozicione të kategorisë së mesme drejtues, dhe 10 pozicione të kategorive ekzistuese.



Për vitin 2022 për punonjësit që i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Shërbimit Civil është në masën 54.7% ndërsa për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune realizimi i strukturës është në masën 82%.

Në strukturën e punonjësve civil i janë bashkuar edhe 33 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar, pra 33 pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar me punonjës me emërim apo kontratë të përkohshme **dhe jo sipas procedurave të konkurrimit**, veprime në kundërshtim me ligjin, pasi çdo marrëdhënie e re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të neneve 22, 23, 25 dhe 26, duhet të respektohen kërkesat e procedurave të rregullta konkurrimit, pasi çdo emërim që realizohet në kundërshtim me këtë rregullt, është i pavlefshëm dhe në kundërshtim me nenin 10 pika (i) shkronja (a) dhe shkronja (ç) të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore Bashkia Sarandë, duhet të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivel ekzekutiv për rastet e pozicioneve të lira në institucion, sipas nevojave të strukturës në fuqi në momentin e zbatimit, në referim të pikën 9 të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Gjithashtu duhet të evidentohen nevojat për të rishikuar përshkrimin e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, duke e përshtatur me pozicionet e strukturës aktuale dhe kërkesave ligjore e nënligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandim:** Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me DBNjtë marrë masa si vijon:

- Hartimin dhe miratimin e një rregullore mbi përshkrimin e pozicioneve të punës në institucion, në bashkëpunim me nëpunësin civil, duke analizuar përshkrimet aktuale të pozicioneve të punës dhe për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil të jenë në përputhje me detyrat funksionale dhe kërkesat specifike të ligjit dhe VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionin e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

- Të planifikojë dhe të shpallë për tu plotësuar pozicionet e lira në shërbimin civil, në përputhje me strukturën e institucionit, duke u kujdesur që të realizojë procedurën në grup për kategorinë ekzistues.

- Të hartojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në fund të vitit 2022, në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin e pranimit në shërbimin civil”.

**Brenda datës 31.10.2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtorja e të Ardhurave nuk ka në strukturën e saj sektor të menaxhimit dhe mbledhjes së borxhit. Nisur nga numri i lartë i debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore, për kategorinë e taksapaguesve biznes dhe familjar, gjerësisht se ky sektor është i nevojshëm për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore në rend shterues për arkëtimin e debitorëve.

-Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Sarandë, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Sarandë.

Për situatën e krijuar më sipër nga niveli drejtues i Bashkisë Sarandë, nuk janë marrë masat e nevojshme, me qëllim plotësimin e strukturës me sektorin e menaxhimit të borxhit tatimor, si dhe krijimin e pozicionit të përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar; Nenin 3 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Shkronjën “d” në pikën 8 në nenin 8, shkronja “f” në pikën 4 në nenin

9, si dhe shkronjën “b” në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë, sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

### **Brenda vitit 2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton një gjendje e konsiderueshme në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 511,887,154 lekë, nga e cila: debitorët për taksat dhe tarifave vendore për vlerën 348,067,442 lekë ose 68 % të totalit dhe vlera e lartë e gjendjes prej 163,812,712 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat evidentohet se nga Bashkia Sarandë nuk është kryer asnjë veprime për arkëtimin e tyre, si dhe nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore duke kaluar afatet e kërimit.

Gjithashtu evidentohet dhe fakti se megjithëse janë debitorë ndaj kësaj bashkie, këto shoqëri vijojnë të lidhin kontrata me Bashkisë Sarandë, pa mundur likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe mos lejimin e tyre në procedura.

Në lidhje me debitorët e taksave, rezulton se dhe kjo vlerë nuk është e saktë, pasi në të nuk janë reflektuar detyrimet debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ALUIZNI) në shumën 74,782,000 lekë dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd UK S. nda në shumën 259,314,461 lekë.

Nga auditimi është konstatuar dhe fakti se detyrimet për shpërblim dëmi në vlerën 10,317,550 lekë të rekomanduara dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9 datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022, **nuk janë të kontabilizuar** si detyrime dhe nuk është kryer asnjë verim për njoftimin e tyre, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 40, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DPZHT dhe Drejtorinë e të ardhurave, të marrin masa për rakordimet vjetore të vlerës së debitorëve në fund të periudhës për të gjitha llojet e Taksave. Tarifave vendore, duke kryer kontabilizimin e tyre në pasqyrat financiare.

Të kontabilizohet në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 74,782,000 lekë për taksën e ndikimit nga ndërtimet informale (ALUZNI) dhe detyrimet nga abonentët familjarë sipas aktmarrëveshjes me Nd. UK Saranda në shumën 259,314,461 lekë, si dhe të kontabilizohen vlera shpërblim dëmi prej 10,317,550 lekë të rekomanduara dhe përcjellë me shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 nga KLSH, sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 22.7.2022.

**6.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e procedurave të prokurimit të mos lidh kontrata shërbimi/ zbatimi në subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë Sarandë, për detyrimet debitorë të ardhura nga auditimet e KLSH apo institucionet të tjera.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomikë të marrin të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për vjeljen e detyrimeve në **shumën 163,812,712 lekë**, sipas listës analitike që disponon Sektori i Financës në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llog. 202 “*Studime dhe projektme*”, konstatohet se nga 114 studime dhe projektme në vlerën 119,561,177 lekë, ku disa prej tyre janë projekte të hartuara ndër vite dhe gjendje në magazinën e Bashkisë Sarandë, evidentohet fakti se një pjesë e këtyre projekteve janë vënë në zbatim por që me mbylljen e vlerës së investimit nuk është i është bashkuar investimit, duke bërë klasifikim nga llog. 202 në llog. 212 ose 213, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektorin e Menaxhimit të kontratave), Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 202 “*Studime dhe projektme*”, duke evidentuar të gjitha projekteve të prokuruar dhe vënë në zbatim gjatë periudhave ushtrimore dhe vlera e tyre ti kapitalizohet investimet sipas destinacionit të llogarive 212 ose 213.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**8. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 115,397,833 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llog. 210 “*Toka Troje Terrene*”, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **16 artikuj** aktive materiale në vlerën 78,696,463 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në shumën 38,169,299 lekë kjo për 4 artikuj dhe llog. 211 “*Pyje dhe plantacione*” në shumën 40,527,164 lekë kjo për 12 artikuj, pra kemi pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 210 “*Toka Troje Terrene*”, konkretisht pasqyra 1, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, Pika 2. Klasa 2, “*Aktivet afatgjata*” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “*Klasifikimi kontabël*”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në shumën totale prej 115,397,833 lekë dhe për **16 artikuj** në vlerën 78,696,463 lekë që nuk i përkasin kësaj llogaritë të kontabilizohen në llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në shumën 38,169,299 lekë për 4 artikuj dhe llog. 211 “*Pyje dhe plantacione*” në shumën 40,527,164 lekë për 12 artikuj, etj.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” sipas Formatit nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,102,204,443 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,134,852,828 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llog. 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” konstatohet se, kjo llogari është e analizuar sipas vlerës së investimeve të kryer pra vlerës së ndërtesave nuk i është shtuar vlera e konstruksionit, por janë trajtuar si artikuj kontabël më vete.

Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **25 artikuj** aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210

“Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog 202 “studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211-“Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987lekë.

Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, vë kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,852,828 lekë duke i shtuar vlerën e konstruksionit ndër vite (investimit), si dhe sistemimin **25 artikuj** aktive materiale në vlerën 55,021,942 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 8,282,128 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 40,376,675 lekë, llog. 202 “Studime e projekte” në vlerën 272,152 lekë dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 6,090,987 lekë, etj.

Të inventarizohet me analizë të veçantë për çdo artikullvlera prej 1,761,146 lekë, e cila është emërtuar “Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,134,107,522 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 3,382,689,240 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 248,581,718 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se, në këtë llogari rezultojnë asete të cilat i përkasin UK që duhet të zbriteshin nga kontabiliteti për **6 artikuj aktiv në vlerën 582,222,531 lekë**. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “Rikonstruksion”, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, vë kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për transferimin e të gjitha aktiveve që nuk i përkasin kësaj bashkie, kryesisht të **6 artikuj në vlerën 582,222,531 lekë** që i përkasin Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Të analizohet me kujdes llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për investimet e kryera në fushën e ujësjellësit dhe për objektet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet transferimi i tyre në Ndërmarrjen së Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Të analizohet vlera prej 29,568,137 lekë e cila është emërtuar “Rikonstruksion”, duke evidentuar çfarë përfaqëson.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerë bruto 76,117,705 lekë për të cilat

ka inventar fizik. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim **8 artikuj** aktive materiale në vlerën **1,814,418 lekë**, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “*Inventar Ekonomik*”, duke mos dhënë siguri për pasqyrat financiare viti 2022, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), “Klasifikimi kontabël”, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për analizimin e llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerë bruto 76,117,705 lekë për kontabilizimin gabim të **8 artikuj** aktive materiale në vlerën **1,814,418 lekë**, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “*Inventar Ekonomik*”.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën 4,826,249,599 lekë është paraqitur e plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi.

Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llog. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 115,397,833 lekë; 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 31,804,000 lekë, 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,134,552,828 lekë, 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 3,382,659,240 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 76,117,705 lekë, **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Kjo mënyrë e evidentimit dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Gjithashtu këto objekte nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (*certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor*), pasi dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit të llogarive 21 “Aktive afatgjata materiale” në lidhje me blerjen, krijimin apo shtesat e tyre. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për zberthimin e llogarive 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 115,397,833 lekë; 211 “*Pyje, Plantacione*” në

vlerën 31,804,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,134,552,828 lekë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,382,659,240 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 76,117,705 lekë, në përcaktimin e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për A. kull, të vlerës së plotë të çdo aktivi, nga vlera fillestare dhe shtesat gjatë viteve.

**14.2. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masa për hapjen e kartelave kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

**14.3. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin e pronave me certifikatë pronësi dhe në bashkëpunim me Eksperte vlerësuar të licencuar të aseteve për pronat e certifikuar me certifikatë pronësi por pa vlerë të bëhet vlerësimi i tyre dhe të futen në kontabilitet.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**15. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje dhe në çelje të vitit ushtrimore 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, por në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2022 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat gjatë vitit 2022 janë kryer pagesat, për vlerën prej 179,186,144 lekë që i përkasin llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”. Nga sa trajtuar më sipër kjo llogari nuk duhet të ishte zero, pasi ka investime në proces, por duhej pasqyruar në vlerën gjithsej **643,825,569 lekë, veprime të cilat nuk janë** siguri për pasqyrat financiare të vitit 2022, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave, të analizojë të gjitha investimet në proces për fazën në të cilët ato ndodhen, ku për investimet e përfunduara dhe marrë në dorëzim të bëhet kapitalizimi i llogarisë përkatëse sipas investimit. Ndërsa për investimet të cilat nuk janë mbyllur me akt marrje në dorëzim të bëhet kontabilizimi i tyre në llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në fazën e përfundimit.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se llog. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Sarandë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 40,484,979 lekë, cila përfaqëson 5% garanci punimesh, sipas *aneksit 3.9 bashkëlidhur Raportit të Auditimit*.

Kështu për 78 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Sarandë, janë ngurtësuar fonde në vlerën 36,267,256 lekë (*sipas Aneksit 3.10, bashkëlidhur Raportit të Auditimit*), për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Sarandë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Nga Drejtoria e PZHT, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave dhe Drejtoria e Ekonomike nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,267,256 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i

ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim DPZHT Bashkia Sarandë, dhe me Degën e Thesarit të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet që janë marrë në dorëzim konform përcaktimeve në kontratë, të bëjnë njoftimet e subjekteve për marrjen e garancive të punimeve në masën 5%. Në rast mos plotësimi i kushteve ose refuzimit nga subjektet ti kërkohet Degës së Thesarit Sarandë, kalimin e fondeve në favor të autoritetit kontraktor si e ardhur për mos përmbushje të kushteve të kontratës.

#### **Brenda datës 30.9.2023**

**17. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi ligjshmërinë dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë, rezulton se në 31 raste janë zhvilluar projekte artistike, aktivitete kulturore me vlerë 19,100,802 lekë (sipas aneksit 3.8 bashkëlidhur Raportit të Auditimit), për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7 e 9 dhe nenet 65-70, ligjin nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e këtyre shpenzimeve është kryer sipas VKB nr. 51, datë 24.12.2021, dhe shprehja e ligjshmërisë me shkresën nr. 2/1 prot., datë 17.01.2022. Nga Bashkia Sarandë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 3 subjekte është likuiduar shuma 1,219,128 lekë. Vlera **1,219,128 lekë** përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 58-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të evidentojë të gjitha rastet të cilat janë objekt i ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit (kryesisht aktivitet social kulturore), të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i **5 procedura** me fond limit **102,929** mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **5 procedura** me fond limit **102,929** mijë lekë, kriteret të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

<b>Nr.</b>	<b>Objekti i Prokurimit</b>	<b>Fondi Limit</b>
1	Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare A. Sh, Sarandë	59,595,833
2	Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh.	7,500,000
3	Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi A.Sh, mbi komisarjat dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V, Kodër	10,000,000
4	Rikualifikim i rrugëve të brendshme në lagjen nr. 3 dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme në lagjen “L. D. ”.	9,166,666

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë kriter specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit, Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Drejtues teknik në kundërshtim me kreun I/201 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet se, për punime deri në 30,000,000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier, certifikata ISO jo në përputhje me tipologjinë e objektit të prokuruar, të cilat gjejnë pasqyrim në trajtimin e çdo procedure si më poshtë.

Vendosja si kritere e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cenon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kritereve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në:

- Në 10 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 10 raste urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Në 10 raste ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë;
- Në 10 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 10 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 10 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;
- Në 2 raste punonjësi i cili është anëtar në komisionin e blerjeve të vogla rezulton të jetë edhe anëtar në komisionin e marrjes në dorëzim të mallit të prokuruar;
- Në 10 raste nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Në 5 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga OE, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përllogaritur penaltet;
- Në 10 raste nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pika 3 në nenin 34, pika 4 në nenin 36 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Pika 2 në nenin 26, neni 27, pika 1 në nenin 45, pika 3 në nenin 56, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pika 1 dhe pika 4 në nenin 75, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 2 në nenin 80 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Pikën 2 dhe 17 në Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Shkronja “b” në pikën 3 të nenit 22 në Ligjin nr.10 296 datë 08.07.2010, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 43 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”;



Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” neni 13 i “Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 79-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të angazhojë persona të kualifikuar në komisionet për përllogaritjen e sasive dhe fondit limit, dhe në çdo rast të dokumentohen veprimet e kryera në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

**Në vijimësi**

**19.2. Rekomandimi:** Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

**Në vijimësi**

**19.3. Rekomandimi:** Gjithashtu për 5 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

**Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave nuk ka në strukturën e saj sektor të menaxhimit dhe mbledhjes së borxhit. Nisur nga numri i lartë i debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore, për kategorinë e taksapaguesve biznes dhe familjar, gjykojmë se ky sektor është i nevojshëm për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore në rend shterues për arkëtimin e debitorëve.

-Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Sarandë.

Për situatën e krijuar më sipër nga niveli drejtues i Bashkisë Sarandë, nuk janë marrë masat e nevojshme, me qëllim plotësimin e strukturës me sektorin e menaxhimit të borxhit tatimor, si dhe krijimin e pozicionit të përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar; Nenin 3 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Shkronjën “d” në pikën 8 në nenin 8, shkronja “f” në pikën 4 në nenin 9, si dhe shkronjën “b” në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Sarandë, sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

**Brenda vitit 2023**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

**a-** me nr. 513, datë 31.05.2022, për subjektin ndërtues “E.D.S.M C..” Shpk. (zhvilluesi Ll. L.), për objektin: “Godinë shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë”, Bashkia Sarandë. Nga plani i vendosjes konstatohet se distanca në orientimin verior është 4.2 metër nga 5 metër që është distanca minimale e lejuar për një objekt 4 kate, si dhe në pjesën jugore objekti është ngjitur me kufirin e pronës.

**b-** me nr. 491, datë 20.04.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk (zhvilluesit: S.Zh. ) për objektin: “Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë” Rruga “Skënderbeu”, Bashkia Sarandë. Nga planvendosja e miratuar nga ana e DPZHTK, Bashkia Sarandë, konstatohet se distanca e objektit nga kufiri i pronës në anën perëndimore dhe veriore nuk është në përputhje me nenin 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” të VKM nr. 408, datë

13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”. Distanca duhet të ishte 7 metër jo 1 dhe 1,2 metër.

**c-** me nr. 484, datë 08 .04.2022, për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvillues OE “O.” Shpk) me , për objektin: “*Strukturë banimi 6 kate me 1 kat parkim*”, Rr. ‘B.’, Bashkia Sarandë Në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar, referuar VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 6 kate është 7 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.

**d-** me nr. 554, datë 18.10.2022, për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi I.I.), për objektin: “*Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë*” Bashkia Sarandë. Në orientimin verior dhe jugor distanca minimale e lejuar bazuar mbi rregulloren e planifikimit të territorit VKM nr. 408 datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, për një objekt 4 kate është 5 metër ndërkohë në planvendosjen e miratuar këto distancat nga kufiri i pronës janë më të vogla se ajo e lejuar.

**e-** me nr. 534, datë 25.07.2022 (2888) për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi: Th..R.) për objektin: “*Strukturë 4 kate me 1 kat nën tokë*” NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. Distanca e lejuar nga kufiri i pronës duhet të ishte jo më pak se 5 metër. Në këtë rast rezulton të jetë me vogël se 5metër.

**f-** me nr. 537, datë 04.10.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk, (zhvilluesit “S.E.G A.” Shpk) I. N. dhe S.Zh. për objektin: “*Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*”, Rr. “B. G.”, Bashkia Sarandë.

Nga planvendosja e miratuar konstatohet se edhe në këtë rast distancat nga kufiri i pronës nuk janë në përputhje me rregulloren e planifikimit të territorit në veri dhe jug janë pothuajse ngjitur me kufirin e pronës, ndërsa në lindje 1 metër nga kufiri i sajë. Distanca minimale për një objekt 4 kate duhet të ishte 5 metër. Distancat nga prona janë më të vogla se ato të lejuara. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandw të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se leja e ndërtimit me nr. 513, datë 31.05.2022 dhënë subjektit ndërtues “E.D.S.M C.” Shpk, (zhvilluesit Ll. L.) për objektin: “*Godinë shërbimi 3 kat me 1 kat nëntokë*”, Bashkia Sarandë.

Distanca minimale ndërmjet dy objekteve ku njëri është 4 kate dhe tjetri është 5 kate sipas rregullores së planifikimit duhet të ishte 11 metër. Nga planvendosja dallon se këto distanca janë më të vogla. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” u konstatua se leja:

**a.** me nr. 554, datë 18.10.2022, subjektit ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesit: I.I.) me, për objektin: “*Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë*”, Bashkia Sarandë. Nga projekti i miratuar konstatohet që në fasadën e pasqyruar objekti në fjalë 2 katet e parkimit i ka mbi kuotën e sistemit dhe jo nën tokë. Objekti në fjalë rezulton me 6 kate. Numri i kateve të lejuara në zonë është 4 kate.

**b.** me nr. 537, datë 04.10.2022, për subjektin ndërtues “S.E.G A.” Shpk (zhvilluesit: “S.E.G A.” Shpk, I. N. dhe S.Zh.) për objektin: “*Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*”

Rr. "B. G.", Bashkia Sarandë. Objekti konstatohet që është 5 katësh dhe jo 4 katësh. Plani i Përgjithshëm Vendor për zonën është për objekte deri në 4 kate.

c. me nr. 540, datë 05.10.2022, për subjektin ndërtues "A. K." Shpk (zhvilluesit: "A. K." Shpk), për objektin: "*Strukturë banimi 4 kate me 2 kate nëntokë*". Objekti është në lartësinë e 6 kateve pasi 2 katet e parkimit janë të vendosur mbi kuotën e sistemimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin "e-Leje" për lejet e ndërtimit me të dhënat:

a. me nr. 554, datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues "M&S K." Shpk, (zhvilluesi I.I), me , për objektin: "*Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë*", Bashkia Sarandë. Intensiteti në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është  $1.8\text{m}^2/\text{m}^2$ .

b. me nr. 537, datë 04.10.2022, dhënë subjektin ndërtues "S.E.G A." Shpk , (zhvilluesi "S.E.G A." Shpk , I. N. dhe S.Zh.), për objektin: "*Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*" Rr. "B. G.", Bashkia Sarandë. Intensiteti në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 1.8. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**24.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin "e-Leje" për lejet e ndërtimit me të dhënat:-

a. Leja me nr. 554, datë 18.10.2022, për subjektin ndërtues "M&S K." Shpk , (zhvilluesi I.I...) me , për objektin: "*Strukturë hotelerie 4 kate me 2 kate nëntokë*", Bashkia Sarandë. Koeficienti i shfrytëzimit në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 50%.

b. Leja me nr. 537, datë 04.10.2022 për subjektin ndërtues "S.E.G A." Shpk, (zhvilluesit "S.E.G A." Shpk, I. N. dhe S.Zh.), për objektin: "*Strukturë banimi 4 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*" Rruga "B. G.", Bashkia Sarandë.

Koeficienti i shfrytëzimit në këtë rast është më i madh se ai i lejuar që është 50%. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**25.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandë të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin "e-Leje" për lejet e ndërtimit me të dhënat:

a. me nr. 484, datë 08.04.2022 për subjektin ndërtues "M&S K." Shpk, (zhvilluesi "O. 2." Shpk), me , për objektin: "*Strukturë banimi 6 kate me 1 kat parkim*", Rr. "B. ", Bashkia Sarandë. Në planvendosje nuk janë pasqyruar objektet kufitare, të specifikuar me numra katesh dhe distanca që kanë me objektin.

b. nr. 491, datë 20.04.2022 për subjektin ndërtues "S.E.G A." Shpk, (zhvilluesi S.Zh.), për objektin: "*Strukturë banimi 6 kate me pishinë dhe 1 kat parkim nëntokë*" Rruga "Skënderbeu", Bashkia Sarandë. Planvendosja e miratuar nuk ka të pasqyruara distancat e objektit në fjalë nga objektet kufitarë të cilët e rrethojnë.

c. Leja me nr. 551 datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues "A. 2." Shpk (zhvilluesi G. S), për objektin: "*Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat me 1 kat nëntokë, në funksion të Turizmit*", Bashkia

Sarandë. Planvendosja e miratuar nuk ka të pasqyruara distancat e objektit në fjalë nga objektet kufitarë të cilët e rrethojnë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandë të merren masa për të miratuar leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe (KTP).

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin “e-Leje” për lejet e ndërtimit me të dhënat:

a. me nr. 550, datë 17.10.2022 për subjektin ndërtues “A.” Shpk, (zhvilluesi H. H.), për objektin: “Shtesë në lartësi 2 kate dhe shtesë anësore 1 kat në objekt ekzistues 3 kat në funksion të turizmit”, Bashkia Sarandë.

b. me nr. 551, datë 18.10.2022 për subjektin ndërtues “A.” Shpk, (zhvilluesi G.S), për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat me 1 kat nëntokë, në funksion të Turizmit”, Bashkia Sarandë.

c. me nr. 456 datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi Z. F.), me , për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat, në funksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë

d. me nr. 458, datë 15.02.2022 për subjektin ndërtues “I.” Shpk, (zhvilluesi A.Ç. dhe Zh. Ç.) për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 2 kat, në funksion të Turizmit”, NjA Ksamil, Bashkia Sarandë

e. me nr. 499 datë 23.03.2022 për subjektin ndërtues “M&S K.” Shpk, (zhvilluesi L. Gj.), për objektin: “Shtesë 2 kate dhe 1 kat parkim nën tokë në objekt ekzistues 1 kat” afati kohor i kësaj leje është 24 muaj.

Për lejet e mësipërme të miratuara nga ana e urbanistikës, bashkia Sarandë, konstatohet se nuk janë kërkuar akt-ekspertiza nga inxhinier të licensuar për këto situata. Këto shtesa kati të miratuara a ndikojnë në qëndrueshmërinë e dhe aftësinë mbajtëse të strukturës dhe themeleve të objektit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Sarandë të të merren masa që gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit, të respektohen të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane, të merren masa për të miratuar leje ndërtimin e shtesave të merret konfirmim nga inxhinieri i licensuar me anë të akt-ekspertizës se shtesa e ndërtuar mbi objektin ekzistues nuk ndikon në qëndrueshmërinë dhe aftësinë mbajtëse të strukturës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e IMT bashkia Sarandë, u konstatua se për procesverbalin me nr. 0000160 serie, dalja nga kushtet e deklaratës paraprake të lejes së ndërtimit është mbajtur vendim me gjobë 50,000 lekë, Për procesverbalin e kundërvajtjes më nr. serie 0000161 me kundërvajtjes “Ndërtimi i një strukture metalike i mbuluar me sanduiç dhe i veshur” është mbajtur vendim me gjobë 50,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 134-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1. Rekomandim:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa për të vendosur gjoba për kundërvajtjet e konstatuara sipas legjislacionit në fuqi konkretisht ligji 107/2014 neni 52 pika e.) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Për procesverbalin me nr. serie 0000163 është mbajtur vendim gjobe në shumën 5,320,000 lekë. Nuk na janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo procedurë të mbajtur ku të shpjegojë më fjalë apo imazhe fotografike se çfarë situatë është sipas çdo rasti. Gjoba në këtë rast është vendosur sipas vlerës së punimeve të kryera por nuk është vënë në dispozicion të KLSH dokumentacion justifikues se si ka dalë kjo vlerë gjobe. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 134-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1. Rekomandim:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa për gjobat e vendosura të shoqërohen më relacion përkatës dhe shpjegues se çfarë lloj shkelje është konstatuar e shoqëruar me imazhe dhe sipërfaqe ekzakte.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**30. Gjetje nga auditimi:** Disa prej procesverbaleve nga të cilat janë nxjerrë vendime qoftë prishje qoftë vendim me gjobë deri në 500,000 lekë të reja janë nxjerrë pa emër të identifikuar. Për procesverbalin me nr. 0000168 me kundërvajtje “*Hedhja e materialeve inerte në argjinaturë*” nuk është mbajtur vendim prishje apo kthim në gjendjen fillestare. Kundërvajtja e konstatuar është lenë deri në fazën e proces-verbalit të kundërvajtjes dhe nuk ka vazhduar me fazat e tjera si vendim gjobë apo vendim prishje. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 134-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**30.1. Rekomandim:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren që kundërvajtjet e konstatuara të dalin me vendime sipas legjislacionit në fuqi ligji 9780 “*Për inspektimin e ndërtimit*” neni “Neni 13 Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet Brenda 10 ditëve nga marrja e kopjes së procesverbalit ose e njoftimit për rezultatin e kontrollit, inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/ komunës/qarkut/kombëtar nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, i cili nënshkruhet nga kryeinspektori.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**31. Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli i dokumentacionit në fuqi është konstatuar se në 4 raste të procesverbaleve të kundërvajtjes të cilat janë me vendim prishje nuk janë ekzekutuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 134-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**31.1. Rekomandim:** Nga ana e IMT Bashkia Sarandë, të merren masa që kundërvajtjet e konstatuara dhe vendimet e mbajtura të ekzekutohen sipas legjislacionit në fuqi, Neni 13 “*Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet*” e Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, që shprehet: Vendimet e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë, sipas llojit të shkeljes. Përfundimisht, vendimet për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm kanë afat deri në 30 ditë për zbatimin e tyre.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**32. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Sarandë, rekomandimet e auditimit të fundit me shkresën nr. 370/9 datë 26.7.2022. Bashkia Sarandë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nuk ka kthyer përgjigje **duke mos respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh.**

Gjithashtu, nga Bashkia Sarandë, nuk është raportuar brenda afatit të 6 muajve, veprime në kundërshtim me përcaktimet e neneve 15 dhe 30 të ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 “*Për funksionimin dhe organizimin e KLSH*”.

Me urdhër nr. 163, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, z. A. G. është hartuar plani i punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-Së, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtoritë përkatëse. Me shkresën nr. 164, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë është urdhëruar marrja e masave për shpërbllim dëmi sipas vlerave të përcaktuara në shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 (rubrika shpërbllim dëmi).

Me urdhër nr. 3516, datë 12.8.2022 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni Disiplinor për Nëpunësit Civil të Institucionit të Bashkisë Sarandë.

Bashkia Sarandë, nuk **ka raportuar në** Këshillin Bashkiak, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, Neni 50-Auditimi i jashtëm.

*Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se:*

**a.** Janë rekomanduar 15 masa organizative, të pranuar plotësisht, ku rezultoi se janë në proces zbatimi 5 masa dhe **nuk janë zbatuar 10 masa.**

**b.** Janë rekomanduar 6 masa dëmshpërblimi të pranuar për 6 subjekte në vlerën 10,317,550 lekë të cilat rezultojnë të pa zbatuara.

c. Janë rekomanduar Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike të pranuar nga të cilat nuk janë zbatuar 2 rekomandime.

d. Nga masat për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) të pranuar nuk janë realizuar 21 rekomandime.

e. Nga 4 masat disiplinore të rekomanduar rezulton se janë pranuar por nuk janë zbatuar 4 masa.

f. Nga 6 masat administrative të rekomanduar e të pranuar rezulton se nuk janë zbatuar 6 masa.

*Sa më sipër rikërkojmë zbatimin e masave të pazbatuara si vijon:*

#### **A. Masa organizative**

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike të marrë masat që për vlerën e debitorë prej 162,031,719 lekë të rekomanduar në vite nga KLSH-ja por të pa arkëtuara, të cilave po ju kalon afati ligjor i kërimit. Të analizojë dokumentacionin ligjor për to, duke i klasifikuar sipas afateve dhe për detyrimet deri në 5 vjet të nxjerrë akte administrative për rivendosjen e afateve dhe kërkimin e tyre në rrugë administrative dhe ligjore.

#### **Menjëherë**

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa që gjendja prej 14,433,919 lekë e llog. 202 *"Studime dhe kërkime"*, të analizohet dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij.

#### **Menjëherë**

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 210 *"Toka Troje Terrene"*, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"*.

#### **Menjëherë**

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"* sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* dhe llog. 210 *"Toka, Troje, Terrene"*.

#### **Menjëherë**

**9.2. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa për inventarizimin e aktiveve në vlerën 1,761,146 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 212 *"Ndërtesa Konstruksione"*. Të kryej zbrëthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### **Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023**

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* llog. 210 *"Toka, Troje, Terrene"*.

#### **Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023**

**10.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në vlerën 29,568,137 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për

aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### **Gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2023**

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

**31.12. 2023**

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.201 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **7 masa** organizative, ku 6 prej tyre nuk janë zbatuar.
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** mungesë të ardhurash në shumën **495,505,008 lekë**.

**31.12. 2023**

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit të marrë masat dhe të informojë ankimesin L. H. në lidhje me lëshimin e autorizimit nr. 2044/1 prot, datë 31.7.2018 nga Bashkia Sarandë, në adresë të qytetarit z. T. M. me aftësi të kufizuar, duke bërë sqarimet përkatëse ligjore mbi domosdoshmërinë e këtij autorizimi për personat me aftësi të kufizuar.

**Menjëherë**

#### **B. Masa shpërblim dëmi**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “*Kodi i procedurave administrative në R.SH*” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 93, nga **Kryetari i Bashkisë Sarandë**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **10,317,550 lekë** ndaj **6 personave**, si më poshtë:

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Sarandë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **235,200 lekë** pa Tvsh nga OE “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5 prot., datë 03.05.2021 me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr: “K.”, “P.”, “P. Gj.P” dhe riveshje gropash*”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**31.12.2023**

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **317,148 lekë** pa Tvsh nga OE “2” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot., datë 03.05.2021 me objekt: “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “I. Q.” “Ç.”, “A. J.”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

**Menjëherë**

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,400 lekë** pa Tvsh nga OE “M. / ”Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë

26.04.2024 me objekt: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobetoni Rr. Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **125,400 lekë** pa Tvsh nga OE “I. /D.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot., datë 30.04.2024 me objekt: “Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e L. D.”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Sarandës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,363,338 lekë pa Tvsh** nga OE “A.-I. G. C.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 25 prot., datë 01.12.2020, me objekt: “Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë”, Bashkia Sarandë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, të marrin masa për:

a. Llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së kamatëvonesës për mos përfundim në afat të punimeve në objektin “Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”, për vlerën **4,950,064 lekë** nga OE “E.-A.” Shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

b. Arkëtimin e vlerës së Tvsh kreditorë të pajisjeve prej **249,000 lekë**, zbritur padrejtësisht në vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti “E.-A.” Shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

c. Mos kryerjen e pagesave të asnjë vlerë të situacioneve pa bërë dorëzimin e mallit sipas preventivit të zërit 18, ku thuhet se: “Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kV për lëshimin e tre pompave 38 kV secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kV (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë), nga OE “E.-A.” Shpk.

**Menjëherë**

**C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për Hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me objektin e kontratës, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave kualifikuese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DT, veprime të cilat çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet, eficiency dhe ekonomikitet.

**Menjëherë**

**D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).**



**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).

**Menjëherë**

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **285,062 lekë**, të taksës së ndërtesës nga **3** investitorë, *respektivisht:*

- vlera **134,064 lekë** nga investitori **E. O.**;
- vlera **40,320 lekë** nga investitori **D. D.**;
- vlera **110,678 lekë** nga investitori **G. A.**.

**Menjëherë**

**2.1. Rekomandimi:** Nga administrata e Bashkisë Sarandë, duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, sipas rastit. Për personat të cilët i kanë tabelat dhe vijëzimet dhe nuk kanë bërë kërkesa për ndërprerjen e kontratës me bashkinë, të bëhet menjëherë faturimi i vlerës totale të debisë, për të gjithë periudhën e përdorimit të tabelave.

**2.2. Rekomandimi:** Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **720,000 lekë të 18 vend parkime** të cilëve nuk ju është maturuara detyrimi, pavarësisht faktit se ato i shfrytëzojnë vendparkimit e rezervuara, *konkretisht:* subjekti “N&N” për një vendparkime me vlerë **40,000 lekë**, subjekti “A. Zh.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “A. B.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “S.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “A. A.” për dy vendparkime **80,000 lekë**, subjekti “B.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “C. & O.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “E. B.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “F. D.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “I. A.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “K.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “L. H.” për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti “R. Gj.” për një vendparkime **40,000 lekë** dhe subjekti “V. M. (ADM)” për katër vendparkime **160,000 lekë**.

**2.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë nga 12 subjekte**.

**Menjëherë**

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 17,600,000 lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të licencohen apo të pezullohen, sipas rastit.

**3.2. Rekomandimi:** Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektorati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

**Menjëherë**

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,222,300 lekë** të kontratave të pa likuiduara.

Gjithashtu për të gjithë subjektet që nuk kanë likuiduar në afat detyrimin e qirasë sipas kushteve të kontratës të llogariten penalitetet (kamatëvonesat) në shumën **2,945,743 lekë**, dhe të arkëtohen vlera e detyrimit. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë, të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

**4.2. Rekomandimi:** Bashkia Sarandë, të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ASHK Dega (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qera dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.

#### **Menjëherë**

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, të marrë masa për:

- Tërheqjen e dokumentacionit të subjektit "A." Shpk, me kontratë qiraje me Bashkinë Himarë, por që janë kaluar në juridiksion të Bashkisë Sarandë, si dhe të bëhet rillogaritja e detyrimit për kontratën e qirasë të llogaritur në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke krijuar një të ardhur të munguar në vlerën **1,881,000 lekë**, kjo për shoqërinë "A." Shpk.

Për sipërfaqet e mbyllura të kërkohet nga subjekti zbatimi i raportit teknik për ripyllëzim e zonës së shfrytëzueshme.

- Subjektet "P." Shpk dhe "I.-B." Shpk, të cilët nuk kanë kontratë as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë, por kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kollusore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

- Për sipërfaqen rrugë kalimi dhe vendepozitim që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Sarandë.

- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë "P." Shpk dhe "I.-B." Shpk pa kontratë qiraje deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në **vlerën 13,932,000 lekë** për sipërfaqen e shfrytëzuar në vite, nga e cila: për shoqërinë "P." Shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë "I.-B." Shpk në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

#### **Menjëherë**

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondarë dhe matarimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

**6.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të eliminojë praktikën e nxjerrjes së mandat pagesave pjesore të detyrimeve, pasi subjektet të jenë pajisur me njoftim detyrimi vjetorë ku të ngarkohet dhe për detyrimin e prapambetur.

**6.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën **1,650,000 lekë** ndaj **20 subjekteve**, sipas tabelës faqe 62-63 të Raport Auditmit.

#### **Menjëherë**

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **150,332 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- **vlera 58,595 lekë** nga investitorit *E. R. dhe O. J. .*
- **vlera 62,393 lekë** nga investitori *F. P. .*
- **vlera 29,338 lekë** ndaj investitorit *V. Gj.*

#### **Menjëherë**

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës

**677,218 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht*:

- **vlera 536,900 lekë** nga zhvilluesi “**A. D. E. D.**”.
- **vlera 77,642 lekë** nga zhvilluesi “**N. R.**”.
- **vlera 62,676 lekë** nga zhvilluesi “**E. D.**”.

**Menjëherë**

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **317,290,273 lekë**.

**9.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për llogaritjen e saktë të vlerë së kamatëvonesave në masën 0.06% për detyrimet e maturuara por të padredhura sipas afateve ligjore nga subjektet dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.

**9.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të bashkëpunojë me QKB Dega që në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit për procedurat tatimore dhe QKB, të mos lejojnë që për subjektet debitorë të bëhet mbyllja e aktivitetit ose lejimin e administratorëve për hapjen e aktiviteteve të tjera me Nipt tjetër, kjo për të eliminuar në maksimum borxhin e keq.

**Menjëherë**

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të bashkërendojë punën me Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime Sarandë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur më 31.12.2021 prej **84,931,902 lekë**.

**Menjëherë**

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **74,206,014 lekë**, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Menjëherë**

## **E. Masa disiplinore**

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 9 – *Masat disiplinore*, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë**, vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve dhe dhënien e masës disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga puna*”, ndaj **4 (katër) punonjësve**, si më poshtë:

1. **L. B.**, me detyrë Drejtor i DTTV Bashkia Sarandë.
2. **N. A.**, me detyrë Specialiste e borxhit fizik/juridik.
3. **K. K.**, me detyrë Drejt/Drejtoria e Bujqësisë Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.
4. **G. D.**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike.

**Menjëherë**

## **G. Masa administrative:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (kapitulli III/2.3 faqen 35-67), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshime) dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose masë disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **6 (gjashtë) punonjësve**, si më poshtë:

1. **z. R. H.**, me detyrë Specialist IT në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore.
2. **z. L. H.**, me detyrë Specialist Drejtoria Juridike.
3. **z. E. L.**, me detyrë Specialist në NjP në Drejtorinë Juridike.
4. **z. R. Ç.**, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Sarandë.
5. **z. E. Gj.**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm.
6. **z. K. A.**, me detyrë Specialist IT në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore.

**Menjëherë**

#### **I. Për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Shërbimit Civil:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**Menjëherë**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j), si dhe ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Z. A. G.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Sarandë, **dhe**
2. **Znj. T. S.**, me funksion Drejtor Finance.
3. **Z. L. B.** me funksion Drejtor i Taksave Bashkia Sarandë.
4. **Znj. F. E.**, me funksion specialiste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
5. **Z. R. P.**, me detyrë Drejtor i PZHT.
6. **Z. M. L.**, me detyrë Drejtor Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit veterinar, pyjeve, ujitjes dhe kullimit.
7. **Z. M. M.**, me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm.
8. **Z. A. Sh.**, me detyrë Specialist Drejtoria Juridike, **si persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve në zbatim të urdhrit nr. 163, datë 12.8.2022.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 135-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**32.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, të marrë masa për përshpejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi dhe të pazbatuara akoma, dërguara nga KLSH me

shkresën nr. 370/9, datë 26.7.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë”.

Menjëherë

**33. Gjetje nga auditimi:** Në adresë të KLSH me shkresën pa nr. prot., datë 26.5.2023 (me prot., nr. 489, datë 29.5.2023 në KLSH) është depozituar ankesa e qytetarit **z. B. Ç.**, në të cilën kërkohet se nga Bashkia Sarandë, nuk i jepet dokumentacioni për regjistrim në ASHK Drejtoria Sarandë, të pronës miratuar me vendim të K.RR.T.SH në datën 19.2.1999 dhe vendim të K.RR.T-së Bashkia Sarandë, dhe VKB, të sheshit të ndërtimit “*Trualli ndodhet në zonën e Studiuar “Hotel Turizmi Kanali Cukës”, parcela nr. 5, blloku B-9, me sipërfaqe 451.3 m<sup>2</sup>*”.

Nga auditimi i kësaj ankesë në dokumentacioni e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit me shkresën datë 31.5.2023, rezulton se gjendja juridike e pronës sipas dhe përgjigjes së ASHK me shkresën nr. 11341/1 prot., datë 12.11.2021 parcela me vendndodhje pranë blloku B9 P5 me posedues z. B. Ç., kaluar me vendim të KB nr. 1, datë 28.8.1999, **prek pasuri të të tretëve në masën 451.3 m<sup>2</sup>, pra sipërfaqja totale e miratuar me VKB.**

Në zbatim të VKM nr. 329, datë 22.5.2019, kur situata ka mbivendosje së titujve procedura **nuk mund të zgjidhet në mënyrë administrative por vetëm me gjykatë.**

Gjithashtu u kërkua bashkëpunim dhe me grupin që ndodhet për auditim tek ASHK **dhe situata është e njëjtë me përgjigjen e ASHK** (mbivendosje). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**33.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të njoftojë zyrtarisht subjektin mbi gjendjen juridike të pronës **z. B. Ç.** me adresë “*Trualli ndodhet në zonën e Studiuar “H.T.K.Ç”, parcelanNr. 5, blloku B-9, me sipërfaqe 451.3 m<sup>2</sup>*”, kaluar me vendim të K.RR.T.SH në datën 19.2.1999 dhe vendim të K.RR.T Bashkia Sarandë dhe VKB.

Menjëherë

## B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, gërma “b” dhe “c”, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **320,900 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikualifikim .....”, Sarandë, me vlerë të kontratës **18,394,920 lekë** me Tvsh, fituar nga OE “J. K. ” Shpk , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **190,000 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 17 prot., datë 06.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor dhe OE “J. K. ” Shpk . (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 123-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **190,000 lekë pa Tvsh** nga OE “J. K.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 20.12.2020, me objekt “Rikualifikim .....”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Riveshje Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T.” dhe rikualifikim i Rr. “J, K.” Bashkia Sarandë,

me vlerë të kontratës **10,512,051 lekë me Tvsh**, fituar nga OE “N. -” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **52,000 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 11 prot., datë 14.11.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, dhe OE “N. -” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 123-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **52,000 pa Tvsh** nga OE “N. -” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11 prot., datë 14.11.2022, me objekt: “Riveshje Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T.” dhe rikualifikim i Rr. “J, K.” Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi “A. Sh.”, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve në B., Ç., M.”, Bashkia Sarandë, me vlerë të kontratës lekë me Tvsh, fituar nga OE “M. /” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **78,900 lekë pa Tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 15 prot., datë 15.12.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE “M. /” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 123-129, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **78,900 lekë pa Tvsh** nga OE “M. /” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Rikualifikim hapësirash me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi “A. Sh.”, mbi K. dhe rikualifikim i rrugëve në B., Ç., M.”, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

#### Menjëherë

### **C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë Sarandë, duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, civile apo penale, sip as rastit.

Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.

Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që Bashkia Sarandë, ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës.

Nga të dhënat, konstatohet se DTTV Bashkia Sarandë, menaxhon 36 subjekte me parkim me pagesë për vlerën 3,020,000 lekë, nga e cila likuiduar vlera 2,640,000 lekë dhe nuk është likuiduar vlera prej **380,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu konstatohet se për një numër vend parkimesh, bashkia nuk kishte informacion dhe nuk ishin taksuar për vendet që ato shfrytëzonin dhe për të cilat kanë dhe të vendosur në tabelën. Veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji nr.

9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”; VKM nr. 170, datë 25.04.2002, nr. 344, datë 19.4.2017 dhe nr. 970, datë 02.12.2015 “Për liçencat e tregtimit të hidrokarbureve”; UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe nr. 12, datë 4.4.2017, “Për taksat kombëtare”, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të ngrejë një grup pune për të evidentuar numrin e parkimeve të rezervuara nga subjekte private që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, si dhe të shikohet mënyra e taksimit e të gjitha parkimeve të rezervuara.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 380,000 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë nga parkimet e rezervuara.

### **Brenda datës 31.10.2023**

**2. Gjetje nga auditim:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në territorin e Bashkisë Sarandë, ushtrojnë aktivitetet 2 subjekte për shfrytëzim karriere (gurore) në sipërfaqet pyjore/kullosore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18.

1-OE “P.” Shpk, me NIP ushtron aktivitetet në parcelën 17 me emërtesë (Vollder) me sipërfaqe totale 37.02 ha.

OE është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo shoqëri nuk ka kontratë qiraje me Bashkinë Sarandë. Nga OE janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.2020), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në certifikatë pronësie.

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasurinë shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pa kontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **5,778,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 10.7), e ardhura munguar në buxhet.** Kjo vlerë varion në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.

2-OE “I.-B.” Shpk me nip J6 ushtron aktivitetet në parcelën 4 me emërtesë (C. U.) me sipërfaqe totale 92.08 ha.

OE është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 – 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo OE nuk ka kontratë me Bashkinë Sarandë.

OE disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje.

Nga sa trajtohet OE ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (tabela 6), detyrimi i pa kontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet.** Kjo vlerë varion në raport me sipërfaqen që OE ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2022.

Nga sa trajtuam më sipër, Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, duhet të vijojë me procedurat për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në shfrytëzim nga subjektet e mësipërme, ku për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore dhe nuk janë lidhur kontrata, duhet të bëhet pezullimi i

veprimtarisë së shfrytëzimit të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore, deri në momentin e çregjistrim nga fondi pyjorë kullosor për saktësimin e pronarit të pronës.

Nëse pas daljes së VKM për destinacionin se kush është pronarë i ligjshëm i sipërfaqes për të cilën është lëshuar leja minerale dhe nëse ajo është në juridiksion të Bashkisë Sarandë, të lidhen kontratat e qirasë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, dhe Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për dy Subjektet “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk, të cilët nuk kanë kontratë me Bashkinë Sarandë, dhe kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

-Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë “P.” Shpk dhe “I.-B.” Shpk pa kontratë qiraje deri më 31.12.2022, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për shoqërinë “P.” Shpk në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë “I.-B.” Shpk në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Bashkia Sarandë, u përzgjodhën 11 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit, rezulton se për vitin 2022 u konstatuan mangësi si:

-Në rastet e lidhjes së kontratave 2-5 vjeçare, janë lidhur kryesisht në muajt korrik dhe gusht, dhe jo në fillim sezoni (në maj). Në disa raste subjektet nuk kanë paraqitur vërtetimet për detyrimet që kanë ndaj DPTR dhe DTTV. Në një pjesë të rasteve mungojnë ekstrakti i QKB apo Plan-bizneset. Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera. Në një pjesë të madhe të kontratave nuk shoqëroheshin me planvendosje, por edhe ku ishin nuk evidentoheshin përmasat e parcelës, mungonin të dhënat për largësinë e parcelës nga vija bregdetare për respektimin apo jo distancës të paktën prej 7.5 m nga vija e bregut të detit, nuk evidentoheshin shpërndarja e çadrave nëse është respektuar largësia ndërmjet tyre prej 2.5 m, si dhe nëse është lënë e lirë hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave për t’u shfrytëzuar nga publiku. Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar. Në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20% sipërfaqe në përdorim publik. Mungonin aktet e monitorimit të kontratave të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit si detyrim ligjore dhe pse në pjesën më të madhe subjektet ishin të njëjtë në çdo vit. Kryetari i Bashkisë Sarandë, nuk ka ngritur grupe pune për të kryer verifikime në terren. Në disa raste, pagesa e qirasë është kryer shumë me vonësë deri



disa muaj pas mbarimit të sezonit dhe jo në momentin e lidhjes së kontratës apo aktmarrëveshjes sipas kushteve të kontratës.

- Nga auditimi i dokumentacionit për qiradhënien e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit “Stacion plazhi”, rezultoi se Bashkia Sarandë, në vitin 2022 ka në administrim 144 kontrata qiraje për përdorimin e hapësirës së plazhit. Në përfundim konstatohet se në fund të vitit 2022 janë gjithsej 15 subjekte të cilët nuk kanë kryer likuidimin e tarifës vjetore të qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit, gjithsej në vlerën **6,106,500 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar me VKM nr. 424 datë 27.05.2020 neni 14 pika 10, nënpika b. me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” neni 4, pika 3, neni 5, pika 1, neni 4, pika 8, me VKM nr. 321 datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore” i ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, Kreu III, pika 9, Kreu IV pika 1 shtojca B-3, me kontratë tip të miratuar të lidhur ndërmjet palëve neni 6 “Pagesa e qirasë” neni 5, “Detyrimet e qiramarrësit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, dhe Drejtorja e Shërbimeve duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të kryer verifikime në terren për të gjitha kontratat e lidhura me subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.2. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik Financiar, të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej **6,106,500 lekë**, nga subjektet e individ private.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Sarandë, për taksimin dhe tarifimin e subjekteve me aktivitet “Hoteleri” rezultoi se për vitin 2022 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 18,456 mijë lekë, ose 77% e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel. Pra nuk evidentohet, sa dhoma ka hoteli disponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Sarandë, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 13,433 mijë lekë për 494 subjekte. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e fjetjes në hotele, konstatohet se nga Drejtorja e të Ardhurave Bashkia Sarandë, nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerë 13,433 mijë lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën A.3 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtorja e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe

shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

**4.2. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 13,433 mijë lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

#### **Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022, u konstatua se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 2461 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 317,290 mijë lekë. Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 2567 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 321,676 mijë lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke mos aplikuar masa shtrënguese (vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa të tjera shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr.225, datë 22.12.2021 Për miratimin e buxhetit të vitit 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 321,676 mijë lekë.

#### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë, ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 37 kontrata qiraje për objekte dhe truall në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,987,800 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2022 vlera 1,363,860 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 3,195,540 lekë.**

Referuar kushteve të kontratës neni 7 pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet me nënshkrimin e kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të këtij neni nga bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve të kontratës, veprime në kundërshtim me nenin 7 të kontratës së qirave të subjekteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **3,195,540 lekë**, nga kontratat e qirave. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë, të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

**Brenda datës 31.10.2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është 85,315 mijë lekë për 2210 subjekte, nga të cilat 356 subjekte për vlerën 11,109 mijë lekë janë krijuar në vitin 2022. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga DPZHT Bashkia Sarandë, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjith ashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Sarandë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mos pagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale. Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Sarandë, ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën A.4 të Paketës Fiskale për vitin 2022. Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 85,315 mijë lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.

#### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.

Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Sarandë, përgjatë vitit 2022 nuk i është drejtuar me shkresë subjekteve për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu përgjatë vitit 2022 nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.

-Për subjektet e mësipërme nuk administrohen masa shtrënguese (bllokim të llogarive bankare).

-Pra sa më sipër konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

-Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mos marrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2022) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 16 subjekte për 16 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë, në vlerën 3,520,000 lekë dhe në fund të periudhës 31.12.2022 vlera debitore është 21,120,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017. Rregullore e brendshme e Bashkisë Sarandë, “Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit”, pika 1, si dhe shkronja “d”, si dhe “Policia Bashkiake”, neni 5 dhe neni 8; Pika 10 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

**8.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 21,120,000 lekë.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifave vendore për pastrimin dhe shërbimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga DAV, Bashkia Sarandë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit dhe shërbimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2022 në 20 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit në vlerën 1,900,000 lekë gjithsej, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

-Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mos raportimit pranë DAV Bashkia Sarandë, të lejeve të ndërtimit të dhëna për subjektet e mësipërme, por edhe nga puna e pamjaftueshme DAV Bashkia Sarandë, në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Sarandë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreun II, pika 2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, të vitit 2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** DAV Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa maturuar në vlerën **1,900,000 lekë** ndaj **20 subjekteve**.

### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë në Drejtorinë e të Ardhurave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Sarandë, dhe NJA për vitin 2022 janë taksuar 17508 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2022 janë taksuar 1189 familje më pak.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Sarandë, nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe pastrimit, për numrin e familjeve të pa taksuara, do të kishim 3,600 lekë \* 1189 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,280,400 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë, nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 07.03.2018<sup>14</sup>, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenin 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pika B.1.3 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me Administratorin e Njësisë Administrative Ksamil, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2022, rezultojnë 4,280,400 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

#### **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022, u konstatua se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 11,377 familje debitorë për vlerën 87,396 mijë lekë, nga të cilat, në vitin 2022 janë krijuar 4865 familje debitorë për vlerën 3,335 mijë lekë. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “familje”, çka tregon për punë të pamjaftueshme të Bashkisë Sarandë, në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

Sa i përket familjeve debitorë, rezulton se nga zyrat e taksave në NJA janë përcjellë debitorët në DAV pranë Bashkisë Sarandë, por konstatohet se nga specialisti i mbledhjes së borxhit nuk është marrë asnjë masë ligjore (njoftimin e vlerësimin të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Paketa Fiskale e Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 87,396 mijë lekë.

<sup>14</sup>Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

## **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IVMT Bashkia Sarandë, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 320,000 lekë, Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përmbartimit gjyqësor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSh”, neni 14 në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**12.2. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbartuesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

## **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për miratimin e lejeve të ndërtimit, në një rast u konstatua përlllogaritje e gabuar e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 228,066 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të Paketës Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 129-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 320,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**13.2. Rekomandimi:** Kryeinspektori i IVMT Bashkia Sarandë, në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimin të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbartuesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamatë vonesë) të palëve të treta ndaj Bashkisë Sarandë.

## **Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023 dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së DAV Bashkia Sarandë, për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore në fund të vitit 2022 për taksën e tokës bujqësore është 25,675 mijë lekë, e cila në krahasim me fillimin e vitit 2021 është rritur me 2,036 mijë lekë. Përgjatë vitit 2022 janë gjithsej 1652 familje debitore për vlerën 4,381 mijë lekë. DAV Bashkia Sarandë, arkëtimin e kësaj takse e mundëson vetëm kur familjari/personi që ka në përdorim/pronësi tokë bujqësore, aplikon pranë Bashkisë Sarandë, për të marrë një vërtetim/shërbim të caktuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pika 2 në nenin 89 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pika A.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Sarandë, për vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitoare prej 25,675 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

#### **Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Sarandë, u konstatua se deri Më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 22,515 mijë lekë. Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Sarandë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përbarimit gjyqësor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës 22,515,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**15.2. Rekomandimi:** Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, 36 gjoba në vlerën 521,000 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese si dhe nuk janë aplikuar kamat vonesa sipas ligjit në fuqi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 521,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e TNI për disa nga objektet me lej ndërtimi dhe përdorimi, rezulton se nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash për Bashkinë Sarandë, në shumën **2,887,019 lekë, konkretisht:**

**1.** - Leja me nr. 536 datë 19.09.2022, për subjektin ndërtues “K.U.K” Shpk, me zhvillues Xh. M., për objektin: “Hotel 4, 5 dhe 6 kate me 4 kate nëntokë” adresa e realizimit të punimeve: Rr. “B.”, Bashkia Sarandë

Nga fatura e ngarkuar në sistemin “e-Leje” për këtë praktik pasqyrohet se është paguar shuma 5,136,071 lekë. Duke u bazuar mbi vlerën e preventivit që është 263,582,227.43 lekë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paketës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe 263,582,227.43 lekë  $\times 0.03 = 7,907,466$ . Ka një diferencë prej **2,771,395** lekë shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

2.-Leja me nr. 456, datë 15.02.2022 (2415) dhënë subjektit ndërtues “M&S K.” Shpk, zhvilluesit: Z. F., .Leja e ndërtimit për objektin: “Shtesë 2 kat në objekt ekzistues 1 kat, në funksion të Turizmit: NJA Ksamil, Bashkia Sarandë. afati kohor i kësaj leje është: 24 muaj.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë sipas paktës fiskale të miratuar është 3% të investimit për këtë kategori investimi dhe preventivi është 15,476,498 lekë  $\times 0.03 = 464,294$ . Kemi një diferencë prej **115,624 lekë** nga fatura e paguar me atë të llogaritur, shumë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; ligji nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015, datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **2,887,109 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera **2,771,395 lekë** nga investitorit **Xh. M.** .

- vlera **115,624 lekë** nga investitori **Z. F.** .

**Menjëherë**

#### **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimin e 9 procedurave me vlerë të fondit limit **137,262 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura **me vlerë kontrate 130,882 mijë lekë** ose 95 % e vlerës së Fondit Limit, në të cilat kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Nga auditimin e 9 procedurave në 2 (dy) procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **69,595 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP procedura **me vlerë kontrate 68,924 mijë lekë** ose 99 % e vlerës së Fondit Limit ofertat ekonomike të OE të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në 2 (katër) procedura për vlerë kontrate **68,924,867 lekë pa Tvsh, respektivisht:**

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “A. Sh”, Sarandë”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **6,666 mijë lekë**, me fitues OE “A-C.” Shpk, me vlerë të ofertës **59,595 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

a. Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “V. K.”, Shpk. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “V. K.” Shpk, me ofertë 59,085 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **59,085,587 lekë pa Tvsh** (7,542,660lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikualifikim i rrugëve të brendshme në Gj. , M. , dhe Sh.* ”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **7,500 mijë lekë**, me fitues OE “A. C” Shpk, me vlerë të ofertës **6,751 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikualifikim i hapësirave me lulishte dhe stola, Rr. “A. Ç.” mbi A. Sh., mbi komisarariat dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme V., M, Kodër*” Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **10,000 mijë lekë**, me fitues OE “M. /” Shpk, me vlerë të ofertës **9,839 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “M. /” Shpk. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “M. /” Shpk, me ofertë 9,839 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **9,839,280 lekë pa Tvsh**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Rikualifikim i rrugëve të brendshme në L. nr. dhe rikualifikim i rrugëve të brendshme në lagjen “L. D.”*”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **9,166 mijë lekë**, me fitues OE “I. /D.” Shpk , me vlerë të ofertës **8,265 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Riveshje Rr. “M D.”, Sh. & Trotuari Rr. “L. T.” dhe rikualifikim i Rr. “J, K.” Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **9,333 mijë lekë**, me fitues OE “N. -” Shpk , me vlerë të ofertës **8,760 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikualifikim ....”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **16,666 mijë lekë**, me fitues OE “J. K.” Shpk, me vlerë të ofertës **15,329 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Lyerje fasadash për L. nr. , Kodër”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **10,833 mijë lekë**, me fitues OE “V. K.” Shpk, me vlerë të ofertës **10,576 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sinjalistika horizontale, vertikale”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **7,083 mijë lekë**, me fitues OE “S. R. S. S. ” Shpk , me vlerë të ofertës **5,454 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion të sallës së mbledhjes në bashki”, Bashkia Sarandë, Viti 2022, me fond limit **7,083 mijë lekë**, me fitues OE “A. C” Shpk, me vlerë të ofertës **6,820 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 79-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike prej 69,959 mijë lekë.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**1.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Sarandë, në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (*Njësia e Prokurimit*), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret e vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**E. MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gërmat “b”, “c” dhe “ç”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 gërma “b”, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Sarandë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**